

*Bashkia Shkodër  
Biblioteka  
"Marin Barleti"*

- *Editorial* ▪
- *Albanologji* ▪
- *Histori* ▪
- *Tradita arsimore* ▪
- *Letërsi-Art-Kulturë* ▪
- *In memoriam* ▪
- *Personazh* ▪
- *Bibliofili* ▪
- *Reçensione* ▪
- *Kronika kulturore* ▪
- *Veprimtari* ▪

# Gegnia

e përkohshme  
kulturore-artistike

*10 - 2019  
Vjeti IV i botimit  
Shkodër*

## **Gegnia**

E përkohshme kulturore-artistike

ISSN: 2519-73-91

10-2019

Vjeti IV i botimit,

Shkodër

### **Redaksia:**

Maxhid Cungu, Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija

**Redaktor gjuhësor:** Erzen Koperaj

**Botohet nën kujdesin e Bashkisë Shkodër dhe bibliotekës “Marin Barleti”**

**Adresa e redaksisë:** Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

**E-mail:** [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

[info@bibliotekashkoder.com](mailto:info@bibliotekashkoder.com)

**Shënim:** *Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

## **Përmbajtja**

### **▪Editorial▪**

*Hans-Joachim Lanksch ambasador i kulturës dhe letërsisë shqiptare në Evropë.....*

### **▪ Albanologji▪**

Prof. Karl **GURAKUQI**, Nobert **JOKL**. *Populli shqiptar dhe gjuha e tij.....*

Ardian **NDRECA** *Norbert Jokl: Fati i një biblioteke.....*

Mark **PALNIKAJ** *Dokumenti i Stefano Gasparit i vitit 1671, historiku i shkruarjes dhe publikimi i Tij*

Gjovalin **ÇUNI** *Skedë biografike dhe autoriale për Marin Barletin.....*

### **▪ Histori▪**

Bajram **XHAFI** *Hamza Kuçi-një luftëtar i madh i kombit dhe shtetit shqiptar.....*

Gëzim H. **JUKA** *14 Maji i vitit 1913...*

*Shkodra në Kongres të Lushnjës në 1920.....*

### **▪ Tradita arsimore▪**

Njazi **KAZAZI** *Vështrim historik për kualifikimin e mësuesve dhe puna e kabinetit pedagogjik....*

### **▪Letërsi-Art-Kulturë▪**

#### **Poezi**

Rozafa **SHPUZA** *Dyer pa çilca, poezi.....*

#### **Kritikë letrare**

Xhahid **BUSHATI** *Poetika në përjetimin lirik të një proze poetike.....*

Arben **PRENDI** *Poetizimi i gjendjeve metafizike komplekse në poezinë e Pal Ndrecajt.....*

A. **PRENDI** *Një sprovë leximi e vëllimit poetik Carpe Diem të Arjola*

*Zadrimës.....*

### **▪In memoriam▪**

Fatmir **JUKA** *Ndoc GURASHI (1925-shkurt 2018)*

### **▪ Personazh▪**

Palokë Zef **KURTI** *Palokë Kol Kurti- Muzikant, drejtues muzike dhe poet i spikatun.....*

Fritz **RADOVANI** *Trimi i maleve Martin Sheldija.....*

Skënder **TEMALI** *Vehbi Bala – një zë i veçantë në kulturën shqiptare.....*

▪**Bibliofili**▪

Fatmira **LEKIQI** *Një vështrim bibliografik mbi krijimtarinë e Frang Bardhit.....*

Stela **KARAFILI** *Bibliografi e veprës së Lluka Karafilit.....*

Albana **KOMI**

▪**Recensione**▪

Erzen **KOPERAJ** *“Banorët e Alpeve” të W.Obermueller si një ftesë për të rimarrë çështjen e origjinës së shqiptarëve.....*

*“Saga shqiptare e dhembjes” e Fatbardha Saraçit -libër kundër harresës dhe fantazmave të së kaluemes komuniste.....*

*Vlera e shumanshme e librit “Sheuqet Muka, Shkodrani” të autorit Adnan Muka.....*

▪**Kronika kulturore**▪

*“Dante continua....”.....*

*70- vjetori i Teatrit “Migjeni”.....*

*At’ Fishta e ka vendin në komunikim jo në muzeum.....*

*Dibranët e Shkodrës.....*

▪ **Veprimtari** ▪ .....

## HANS-JOACHIM LANKSCH AMBASADOR I KULTURËS DHE LETËRSISË SHQIPTARE NË EVROPË

U ba ma shumë se gjysëm viti, prej vdekjes së Hans-Joachim Lanksch (1943-2019). Pa dyshim ai i meritoi me punën dhe kontributin e tij cilësimet *mik të shqiptarëve, ambasador i kulturës dhe letërsisë shqipe, mjeshtër i replikave* kundrejt problemeve të mëdha të trashëgimisë kulturore. Ndoshta tek kjo e fundit duhet kërkuar edhe ndonjë gjurmë heshtjeje. (Tek *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, shtypun në shtypshkronjën “Kristalina-KH” Tiranë 2008 (botimi i ri), botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nuk ka ndonjë za për albanologun Hans-Joachim Lanksch. As tek *Fjalori Enciklopedik* i Pasho Bakut (organizator: Selim Hoxha), ku ka personalitete, shtete, popuj, fakte, doktrina, terma, art, kulturë, shkencë, letërsi, gjeografi, histori, filozofi, kimi, fizikë, muzikë, sport etj, mungon emni i Hans-Joachim Lanksch).

Në të vërtetë, çdokush që e ndjek letërsinë, mund të dijë se Hans-Joachim Lanksch, i lindun në RFGJ, shkoi të studionte në Mynih për filologji ballkanike e kulturë popullore, ku u njoh me prof. Martin Camajn. Kjo gja e lidhi me letërsinë shqiptare, prej së cilës nuk u nda. Përktheu në gjuhën gjermane një numër të madh veprash të shkrimtarësh shqiptarë, kryesisht në poezi, por edhe në prozë, e nga disa breza, si: Martin Camaj, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Kasëm Trebeshina, Lasgush Poradeci, Fatos Arapi, Visar Zhiti, Frederik Rreshpja, Elvira Dones, Ridvan Dibra, Primo Shllaku, Mimoza Ahmeti, Luljeta Lleshanaku, Lindita Arapi, Agron Tufa, Jamarbër Marko, Rudolf Marku, Ledia Dushi, etj. Penda e tij bani të ndiheshin mirë gjermanisht shkrimtarët e poetët tanë e për këtë u laureua me disa çmime, si: “Nikolaus Lenau” i Shoqatës së Artistëve në Esslingen (1999); “Penda e Argjenditë” (Tiranë 2002) dhe “Azem Shkreli” (2018).

Pavarësisht miqësisë, ai thotë se nuk ishte Camaj, që e shtyu të fillonte përkthimin nga shqipja: *Kurrë nuk kam vendosë me u bâ përkthyes i Camajt a lëre i poezisë shqipe*, - rrëfen ai në një intervistë. ... - *mbetesha mjaft skeptik – dihet se, zakonisht, letërsia e profesorave dhe e diplomatëve është e dobët... Kur u ballafaqova me poezitë e Martin Camajt, më magjepsi bukuria e tyne...*

Në punën si përkthyes, ai joshej nga bukuria e asaj që donte të përkthente e, meqë e quante veten *njëfarë fanatiku të së vërtetës dhe drejtësisë*, donte të përcillte po atë bukuri në gjuhën e tij. Kjo e bëri të kërkonte ma thellë, sepse përkthimi ishte diçka përtej gjuhës, siç e shpreh edhe vetë: *Këtu, me siguri, është në mes edhe diç si afinitet për një gjuhë dhe botën shpirtërore, e cila qëndron prapa saj...*

Lanksch e çmonte letërsinë shqipe: *... në letërsinë shqipe, ka pasur dhe ka autorë, që ishin dhe janë krijues të vërtetë... krijimtaria e shkrimtarëve të tillë meriton të njihet edhe përtej trojeve shqiptare dhe do të ishte një padrejtësi e padurueshme, po që se nuk do ta kapërcente barrikadën e gjuhës ...*

Bukurinë e poezisë shqipe Lanksch e pa në mbështetjen e saj në rranjët e stërlashta arkaike, mbasi kishte bindjen se *përqendrimi në esencialen e qëruar na sjell një modernitet të vërtetë*, në një kohë si tonën që shquhet për humbje vlerash.

Lanksch nuk e mbante veten si studiues të letërsisë, por tha dhe bëri për letërsinë shqipe shumë gjana të vlefshme. Ai e pa letërsinë shqipe, si larmi dhe begati të një tanësie dhe *jo si trikatër-pesë asosh (letërsitë e Shqipërisë, të Kosovës, të Maqedonisë, të ngulimeve arbëreshe dhe të diasporës)*. Për me tregue arritjet e saj i referohej Ali Podrimjes (në Kosovë, me nominimin në raundin e fundit të kandidatëve për një nga Çmimet europiane të poezisë, në Holandë), Kim Mehmetit (në Maqedoni, si kandidat për një nga Çmimet europiane për prozë të shkurtër, në Gjermani), Martin Camaj (në Gjermani, si shqiptar *kandidat për Çmimin nobel*) dhe nuk hezitonte me vlerësue se edhe Kasëm Trebeshina asht kandidat tepër i denjë për këtë çmim, ashtu si citonte një miniaturë që e quante *të mrekullueshme* të poetit arbëresh *Pietro Napoletone*: *“Bën tëtim” (tëtim = ftohtë)*.

Përbashkësinë shqiptare të letërsisë e lidhte me gjuhën dhe traditën. Kështu, thoshte se Camaj *... nuk e nxori diaspora, mërgata a ekzili, por tradita e letërsisë shqiptare dhe thesari i traditave gojore të Shqipërisë së Veriut*.

Tue e pa gjuhën dhe traditat si pasuri, asnjë ma qartë se ai, nuk artikuloi një qëndrim të qartë karshi lëvrimit të gjuhës, të cilën e shihte ma shumë se një mjet për shprehjen letrare.

Ai tregoi se unifikimi dhe shqiptarësia e letërsisë nuk kishte lidhje me nivelimin e krijimeve letrare në vise dhe kënde të ndryshme të hapësirës kulturore shqiptare. Për të kjo do të ishte *shlyerje e shprehjes individuale, zhdukje e karakterit të veçantë dhe sharmit të posaçëm të krijuesve të një rajoni shqipfolës*.

Ishte ironik dhe i vendosun, kur thoshte se *futja e kostallarishtes në të gjitha trojet shqipfolëse ... i bën njëlloj ... monotone dhe monokrone bukuritë e ndryshme natyrore të pejsazheve të letërsisë shqipe*, por këtë nuk e barazonte me mosbashkimin e shqiptarëve nën një standard gjuhësor të përbashkët kur sqaronte: *... kjo nuk do të thotë se jam kundër, kurrsesi. ...por jam kundër “unifikimit” të përdhunshëm e të rrejshëm ... çoroditjes së gjuhës dhe masakrimit të kulturës.*

Kur fliste për përdorimin e dialekteve, nuk e bante në emën të provincializimit të kulturës, as të klaneve, as të ndonjë politike, por në emën të raportit të brendshëm psikik që ka gjuha me njeriun: *Për një shkrimtar që flet dhe mendon gegnisht, të shkruemit gegnisht më duket mënyra më e natyrshme shkrimi. Nëse një shkrimtar geg sheh andrra në gjuhën e njisueme, le të shkruiejë njisuemisht.*

Nuk e ngatërronte asnjë lloj politike me letërsinë e gjuhën. Kundërshtonte dhe ironizonte shpërdorimin e gjuhësisë për qëllime jashtëgjuhësore, shpërdorimin e shkencës për synime joshkencore .. si dhe zbatimin e kriterëve jashtëgjuhësore për vetë gjuhën.

Ishte kritikues i fortë i politikave jofavorizuese për përhapjen e letërsisë shqiptare. Me atë të folur in troç të tij, tregonte se *... tjetër është interesimi për letërsinë shqipe dhe tjetër është interesimi për veprat e kryeshkrimtarit a gjeniut të saj. .... Tjetër është interesimi i shtëpive botuese dhe tjetër është interesimi i publikut lexues. ...Interesimi i botuesve është pothuaj i njëjtë me zero, ndërsa publiku lexues me sa vjen në kontakt me letërsinë shqipe entuziazmohet mjaft për të.*

Ky mik i shqiptarëve tërhiqte vëmendjen në fokusimin e letërsisë shqipe, si institucion. Tregonte për mbrëmjet letrare, leximet me dhe pa autorin përkatës, entuziazmimin e auditorit, duartrokitjet me bollëk dhe pyetjes pa përgjigje “Ma shumë!”. Ai kishte bindjen se *letërsia shqipe has në pëlqim të madh “jashtë”, po qe se e gjen rrugën deri te lexuesi e dëgjuesi.*

Nuk nguronte ta krahasonte hapur këtë gjendje të letërsisë shqipe me *gjendjen e letërsive bullgare, hungareze, rumune, polake, çeke etj. në Gjermani*, për të cilat thoshte se *përfaqësohen e njihen fort mirë*. Tregonte se *në tregun gjerman të librit botohen përvitshëm mbi 10 mijë vepra letrare të përkthyme nga gjuhë të ndryshme të huaja*, duke tërhequn vëmendjen se afirmimi i letërsisë shqipe nuk mund të bahet vetvetiu, por tue informue në vazhdimësi publikun gjerman për kulturën shqiptare.

Për raportin me letërsinë e realizmit socialist thoshte: *Krimi më i randë i stalinizmit ... , përveç dhunimit të së vërtetës, ka kenë kolektivizimi i letërsisë, shtypja e egër e individualitetit krijues. ...Kishte me kenë kobzezë – vazhdon ai- po të kishin rá në njëfarë kolektivizmi të ri, drejtue kundër kolektivizmit të vjetër. ... Pseudoletërsia naziste gjermane nuk lexohet ma, por nuk u harrue ekzistimi i saj. ... Nuk harrohet turpi i historisë së letërsisë gjermane ... që himnizonte nazizmin, ideologjinë dhe udhëheqësin e tij.*

Ishte kategorik kur thoshte se nga letërsia e realizmit socialist, duhet me shpëtue, *çka meriton të shpëtohet ... ashtu siç ishte kategorik edhe kur thoshte se ... letërsia dhe shqyrtimi i saj duhet me u lirue nga diktati i çdo pushteti a drejtimi politik...*

Nuk e dimë çfarë mund të kenë mendue disa me vete, kur shkruante: *... përdorimi i shkathët i instrumentarit estetik nuk e kthen në letërsi zbukurimin e himnizimin e një regjimi totalitar... apo kur citonte shkrimtarë që kanë krye një aksion me krah të kundërt me përpjekjen komuniste ...*

E adhuronte Camajin, sepse *... letërsinë e kishte obsesion dhe jo "mision". Kurse për vete thoshte se vuante nga translatopatia: është një terapi nga më të këndshmet dhe më kënaq pa masë.*

I donte shqiptarët dhe artistët shqiptarë, por kjo nuk e ndalonte t'u thoshte se *...është kollaj të kesh një dushman për të gjitha fajet ... S'është e vërtetë se veprat letrare mund të shkruhen vetëm në qetësi e paqe. ... presioni nxjerr kulmet e poezisë nga poeti... Ashtu siç thoshte hapun se ... Duket se ka shqiptarë të pandërgjegjshëm e të paskrupujt, që janë ndër dushmanët më të mëdhenj të shqiptarëve, ... tregtarë të pandërgjegjshëm dhe kontrabandistë me pseudovlera letrare.*

Nuk u lodh së promovuem i pena të reja të letërsisë sonë, inkurajoi individualitete letrare, i apeloj që të vazhdojnë rrugën e tyne individuale të shkrimit të një letërsie aspak të lehtë, të mos lëshojnë pe e të mos bajnë asnjë kompromis.

E përdori ma se një herë: *Do të përgjigjem me ashpërsinë e mikut të singertë dhe vërtet ashtu ishte: mik i mirë, sepse nuk ngurroi të thoshte fjalën e tij për çështje të rëndësishme, kur e dinte se duhej t'i thoshte, se ishte e randësishme t'i thoshte, pavarësisht gjykimit të klaneve e klikave të vjetra apo konjunkturave të reja.*



▪ Albanologji ▪

**Karl GURAKUQI**

MIS I INSTITUTIT MBRETNUER TE STUDIMEVET SHQIPTARE

**Nobert JOKL**

**POPULLI SHQIPTAR DHE GJUHA E TIJ**

( vijon nga IV/2019, nr. 9, f. 10-19)

Gjuha e shqiptarve ka mbetë si një i vorfen i familjes gjuhesore indo-germane<sup>1</sup>. Ndërsa në fushën e disa gjuhve motra një radhë e palodhshme gjurmuesish na ka parashtuem me një vullndet të papërkulun gadi të gjitha problemat në pikpamje të historisë dhe të studimit gjuhësuer, tue i zgjidhë në shumë drejtime. Fusha e gjuhës shqipe prët ende sot zgjidhjen e një sasi shumë të madhe çashtjesh. Këtu shofim një godinë po thyejse të kryeme, atje na bjen në sy një ndërtesë, së cilës i janë vúm themelet, mbi të cilat është punue me zell dhe është pritë prej një dite në tjetren mbuloja e saj, por ka ngelë e paplotësue me për shkaqe të ndryshme. Arsyet pse gjurmimi i gjuhës shqipe nuk ka përparuem aq tepër, janë të mbrendshme dhe të jashtme, të mbrendshmet e kanë burimin në rrethanat e vetë gjuhës, pse nuk është punuem ashtu sa duhet ase është mbushë me elementa të huej, edhe pse dokumentet e saj janë relativisht të rij, të cilët fillojnë vetëm në shekullin XVI; rrethanat e jashtme, të cilat deri tash e kanë penguem rrugën e një gjurmimit të dendun e të hollësishëm të shqipes mbështeten edhe në gjendjen e mbrapametun të kulturës së përgjithshme të vendit, e cila paraqet vështirësitë më të ndryshme shoqnore teknike dhe hygienike për gjurmimin sistematik të dialektevet, për një mbledhje rrënjësore të visarit gjuhësuer dhe për tjera gjurmime të kësaj natyre.

Prandaj të na lejohet t’ia shtjellim ma haptas këtë pikpamje tue parashtuem një pasqyrë mbi VENDIN DHE POPULLIN E SHQIPTARVET tue cekë shkurtazi FATIN E JASHTËM TË GJUHËS SË TIJ DHE PERMENDOREVET TË SAJA

Populli shqiptar i paraqet gjurmuesit të gjuhës së tij problema tërheqse për studim. Gjuha e këtij populli flitet në bregun linduer t’Adriatikut, përafërsisht ndërmjet shkallës 39 e 42 të

---

<sup>1</sup> Nxjerrë nga libri: “Die Erforschung der indogermanischen Sprachen” . Zëites Buch.II. Albanisch .Strassbur, Verlag von Karl J. Trübner, 1917, Faqe 109-151.

gjansisë dhe jo vetëm në viset më të skajshme të kësaj zone, përhapet kah veri-lindja deri në krahinat e fushës së Kosovës dhe Maqedonisë prendimore (Kumanovë, Kaçanik, Tetovë, Shkup, Manastir) përpiqet në jug dhe jug-lindje nga Saranda deri në Malet e Gramozit me kombsinë dhe gjuhën e greqishtes së re, kufizohet më në fund, tue kaluem nëpër Kostur, deri në brigjet e liqejvet të Prespës dhe t'Ohrit dhe pranë Dibrës, me dialektet bullgare të Maqedonisë.

Ai që dishiron të thellohet më mirë dhe të njohë më me themel këta kufij gjuhësorë të shqipes, që na parashtruem në vijat të përgjithshme për sa na lejoi shtilli i këtij studimi, mundet me nxjerrë njoftime më të plota në veprat e J. G. von Hahn-t ("Albanesische Studien", Eien, 1853) të E. Barbarichi-t ("Albania", Romë, 1905) të Veigandit ("Die Aromunen", 1, Leipzig 1895) në kartat ethnografike të Kiepertit (të ribotueme në vjetin 1902) në veprën e C. Sax-it ("Mitteilungen der Geographischen Gesellschaft in Eien, 1878), ndoshta, edhe por më masë dhe më urti në paraqitjen kartografike të Cvijici-t ("Pelermanus Mitleilungen", 1913) që është më qëllime të këqija. Prej këtyne do të shihet se sa e ndërlikueme është gjendja e gjuhvet dhe e popujvet në disa vise kufitare (si në fushën e Kosovës, Maqedoninë veri-prendimore, Novipazarin në brigjet e Detit Jon) dhe qysh prej qinda e qinda vjetësh pa pushim turmat shqiptare mujtën pak nga pak me u dhanë këtyne viseve gjurmën e jetës së vet. Kjo ndjenjë luftarake e këtyne bijve të thjeshtë të Shqipnisë, zbashku me lodrat e politikës byzantine që ndryshonte herë pas here, shtrini kombësinë dhe gjuhën shqipe deri thellë në Greqi dhe i hapi vetes rrugë ndër krahinat që patën frymën e kujtimeve klasike si në Atikë, Megara, Helikon, Beoti, Argolis dhe Meseni, madje edhe ndër ishujt si në Salamís dhe Egine. Por edhe jashtë gadishullit të Hemusi-t u themeluen shumë koloni shqiptare, sidomos në Itali e në Sicili, më e vjetra e të cilave mrrin deri në gjysmën e shekullit XV.

Në këto krahina të Shqipnisë së vërtetë e cila për gjurmuesin e gjuhës shqipe nuk është e njajtë me Shqipërinë e krijueme nga diplomatija e shtrembët e vjetit 1913, banon një popull i pa përparim. Shkallët e zhvillimit të një pjestimi shoqëror, që përshkruen të gjithë popujt edhe ata më të përparuemit e Europës qëndrore dhe prendimore, u rrejtën këtu, sidomos në pjesën veriore dhe qëndrore, të pa përkrituna nga rrethanat e ndryshme të kohës. Kësë dore ethnologjia dhe historija e së drejtës mund t'i gjejnë këtu dokumentat e një veprimtarie të gjallë.

Këtu mbretnon një kushtetutë fisesh, me rrjedhimet e veta të domosdoshme d.m.th. lidhja e ngushtë individuale, nderimi i madh për "patria potestas", gjakmarrja dhe çmimi i gjakut, detyrimi i luftës dhe Besa, asnjë ligjë shtetnore, kurrënjë gjykatë e vendosun nga autoriteti epruer i

vendit nuk kujdeset për mprojtjen e jetës të liris dhe të pasunís: fisi ásh mprojtësi ma i nalti i rregullimit të së drejtës. Ky vepron simbas kanunit të lanun djalë pas djali nga të parët, krejt áшту sikurse veprohej pranë Germanëve të kohës së Karolingëvet dhe të Mesjetës, sikurse Anglo-saksonët në kohën e mbretënvët të tyne. N’asnji kand të këtij vendi nuk gjinden rruga hekuri, nuk shifen ura (edhe pse aty – këtu mund të takohen ndonji)<sup>2</sup>. Lumejt kapërcehen me govada të bame nga trungje lisash dhe me anë shakujsh dhije dhe, kur ujnát e lumejvet e përmbysin tokën e nuk mund të kalohet prej një bregu në tjetrin, atëherë marrëdhانيت ndërmjet katundevët priten për shumë javë me rradhë.

Asht prandej krejt e natyrshme, qi edhe gjuha, kjo vegël shumë fisnike për bashkimin shoqnuer të popullit, ka psuem ndryshime të mdhaja. Sasia e madhe e ndryshimevët dialektore lidhet ngusht me ndryshimet e ndryshme shoqnore, të cilat kanë penguem qi të krijohet një bashkim i plotë shtetnuer dhe njikohësisht një lidhje e fortë marrëdhaniesh, kështu qi njëni fis me tjetrin janë shikuem si të huej, madje si anmiq ndërmjet vedit. Por, duhet pranuem, se edhe gjendja e natyrshme e tokës e ka pasë gishtin e vet në ndryshimet e shumta të dialektevët.

Nuk lypset të harrohet se Shqipnija ásh një vend kundërstisjesh të mëdhaja morfologjike dhe klimatike: prej visevët bregore me klimën e tyne oqeanike dhe bimsís tyne mesdhetare, qi në disa krahina ásh shumë e plleshme, deri në bjeshkët me borë t’Alpëvet veriore, deri në malin Tomorr, qi ásh i shenjtë për shqiptarët e deri në fushat mâ të mdhaja të lumejvet të Shqipnis së Mesme, takohen njëna me tjetren klimat dhe florat mâ të ndryshme. Përveç kësaj, malet e nalta të këtij vendi nuk janë të përshkueme, sikurse Alpet, nga lugina lumejsh qi lejojnë komunikacione, me anën e të cilave sillet fryma e qytetnimit, por përkundrazi, nga shkaku i mungesës së rrugëvët, nuk janë të përshtatuna për vende banimi dhe nuk lejojnë qi plugu dhe parmenda të sjellin bekimin e punimit të tyne. Jo vetëm këto, por as malet mesatare nuk japin mundësinë e një popullsimi mâ të dendun.

Këso dore shofim se edhe grupimet e shkapërderdhuna shoqnore dhe ndryshimet e shumta dialektore shkojnë krahas me natyrën e sipërfaqes së tokës. Me gjithë këtë, vëmë re se të gjitha dialektet e ndryshme të luginavët malore, të krahinavët bregore dhe të visevët të lumejvet sajojnë dy bashkësi të mdhaja dialektesh, d. m. th. **gegnishten** në veri dhe në Shqipnín e Mesme, dhe **tosknishten** në jug. Si kufi i këtyne dy djalekteve, simbas gjykimit të popullit, caktohet lumi i Shkumbinit. Por dialekti gegë mrrijnë aty-këtu kah jugu edhe përtej këtij kufini.

---

<sup>2</sup> Auktori ketu flet për gjëndjen e Shqipnis para vjetit 1917.

Sido qi të gjykohen ndryshimet ndërmjet gegnishtes dhe tosknishtes (mbi këtë gjâ do të flas gjatë këtij studimi), prap se prap nuk mund të pranohet mendimi qi është ndigjuem aq shpesh, se ndryshimet dialektore të gegnishtes dhe të tosknishtes janë si ato të svedishtes e të germanishtes. Mâ i arsyeshëm dhe mâ me vend është pohimi i J. G. von Hahn-it, i cili e krahason gjendjen e dy grupeve dialektore shqiptare me ndryshimet qi janë ndërmjet germanishtes së naltë dhe asaj s'ultës.

### **Shqipja nuk është një gjuhë e përzieme**

Me gjithë se toka shqiptare ka karakteristika të veçanta dhe ndonse vendi shqiptar është i egër dhe i fortë, kështu qi është i mbyllun për të huejin, prap se prap këto kushte nuk kanë mujtë me penguem, qi pushtues të huej qysh prej kohvet të vjetra të mos përshkoheshin here pas here e pa pushim nepër të.

Këtu ndoqën njëna tjetrën periudhat e pushtimit nga ana e Romakëvevet, e Gotvet, e Sllavëvevet (Serbë e Bullgarë), Byzantinëvevet e Turqvet. Vetëm një periudhë të shkurtër kreshnike, por të lumnueshme, të një vetëqeverimi shtetnuer e gëzoi populli shqiptar në shekullin XI nën udhëheqjen e Fatosit Kombtar, Skandërbeut.

Por sundimi i pushtuesve të huej nuk qe aq fort rranjësuer.

Ajo gjâ qi mujt me u vrejte gjatë sundimit turk të zhdukun tash pak kohë, d.m.th. ndikimi i pakët qi ky sundim pati në formimin e mbrendshëm të jetës së popullit, në kanunin e fisevet dhe në pjestimin e shoqnís me të gjitha rrjedhimet e thella, vlen së paku deri në një farë shkalle edhe për pushtimet e mâparshme. Por do t'ishte gjâ krejt e gabueme, po të dojshim me e mohuem ase edhe vetëm me e përçmuem ndikesen e pushtuesvet të huej, sidomos t'elementit romak. Këso dore gjuha shqipe, sidomos fjalori i saj, ka rrujtë teprica prej të gjitha këtyne ndikesave rrethanat e ndryshme luftarake, qytetare kanë futë herë pas here të hueja, të marruna uhá nga gjuhët e pushtuesvet.

Por a mund të themi, qi për shkak të këtij mozaiku të jashtëzakonshëm të fjalorit, se shqipja është një gjuhë e përzieme, e sidomos se ajo duhet të quhet një gjuhë e përzieme gjymës-romake? Kjo është një çashtje për t'u rrahë, të cilën auktori i këtyne rreshtave beson se mund ta mohojë. Duhet të dihet se ndikesa huej lypset të kërkohet në krejt ndërtimin e fjalivet, dhe vetëm kjo ndikesë mund t'a vërtetojë përdorimin e fjalës "Gjuhë e përzieme". Përziemje gjuhësore në kuptim të gjanë kemi gjithkund në botë, dhe dishmí për këtë fare përziemjeje gjuhësore në kuptimin teknik nuk na janë paraqitë në një mënyrë qi të na e mbushin mendjen. Porsi do qi të

jetë puna e çfarëdo qëndrimi të mirret në këtë çashtje, elementet e hueja kanë randësi për gjuhën shqipe vetëm për kohën në të cilën këto kanë hymë në të. Nji punë e tillë është shumë e randësishme sidomos për shqipen tue qenë se përmendoret e vërteta të saja gjuhësore vetëm shumë vonë kanë nisë të japin dritë në historinë e saj.

### **GjonBuzuku**

Përgjithësisht deri në këto kohët e vona, gjuhëtarët kanë pasë zakon t'i caktojnë përmendoret më të vjetra të shqipes në shekullin XVII, dhe kanë qitë krejt në harresë përkthimin Bibljes së Dom Gjon Buzukut, qi ruhet në Seminarin priftnuer grek-unit në Palermo dhe qi është i vjetit 1555<sup>3</sup>. Shkrimet e auktorvet italo-shqiptarë, si Guzzetta e Parrini, thuhet se e kanë përmendun shkurtazi qenien e këtij dorëshkrimi (ndonse shkruesi i këtij studimi nuk ka qënë në gjëndje t'i vërtetojë me sy shenimet përkatëse të këtyne shkrimtarve). Lajme më të gjata mbi ket dokument të vjetër shqip i kemi nga nji shkrim qi episkopi grek-unit i Palermit, Emzot Pal Skiroi i pat dërguem drejtorit të së përkohshmes amerikane shqipe "Flamuri"(Dielli) (Boston-Mass., 18 Mars1990, Nr:5), botimi i nji pjesë krejt të vogël të mbrendís së librit të Buzukut (faqe 58, shtylla 2, rreshtat 6-33, Kap17, vjershat 17-24) në revisten "Tomorri" (Elbasan, 1910, Nr.12-30, Qershor) na jep edhe mundësin të japim nji gjykim të përkohshem mbi gjuhën geqe të kësaj përmendorje. Nuk është nevoja të përmendet aq fort, se kjo vepër na paraqet dishmi të kjarta, të cilat i hapin rrugë dijtunís gjuhësore për nji gjendje më të vjetër, të gjuhës, tue studjuem vetitë e disa dialekteve qi fliten sot. Natyrisht do të fitojmë më tepër dritë mbi vleftën, zanafillën, e kohën e përpilimit dhe mbi caktimin e vendit të botimit të kësaj përmendorje vetëm atëherë kur do të kemi nji botim të plotë të saj, qi t'u përgjegjet të gjitha kërkesavet filologjike. Vetë Emzot Pal Skiro-i pat lajmue qysh në vjetin 1913 se do të bante nji botim (shif revisten "Fiala e t'inzoti", vjeti i Nr.47)<sup>4</sup>

---

<sup>3</sup> Këtu Norbert Jokl-i bjen në gabim, pse libri i Buzukut nuk asht nji përkthim i Bibljes, por përkthimet e pjesvet ma me randësi të liturgjis katholike; oficja e Zojës, shtatë Psalmet pendestare, disa pjesë të ritualit, etj. Prap Jokli gabon kur thotë se libri i Buzukut ruhet në Seminarin e Palermit. Puna qëndron kështu: Emzot Kazazi në vjetin 1740 e gjeti ket liber në Bibliothekën e Vatikanit, ku gjindet edhe sot; ky përshkroi me dorë faqen e fundit të librit dhe ai dërgoi At Gjergj Guzzetës, themeluesit të Seminarit të Palermit, kjo faqe ra në dorë ma vonë të At Pal Parrinit, i cili qe më i Drejtuer i Seminarit të naltpërmendun. Prej këtij libri At Justin Rrota bani tri kopje fotografike, prej të cilave njena gjindet në Bibliotheken Kombëtare të Tiranës (Shën. i përkthyesit)

<sup>4</sup> Ky botim lajmohet me këto fjalë: "Edhe pak ka të botohet veç te një fletë e shtume e "Fjalës t'in Zotit", libri i Dom Gjon Buzukut (1555), që kujtojnë të të shkrimet e tyre P. G. Guzeta, P. P. m. Parrini e Imzot G. Krispi(shenim i përkthyesit).

## Përmendore tjera shqipe

Kurse njohunit t'ona mbi shqipen e gjysmës së shekullit XVI tash për tash janë të pakta, jemi në një gjendje më të mirë për sa i përket fundit të këtij shekulli, pse prej kësaj kohe kemi një libër të vogël të gjetun në Bibliothekën e Vatikanit. Mark La Piana (qi është pseudonym i Gaetan Petrotës në Piana Dei Greci)<sup>5</sup> zbuloi në Cod. Barber latin 3454 një përkthim shqip të katekizmit. Këtë përkthim e kemi në tri përpunime dhe është i bamë prej Lukë Mantragës nga Piana e Arbreshvet dhe ka datën 20 Mars 1592. Teksti shqip dhe konteksti italisht i këtij katekizmi që botuem me një parathënë të bukur e me shënime prej vetë zbuluesit në revistën "Roma e l'Oriente" vjetit II, Nr. 18-23, është edhe si botim i posaçëm "Il catechismo Albanese di Luca Matranga", Grottaferrata, 1912<sup>6</sup>. Gjuha e këtij libri përgjithësisht na paraqet dialektin e sotëm t' Arbreshvet të Sicilís.

Përveç përmendorëve në dorëshkrim të bame të njoftuna në kohët e fundit, pati fatin të mos njihet deri vonë nga bota dijtunore, nga bibliografët dhe nga gjurmuesit e gjuhës. Asnjë botim i vjetit 1625 "Speculum Confessionis, in Epiroticam linguam a Petro Budi episcopo Sapatense et Sardanense translatum", Romae, 1621. Ky libër është një pasqyrë rrëfimi, e përkthyer në gjuhën shqipe nga Pjetër Budi i cili është prej një katundi afër Krujës<sup>7</sup> dhe që ka shumë meritim për gjuhën e vet amtare. Libri është shumë i rrallë<sup>8</sup>. Një kopje të tij e zbuloi shkrimtari Faik Konica, drejtori i së përkohshmes "Albania" në Bibliotekën Mazari të Parisit.

Dokumentat gjuhësore që na kanë mbetë nga koha përpara shekullit XVI, me mzi mund t'a meritojnë emrin "përmendore gjuhësore". Megjithatë, na jep një dishmi të çmueshme për shqipen e fundit të shekullit XV një listë e vogël fjalësh e cila gjindet në librin "Die Pilgerfahrt des Ritters Arnold von Harff von Coeln..." dhe që ky e pat përpiluem në vjetët 1496 deri 1499 (botuem nga E.V. Groote, Coeln, 1860) dhe që që ribotuem prej G. Meyer-it në librin "Albanesische Studien" 2, faqe 4-5.

Një 30 vjet përpara kësaj dishmije kemi edhe një dokument tjetër gjuhësor prej vjetit 1462 d.m.th. një formulë të shkurtër pagzimi e cila u gjet në një dorëshkrim latin të

---

<sup>5</sup> Mark La Piana nuk është pseudonym i at Gaetan Petrotës, por është emri i vertetë i një shkrimtari të vlefshëm edhe ky nga Piana e Arbreshvet të Sicilís. (Shën. i përkthyesit)

<sup>6</sup> Në vjetin 1931 At Justin Rrota botoi disa copa të zgjedhura e të komentuar për Shkollat e Mesme në titullin "Shkrimtari më i vjetër Italo-shqyparvet D. Lukë Matranga". (Shënim i përkthyesit)

<sup>7</sup> Katundi për të cilin flet N. Jokli është Guri i Bardhë në Mat. (Shënim i përkthyesit)

<sup>8</sup> Libri nuk është aq fort i rrallë, pse përveç disa kopjeve që gjinden në Seminarin e Palermit, e kanë edhe shumë vetë dhe mjaft Bibliotheka (Shënim i përkthyesit)

Bibliothekës *Laurentiana* dhe qi përmendet nga N. Jorga në librin “*Notes et Extraits pour servir a l’histoire des Croisades au XV-ième siècle*”( IV-ième serie, Bukarest 1915 faqe 194). Shkrimtarët shqiptarë Dh. Beratti dhe Lumo Skëndo (Mid-hat Frashëri) e kanë ribotuem këtë dishmi të vjetër të gjuhës së vet amtare (“*Tribuna Albano-Romana*” Nr. 7, Maj 1916, “*Diturija*,” moti i dytë, Nr. 1 faqe 5).

Të një kohe me fjalorthin e Von Harff-it duket të jetë një formulë martese, qi na e lajmon G. Krispi në veprën e vet “*Memorie storiche di talune constumanze appartenenti alle colonie graco-albanesi di Sicilia*”, Palermo 1953 faqe 88-89. Simbas Krispit, kjo formulë qe zbuluem prej Krye-epishkopit të Shkupit D. Gjon Battista Nikollë Kazazit dhe qe nxjerrë prej At Gjergj Guzzetës nga një dorëshkrim i Propagandës në Romë.

Për krejt kohën, qysh se Shqiptarët përmenden për herë të parë në Mesjetë (Michael Attaliota 1040-1043) deri në dishmit gjuhësore qi parashtruem ma sipër, jemi të shtrënguem t’u sillemi vetëm pak cekjevet të rasëshme emnash dhe fjalësh shqipe në dokumentat latinë-romakë, sllavë dhe grekë.

Vetëm me “*Dictionarium latino-epiroticum una cum usitatoribus loquendi formulis per Franciscum Blanchum*”, të botuem në Romë në vjetin 1635 fillon radha e vorfën e përmendorevet më të vjetra, qi janë më të njoftuna. “*Blanchum*”, qi gjindet në titullin e librit, është një përkthim nga shqipja *i bardhë*.

I sipër-përmenduni Pjetër Budi botoi në vjetin 1664 në Romë me qëllim propagande një përkthim të katekizmit të famshëm të Kardinal Bellarminit, “*Dottrina Christiana...Dal R. P. Roberto Bellarmino... Tradotta in lingua Albanese dal Rev. Don Pietro Budi da Pietra Bianca*.” Tue marrë parasysh vend-lindjen e Pjetër Budit, edhe kjo vepër është hartuem në dialektin gegë, sikurse përgjithësisht, tue përjashtuem përmendoret gjuhësore të kolonivet shqiptare t’Italís, çdo gjë qi kemi mbi dokumentat më të vjetër të gjuhës shqipe, do t’u dihet Gegvet katolikë të Shqipnís Veriore.

Në pikëpamje të mbrendís, të shkrimit dhe të gjuhës, kryet e vendit në këtë letërsi e zen vepra e Pjetër Bogdanit “*Cuneus prophetarum de Christo salvatore mundi et eius evangelica veritable, italic et epirotice context et in duas partes divisa*” Patavi, 1685. Vepra tjetër qi u botue në Venedik prej të njajtit auktuer në vjetin 1691 “*L’infallibile Verità della Cattolica Fede*” është e njajtë, përveç titullit, me veprën “*Cuneus Prophetarum*”, Bogdani qe prej një familje fisnike të Gurit të Hasit (krahinë e Dukagjinit në prefekturën e Prizrendit) ma vonë u ba episkop i Shkodrës

dhe pastaj pati drejtimin e Krye-epishkopatit të Shkupit, ky pat një kulturë të thellë skolastike-theologjike, zotnonte gjuhët klasike e shumë gjuhë tjera lindore, na la një vepër e cila nuk është vetëm një përkthim, por na parashton edhe një doktrinë të gjanë mbi sendet hyjnore dhe një histori biblike të shkrueme në një shqipe, në të cilën vihet në një zotsi stylistike dhe një pastërti gjuhe shembullore. Vepra e tij është një meritim i mbrekullueshëm, në qoftë se mendojmë se në kohën e tij ishte dhe, është gjithnjë sot, një gjuhë shumë pak e përparueme.

Nën Papën Klementi XI, i cili që prej gjakut shqiptar, u mbajt në vjetin 1703 një Kuvend shqiptar krahinuer vendimet e të cilit u botuen në vjetin 1706 në gjuhën shqipe gege “*Concilli Provinciali o Cuvendi i Arbënit*”, Romae.

Misionari *Francesco Maria Da Lecce* na la me veprën e vet “*Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*”, Romë 1716, një përpilim themeluer gramatike të gjuhës shqipe në dialektin gegë, i cili që shtyp në shkurtim, në *pasqyrat krahasuese të Vaters-it (Halla, 1822)*.

Në Chieutti (Capitanata, n’Italin e poshtme ) u gjet një dorëshkrim zanafilla e të cilit mrrin në vjetin 1737. Mbrendin e këtij dorëshkrimi na e paraqesin tri botimet e M. Marchiano-it 1) “*Canti popolari albanesi delle Colonie d’Italia*” Foggia 1908.

Kangët popullore të botueme në këtë libër përkojnë pjesërisht me kangët e mbledhjevet të maparshme (Basile, Vigo, Dorsa, De Rada “*Rapsodia e un poema albanese*”, Firenze, 1866, Camarda, Biondelli) dhe me ato të mbledhuna ma vonë nga A. Scura “*Gli Albanesi in Italia*”, Neë York (1912). Mbledhja e bame nga Marchiano-i mbështetet në një dorëshkrim qi e ka datën, por pa dyshim këto kangë përta i përket mbrendís së tyre, janë shumë mâ të vjetra se të shekullit XVIII.

2) “*Poesie sacre albanesi*”, Napoli, 1908 dhe

3) një katekizëm “*Il christiano albanese*” qi u botue në revistën romake theologjike “*Bessarione*”, vjeti 15, bleni 27, 185-217. Auktori i kangvet fetare dhe i katekizmit është Don Nikolla Figlia, kryepriifti i Mezzojuso-s në Siçili. Kolonitë shqiptare t’Italis kanë meritimin e poezís shqiptare në shekullin e XVIII<sup>9</sup> është libri i Varibobës ‘*Gjella e Shën Marisë së Virgjer*’ Romë 1762. Kjo vepër përmban jetën e Nanës së Krishtit në vjershë qi u ribotue në “*Grammatica Albanese*” (Manuali Hoepli, Nr. 253-254), Milan, 1897, të V. Librandit).

---

<sup>9</sup> Nuk i përgjegjë së vërtetës ky pohim, pse meritimin e parrë të vjershimit shqip e ka Pjetër Budi i cili në vj. 1618 botoi 19 poezi në strofa katërshe, tetërrokshe në mbarim të librit “*Dottrina Christiana*” (Shënim i përkthyesit)



Po të shtojmë edhe dy fjalorët e vegjël: të Kavaljotit “*Protopeiria*” Venedik 1770 (i ribotuem në “*Untersuchungen ueber Geschichte der oestlichen europaeischen Voelker*”) të Thunmmann-it, Leipzig 1774 dhe në “*Albanesischen Studien*” të G. Meyer-it, bleni 4) dhe të Danjelit “*Eisagogike dhidhaskalia*”, Voskopojë, 1770. Kemi parasysht për sa dimë deri sot, një pasqyrë të plotë mbi burimet gjuhësore për kohën deri në fillimin e shekullit XIX.

Mbi gjith atë, shkrimtari italo-shqiptar G. Krispi (“*Memorie sulla lingua albanese*”, Opuscoli, faqe 127 vrejti) na parashtron edhe dy dorëshkrime më të vjetra fjalorësh, të cilat ruhen në bibliotekën e Seminarit Shqiptar: njënin nga Catalano krye-epishkop i Durrësit dhe tjetri nga Nikolla Chetta. Prej këtij të fundit na paraqet vetëm një provë krejt të vogël. Një radhitje më e përpikët e këtyne shkrimeve është sot për sot e pamundur pse nuk dimë kurrëgjatë ma të sigurtë mbi mbrendin e tyre dhe mbi kohën e përpilimit. I pari i këtyne autorëve Catalano vdiq në vjetin 1694. Kot u përpoq Gustav Meyer-i për shfrytëzimin e këtyne shkrimeve .

### **Cilët janë Shqiptarët? – Qysh do të radhitet shkencërisht gjuha shqipe?**

Këto janë dy pyetje, me të cilat është marrë ditunija gjuhësore qysh prej themelimit të saj. Shum vjetë përpara Franz Bopp-it,<sup>10</sup> pra në një kohë kur nuk ishte rrahë ende hekuri për gjurmimin e këtyne problemave, u muer me këto çashtje në shekullin e vet mendja e hollë e njëj Leibniz-it<sup>11</sup> të cilin në fillimin e shek XIX e ndoqën edhe disa tjerë. Këtu nuk është rrasa të zgjatemi mbi këto prova të bëme përpara Franz Bopp-it. Vetëm duem të përmendim shkurtazi, se Leibniz-i në letër-këmbimin e vet me shkencëtarë t’asaj kohe e qi kanë një randësi dijtunore, shpesh here flet mbi fisnin gjuhësore të gjuhës shqipe dhe pranon një afërsi të kësaj me keltishten dhe gjermanishten.

Në vjetin 1774 Johann Thummann shkroi librin “*Untersuchungen ueber die Geschichte der oestlichen europaeischen Voelker*” (Leipzig, 1774)<sup>12</sup>, randësija e madhe e kësaj veprë në pikëpamje të mbrendisë së thellë u çmue ashtu si duhet vetëm nga shkencëtarët e shekullit XIX. Simbas këtij autori të vlefshëm, *shqiptarët kundrohen themelisht, në mbështetje të historisë, si pas-ardhësit e Ilirvet të vjetër*; ky mendim e kjo pikëpamje pat qenë çekë edhe nga Leibniz-i në njënen nga letrat e sipër-përmenduna.

<sup>10</sup> Franz Bopp-i lindi me 14 shtatuer 1791 ( Shënim i përkthyesit)

<sup>11</sup> Gottfried Leibniz lindi me 1 korrik 1646 dhe vdiq me 14 Nanduer 1716( Shënim i përkthyesit)

<sup>12</sup> “Gjurmime mbi historinë e popujve evropjanë të Lindjes

Në Leibniz-in dhe Thummann-in mbështetet kryesisht Malte-Brun-i,<sup>13</sup> i cili i kushton një bisedim të përmbledhun, por të randësishëm, çashtjes shqiptare në pikëpamje të racës dhe të fisnis gjuhësore në vëllimin III të veprës së vet “*Annales des voyages*” (Paris, 1809).

Shum të çuditshme janë pranë këtyne pikëpamjeve pohimet e Adelung-ut,<sup>14</sup> i cili ia nxjerr burimin gjuhës shqipe nga Bullgarët Tatarë ase nga një fis në lindje të Detit të Zi!

Malte-Brun-i pat parashtruem edhe më përpara mendimin se gjuhët europjane kanë afërsi njëna me tjetrën. Ky mendim, që u perhap gjithnjë më tepër sidomos nga përparimet shkencore të mbarimit të shekullit XVIII, u vu në shkallën e një pohimi me themel shkencor dhe ky meritim i përket veprës së Franz Bopp-it. Këso dore u krijue një dijtuni e ré, dijtunija krahasuese gjuhësore, edhe në këtë mënyrë u krijuan kritere të reja edhe zgjedhjen e problemës shqiptare.

Franz Bopp-i e rrahi çashtjen e gjuhës shqipe vetëm kah mbarimi i veprimtarís së vet, tue futë në rrethin e gjurmimevet të veta, prandej nuk duhet të na çudisë puna, se mu në mbështetje të përfundimevet të nxjerruna nga Bopp-i, u parashtrue pyetja:

#### **A është shqipja një gjuhë indo-gjermane?**

Kjo pyetje me randësi mori një kuptim dhe qëllim të veçantë vetëm mbas daljes në shesh të Franz Bopp-it. Edhe përpara këtij, kemi J.v. Xylander-in, i cili i pati dhanë një përgjegje pohuese kësaj pyetjeje në librin “*Die Sprache der Albanesen*” (Frankfurt a. M. 1835, f. 311), gjithashtu edhe August Schleicher-i në veprën e vet “*Die Sprachen Europas*” (Bonn, 1850) e mpron përmas ket mendim tue u kufizuem në një paraqitje të shkurtën, por methodike, të lakimit, të zgjedhimit, të numrorvet, etj. Këtij i u shoqne G. Stier-i, i cili prej njëj analize së hollë të numrorëvet dhe të verbit substantiv nxjerr përfundimin se shqipja ka karakter indo-german. (“*Allg. Monatschrift fuer Eissenschaft u. Literatur*”, 1854).

Por me ket studim tepër fragmentar të çashtjes u hap rruga për një gjurmim më të thellë e më të hollësishëm. Me gjith këtë, edhe vetë Bopp-i u rezervue të zgjatej në Gramatikën

---

<sup>13</sup> Konrad Maltebrun qe një geograf i përmendun, lindi në Thisted në Danimarkë me 12 Gusht 1755, mbasi kreu studimet e veta në Kopenhagen, u dallue në zotsí letrare. Prej vjetit 1803 deri 1807 botoi në 16 vëllime veprën e madhe “*La grande Géographie mathématique... de loutes les parties du Mondes*”, me të cilën fitoi një fame të madhe. Një përhapje më të madhe pati vepra tjetër “*Précis de la Géographie Universaille*” (6 vëllime, Paris 1810). Vdiq në Paris me 14 Dhetuer 1826. (Shenim i përkthyesit)

<sup>14</sup> Johann Christoph Adelung lindi në Spatenkoë në Pomerani me 8 Gusht 1722.

U dallue sidomos në filologji, shkroi shumë vepra dhe në vjetët e mbramë të jetës bëni planin e një vepre, që do të përfshinte të gjitha gjuhët e botës, por prej kësaj vepre botoi vëllimin e parë. Kjo vepër ka këtë titull : “*Mithridates oder allgemeine Sprachenkunde mit dem “Vater Unser” in beinahe fuenfhundert Sprachen und Mundarlen* , Berlin 1806-17. (Shenim i përkthyesit)

Krahasuese mbi këto parime të vërtetueme, të përrueme në systemën e zgjedhimit. Në punimin e vet *“Ueber das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen”* (Abhandl. D. Preuss. Ak. Der Eïss., Phil. Hist. Kl. 1854) që në gjendje të zhdukte çdo dyshim se shqipja i përkitte trungut gjuhësor indogjerman. Ndërkaq kjo pikëpamje mbeti e vetmueme e nuk u bâ pasuni e përbashkët shkencore për dijtunarët e kohës së Franz Bopp-it. Madje, deri A. F. Pott-i, që ishte një gjurmues i madh i kohës së Bopp-it, i mveshi shqipes, sikurse edhe keltishtes dhe armenishtes, *“nji natyrë të huej nga indogermanishtja”* me gjith indogermanizmat e shumta të tyre. (*“Blaetter fuer liter. Unterhaltung”*, 1854, f. 409 e përtej).

Kjo pikëpamje e shtrembët qindroi edhe për shumë vjet të tjerë, deri në atë kohë kur studimet shqiptare gjetën gjurmuesin e vet më të randësishmin, Gustav Meyer-in. Ky albanolog përpiqet të tregojë, por pa bazë, se numrorët e shqipes, që kanë një karakter të pamohueshëm indogjerman, kanë zanafillë të huej e sidomos sllave, kurse themelin e gjuhës, është e dijtun, vetëm me hamendje dhe pa parashtruem ndonji argument gjuhësuer, e paraqet si një tepriçë të fundit të një trungu gjuhësor ilir-pelasg, që përfshin krejt Europën jug-lindore dhe që mrrijnë edhe në Itali e në Azi të Vogël (*“Zur Literatur der Sprachenkunde Europas”*, Leipzig, 1887).

Sa për kurjozitet të përmendet mendimi, që bjen në kundërshtim me vetvedin, i Benloëes-it, i cili, pothuajse një të katërt shekulli mbas Bopp-it, në dy shkrime me një metodë krejt të gabueme: *“La Grèce avant les Grecs”* (1877) dhe *“Analyse de la langue albanaise”* (1879) përpiqet të mbrojë thezën që nuk mban, d.m.th. se shqipja largohet shumë nga grumbulli i gjuhvet indogjermane, dhe se përkundrazi ka afërsi me finishten dhe tatarishten. Leibniz-i pati këshilluem me një gjykim të mprehtë, se në gjurmimin e shqipes duheshin dallue: elementet e vendit nga ato të marruna uha, por kot së koti, pse nuk u muer parasysh.

### **Cilës familje indogjermane i përket shqipja?**

Në lidhje të zhdrejtë me çashtjet e bisedueme deri tani është edhe kjo. Me cilën nga familjet gjuhësore të daluna prej indogermanishtes është më afër gjuha shqipe? Bopp-i përgjegjet kësaj pyetjeje në një mënyrë të urtë kritike, kur thotë se shqipja *“në pjesët e saja themelore që e përmbajnë nuk ka lidhje të ngushtë ase nuk ka aspak lidhje zanafille me asnjënen nga motrat e tjera të sankskrishtes të kontinentit t’onë”*.

Bopp-i me këtë pikëpamje i ra nenit të kambës pikëpamjes së gjurmuesit tjetër të kohës së vet, August Schleicher-i, i cili u përpoq që gjuhën shqipe t’a nxirte nga “familja dyfishe

pelasge” (greqisht, italisht) dhe kërkon t’a numërojë ma afër familjes greke. Kjo pikëpamje e Schlejcher-it e cila u duk se u çmua ma tepër se teoria kritike e Bopp-it, gjeti pëlqim edhe mbas botimit të shkrimit të këtij të fundit. Deri burra të dijtun, shërbimet e të cilvet nuk mund të mohohen përse i përket gjurmimit të shqipes dhe sidomos njohunís së rregullavet të saja, e pranuen dhe e pëlqyen, si b.f. G. Stier-I (KZ 11.253) dhe Dhimitër Kamarda me vepren “*Saggio di grammatologia comparata sulla lingua Albanese*” (Livorno 1864). Prandej është krejt e natyrshme, qi nuk u përkit pikëpamja e parashtrueme nga Boop-i, as ajo e Thumman-it dhe e Malte–Brun-it, se shqipja rridhte nga ilirishtja. Kështu qi pikëpamja e Schleicheri-it pati edhe shumë ndjekës tjerë, si p.sh historiakët Niebuhr dhe Fallmerayer (“*Das albanisch Element in Griechenland*”). (Abh. d. Ak. III, KL. Bleni 8), filologët dhe gjuhëtarët: Kopitar (*Ëiener Jahrbuecher der Literatur*, 45, 85), Benfey (Gotlinger Gel.Anz. 1855,539), (*Denkschriften der Ëiener Ak*’, Phil. – hist. KL., 12, faqe 4 e përtej), Diefenbach (“*Voelkerkunde Osteuropas*”, I, 72) dhe gjurmuesit e specializuem të Shqipnis, si Leake (“*Researches in Grece*”) dhe Johan Georg von Hahn (Alb.Studien,Ëien,1853,1,213 e 2 përtej).

### **Hahn-Meyer-Kretschmer.**

Georg von Hahn-i qe i pari, qi në zgjidhjen e kësaj çashtjeje bëni një përparim të vërtetë methodik, mbasi ai u përpoq të zhvillonte me mjetin e shqipes disa pjesë të materjalit t’emnavet të vendeve, qi na kanë mbetë nga ilirishtja, kjo method parimisht është e drejtë, kështu qi edhe vetë Hahn-i në disa rase ka nxjerrë përfundime të drejta. Asht e vërtetë se Hahn-i mbështetet endë në parimin mjegulluer të Pelasgëvet kur jep gjykimin e vet mbi çashtjen e zanafillës, tue krahasuem ilirishten me pelasgishten.

Mjeshtri i dijtunís gjuhësore shqiptare, Gustav Meyer-i sikurse kuptohet vetvetiu, në kriteret e veta e hodhi në njënjë anë këtë vepër të Hahn-it, dhe pastaj në një mënyrë t’urtë e përcakton shqipen si një epokë të re të dialekteve të vjetra ilire. (*Groebers Grundr.d. rom. Philologie, 1Aufl., 1: 804, 2 Aufl. bearb. Von W.Meyer-Lubke, 1, 1038*). Me anën e studimit të mbishkrimeve të mesapishtes, qi është një degë e ilirishtes së vjetër të vendosun në Itali, mujtën S. Bugge (B B, 18,193 e përtej) dhe sidomos në një mënyrë të gjënë e të hapët Paul Kretschmer-i (“*Einleit, I d. Gesch.d. Griech. Sprache*”, f.262 e përtej) me na dhanë vërtetimet e sigurta mbi zanafillën ilire të Shqiptarvet, por mbasi si në disa rase pat qënë hapë rruga nga Stier dhe G. Meyer-i. Kretschmer-i, qe prap ai qi i bëni një shqyrtim kritik lidhjes së shqipes me gjuhën e

Venetëvet, të cilët simbas një gojëdhane së vjetër, janë një fis ilir, që i mveshi venetishtes, sidomos pse kjo bân pjesë në gjuhët kentume, natyrën e një dialekti veriuver ilir në krahasim me ilirishten jugore (prandëj edhe me shqipen), kurse Pedersen-i (*KZ, 36,300 e vijim*) shkon edhe më përtej edhe kundërshton, me të drejtë, se venetishtja i përket ilirishtes.

Rrugën e çelur nga Hahn-i, d.m.th. spjegimin e emnavet të vjetër ilirë të vendeve me anën e shqipes, e kundërshton prap Gelzer-i (*“Zeitschrift für rom, Philologie”, 37,273-286*)

### **Zanafilla ilire mbetet e pa-trandun**

Natyrisht nuk është thanë ende fjala e fundit në të gjitha hollësitë mbi këtë çashtje në kundërshtim. Me gjithë këtë, argumentet e randësishme që deri sot janë paraqitë për mprojtjen e teorís ilire, janë një përfundim, që nuk mujtën me e trandë as kundërshtimet e Hirt-it (*Festschrift f. Kiepert, 1. 181 e përtej*). Kundra parimit të Hirt-it, se Shqiptarët rrjedhin nga Thrakasit, mund të parashtrohet një radhë e gjatë arsyesh natyrë gjuhësore. Ndoshta populli thrak ka pasë një pjesë në formimin e kombsis shqiptare, sikurse e pat kujtuem edhe Thunman-i me pamjen e vet të kombsis shqiptare, sikurse e pat kujtueme dhe Thunman-i me pamjen e vet të largët, dhe sikurse shifet kjarisht nga rrogatjet e Karl Patsch-it mbi barasimin e emnavet të vendeve, të lumejvet e të malevet në viset thrake dhe ilire, (*Jahreshfle d.Oesterr. Archaeol. Inst., 10,169 e përtej*). Kësore na del pra një synthezë e këtyne dy parimeve kundërshtare, të cilat Baron F. Nopça i mori për t'i spjeguem si të gjashme një mbishtesë të njëj elementi thrak mbi ilirishten (*“Eissenschaftliche Mitteil a Bosnienu. d. Herzegovina”. 12,223*). Dy parimet e tjera që largohen pakëz nga të parat, dhe që parashtrohen nga dy gjurmues rumunë, nuk qenë në gjendje të ndikojnë për të gjatë kohe në zhvillimin e kësaj çashtjeje.

Parimi fantastik i Hasdeus-it, i cili flet për një element pelasg të hershëm ballkan, farefis me Egyptasit, me një mbishtresë nga ana e Thrakasvet në veri, nga ana e Grekvet në jug, u pranuen nga Sandfeld Jensen-i (*Nord Tidskr.f. filologi, 3 r.3,105 e përtej*).

Sa pak arsye ka Parvân-i që thotë se Shqiptarët erdhën pak nga pak në viset e sotme ndërmjet shekullit III dhe VI nga Dacija (*Beih. 26 zur Zeitschr. F. rom. Phil. F.61 e përtej*), dhe se provat gjuhësore na japin dishmin për vijimsin e vendeve të banimit të Shqiptarvet qysh prej kohvet më të vjetra deri në ditët'ona, shifet nga vretjtjet e L.Spitzers-it në (*Mitleilungen des rumaenischen Institutes”(Wien, 1,292 e përtej*)

## Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët kufitare të Ballkanit

Tue studjuem në pikëpamje të dijtunís gjuhësore problemën e radhitjes së shqipes në lidhje me gjuhët kufitare ballkanase, na del në shesh sidomos problema e afrimit të saj me rumanishten.

Pikëpamjet e dy dijetarvet rumunë, qi përmendëm pak mâ përpara, mbështeten në faktin e pamohueshëm se ndërmjet rumanishtes dhe shqipes gjenden afrime gjuhësore të vjetra. Këta dy mjeshtra të dijtunís gjuhësore qenë ata qi çmuen randësín e kësaj probleme dhe qi për të parën herë u përpoqën t'a zhvillojnë. Asht e vërtetë se edhe në shekullin XVIII Joh. Thunmann-i, me zgjuetsinë e vet të rrallë, pati cekë lidhjen qi gjindet ndërmjet rumanishtes dhe shqipes. Por meritimi i të cekunit të kësaj çashtjeje në një mënyrë bindse i përket Slavistit të madh Miklosich-it<sup>15</sup>. (*Die slav. Elem. Im. Rum. Denkschrift der Wiener Ak, Phil.-hist. Kl. 12*). Këtë e ndoqi Schuchardt-i, i cili na përmend edhe tjera afrime ndërmjet këtyne dy gjuhve, sidomos në pikëpamje të tingujvet, dhe qiti në shesh zhvillimin paralel semasjologjik t'elementeve latine në të dyja gjuhët ("*Wokalismus des Vulgaer-lateins*", 3, 46-55). Ma pak bindës qe përfundimi, qi Miklosich-i ("*Alb. Forschungen*" 2. 78) nxori nga fakti i disa afrimevet gjuhësore. Asht për t'u çuditë se mu ky mendim, prej të cilit mâ vonë vetë Miklosich-i hoqi pjesërisht dorë, u pranue prej atyne qi erdhën mbas tij me një farë përdashunimi, madje edhe nga Schuchardt-i.

Kundra kësaj pikëpamjeje, e cila qysh nga zanafilla e vet qe krejt arbitrare, simbas së cilës afrimet gjuhësore do t'i mvesheshin njëj nënshtrese së përbashkët të dy popujve, shkroi Hasdeus Landsmann Cihac-i (*Boehmers Rom. Studien*, 4, 431 e përtej) dhe sidomos në një mënyrë bindse Sandfeld Jensen-i, i cili tue parashtruem një përmbledhje objektive dhe kritike t'afrimevet gramatikore (*Nord.Tidskrift f. filologi*, 3 r., 3, 105 e përtej, *Groebers Grdr. D. rom. Phil.* 1. Faqe 524 e përtej), qiti në shesh varunín e ndryshme të këtyne dy gjuhëve nga njena tjetra, dhe në kundërshtim të hapët me Gustav Meyer-in, i cili, për të parën herë na tërhoqi vërejtjen për një ndikesë latine mbi shqipen. Rrethanen për studimin e kësaj problem, d.m.th. të "*çashtjes së nënshtresës*" na e jep Ludëig v. Thalloczy në veprën "*Ilyr.-alb. Forschungen*"<sup>159</sup>.

---

<sup>15</sup> Franz Miklosich, filolog sloven, lindi me 20 shtatuer 1813 në Stirin jugore dhe vdiq në Vienë me 7 mars 1891. U laureue në filozofi në Universitetin e Grazi-t dhe në Drejtësi në Vjenë. Miklosichi është i pari sllavist, qi u muer me të gjitha gjuhët sllave në të gjitha pikëpamjet. Vepra e tij kryesore është "*Vergliechende*".

Për një studim gjuhësor – historik të shqipes kanë një randësi mjaft të madhe edhe pjesët leksikore shqipe të përdorura në rumanishten. Këtë çashtë e zhvillon tue i ramë punës në të Densusianu në librin *”Histoire de la langue roumaine”*.

Hollësi të reja mësimtare mbi afrime të ndryshme leksikore të këtyne dy gjuhëve i gjejmë ke Puscariu në veprën *”Etymologisches Woerterbuch der rumaenischen Sprache”*. Të vrehen për shembull zhvillimet mbi fjalët rumune *caciula*- shqip kësulë: aromunisht *picul’u* (të holla të ruejtuna për pleqni)– shqip *pekul* (kujdes):<sup>16</sup> rumanisht *zbor* (me fluturue) – shqip *zborak* (trumcak, harabel); etj. Një grupim të elementeve shqipe të rumanishtes simbas pikëpamjeve kulturore-historike dhe njikohësisht një radhitje gramatikore u përpoq t’a bante C. Treimer-i (*Zeitschrift f. rom. Phil.*, 38 385 e përtej) ; por kjo vepër ka nevojë për disa përmirësime në metodën dhe në përfundimet e nxjerrura mbi zhvillimin historik të tingujvet.

Duhet dijtë se jo çdo afrim ndërmjet gjuhëve mbështetet në marrëdhëniet historike; shpesh herë afrimi i një fjale së një gjuhe me një tjetër është vetëm kombinacion. Studimi i E. Meyer-Luebkes (*Mitteil. D. Rum. Institutes Wien*, 1.1 e përtej) e ka meritimin e paraqitjes sistematike të marrëdhënieve ndërmjet gjuhës shqipe dhe rumune, është edhe meritimin e cekjes së tendencave kryesore të zhvillimit gjuhësor. Bashkë me afrimet e nxjerrura ndërmjet këtyne dy gjuhëve ndriçohen edhe ndryshimet e randësishme në mes tyre, mendimi në se një element para-etnik shqiptar ka ndikuar themelisht sidomos sistemin rumune të tingujvet, dhe që gjeti aq shumë pëlqim nga gjuhëtarët, u rrëxue definitivisht nga spjegimet kritike të Meyer-Luebkes.

Me gjithë këtë, disa veti në pikëpamje të tingujvet dhe të semasjologjisë të pjesëve shqiptare në rumanishten, sikurse me të drejtë e thekson Gustav Meyer-i (*Alb. Stud.* 3, 22), janë të kohës kur gjuha dhe kombësia rumune nuk ishin ende të sajume.

Ndikesa e gjuhës shqipe mbi gjuhët e tjera të Ballkanit është shumë më e rë. Sikurse në çdo fushë tjetër të dijtunis gjuhësore të shqipes dhe të gjuhëve kufitare të saja, është edhe në këtë pikë Gustav Meyer-i na ka dhanë, zhvillime shembullore. Gjurmimet e tija për ndikesën e shqipes mbi njënjën prej gjuhëve kufitare jo rumune gjenden në librin e tij *”Neugriechische Studien”*, 2, 64-71; këtu ky albanolog bën fjalë mbi elementet shqipe të greqishtes së rë.

---

<sup>16</sup> Fjalori i Kristoforidhit në f. 305 fjalës *pekul* i jep kuptimin e pasunis midis vllazënve ase grues dhe burrit e ka prap në kuptimin e dytë këso dore : e kam *pekul* e kam t’imin, ekam mbé *pekul* at njeri –e kam me sy të mirë. Në faqen 306 Kristoforidhi ka edhe fjalën *pekul* , së cilës i jep kuptimin e dhuratës.

Ndikesa e shqipes mbi gjuhët sllave të Ballkanit dhe mbi turqishten nuk ka qënë gjurmue endë monografisht, ndonse kjo problem është e randësishme dhe meriton të studjohet.

Me gjith atë Miklosich-i në Fjalorin e vet Etymologjik të gjuhvet sllave ka marrë parasysh edhe gjuhën shqipe, por këta shënime qi natyrisht janë të pakta, nuk mrrijnë me e shkoqitë problemën plotësisht.

Rasa të pakta të ndikesës së gjuhës shqipe mbi gjuhët kufitare të Ballkanit i kam parashtruem në dy shkrimet e mija në librin “*Mitteilungen des Rumaenischen Institutes*”, (Wien 1, 289 e përtej i F. 33, 420 e përtej).

## DIALEKTET E SHQIPES

### **Mendimet e ndryshme t’Albanologvet.**

Në dialektet mbahet gjallë koha e kalueme e kombsis Georg von Hahn-i i mirënjoftuni gjurmues i vendit dhe i njerzvet të Shqipnis dhe përshkrues i hollë i gjuhës së saj, e shpjen ndamjen e shqipes në dy grumbujt e dialektevet, gegnisht dhe toskënisht, në kohën e motnis, gjithashtu ngulë kambë në ndamjen në Gegë e në Toskë, n’Ilirë e n’Epirotë. Theodor Bentey e kishte vûm qysh përpara në dyshim mendimin e kësaj ndamjeje shumë të vjetër, por natyrisht pa parashtruem arsyet e këtij mendimi.

Ndërkaq nuk është punë e veshtirë për vëzhguesin e dijtunis gjuhësore qi të provojë rinin relative të ndamjes dialektore të sipër-përmendun . Asgjâmangu gjurmim djalektuer, sidomos i shqipes, qi është një gjuhë, tradita letrare e së cilës është e re, ka një randësi shumë të madhe. Dhe me të vërtetë në një gjuhë të tillë, si shqipja, dialektet e saja me vjetërsit e veta të ruejtuna, kanë në vete vleftë, përmendoresh gjuhësore.

Por mjerisht në këtë pikpamje, d.m.th. në gjurmimin e dialektevet të shqipes, është punuem pak ase aspak. Shënime të rasëshme e të drejta mbi këtë çashtje gjinden shpesh te Kamarda “*Saggio di gramatologia comparata sulla lingua albanese*”. Për ndryshime kryesore ndërmjet gegnishtes dhe toskënishtes na flet Dozon-i në veprën “*Manuel de la langue chkipe*”, f. 329 e përtej. Marrëdhانيت fisnore dhe ndamjen e nëndialektevet ma të randësishme të grumbullit djalektuer të toskënishtes i cekë shkurtazi Konstatin Kristoforidhi në “*Gramatikë tës albanikës glosses*”. Kemi edhe disa fakte gjuhësore të disa djalekteve qi na janë bâm të njoftuna në vija të përgjithshme, kështu p.sh. na japin pak dritë mbi dialektet arbneshe t’Italis, Jeronim De Rada (“*Grammatica della lingua albanese*”). Princi Lucian Bonaparte (“*Transact of the*



*Philolog. Soc.*” 1884, f.492 e përtej) , Hanusz-i (MSL, 6, f.263 e përtej). Këto dialekte arbneshe, qi tash sa qindvjetsha janë shkëputë nga vendi i lindjes, qi patën një zhvillim të veçantë dhe qi prandaj mund të ngjallin një interes të naltë në pikëpamje të historís së gjuhës, u rrahën përmbledhtas në studimin e Maksimiljan Lambertz-it (II. , f.1 e përtej). Në ket studim del në shesh edhe ndonji shkëndí drite mbi rregullat gramatikore të dialektevet tjera, mbi lëvizjet dialektore, të cilat këso dore fituen pozitën e vet historike dhe kufinin e vjetër të vetin.

Reinhold-i në veprën “*Notes pelasgicae*” (Athinë, 1885) , Kullurioti në librin “*Albanikon alfabëtarion*” (Athinë , 1882) dhe Gustav Meyer-i në veprën “*Albanesische Studien*“ 5 (Eiener Sitz.-Ber., 135) na japin orjentime mbi dialektet qi fliten në Greqi, kurse shkodranishtja, e cila, në një farë mënyrë ka qënë e njoftun prej teksteve të vjetra dhe prej botimeve të Propaganda Fides, i u lëshue në dorë gjurmuesit gjuhësor më anën e Junggu-t me librin “*Elementi gramaticali della lingua albanese*“ (Shkodër , 1881) dhe gjeti një studiues besnik e vesh-hollë në gjuhëtarin J.U. Jarnik (“*Zur alb. Sprachenkunde*” Lapzig, 1881, “*Prispevky ku poznani nareçi albanskych*” d.m.th. “*Ndihmesë për njohjen e dialektevet shqipe*”, Pragë, 1885). Një radhë vrejtyesh të çmueshme për njohjen e dialektevet na parashtron Gjergj Pekmezi në veprën “*Gramatik der alb. Sprache*” (Vjenë, 1908). Asht e dijtun se në këto rase na paraqiten vetëm tekste gjuhësore të dialektevet dhe jo caktimi i gjith-anshëm në pikpamje të dijtunís gjuhësore të një tipi dialektuer. Të rrahunit e kësaj çashtjeje në mbështetje të shenimeve të nxjerruna prej atij vetë (në Korfu dhe në viset shqiptare kundruell këtij ishulli) i përket Holger Pedersenit . Studimi i tij silltet rreth një dialekti lab dhe gjindet në veprën “*Albanisische Texten und Glossa*” ( Leipzig, 1895- Abhandl.) d. Saechs . Ges. D. Wiss. Phil. –hist. Kl. 15) të cilin e ka përshkruem në pikpamje shkencore tue u mbështetë në një radhë tekstesh të mbledhuna me kujdes, të cilat n’anën tjetër na paraqesin një interes në pikpamje të njohunivet popullore, ket studim e ka pajisë edhe me një *Fjaluer* të punuem me përpikní. Ky punim, i bâm nga Pedersenit dhe qi asht një fitim i madh për dijtunin gjuhësore shqiptare në pikëpamje të dialektevet, na paraqet në një mënyrë dhe intuitisht këtë degë dijtunore.

Shka u tha për Pedersen-in mund të thuhet me të drejtë edhe për Eëigand-in, i cili bani një studim të hollësishëm mbi dialektin gegë të Borgo-Erizzo-s në Dalmati (“*Jahresbericht des Rumaenischen Institutes*” Leipzig, 17,177 e përtej). Tue qenë se këtu është fjala për dialektin e një kolone, caktimi i tingujvet dhe i trajtavet të tija, është edhe gjurmimi i visarit të tij gjuhësuer, janë shumë të randsishëm edhe si mjet ndihmës në pikpamje kronologjike. Gjithashtu Weigand-i

me veprën e vet *“Albanesische Grammatik im Suedgegischen Dialekt”* (Leipzig, 1913) na ka parashtruem një studim mbi dialektet e Shqipnis së Mesme, të Durrsit, t’Elbasanit e të Tiranës, të cilat deri tani kanë qenë lanë gadi krejt mbas dore, kjo gramatikë, qi i shërben shumë mirë qëllimit praktik, dhe qi, tue marrë para sysh natyrën e punës, i jep njëkohësisht një ndihmesë edhe Djalektologjis, u plotsue nga vetë auktori edhe një Fjaluer (1914).

Edhe përpara Weigandi-t, Gjergj Pekmezi i pati shetitë këto vise të Shqipnis së Mesme me qëllime djalektologjike dhe i pati parashtruem Akademis së Vjenës (*“Anzeiger”*, 1901, f.39 e përtej) një raport të përkohshëm mbi përfundimet e nxjerruna. Në këtë raport gjindet një radhë shënimesh mbi veçanti dialektore të vrejta në vise të vështira për përshkrim, si në Dibër, Bërzhëtë, Shpat. Por mjerisht këto shënime Pekmezi i ka bâm ma tepër në mbështetje mbi sa ka mujtë me mbajtë mend, tue mos shkruem me të shpejtë aty për aty, kështu qi u mungon përcaktija dhe nuk kanë një përpikni fonetike. Raporti definitiv, të cilin Pekmezi pati lajmue se do t’a paraqiste me të gjitha shënimet e plota e me përfundimet e nxjerruna, deri tani nuk është pam gjakundi.

Mbi dialektet gege lindore, të cilat deri sot janë qitë krejt në harresë, Jokl-i na premtion një studim dhe një gjurmim sa më të shpejtë. Raporti i shkurtë mbi këto studime (*“Anzeiger der Wiener Akademie”*, 1915, f. 68 e përtej) i thekson karakteristikat e këtij dialekti qi është ai qi flitet në Rapshishtë afer Gostivarit.

### **Etymologjija, çashtje shumë e rëndësishme për shqipen**

Çashtja e etymologjis për gjuhën shqipe ka më tepër rëndësi se në çdo gjuhë tjetër, indogjermane. Kuptohet vetiu se jemi tue folë për atë etymologji, e cila shenon jo vetëm mendime ase rasa shumë a pak të vërteta, por për atë, *“qi është një dijtuni, në të ciklën sikurse në çdo dijtuni tjetër, puna serioze dhe e qindrueshme duhet të na shpjerë në përfundime të sigurt”* (H. Schroeder). Në qoftë se etymologjija është themeli i gramatikës dijtunore për çdo gjuhë, mbi të cilën etymologji mbështetet fonologjija dhe morfologjija, atëherë kjo degë e dijtunis gjuhësore është dyfish më e rëndësishme për gjuhën shqipe, qi ka një visar gjuhësuer të përziem e të shumëngjyrshëm.

## Leipniz-i, Bopp-i dhe Kamarda

Randësin themelore të kësaj çashtjeje e pati njoftë me kohë Leibniz-i, por zgjati shumë, derisa u çmua si duhet kjo njohje e këtij *philosophus Germaniae*, i cili, me intuiten e vet, pati zbuluem shumë gjana themelore.

Vetë Leibniz-i bëri disa prova në fushën e shpjegimit të fjalvet shqipe dhe pasardhësi i tij më i denjë i kohës para se të themelohej dijtunia gjuhësore, Malte-Brun-i, na parashtrori një përmbledhje të etimologjive të filozofit dhe u përpoq t'i shtojë këto me anën e shpjegimeve të veta ("*Annales des voyages*" 3,167 e përtej.) Në këtë listë gjindet ndonjë krahasim i drejtë i 102 shpjegimeve, si p.sh. i fjalës shqipe *mish* me sllavishten *meso*, i fjalës *njeri* me greqishten *aner*, dhe të ndonjë fjale tjetër, që deri sot janë pranuem përgjithësisht, tue mbetë së paku *communis opinio*.

Por në shqyrtimin e posa-filluem të histories së gjuhvet indo-gjermane, është e dijtun se kanë mujtë me rrëshqitë edhe krahasime të gabueme. Bopp-i në fushën shqiptare ia solli kujdesin e vet etimologjis si një gjëje së dytë, me gjith këtë, gjejmë në shkrimin e tij "*Ueber das Albanesische*" një radhë shpjegimesh të dobishme, që kanë mbetë edhe sot të pa-trandshme, si psh *viç* dhe *vjet*: ind. e vj. *vatsá*; *vjehërr* : ind.e vj. *shváshura*, mbar (baj), *bie* : ind.e vj. *bharámi*, *ap*: ind. e vj. *ap* = nxjerri; *ditë*: ind.e vj. *dina* e disa fjalë tjera. Mirëpo për të mrrijtë në një gjykim themelisht të drejtë të visarit gjuhësor të shqipes, nuk i qe e mundun as vetë Bopp-it, ndonse, si shifet, mbas disa shenjash, njohësin e vërtetë e kishte disi para sysh. Kërkesa e Leibniz-it, që u përmend më sipri, me të cilën këshillonte dallimin ndërmjet fjalvet origjinare të gjuhës dhe atyne të marruna nga gjuhët tjera, nuk pat qënë edhe zbatueme. Prandej nuk është për t'u habitë, pse Bopp-i, tue u mbështetë në parime jo të drejta etimologjike, bëri gjykime të shtrembta gramatikore, si b.f. në gjykimin e zvendësimit të grykorevet, ku ai fjalën shqipe *qen* (e marrun nga latinishtja *canis*) e krahason drejt për së drejti me indishten e vjetër *shvan*.

Gjithashtu edhe Kamarda, e sidomos të ky, gjindet një trazim në elementet e ndryshme të visarit gjuhësor të shqipes. Ky albanolog e mbështeti në këtë trazim studimin e vet mbi fisin e shqipes me latinishten dhe me greqishten dhe, i ngulun në këtë mendim, duket se formalisht doli nga rruga e pranimit t'huajtjes së fjalëvet të hueja. Edhe Schleicher-i, tue ndjekun këtë udhëzim të gabuem, mrrijti në gjykimin e vet të sipër-shenuem në çashtjen e farefisnis. Edhe shembulli i Benloeë-it, që thotë me i ruejtë këtij gabimi, pat qënë theksuem. Natyrisht se këtij nuk mund t'i nrifej si punë e madhe ajo gjë që patën cekë me kohë Bopp-i dhe Schleicher-i, të

cilët, me zotsín e shqueme të vetën, e kishin ndiem si gabim të randë. Gjurmimi themeluer dhe systematik i visarit të fjalvet të shqipes pat qênë hakluem (shqyrtuem) edhe përpara Benloew-it, pse, sikurse dihet, gjurmimet shqiptare të Miklosich-it (tri pjesë) patën qênë botuem qysh në vjetin 1870-71 (në “*Denkschriften der Wiener Akademie*”, Phi. Hist. Kl. 19-20.)

Pra, sikurse në fushën e armenishtes qe e mundun me krijuem një mendim të drejtë të historís së saj vetëm me anën e një shqyrtimi të hollë të fjalvet thjeshtësisht armene, tue i dalluem nga ato të marruna uhá, ashtu ásh bâm dhe duhet bâm edhe me gjuhën shqipe. Në këtë fushë dy janë drejtimet, simbas të cilavet këto gjurmime duhet të ndjekin rrugën e vet, njëni drejtim ásh negativ dhe tjetri pozitiv (Pjesa I: Elementet slave në shqipen. Pjesa II: Elementet romane në shqipen, Pjesa III: Trajta e verbavet t’uhajton në shqipen). Këto drejtime patën, jo vetëm fuqi të mnjanojnë përfundime të pa-mendueme për historín gjuhësore të shqipes, por ndihmuen edhe në gjurmimin e vetë pasunís së fjalvet të shqipes, qenë mjete të dobishme zavendësimi për dokumente të vjetra, madje, mund të thomi, qenë vetë dokumente, qi pritshin vetëm spjeguesin e vet të zotin.

### **Gjurmimet e Miklosich-it**

Spjeguesi i parë i tyne qe vetëm Miklosich-i, ndonse nuk duhet të mohohet, se edhe G. Stier-i në gjurmët e veta të pakta (“*Allg. Monnatschrift*” 1854, faqe 861 e përtej, KZ. 11, 132 e përtej, 206 e përtej) u mbështet në dallimin e visarit të fjalvet. Ai mnjanoi edhe ndonji gabim të gjurmuesvet të kohës së vet, si p.sh. ásh për t’i u falun nderit për gjykimin e fjalvet qint, qen, edhe për ndonji spjegim tjetër, qi u bá pasuni e vijueshme e gjurmimit gjuhësuer të shqipes dhe t’indo-gjermanishtes, ashtu edhe për krahasimin e fjalës *mës* (maz) me *Juppiter Menzana* të Salentinvet mesapikë, të fjalës *sorrë* me ruishten *soroka* etj. Miklosich-i nuk u kënaq vetëm me gjurmimin e disa kategorive fjalësh, por u përpoq të kategorizonte krejt visarin e fjalvet, qi asokohe ishin të njoftuna. Shumë fjalë, të cilat para-ardhësi mâ i afërmi i Miklosich-it, Dhimitër Kamarda i pati mbajtë si thjesht shqipe, u njoftën si t’uhajtuna, mbasi u studjue natyra e vërtetë e tyne. Nji radhë e vogël (natyrisht jo e plotë) të tilla fjalësh, të cilat Miklosich-i i bjen të marruna nga slavishtja na jep një pasqyrë të gabimevet të mëparshme si p.sh. *grusht* nga fjala *grëstë*, *gozhdë* nga fjala *gozdij*, *kluq* nga *kljuçi*, *porosit* nga *poruqiti*, *sanë* nga *séno*.

Me burim roman Miklosich-i paraqet ndër sá tjera këto: *ërgjent* nga *argë entun*, *kërp* (kanp) nga lat. vulgare *cánape*, *qërshi* nga *cerasus*, pak nga *paucus*, *pyll* nga *padule* për *palude*,

*shëroj* nga *sanare* etj. Të merret parasysh vetëm randësia e këtij punimi nga pikëpamja e gjykimevet t'ona të sotme.

Spjegimet e fjalvet të sipërme kanë randësi për studimin e përfaqsimin të grykorevet në gjuhën shqipe, të cilat Kamarda tue i marrë kinse si fjalë thjesht shqipe, si *qen*, *dërgjent*, kishte rrëshqitë në gabim. Për sa i përket fjalës *qen*, edhe dedukcioni qi lidhet me këtë, rá në gabim edhe vetë Bopp-i. Gjithashtu mbështetet për një pjesë të mirë mbi gjurmimet etymologjike të Miklosich-it edhe studimi i përfaqsimin të dyzanorit *au*; këto na japin landë për historín dhe kronologjín e tingujvet *s* dhe na tregojnë udhën për ndriçimin e grupit *kl*, na lëshojnë dritë mbi zhdukjen e *media-s* ndërzanore, etj. Gjurmimet e Miklosich-it, porsa u botuen, për arsye të shenimevet me randësi parimore, gjetën një vijim shumë të vlefshëm edhe për ditën e sotme në studimet e Schuchardt-it: “*Albanisches und Romanisches*” (KZ, Zeitschrift fuer indog. Sprachforschung von A. Kuhn, 20, 240-302), ky studim e kapërcen shumë rrethin e një parafraze referuese ase kritike, në pjesën e vet etymologjike ndreqë disa spjegime të Miklosich-it, shumica e të cilavet në këta pesëdhjetë vjetët e fundit, qysh prej botimit të tyre, kishin pasë zanë rranjë të fortë, si b. f. *purtoj* (përtoj, pritoj) nga verbi *pigritor*, *i vorfën* nga *orphanus*, *uroj* nga *augoro*. Aty gjindem edhe plotsime qi i kanë rrëshqitë Miklosich-it, Schuchardt-i pra na provon një radhë fjalësh të rrjedhuna nga latinishtja, qi i kanë shpëtuem Miklosich-it, ndër të cilat mâ të randësishmet janë: *thekër* (thekën), *gjel*, *vërri*, (vrri) *kumbullë*, etj.

Miklosich-i, në fundin e jetës së vet puntore e shumë të meritueshme, iu vù një punë së madhe, d. m. th. ndërsa ai po bânte dallimin e elementevet romane dhe sllave, deshti të zgjidhte edhe pjesën turke të futun në fjalorin e shqipes. Këtë punë e bâni ai në një *Monografi*, qi përfshinte të gjitha gjuhët e Ballkanit, madje ato të krejt Europës Lindore (“*Die tuerk. Elemente in den suedost und osteurop. Sprachen*”, Vjenë, 1884-1890; Denkschriften der Wiener Ak., Phil. – hidt., 34, 35, 37, 38); kjo monografi, në pikëpamje sllave, âsht e randësishme për shënimet e veta kulturore, historike dhe gjuhësore. Edhe për ndriçimin e shqipes, ky studim i Miklosch-it ka një randësi themelore. Tue lane në njënen anë randësin e posaçme të gjurmimit të fjalvet t'uhajtuna, qi gjinden në këtë monografi, auktori rrin fare larg sidomos nga gabimet, në të cilat shpeshherë pat râm Kamarda, si për shembull në krahasimin e fjalës greke *poietés*–poet me fjalën shqipe *bejtar*, dhe Benloeë-i i cili bjen gadi rregullisht në gabim në veprat e tija të sipër-përmenduna.

## Gjurmimet e Gustav Meyer-it

Këso dore u gatue në një mënyrë të mirë rruga e gjurmimit të fjalorit të shqipes, së paku për sa i përket pasunís s'uhajtun të saj, dhe meritimi u përket sidomos Miklosich-it dhe Schuhardt-it, kështu që Gustav Meyer-i e pati rrugën çelë për punimet e tija të thella e të shumanshme. Në qoftë se për dy gjurmuesit e sipërm studimi shqiptar që pak a shumë një gjë e dorës së dytë, duhet të thuhet se G. Meyer-i i a fali dijtunis gjuhësore shqipe një pjesë të madhe të zellit të vet të shquem e të zotsis së vet larg-shikuese. Në gjurmimin e fjalvet t'uhajtuna, puna e G.Meyer-it, tue ndjekë veprimtarin e para-ardhësve të vet, u kufizue në plotsim dhe në përmirsime, në shtime e në kritika. Këso dore në veprën e vet madhështore “*Etymologisches Woerterbuch der albanischen Sprache*” (Strassburg, 1891) mrrijti me spjeguem një radhë fjalësh me pikë-pamje të qindresës e të karakterit uhajtës, që u kishin pasë shpëtuem albanologvet përpara tij, të krahasohen p.sh. fjalët *flakë*, *kluar* (mundësi i mtinit), *kullosë*, *kosore* (kosë), *mutí* (mtí), *kotell* (kupë e madhe druni), *parmendë*, *pê*, *tershërë* (tërshanë). Ndonji prej këtyne fjalve Meyer-i i nxori në dritë nga veprat më të reja, të cilat i patën munguem Miklosich-it, si b. f. *kotell*, *pëti* ase *muti*, të nxjerruna nga Mitko-ja në librin “*Albanike Melissa*” (Aleksandri, 1878), që është një përmbledhje tekstesh popullore. Në rasia tjera Meyer-i mujt i përmissojë pikëpamjen e para-ardhësve të vet, si p.sh. ke fjala *shpejt*, të cilën, në kundërshtim me Miklosich-in, e nxjerr nga slavishtja, ke fjala *shkráp* (hagrep, përcollak), për të cilën caktoi sllavishten së paku si burim të drejt-për-drejtshëm. Gati krejt natyrisht Meyer-i e vijoi këtë anë të veprimtarís së vet edhe mbas botimit të *Fjalorit*; kështu e shofim në pjesën IV të veprës së tij “*Albanesischen Studien*”, Vjenë, 1895 (Wiener Sitzungsber, 132), ku ai ribotoi dhe komento i fjalorthin greqisht – *jug-rumanisht* – shqip, të Kavaljotit. Të krahasohet këtu p.sh. spjegimi i drejtë i verbit *nis* nga fjala latine *initium*, kurse Miklosich-i këtë fjalë deshti me e nxjerrë nga greqishtja, *ekinesa*. Më në fund Meyer-i ia solli synin edhe fushës së rumanishtes, së sllavishtes dhe asaj së turqishtes dhe mrrijti kështu të sigurojë përfundime të reja në pikëpamje të zhvillimit të fjalvet t'uhajtuna, këso dore b.f. me anën e hungarishtes, si për shembull fjalën *qipare* (tipare, karakteristikat e fytyrës) e nxjerr drejt për së drejti nga hungarishtja *kép* (fytyrë) etj.

Por në qoftë se fjalori Etymologjik i Meyer-it u bâ një vepër burimi e radhës së parë dhe një bunar i dijtunís gjuhësore, veprimtaria e tij ka edhe një randësi tjetër, pse nuk që vetëm një vijues i këtyne studimeve, por mund të thuhet se që themelues i parë i tyre. Asht e vërtetë se Bopp-i ia hapi rrugën shqipes për dijtunín gjuhësore indo-gjermane, por nuk e vijoi,

nuk e çoi deri në fund; kjo punë kërkonte me doemos një veprimtari etymologjike me methodë, urtësi, kujdes dhe energji.

## ARDIAN NDRECA

### NORBERT JOKLI: FATI I NJI BIBLIOTEKE DHE I NJI NJERIU QË I PËRKISNIN SHQIPNISË

Norbert Jokli ka qenë një prej figurave më të shndritshme që ka njohtë albanologjia gjatë shekullit të kaluem. Ai ka lindë me 25 shkurt 1877 në Bzenec apo siç njihet ndryshe Bisenz, në jug të Moravisë dhe ka vdekë në rrethana tragjike në maj të vjetit 1942.

Por, para se me u njohtë si albanolog i madh, ai ishte i çmuem si studjues i filologjisë balto-sllave dhe si bibliotekar (*Oberstadtsbibliothekar*) i Universitetit të Vjenës.

Admirues i madh i Fishtës, Konicës, Sqiroit, Naimit dhe traditës bektashjane, njohtës i De Radës dhe i arbëreshëve, simpatizues i Shantojës dhe i Koliqit, Jokli pati një letërkëmbim të dendun me shumë personalitete kulturore dhe politike shqiptare.

Është meritë e tija që qysh në vjetin 1914 në Vjenë u kryen, për qëllime studimi, regjistrimet e para zanore në gjuhën shqipe me subjekte shqipfolës. Ai njihet si autor i shumë studimeve që trajtojnë kryesisht probleme etimologjike dhe çështje letrare të gjuhës shqipe.

Ernest Koliqi, tue përshkrue një vizitë të bame së bashku me Aleks Budën në shtëpinë e Joklit në dhator të 1937, shkruente një vjetë më vonë te «*Demokratia*» e Vangjel Koçës:

*“E më çoi fill ke një raft librash [...] Botime të vjetra e të reja: Toskësh e Gegësh e Shqiptarësh t’Italís; të gjithë auktorë të mëdhej e të mesëm e të vegjël fare; kolekcjone së përkohëshmesh shti për bukurí në kartuç, radhíteshin të dendun n’at bibljotekë të smirueshme. Shum prej atyne botimeve sot nuk gjinden më, sado me i pague. Sejcili vëllim më së miri i lidhun mbante të shkruem me gërma ari në shpinë titullin e vet. Sýt e mij shetitshin plot lakmi mbi ato tituj e zemra më ndrydhej. Paska qenë dashtë të shkojshëm larg Shqipnije, në një vend të huej, për të gjetun bibliotekën ideale shqipe”.*

Jokli pat krijuë një bibliotekë albanologjije e indogjermanistike me rreth 3000 ekzemplarë libra, prej të cilëve sot kanë shpëtue më pak se 200 copë. Ndër të tjera ai ruente dorëshkrimin e një Fjalori etimologjik të gjuhës shqipe, i cili ishte vazhdimi ideal i punës së nisun prej G. Meyer-it. Mjerisht gjurmët e atij dorëshkrimi kanë hupë qysh në pranverën e vjetit 1942.

Duhet thanë se dëshira e tij ishte që biblioteka e vet t’i përkiste Shqipnisë. Simbas historianëve të sotshëm, ka qenë pikërisht kjo dëshirë fisnike e Prof. Norbert Joklit që ka shenjue fatin e tij mizor. Ngjarjet kanë rrjedhë pak a shumë kështu.



Kalvari i Joklit zen fill në maj të vjetit 1938, atëherë kur nacionalsocialistat filluene me e persekutue e me ia mohue të drejtat profesionale. I shtymë prej disa miqsh, ai vendosi me i drejtue në vjeshtën e vjetit 1939 një lutje *Gauleiter*-it Bürckel, komisarit të *Reich*-ut për zonën e Ostmark-ut, tue i kërkue njohjen e të drejtave të barabarta me “racat e përzieme të gradës së parë”. Lutja nuk u pranue e kështu që Joklit iu mohue e drejta me konsultue deri edhe bibliotekën dhe iu revokuen të gjitha privilegjet akademike.

Megjithatë, në Shqipni, Prof. Jokli pati gjithmonë dashamirë dhe miq të singertë. Me rasën e Kuvendit të parë të organizuëm prej Institutit të Studimeve Shqiptare, të zhvilluëm në Tiranë prej datës 9 deri me 13 prill 1940, ishte ftue me marrë pjesë edhe “*profesor Jokli, albanologu i njohtun izraelit prej Vjenës*” – kujton Francesco Jacomoni (shih: *La politica dell’Italia in Albania*, Cappelli, Rocca San Casciano 1965, fq. 183). Dihet se organizator i atij tubimi të randësishëm ishte ministri Ernest Koliqi.

Në një letër të shkrueme në Tiranë me datën 15 prill 1940, Aleksandër Xhuvani ndër të tjera i kumtonte Joklit:

*“Kemi pasë këto ditë, si do ta marrish vesh, një Kuvend të parë të studimeve shqiptare, ku u mblodhën Shqiptarë e Italianë shkencëtarë e studimtarë, ndër të cilët edhe Bartoli e Tagliavini. Ju kemi zanë n’gojë shumë herë dhe na vinte keq që s’gjindeshit edhe ju në mes t’onë. Ju kemi dërgue të fala me disa kartolina.*

*Gjithë përpjekjet t’ona rrahin që të të sjellin këtu ose gjetiu të veç, për të vijue punën e studimevet t’ueja dhe shpresojmë që t’ja dalim në krye kësaj dëshire*”. (shih: Jokl Nachlass Autogr. 279/114)

Në vjetin 1972 Ernest Koliqi kujtonte ndër vullajt e «*Shejzave*» sesi Prof. Carlo Tagliavini, albanolog i Universitetit të Padovës, me një «letër kushtrimore» të datës 14 mars 1941 i kërkonte me bâ diçka për Joklin:

*“...bahet fjalë me shpëtue njeriun. Dëshira e tij kishte me qenë, siç e din, me kalue vjetët që i kanë mbetë (tash është 64 vjeç) në Shqipni... Un t’i shkruiej këto gjana që të jesh në dijeni të plotë dhe n’emën të miqsisë sonë të vjetër të lutem që të bajsh gjithçka është e mujtun; bahet fjalë me shpëtue njeriun, me shpëtue albanologun mâ të madh, i cili mundet me i dhanë ende shumë studimeve shqiptare*”. (*Shejzat*, 1972, n. 1-4, fq. 83-88)

Duhet thanë se prof. Tagliavini e kishte këshillue Joklin me ia falë me anë të një akti zyrtar bibliotekën e tij Shtetit shqiptar, në mënyrë që me e pasë më të lehtë me marrë lejen për me shkue në Shqipëri (shih: C. Tagliavini, në *Indogermanisches Jahrbuch*, XXVIII, 1949)

Me 15 mars 1941, konsulli shqiptar në Vjenë, dr. Nikollë Rrota (vlla i piktorit Simon Rrota dhe i gjuhëtarit Át Justin Rrota) i shkruente Koliqit:

*“Në rasë të konferencës që mbajti më 27 fruer v.v. miku i jonë, z. Prof. Tagliavini, e informova hollësisht mbi gjendjen e tmershme në të cilën ndodhet sot Prof. Jokl, kurse rryma e sotshme e Nacizmit ka marrë masa tepër të rrepta kundra çëfutënve [...] parashifet që shpejt do t’instradohet për në Poloni pa pasë mundësi as me e marrë me vehte bibliotekën e tij e as me krye më ndonji vepër ditunije. Siç dihet, biblioteka e tij është një ndër më të pasunat dhe më të vlefshmet mbi letraturën shqipe, sikurse mund t’a vërtetojë edhe z. Prof. dr. Ekrem Çabej”.*

Konsulli Rrota, siç marrim vesht prej një letre të P. Kretschmer-it kishte fillue përpjekjet për shpëtimin e Joklit qysh në prill të vjetit 1940.

Në këtë kohë personalitete të ndryshme të kulturës e politikës europiane dhe të vetë qeverisë shqiptare, të përfaqsueme në personën e Ernest Koliqit, po bânin çmos për me e shpëtue Prof. Joklin - tue e ftue me jetue e me punue në Shqipëri. Këtë gjë e dëshmojnë letrat e profesorave Krahe, Kretschmer, Tagliavini, Koliqi, F. Ercole, G. Schiro’ jr., e gjithashtu edhe hapat e marrun në rrugë diplomatike prej ministrit Giuseppe Bottai, prej ambasadorit italian Dino Alfieri në Berlin dhe prej konsullit shqiptar në Vjenë, Dr. Nikollë Rrotës, i cili u përpoq me aq sa mundej edhe mbas vdekjes së Joklit për me dijtë diçka për rrethanat tragjike të fundit të tij.

*“Sa mora letrat e Tagliavinit dhe të Rottës, kujtonte E. Koliqi në vjetin 1972, unë folë me Kryeministrin z. Shefqet Vërlaci i cili pranoi menjherë propozimin t’em me e emnue Jokl-in Organizator t’Arkiveve Shtetnore dhe të Bibliotekave shqiptare. Mblodhi Këshillin Ministrues, që njizâni vendosi at emnim. I a dërgova dekretin përkatës Prof. Jokl-it në Vjenë dhe kumtova njikohësisht Tagliavinin dhe Rottën”.*

Mbas këtyne orvatje fillestare, Koliqi do të shkante apostafat në Romë për me folë për shpejtimin e çeshtjes së Joklit me ministrin Bottai. Ndërkaq ishin tue u bâ traktativa ndërmjet Ministrisë së jashtme italiane dhe asaj gjermane e Bottai e këshillonte Koliqin me folë me Cianon, në mënyrë që ky t’i shkruente J. Ribbentrop-it.

Edhe Prof. Eqrem Çabej, i cili ndodhej në Romë në korrik të vjetit 1941, mbasi ishte emnue prej Koliqit si përfaqësues i palës shqiptare për hartimin e «*Atlantit gjuhësor*» për pjesën e arbëreshëve, interesohej në mënyrë aktive për fatin e Joklit.

Me 18 tetor të vjetit 1941 Prof. Tagliavini, i cili s'prante tue u përpjekë për kolegun e vet austriak, i shkruente Koliqit se konsulli Rrota dhe Jokli kanë ndeshë në vështirësina të paprituna në marrjen e lejes së kalimit dhe se është nevoja që Mëkambësi Jacomoni t'i shkruente një letër urgjente ambasadorit italian Dino Alfieri në Berlin. Jacomoni e shkroi letrën dhe ia nisi menjherë ambasadorit italian. Megjithatë, si ministri Bottai, ashtu edhe ambasadori Alfieri nuk e përmendin në ditaret dhe kujtimet e veta çeshtjen e Joklit.

Me një letër tjetër, e cila mban datën 1 prill 1942, Tagliavini i kumtonte Koliqit lajmin e arrestimit të Joklit dhe përpjekjet për me ndërhy nepërmjet kryeministrit Kruja.

Shkruen Koliqi:

*“Unë nga Tirana i telefonova menjherë Bottai-t në Romë e shkova mandej fyll tu Mustafa Kruja i cili në sý t'em mori telefonin e foli me Ciano-n tue e lutë nxehtësisht me bâ çmos për shpëtimin e Jokl-it. Ciano përgjegji se do të lutte Mussolinin me ndërhy pranë Hitlerit”.*

Duhet thanë se përveç Gestapos, kishte edhe persona të tjerë që nuk donin që Jokli të gjente strehë në Shqipni; një ndër këta ishte edhe Viktor Christian, dekani i fakultetit të filozofisë në Universitetin e Vjenës. Christian kishte frikë se tue fitue të drejtën me shkue me jetue në Shqipni, Jokli do të merrte me vete edhe bibliotekën e tij; ndërsa në rasën tjetër, biblioteka e sekuestrueme prej nazistave do t'i kalonte fondit të Universitetit.

Në fakt, dekani i filozofisë Christian, që mâ vonë do të bâhej rektor i Universitetit, i shkruente *SS-Hauptsturmführer*-it Brunner se, në qoftë se Jokli do të shkonte në Shqipni, biblioteka e tij s'do të mbetej në Vjenë, por në rasë se autoritetet do ta internonin në Poloni, dekani i lutej oficerit SS, që biblioteka t'i jepej fakultetit të filozofisë.

Kah mbarimi i prillit 1942, dekani Christian ishte i informuem për internimin e Joklit dhe për faktin që biblioteka e tij, tue i kalue Universitetit të Vjenës, do të vendosej së shpejti në mjediset e Institutit të Indogjermanistikës ose të atij Oriental.

Menjherë do të interesohej edhe drejtori i përgjithshëm i Bibliotekës Kombtare austriake, Paul Heigl, i cili kërkonte që librat e «çifutit Jokl» të baheshin pronë e komunitetit të gjanë të studjuesve. Edhe ambasada italiane në Vjenë, në emën të së drejtës që kishte fitue Italia prej

bashkimit të kunorave mbretnore me Shqipnin, bante hapat e saj për marrjen e kësaj biblioteke me përbanje albanologjike.

Nji ndër gjanat mâ me vlerë që hupën prej asaj biblioteke, është edhe dorëshkrimi i Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe.

Nji fat të ngjashëm me Fjalorin etimologjik të Joklit, pati edhe Fjalori i gjuhës shqipe i Mustafa Krujës, i cili, edhe pse ekzistonte në dorëshkrim në Institutin e Studimeve shqiptare, mbas vjetit 1944 i hupi fara si mos me pasë qenë kurrë. Fate të ngjashme me bibliotekën e Joklit patën edhe mâ të mëdhat biblioteka që ekzistojshin asokohe në Shqipni: biblioteka dhe arkivat e Lef Nosit, Mithat Frashërit e Eqrem bej Vlorës si edhe biblioteka dhe arkivi i Etënve françeskan dhe i atyne jezuit në Shkodër.

Tue u kthye te Jokli: mjerisht, megjithë përpjekjet e autoriteteve mâ të nalta shqiptare, egërsija naziste nuk i dha mundësi albanologut të shquem me u strehë në vendin tonë.

Me 3 mars 1942 dy nëpunësa të Gestapos e morën profesorin prej shtëpisë së tij në Neustiftgasse 76 dhe e ndryene mâ së parit në Sperrgasse e mandej në kazermen Roßauer në Vjenë. Si nji shkencatar i vërtetë dhe si njeri i dashunuem mbas librash, ai ndihej prej kohësh i dëshpëruem vetëm prej idesë se mund të ndahej përgjithmonë prej librave të tij të çmueshëm. Bile, i kishte pohue gjuhëtarit Carlo Tagliavini, se në rasë se do t'i duhej me u nda prej librave të vet, do të preferonte me mbytë veten.

Si datë e vdekjes së N. Joklit konsiderohet 6 maji 1942, por përta i përket rrethanave të vdekjes së tij jepen variante të ndryshme. Ernest Koliqi, i informuem prej konsullit Rrota, tregon se gjatë rrugës për në nji kamp përqëndrimit në Riga, Jokli u hodh prej trenit kur po kalonte mbi nji urë të naltë rreth 100 metër dhe mbyti veten. Disa studjuesa austriakë pohojnë se Jokli vdiq nën tortura në kazermen Roßauer në Vjenë, ndërsa të tjerë pohojnë se vdiq në kampin e përqëndrimit të Maly Trostinec-it, nji lokalitetit rreth 12 km në juglindje të Minsk-ut, në Ruteninë e Bardhë. Ka gjasë që ky variant të jetë mâ i mundshmi.

Kampi i Maly Trostinec-it ishte krijue qysh në nandor të vjetit 1941 në territorin e ish kolkozit «*Karl Marx*». Tue qenë se në gjysmën e marsit të 1942 partizanët kishin sulmue kampin tue vra rojet, mbas këtij episodi kompania e rojeve ishte shtue si numër, tue arritë shifrën 250 ushtarakë. Zakonisht ekzekutimet në masë në këtë kamp bâheshin me anën e pushkatimit, i cili kryhej në pyllin e Blagoëshçinës.

Simbas listave të transportit të *Reichsbahn*-it (hekurudhat e *Reichut* III), mbartja e parë e hebrenjve prej Vjenet për në t'ashtuquejtunin «*Reichskommissariat Ostland*», u bâ me datën 6 maj 1942. Nji gja të tillë e konfirmon edhe nji raport i detajuem i komisariatit të policisë vjeneze (95. *Pol. Revier*) i shkruem me datën 16 maj 1942. Raporti përshkruen me hollsi «evakuimin» e 1000 hebrenjve prej Vjenet, lista e të cilëve, sqaron me nji ton të ftohtë burokratik funksionari i policisë, ishte raditë prej kapitenit S. Brunner. Mbasi përshkruen me hollësi nisjen prej Vjenet, itinerarin si dhe ndalesat e ndryshme, raporti ven në dukje faktin se me datën 9 maj, kur treni mbërriti në Kajdanoëo, në afërsi të Minskut, kishin vdekë 3 burra dhe 5 gra prej hebrenjve të internuem. Emnat e tyre nuk shenjohen, por ka shumë mundësi se njeni sish të ketë qenë albanologu Norbert Jokl.

### **EPILOG: NAZIZMI DHE KOMUNIZMI SI ANMIQ TË NJERZIMIT**

Lind pyetja: a do të kishte mujtë me shpëtue Jokli po të kishte mbërritë me marrë lejen për me jetue në Shqipni? Deri në nandor të vjetit 1944 besojmë se po, por mâ vonë, tue marrë parasysh se Jokli kishte qenë nëpunës i Perandorisë austro-hungareze dhe se në Shqipni kishte shkue vetëm nji herë, i ftuem prej Mbretit Zog për me marrë dekoratën e naltë «*Komandar i Urdhnit të Skanderbeut*», e cila i ishte dhanë me rasën e 25 vjetorit të Pamvarsisë; por mbi të gjitha tue mos harrue faktin se kishin qenë fashistat si Ernest Koliqi që e kishin ftue me ardhë përgjithmonë në Shqipni, na duket pak e vështirë se puna e nisun prej Gestapos do të kishte mbetë përgjysmë për mungesë zelli prej homologëve të tyre të shquem të regjimit të Tiranës!

Por tue qenë se punët kanë rrjedhë njilloj keq, mâ mirë që «marrja» për ketë vrasje të poshtër i ka mbetë gjermanve dhe jo shqiptarve.

Edhe pse mbi ndërgjegjen e shqiptarve peshojnë vdekje të tjera po aq tragjike sa ajo e Joklit, bâhet fjalë për emna si Lef Nosi, Pal Dodaj, Xhevat Kortsha, Pashk Bardhi, Bernardin Palaj e shumë të tjerë, mbi ndërgjegjen e kombit peshon edhe sekuestrimi i mundit të tyre shumëvjeçar dhe përvetësimi i paturpshëm i vlerave studimore prej autoriteteve të vetëquejtuna «shkencore» të regjimit komunist.

Fati i Joklit âsht nji mësim historik dhe njerzor: nazizmi dhe komunizmi janë degët e thata të po të njejtit “dru të shtrembët që âsht njerzimi” (I. Kant).

Në qoftë se në hymje të kampit të Auschëitz-it komandanti Rudolph Höss kishte shkruar: «*Puna të bân të lirë*», mos të harrojmë se në hymje të gulagëve, sovjetikët venin shprehje si këto: «*Puna të kthen në shtëpi*» ose «*Puna në BRSS është çeshtje nderi dhe lavdie*» (kampi i Vorkutës).

Kur Margarethe Buber Neumann, grueja e një komunistit gjerman të vramë prej Stalinit në kohën e «purgave» të fundit të vjetëve '30, u dorzue prej sovjetikëve në duert e nazistave, tue kalue kështu prej një «gulagu» në një «lager», vërejti se ndryshimi i vetëm që mujti me pa ishte higjiena, të cilën nazistat e kishin më për zemër sesa muzhikët e kuq.

Në vjetin 1947, ish-komandanti i kampit të përqendrimit të Auschëitz-it, R.Höss, ndërta pritte në një burg polak ekzekutimin e dënimit kapital, shkruente me të shpejtë kujtimet e veta (shih: R. Höss, *Kommandant in Auschëitz. Autobiographische Aufzeichnungen*, me parathanje dhe komente të Martin Broszat, Stuttgart 1978). Ndër të tjera tregon, tue dashtë me provue se edhe ndërmjet «fitimtarëve» ka njerëz si ai, sesi në kohën e aleancës me Moskën: në vjetët 1939-1941, nazistat merrshin eksperiencë prej kolegëve të tyre sovjetikë në fushën e kampeve të çfarosjes në masë. Mbas pushtimit të territorit sovjetik – vazhdon Höss - nazistat mbetën të mahnitun për punën shumë të respektueshme që kishin bân kolegët e tyre sovjetikë. Kah ana tjetër komisioni tepër sekret i Vishinskit – shkruente historiani rus Arkady Vaksberg në vjetin 1990 - që mbikqyrte punimet e gjyqit të Nürnberg-ut, kishte si qëllim mospërhapjen e «sekreteve» të tilla prej të pandehunve.

Sulmi i Hitlerit ndaj lëvizjes komuniste, simbas dëshmimeve të hierarkut nazist H. Rauschning, bân më tepër për arsye taktike sesa ideologjike, tue qenë se themeli i nazizmit ishte vetë marksizmi. Ndërsa socializmi sulmohej kryesisht për karakterin e vet internacionalist dhe demokratik, ashtu siç sulmoheshin shtetet demokratike për karakterin e tyre plutokratik.

Pesë ditë përpara sulmit ndaj BRSS, J. Goebbels-i shenjonte në ditarin e tij se fitorja ndaj judeo-bolshevizmit do të çonte drejt vendosjes së socializmit të vërtetë (*der echte Sozialismus*).

Nacional-socializmi hitlerian tue vu në jetë të ashtuquejtunen «zgjidhje finale» për çeshtjen hebraike, nuk bân gjë tjetër veçse ndiqte pikë për pikë mësimet e Marx-it dhe të Engels-it.

Justifikimi i genocidit dhe spastrimi etnik janë karakteristika të Shtetit totalitar dhe të teoricienëve të tij (shih: George Watson, *The lost literature of socialism*, The Lutterworth Press, 1998).

Siç ka vu në dukje studiuesi G. Watson, në vjetin 1849 Friedrich Engels-i kërkonte prej faqeve të revistës «*Neue Rheinische Zeitung*», (e cila drejtohej prej mikut të tij K. Marx), zhdukjen e hungarezëve, mbasi këta ishin rebelue ndaj Vjenës. S'mjaftohej me aq, por donte edhe shuemjen e disa popujve sllavë si serbët, e mandej baskët, bretonët dhe malësorët skocezë. Nuk është për t'u çuditë që Stalini te vepra e tij “*Themelet e leninizmit*” (1924) e porosiste këtë artikull si të nevojshëm për t'u lexue prej revolucionarëve. Engels-i edhe te një letër drejtue Marx-it (23 maj 1851) mohonte ekzistencën e polakëve si komb dhe vlerësonte ekspansionin prusian drejt lindjes, si të domosdoshëm; bile edhe çmonte Rusinë e Carit si një «vend progresist» që dinte me «trajtue» pakicat. Engels-i e konsideronte racën si një ndër faktorët ekonomikë që përcaktojnë fenomenet historike (shih: *Letër e Engels-it drejtue W. Borgius*, 1894).

Edhe Marx-i te shkrimi me titull «*Revolucioni dhe kundërrevolucioni në Gjermani*» (botue te *NRZ*, 1852) mendonte sesi mund të zhdukeshin prej faqes së dheut grupet etnike të çekëve, sllovenëve, dalmatinëve - të cilët, simbas tij, s'kishin vitalitet dhe duhej të asimiloheshin prej gjallnisë gjermanike.

Prej këtyne nënvizimeve jo të rastësishme kuptojmë se doktrinat totalitare duen me shpëtue gjysmën e botës tue shue gjysmën tjetër e të gjithë ata që i kundërshtojnë janë të destinuem me iu bashkangjitë asaj «gjysmës tjetër».

Tiranët nuk i duen njerëzit e lirë të kulturës dhe të shkencës, e edhe atëherë kur mundohen me u paraqitë si shpëtimtarë të kulturës e të vlerave kombtare, tiranët nuk bâhen dijetarë apo të urtë, mbasi ai që tue vra shkencatarin kujton se ka shpëtue veprën, përveçse mizor është edhe stramastik i përbuzshëm.

Mark PALNIKAJ

## **DOKUMENTI I STEFANO GASPARIT I VITIT 1671, HISTORIKU I SHKRUARJES DHE PUBLIKIMI I TIJ**

Ky dokument konsiderohet më i rëndësishmi për Historinë e Shqipërisë për shekullin XVII.

### ***Relacion apo Raport?***

Në të gjitha rastet kur është komentuar ky dokument është cilësuar si “Relacioni i Stefano Gasparit i vitit 1671”. Në të vërtetë ky cilësim me këtë emër ka qënë i padrejtë sepse ky dokument nuk është një relacion në kuptimin zyrtar të tij. Mbas krijimit në Vatikan në vitin 1622 të institucionit për përhapjen e fesë e quajtur Propaganda Fide, njëri nga vendimet ka qënë detyrimi për klerikët që punonin brënda kontinentit European të dërgonin çdo vit nga një relacion për gjendjen në teritorin që ata administronin nga ana fetare. Ata që punonin në vende të tjera jashtë Europës, duhet detyrimisht të dërgonin një relacion së paku një herë në dy vjet.

Relacioni nuk mund të hartohet sipas dëshirës së njërit apo tjetrit klerik por ishin caktuar një listë me 27 kërkesa mbi të cilat duhet të dërgoheshin të dhëna në mënyrë që në Vatikan të kishte të dhëna të mjaftueshme për të njohur realisht gjendjen e të gjitha rajoneve ku ata kishin aktivitetin e tyre fetar. Në vitin 1802 numri i pikave mbi të cilat duhet të përfshiheshin të dhëna në relacionet e dërguara ishte 69.

I parë në këtë këndvështrim ky dokument nuk është një relacion por është një raport me shkrim për gjendjen në zonën e influencës së kishës katolike në Ballkan. Ky është kërkuar me vendosmëri nga Papa dhe është sponsorizuar me fond të veçantë nga kisha, ndryshe me relacionet që ishin një detyrim ligjor dhe një punë rutinë që duhet të kryhej nga Ispeshkvinjtë, Vikarët Apostolik dhe meshtarët në zonat ku ata shërbenin.

I shkruar në 125 fletë dhe i shpërndarë në 211 faqe dorëshkrim, ky i tejkalon kufijtë e një relacioni informativ dhe ka rëndësinë e një studimi të plotë për zonat që ai i studjoi dhe i shkeli me këmbë për dymbëdhjetë muaj pa ndërprerje.

Rëndësia e këtij dokumenti qëndron në faktin se popullsia e Shqipërisë së Veriut e përfshirë në teritorët e shtatë dioqezave, në shumicën dërmuese i kishte mbijetuar asimilimit fetar dhe nuk e kishte pranuar të bëhej reneгат i fesë katolike në pjesën më të madhe të tij.

Këtë qëndresë e kishin bërë në mënyrë të pavarur dhe pa mbështetje nga Selia e Shenjtë për afër një shekull e gjysmë.

Në masë të madhe ata jetonin si shqiptar por si të krishterë jetonin vetëm për forcë zakoni dhe jo sepse kisha romane kishte treguar ndonjë përkujdesje për ta.

Mbas krijimit të organizatës për përhapjen e fesë në janar 1622 e quajtur ndryshe edhe Propoganda Fide, u krijuan organizma për të rimëkëmbur besimin e harruar nga një pjesë e popullsisë së vendeve të pushtuara nga Perandoria Osmane ku bënte pjesë edhe popullsia e Shqipërisë së sotme.



Për përmbushjen e këtij misioni organet më të larta të Selisë së Shenjtë në Vatikan vendosën të dërgonin një person për të paraqitur një panoramë të saktë të gjendjes së besimtarëve në këto treva. Personi i ngarkuar me këtë punë duhet të shkonte fshat më fshat dhe të përshkruante në mënyrë të hollësishme realitetin në të cilin ndodhej popullsia e këtyre vendeve. Duhet të silleshin të dhëna për gjendjen dhe numrin e popullsisë, sa ishin konvertuar në fenë islame dhe sa e ruanin akoma besimin e mëparshëm, gjendjen e kishave dhe inventarit të brendshëm, shpenzimet e nevojshme për riparimin e tyre, gjendjen e pronave të kishave dhe vlerën aktuale të tyre dhe të dhëna të tjera me karakter social dhe politik.

Dokumenti përmban të dhëna të hollësishme për numrin e popullsisë por edhe vendbanimet dhe emertimin e tyre edhe kur janë katër apo pesë familje. Ka të dhëna gjeografike ku përfshihen emrat e lumenjëve, maleve, krahinave, kufinjat gjeografik të tyre etj. Ka të dhëna me karakter ekonomik ku tregohet për llojet e bimëve që kultivoheshin, për prioritetet, për gjendjen ekonomike të popullsisë, për monedhat, për shërbimet që ofroheshin si fetare ose edhe shëndetësore deri edhe kirurgjikale.

Nisur nga këto informacione që përfshin ky dokument është konsideruar nga studiuesit e huaj dhe më vonë edhe nga ata shqiptar si dokumenti më i rëndësishëm për historinë e Shqipërisë për shekullin XVII. Por nëse një relacion i ngjajshëm i Zmajeviqit i vitit 1704 është publikuar i plotë dhe me fare pak gabime, dokumenti i Gasparit megjithse mjaft me rëndësi, akoma edhe sot e kësaj dite është publikuar vetëm pjesërisht dhe me shumë gabime të cilat vazhdojnë të merren në konsideratë si burime historike të sakta dhe të prodhojnë shkrime me gabime të cilat nganjëherë shkojnë deri në tjetërsim të realitetit historik.

Nga të dhënat arkivore merret vesh se dërgimi i Shtjefën Gasprit në Shqipëri për të raportuar për gjendjen e kishës katolike në këto treva por edhe për gjendjen sociale dhe shoqërore të popullsisë së këtyre trevave, është iniciuar nga vetë Papa dhe është ndërmarrë nga organet më të larta të shtetit të Vatikanit. Ai është përzgjedhur për këtë mision sepse ishte me kombësi shqiptare, njipte gjuhën dhe zonat në të shtatë Dioqezat me popullsi shqipfolëse, kishte mbaruar me sukses Kolegjin Ilirik të Loretos dhe Kolegjin Urbanian në Vatikan dhe mbi të gjitha ishte i njohur edhe për një inteligjencë të mirë në raport me kolegët e tjerë. E thënë ndryshe, ai në vitin 1670 kishte mbaruar dy shkolla të larta nga më në zë për atë kohë dhe kjo ishte padyshim një arritje shumë e madhe e tij.

Në fillim ofertën për të kryer një mision të tillë ai nuk e ka pranuar me pretendimin se i rrezikohej jeta nga turqit që kishin pushtuar këto zona dhe se i kishin ofruar një pagesë të pamjaftueshme. Mbas disa muaj bisedimesh midis tij dhe eprorëve, është rënë dakort që ai të vizitonte dioqezat me banorë shqip-folës jo si klerik por si një turist, qytetar i thjeshtë kundrejt një shume shumë të madhe monetare për nevoja të shërbimit si ushqim, fjetje, pagesë për kuajt dhe shoqëruesit dhe për ryshfetet që parashikohej se do ti duheshin për pushtetarët e korruptuar turq nëse ata do ti nxirrnin pengesa. Shuma e madhe monetare që i është vënë në dispozicion për të përmbushur misionin e ngarkuar, e vinin atë para përgjegjësisë që detyrën e ngarkuar ta kryente në nivelin më të lartë të mundshëm. Në dokumenta e ruajtura në Arkivin e Propogandës

së Fesë në Vatikan (APF) del krejtësisht e qartë që Gaspri dërgohej në misionin e tij jo si **relator** por si **eksplorator** dhe raporti që ai duhet të sillte duhet ti tejkalonte kufinj të një relacioni.

Prandaj ka kaq shumë rëndësi gjetja dhe publikimi korrekt i këtij dokumenti sepse në të është përfshirë maksimumi i mundshëm i informacioneve që mund të merreshin në atë kohë nga një person i huaj, nga vende kundërshtarë me pushtuesin osman të vendit tonë.

Në Shqipëri ky dokument është publikuar për herë të parë në revistën “Hylli i Dritës” në katërmbëdhjetë numra gjatë viteve 1930, 1931 dhe 1932.

Nisur nga sa paraqitëm më sipër jemi të mendimit që ky dokument nuk është e drejtë të emërtohet relacion, por raport mbi gjendjen kishtarë në shtatë dioqeza të shtrira në bregdetin ballkanik deri në thellësi të kontinentit evropian.

### ***Publikimi i dokumentit***

Historianët dhe studiuesit e ndryshëm që merren me histori i janë referuar këtij dokumenti që ata e kanë emërtuar relacion në dhjetëra shkrime të publikuara gjatë këtyre nëntëdhjetë viteve për të ilustruar shkrimet e tyre duke sjellur shumë herë konfuzion dhe pasaktësi të “çertifikuara” me autoritetin e revistës prestigjioze “Hylli i Dritës”.

I pari që ka reaguar mbas këtij publikimi ka qënë studjuesi Fulvio Kordinjano i cili në vëllimin e tretë të librit të tij me titull “*L’Albania a traverso l’opera e gli scritti di un grande Missionario italiano il P. Domenico Pasi S. I. 1847-1914*”, botuar në Romë në vitin 1934, i ka kushtuar këtij dokumenti një kapitull të tërë, atë të dhjetin, nga faqja 321 deri në faqen 332 duke i bërë një analizë të thellë historikut të tij dhe publikimit në revistën “Hylli i Dritës”. Ai ka shkruar se ka kërkuar kopjen origjinale të këtij dokumenti në arkivat italiane të kohës dhe nuk e ka gjetur. Në vazhdim të punës së tij ai ka lexuar kopjen e këtij dokumenti që ishte i ruajtur në fondet e APF në Romë dhe kopjen e Napolit të botura në revistën “Hylli i Dritës”.

Mbas studimit të vëmendshëm të kopjes dhe të revistës, ai ka arritur në konkluzion se publikimi përmban më shumë se njëqind gabime që vinin nga pamundësia e leximit dhe rishkrimit të realizuar nga paleografët që janë marrë me këtë punë dhe ka publikuar në librin e tij një tabelë me njëqind gabime që ai ka mundur të identifikojë. Kjo tabelë është e vendosur në faqet respektive 327 deri 332 të librit në fjalë. Në këtë korrigjim të gabimeve të vërejtura ai nuk ka përfshirë paragrafët që mungojnë në kopjen e Napolit.

Në respekt të aftësive të tij si studiues shumë i aftë dhe të dashamirësisë së tij për Shqipërinë, po sjell të plotë pjesën kryesore të kapitullit X të librit që cituam më sipër dhe lexuesi është në gjendje të nxjerrë konkluzione për atë çfarë shkruhet në relacion dhe për rëndësinë e tij. Po e vendosim të shkruar në gjuhë shqipe faqet nga 321 deri 327 të këtij libri. Siç mund të shifet më poshtë Kordinjano nuk i quan relacion por dokument këto shkrime të klerikut shqiptar Shtjefën Gaspri, të njohur simbas emrit të shkruar në gjuhën italiane Stefano Gaspari.

“ Shënime Historike mbi vizitën në Kishën e Arbërisë dhe të Serbisë të kryer nga D. Shtjefën Gaspri.” \*

Dokumenti i D. Shtjefën Gasprit, nga i cili kemi nxjerrë një statistikë të përmbledhur për çdo Dioqezë, pas vizitës së bërë dhe të përshkruar nga Imzot Marino Bici i Arbes (Dalmacia), Arkipeshkvi i Tivarit (nga 1608 deri në vitin 1625), është më i rëndësishmi për të gjithë shekullin XVII. Në të vërtetë, ky dokument të bën të shohësh kushtet jo vetëm të dy viteve (1671-1672), gjatë të cilave Gaspri përshkon Shqipërinë katolike, por të bën të kuptosh të gjithë grumbullin e dokumenteve të Propaganda Fides, të cilët referojnë kushtet e lartpërmendura fetare të Katolicizmit shqiptar. Kemi përmendur ndonjë gjë në serinë e parë të dokumenteve, në Shtesën e Volumit II. Këtu del e nevojshme të bëhet e ditur historia e asaj vizite, si dhe të dalin në pah ndryshimet midis Dokumentit Romak dhe atij nga i cili u morën statistikat e përfshira në punimin tim:

Propaganda Fide duhet të ketë qenë e shqetësuar nga relacionet e ndryshme dhe kontradiktore që merreshin nga Shqipëria. Por të gjitha të bënin të besojë se ishin jo të pëlqyeshme. Dokumentet dhe Actat flasin për përplasje të pafundme juridiksioni midis disa peshkopëve, flasin për simoni<sup>1)</sup> në shpërndarjen e Sakramenteve dhe në Urdhrat e Shenjtë, flasin për Kler rebel, i cili pushtonte famullitë me ndihmën e fuqisë sekulare të Turqve, për zgjedhjen jo të mençur të çështjen e kandidatëve për Priftëri dhe prej nga rrjedh edhe dalja mbanë kaq e dobët e jo pak priftërinjve. E gjithë kjo, bashkë me apostazitë që ndodhin dhe me persekutimet që herë pas here rindizen, e bindi Kongregacionin e Shenjtë që të dërgojë një vizitor. Kjo nuk mund të ishte shumë e lehtë, si për shkak të Qeverisë turke, ashtu edhe për arsye të vetë Klerit. Si i bëhej? Propaganda Fide mendoi të dërgonte një Shqiptar, të aftë për një detyrë kaq të rrezikshme dhe njëkohësisht kaq të rëndësishme dhe kaq delikate, i cili duhej të paraqitej jo si Vizitor, por si eksplorator, në dukje si një udhëtim që dikush, i cili jeton larg dhe dëshiron të shohë sërish atdheun, e bën për qejf të tij. Një i huaj menjëherë do të ngjallte dyshime, për një person vendas ishte mjaftë më e lehtë.

Por nuk ishte e lehtë të zgjidhje, ashtu siç del nga letrat e shumta të Propagandas drejtuar Imzot Nuncios së Venecias (Arkiva e Athinës). Ja si flasin Dokumentet e Propagandës.

“... i shtohet (Gasprit) se përse i takon kësaj (parasë) do t'i jepej urdhër Kavalier Bolicës në Kotorr, që në rast të urgjencave të tilla të pajisej me atë që kishte vërtet nevojë dhe për atë që mbetet i ofrohej 40 skudë në muaj për viatikon<sup>2)</sup> në shkuarje dhe patjetër në kthim, njëzet skude në muaj për kohën e qëndrimit dhe duke pranuar që të nisej sa më parë, por që para së gjithash të kujtohej që mendimi i Kongregacionit të Shenjtë nëpërmjet shumë letrash të shprehura mjaft qartë, ishte se ai duhej të shkonte dhe të luante rolin e një eksploratori dhe jo të një Vizitori, duke u shprehur të gjithëve se shkonte për qejf të vet, nga dashuria që kishte për Atdheun dhe jo

\* Në kohën kur është shkruar ky relacion, një pjesë e veriut të Shqipërisë së sotme emërtohej Arbëri dhe Dioqeza e Shkupit e cila përfshinte të gjithë teritorin e sotëm të Kosovës dhe Shkupin me rrethina, emërtohej Dioqeza e Serbisë ( Diocesi di Serbia)

<sup>1)</sup> Quhej tregimi i gjërave që mbahen për të shenjta (shën. i përkth.).

<sup>2)</sup> Quhej furnizimi ushqimor për udhëtimin (shën. i përkth.).

si i dërguar nga Kongregacioni i Shenjtë, çka ai e tregonte në përgjigjet e tij se ende nuk e kishte kuptuar mirë.

*Imzot Nuncio përgjigjet se ndërsa i fliste sërish atij në këtë mënyrë, pothuajse ishte prishur bashkëbisedimi, meqenëse Gaspri këmbëngulte në pretendimet e tij dhe duke e tepruar se 40 skudet nuk ishin aspak të mjaftueshëm për t'ia dalë mbanë. Por që dy ditë më pas i kishte shkruar një letër, e cila t'i përcillej EE.VV., përmbajtja e së cilës është se kishte kënaqësinë të bëhej gati për nisje për të gjithë muajin tetor, të paguar nëse i jepnin çdo herë në Venecia tetëdhjetë skudet e viatikos dhe nëse sigurohej se i jepnin në Kotorr njëzet skude në muaj për shumën e caktuar atij”.*

*(Illir. 330 fol. 81-27 nëntor 1662).*

*(Card. Brancacci).*

*“-Ka disa vite që me urdhër të EE. VV. kërkohet një person për vizitën në Shqipëri dhe midis atyre që u propozuan, një ishte D. Shtjefën Gaspri, prift shqiptar, i cili tani banon në Padova, por që nga cilësia e pyetjeve të tij argumentohet se ai nuk do të dinte të përmbushte mjaftueshëm sensin e Kongregacionit të Shenjtë, i cili ishte që të shkonte **jo si Vizitor**, por në mënyrë sekrete **si Eksplorator**, përveç teprive, në të cilat ai fuste vështirësitë e tij dhe për këtë arsye thoshte se kishte nevojë për shumë parà, pothuajse u prish bashkëbisedimi dhe u urdhërua që të bëhej një kërkesë e re për të gjetur ndonjë tjetër më i përshtatshëm, mirëpo meqë doli e kotë çdo përçapje iu shkrua sërish Imzot Nuncios së Venecias, i cili përgjigjet se Gaspri kishte ulur shumë nga pretendimet e tij dhe se duhej përshtatur përpikmërisht me udhëzimet, të cilat nëse i jepeshin deri në 2 prill 1663 miratoheshin nga EE.VV., i shkruhej Imzot Nuncios që ai të bënte pjesën e tij në mënyrë që të viheshin në zbatim. Tanimë, Gaspri shkruan se meqenëse nuk ka marrë asnjë urdhër për t'u nisur gjatë gjithë kësaj kohe, ka menduar se Kongregacioni i Shenjtë nuk donte të vepronte; por ofrohet sërish për këtë detyrë dhe shton se nëse nuk i jepet vendimi deri në gushtin e ardhshëm, ai do ta marrë si refuzim, meqenëse bashkëbisedimi ishte prerë dhe ai çlirohej nga fjala e dhënë, kështu priste përgjigje nga EE.VV.”.*

*Nga e gjithë kjo kuptohet rëndësia e jashtëzakonshme që i jepte Kongregacioni i Shenjtë vizitës së Gasprit. Dokumenti, siç është ruajtur në Arkivin e Propagandës, gjendet i shkruajtur në shpinën e volumit: Vizita e Alb.(Vizita në Arbëri) e vitit 1676 bërë nga Shtjefën Gaspri (Lidhja) 34, përmban 156 fletë; në fletën e parë është një listë e priftërinjve të Shqipërisë dhe të Bullgarisë, me një sigurim skudesh të paguara atyre, vizita e vitit 1676, nga e cila ndoshta kush shkruan ka shkruajtur treguesin e jashtëm të volumit ka datën 1576, e cila nuk është sigurisht ajo e vizitës së Gasprit. Fleta 1, pra nuk ka të bëjë me vizitën.*

*Vizita e 7 dioqezave përfshihet midis fletëve 6-123; vijojnë të gjitha bashkëlidhjet dhe shtojcat dhe Actat përkatës të Propagandës me disa dokumente në lidhje me ndarjen e kufirit midis Lezhës, Sapas dhe Durrësit. Fleta 156 mban korrektimet e tre Kardinalëve Ottoboni, Caraffa, Rasponi në skicat e Actas.*

*Nga ky dokument duhet të ekzistojë një kopje në një Arkiv të Napolit, nga i cili është nxjerrë ajo që është botuar këto vitet e fundit në revistën shqiptare të Rr. PP. Françeskanë “Hylli i Dritës”.*

Nga kjo unë nxjerr shënime të mia statistike. Duke përqasur këtu në Romë shënime të tilla me Dokumentin e Propagandës, dallova menjëherë se Dokumenti romak është mjaft më i plotë. Nuk e di nëse mangësitë e botimit të “Hylli i Dritës” janë prej vetë Fletores apo prej redaktimit të Dokumentit të bërë në Napoli. Sigurisht nga Fletorja françeskanë nuk dallohet nëse është hequr ndonjë enkas.

Dallimet midis këtij botimi dhe dokumentit romak, ndonëse nuk janë të një rëndësie të madhe nuk rreshtin së qeni përkatëse. Meqenëse ndonjëherë ortografia e emrave gjeografikë është e ndryshme, kështu ngatërrohet p.sh. Plava me Pedanan (Arkidioqezja e Shkodrës – Veri): Zusci me Zuani (Xhani, Xhaj i Shkrelit) etj., etj. Çka mund të jetë gabimi i kopjuesit që ka përdorur Fletorja e Shkodrës apo e redaktorit të tekstit napoletan. Por është e vërtetë se ndonjëherë ortografia gjeografike e Dokumentit në “Hylli i Dritës” është më e saktë, çka të bën të hamendësosh se Dokumenti i Napolit nuk rrjedh drejtpërdrejt nga Dokumenti i Romës, por ka të ngjarë që të dy të rrjedhin nga origjinali, të cilin nuk munda ta gjej.

Përsa i takon mangësive dhe pjesëve të hequra të Dokumentit napoletan, i cili u botua te “Hylli i Dritës”, po bëjmë një përmbledhje të shkurtër.

Mangësitë i takojnë në pjesën më të madhe shënimeve që Gaspri i bën secilit Prift dhe Prelat Shqiptar, në mënyrë të veçantë. Të tilla shënime përforcojnë dhe ilustrojnë një dokumentacion të gjatë të Propagandës dhe të bëjnë të kuptosh se edhe Shqipëria si një pjesë e madhe e Europës, si dhe asokohe ashtu si i gjithë Ballkani dhe Lindja e Afërme, kishte rënë në një krizë të tmerrshme eklesiastike. Kjo nga ana e saj të bën të kuptosh se si Apostazia depërtoi gjithmonë e më shumë dhe Katolicizmi shpëtoi vetëm si nga një mrekulli. Duke mos trajtuar tjetër përveçse Relacionit të Bizzit, relacion i dhjetëvjeçarëve të parë të Shekullit dhe më pas atë të Gasprit, si dhe Koncilin I Shqiptar të vitit 1703, kemi një kuadër tragjik të historisë eklesiastike të Shqipërisë dhe të Serbisë. Misionet Françeskane, në dhjetëvjeçarët e parë të jetës së tyre, kanë qenë një pranverë e mahnitshme fetare, e cila mjerisht ishte tashmë në rënie, pra në kohën e vizitës së Gasprit.

Nga Dokumenti i plotë i Gasprit del:

1. Në Dioqezën e Pultit, nga tri Priftërinjtë që janë këtu (përfshirë vikarin), askush nuk bën detyrën e tij pastorale siç duhet, megjithëse, me përjashtim të lakmisë së vikarit, nuk është treguar ndonjë ves i veçantë.

2. Në Dioqezën e Shkodrës, ndër 13 Priftërinjtë, vetëm tre kanë një vlerësim të mirë, përsa i takon zakoneve, të tjerët jo vetëm e kanë lënë pas dore detyrën e tyre priftërore, por janë skandal i vërtetë për besimtarët. Është e dhimbshme që Gaspri thotë edhe për Pjetër Bogdanin – i cili ka mbetur në Histori me aureolën e një shkrintari të parë shqiptar dhe apologjist shqiptar – se ishte “më lakmitari për parë”.

3. Në Dioqezën e Sapas, ndër 21 Priftërinjtë, një (nxënës i Propaganda Fides) është pa njollë, madje i lavdërueshëm; për dy shënohet vetëm se ata nuk bëjnë një jetë të shturur; vetëm një jep mësim Doktrinën e Krishterë, për të gjithë të tjerët, përfshirë peshkopin Fra Simone Suma, Vizitori përdor një gjuhë kritikuese.

4. Në Dioqezat e Lezhës mund të marrësh pakëz frymë dhe mbetesh i ngushëlluar, pasi megjithëse kleri i ulët ishte siç mund të ishte dikush i caktuar pa pothuajse asnjë përgatitje, megjithatë ndër 18 Priftërinj (përfshirë Mirditën), tre janë bindshëm të lëvdueshëm, një është fajtor vetëm për pjesëmarrjen në një farë mënyre në grabitjet, duke përfutur; por nëse për këtë ishte fajtor edhe vetë peshkopi, Imzot Gjergj Vladanji? Të tjerët janë injorantë, por nuk bëjnë skandale.

5. Në Arkdioqezën e Durrësit janë në shërbim 35 priftërinj. Nga këta, 12 kanë vlerësime të mira përsa i takon zakoneve, dy apo tre janë shembullorë, të gjithë të tjerët janë të padenjë për detyrën e tyre të lartë priftërore që u është besuar.

Arkipeshkvi, Imzot Gerardo Galata, mjerisht nuk ishte Prelati i duhur për Kishën dhe Ungjillin, për arsye të lakmisë së tij, e cila e bënte të kryente marrëzira.

6. Në Shkup ndër gjashtë priftërinj, 3 janë me vlerësim të mirë. Arkipeshkvi, Imzot Andrea Bogdani, është tashmë tetëdhjetë vjeç, por mjerisht shiste edhe ai Vajra të Shenjtë.

7. Në Arkidioqezën e Tivarit, një syresh ka vlerësim të mirë, tre nuk e ushtrojnë siç duhet detyrën priftërore, një është fajdexhi dhe shumë injorant.

Vizitori ankohet shpesh se Peshkopët e lenë veten të udhëhiqen nga qëllimet e tyre simoniake në zgjedhjen e Klerit, gjë nga e cila rridhnin të këqija të pallogaritshme; kështu nuk kishte një dorë të fortë në mënyrë që të jepet mësim Doktrina e Krishterë, të hiqeshin veset, të qortoheshin skandalet, në një Kler të ulët që në më të shumtën e rasteve ishte shumë injorant, aq sa nuk dinte të shkruante, lexojnë pak apo keq, kështu nuk kuptojnë atë që lexojnë dhe nuk munden të kremtojnë Meshën e Shenjtë pa një mal gabimesh. Me pak fjalë, kishte humbur tërësisht jo vetëm shpirti eklesiastik, por edhe vetë shpirti i të krishterit.

Vizita e Gasprit ishte një lëvizje serioze nga ana e Propaganda Fides, lëvizje që do ta vinte në krye të Koncilit të Parë Shqiptar të vitit 1703. Aty ishte vetëm një prelat, Andrea Zmaieviq (Grykat e Kotorrit), për të cilin Gaspri bën një lëvdatë të përsosur dhe që duhej të ishte pararendësi i Vincenzo Zmaieviqit, i cili me urdhër të Romës hapi në Merqinë Koncilin e lartpërmendur.

Është e dhimbshme që në një kohë me kaq shumë shturje, braktisje dhe apostazi, vetë Urdhëri i Shën Françeskut në Shqipëri, i cili madje kishte nxjerrë martirë, i braktisi pozicionet e tij, ato të një heroizmi misionar, e harroi zellin zanafillor. Në dallim nga Kleri i Ulët dhe Kleri i Lartë, i cili me përjashtim të Imzot Zmaieviqit, ishte asokohe vetëm Shqiptarë, Françeskanët kishin në radhët e tyre, në strehëzat e tyre, italianë, dalmatë dhe shqiptarë.

Ja si gjykonte Gaspri: “Për sa unë kam bërë në veprimet e kësaj vizite, kam gjetur se është shuar krejt në Etërit e lartpërmendur ai zell dhe dëshirë e zjarrtë që kanë pasur kur kanë hyrë për herë të parë në këtë Provincë, në mbajtjen dhe dhënien mësim të Doktrinës së Krishterë për rininë dhe zakonet e mira, meqenëse nuk e ushtrojnë më këtë funksion të shenjtë të tyre në asnjë vend të misioneve të tyre”.

Pavarësisht të gjitha këtyre, aty kishte ende disa priftërinj mjaft të zellshëm. Unë mendoj se mjedisi kishtar i përgjithshëm i bën që t’ju bjerë zelli i parë, si dhe duhet shtuar fakti se nuk

*duket të kenë qenë me fat dhe të matur në zgjedhjen e vokacioneve të reja për vendin, ashtu siç del nga shënimet e Gasprit.*

*Tani duhet të themi nëse e gjitha kjo mund të ketë ndodhur në një shekull persekutimi që ka pasur martirët e vet dhe ndërsa peshkopët merreshin ndër nxënësit e Kolegjit të Propagandës si dhe Kolegji i Loretos, atëherë cilat duhet të kenë qenë kushtet eklesiastike në periudhën që paraprinte pushtimin otoman, në mes pasurive, luftërash të brendshme dhe krahas skizmës, e cila kërcënonte kudo Shqipërinë? “.*

Këtë kapitull Kordinjano e shkroi në vitin 1933 dhe e botoi në vitin 1934. Siç mund të kuptohet nga leximi i këtij shkrimi, Kordinjano kopjen e dokumentit të depozituar në Napoli nuk e kishte parë kur shkroi librin por ai kishte në dorë kopjen e ruajtur në Arkivin e Propagandës Fide. Më poshtë Kordinjano ka shënuar edhe 4 faqe të librit të tij me gabimet që ai kishte vënë re në botimin në “Hyllin e Dritës” të kopjes së dokumentit të Gasprit. Këto nuk po i përfshijmë në botim sepse lexuesi mund ti gjejë të shkruara qoftë në librin origjinal të Kordinjanos qoftë në përkthimin e këtij libri nga Ilirjana Angoni dhe botuar nga shtëpia botuese “Plejad” në vitin 2011.

Tani, mbas tetëdhjetë e shtatë viteve që është publikuar pjesa e fundit e kopjes së këtij relacioni të marrë nga Biblioteka Kombëtare e Napolit në Pallatin Mbretëror të këtij qyteti, marrë shkas nga gabimet e shumta që përmban ky publikim, vendosëm të merremi edhe një herë me këtë problem. Për këtë arsye kemi marrë të plotë kopjen e këtij relacioni që gjëndet në Napoli që ruhet si dorëshkrim në 125 fletë ku të shkruajtura janë 111 faqe, në një dosje me rreth 450 faqe dokumenta të ndryshme. Kemi marrë edhe kopjen që gjëndet në Arkivin e Propagandës Fide në Vatikan, edhe ky në dorëshkrim me mbi 120 fletë me 208 faqe pothuajse të shkruara të plota.

Nga krahasimi i dy kopjeve të përmendura dhe i shkrimit të publikuar në “Hyllin e Dritës”, lehtësisht dallohet që ka ndryshime të mëdha midis kopjeve në dorëshkrim dhe tekstit të publikuar në revistën në fjalë. Nga studimi që u kemi bërë këtyre dokumenteve kemi vënë re që kopjet dorëshkrim midis tyre kanë dallime dhe nuk janë kopjuar nga i njëjti person por nga dy kopjues të ndryshëm. Teksti i publikuar në revistën “Hylli i Dritës” është një rishkrim i kopjes dorëshkrim të Napolit por i rishkruar me më shumë se dyqind gabime.

Kopja që ruhet në Vatikan ka ndryshime të dukshme sepse ka të shkruara të dhëna që kopja e Napolit nuk i përfshin. Ajo është shumë më e plotë se kopja e Napolit dhe ka disa paragrafe shkrime më shumë, me të dhëna që kopjuesi që ka shkruar kopjen e Napolit i ka lënë pa i shkruar për motive që për ne nuk janë të qarta. Një hamendësim mbi mospërfshirjen e disa paragrafeve në kopjen e Napolit mund të jetë që ai u shkrua jo i plotë për të ruajtur disa të dhëna që për atë kohë mund të konsideroheshin sekrete. Kjo ide e jona mund të konsiderohet vetëm një hamendje e pa bazuar në të dhëna konkrete. Arsyeja e mos përfshirjes në kopjen e dokumentit të këtyre paragrafeve mund të jetë krejt tjetër nga ajo që mendojmë ne.

Nisur nga ky fakt, jemi të mendimit që duhet kërkuar në arkiva të tjera për të bërë të mundur gjetjen e kopjes origjinale të shkruar nga autori dhe të bëhet rishkrimi dhe publikimi nisur nga kopja origjinale. Mbasi këtë gjë ne nuk e kemi arritur, atëherë kemi rishkruar

korrektësisht kopjen që gjëndet në Arkivin e Propogandës Fide. Jemi të mendimit që kopja origjinale mund të ndodhet në Arkivin Sekret ose në fondin e dorëshkrimeve të Bibliotekës Apostolike në Vatikan. Nëse dokumenti origjinal do të gjëndet dhe të publikohet, atëherë do të zhdukej çdo hije dyshimi mbi saktësinë e publikimi tonë. Deri sot ky relacion është botuar dy herë por në të dyja rastet jo i plotë. Botimi i parë, siç e thamë më sipër, u botua në revistën “Hylli i Dritës”, në vitet 1931, 32, 33 në 14 numra. Ky botim nuk është i plotë sepse nuk është e plotë kopja që gjëndet në Bibliotekën Shtetërore të qytetit të Napolit, në fondin Brancaciana sipas së cilës është bërë publikimi.

Botimi i dytë i këtij relacioni është bërë nga albanologu Peter Bartl, në serialin e botimeve të tij “Albania Sacra” në 4 volumet e para. Ai ka botuar sipas kopjes që gjëndet në Arkivin e Propagandës Fide në Vatikan të dhënat për Dioqezat e Durrësit, Lezhës, Sapës dhe Pultit. Nuk ka botuar akoma të dhënat për Shkodrën, Tivarin dhe Shkupin. Pra edhe ky botim është i pjesëshëm sepse nuk ka të shkruar tre nga shtatë Dioqezat e përshkuara në relacion.

### *Publikimi i dokumenti nga ne*

Për këtë arsye ju vumë punës për një publikim të plotë të kopjes që gjëndet në Arkivin e Propagandës Fide, edhe pse është kopje e dokumentit dhe jo origjinali i shkruar nga autori i këtij relacioni, por sepse është më i plotë. Për të bërë një punë sa më cilësore ne vepruam në këtë mënyrë: Morëm në mënyrë elektronike, të skaneruara me ngjyra, të dyja kopjet e dokumenteve në arkivat përkatëse. Riprodhuam nga një kopje për secilën në format A4 të shkruar bardh e zi dhe jo me ngjyra dhe i lidhëm si libra të veçantë.

Morëm nga revistat “Hylli i Dritës” të gjithë numrat ku ishte botuar dokumenti dhe riprodhuam një kopje të plotë të këtij botimi për ta patur si referencë për rishkrimin që do të bënim. Vendosëm në tavolinën e punës tre kompjuterë rresht dhe shfaqëm në dy monitorët anësorë kopjet e dorëshkrimeve nga dy arkivat e përmendur. Kjo gjë na krijoi mundësinë që të shofim me ngjyra dhe të zmadhuar deri në 200% kopjet e dokumentit. Të dyja publikimet e mëparshme të dokumentit i krahasuam me kopjet arkivore në dorëshkrim.

Mbas një rishkrimi me vëmëndjen më të madhe të këtij dokumenti, vumë re se botimet e më parshme kishin mospërputhje me kopjet dorëshkrim në mbi 670 raste në të 208 faqet e rishkuara. Këto mospërputhje, jo gjithmonë e tjetërsojnë kuptimin e dokumentit por në disa raste kishte edhe gabime të palejueshme të cilat e ndryshojnë shumë kuptimin e tij. Ky tjetërsim, sjell pështjellim shumë të madh për studiuesit që shkruajnë histori me të dhënat që ofron ky dokument. Mospërputhjet më të rëndësishme janë, harrimi pa shkruar i disa fjalëve, shkruarja gabim e shifrave në disa raste, shkruarja gabim e emrave të vendeve në disa raste dhe të tjera gabime më pak të rëndësishme. Kompjuteri na ndihmoi që të bëjmë regjistrimin e të gjitha këtyre mospërputhjeve dhe korrigjimin e shumicës së tyre.

Në disa raste kemi vendosur shënime sqaruese në fund të faqes. Përkthimi në shqip i dokumentave është bërë sipas rregullave gramatikore të gjuhës shqipe, por nganjëherë kemi toleruar duke i qëndruar besnik kuptimit të fjalisë në origjinalin italisht. Është si të thuash një



përkthim i lirë çka nënkupton përkthimin me saktësi të mendimit dhe jo domosdoshmërisht përkthimin fjalë për fjalë të tekstit. Kjo është një punë e vështirë që ka kërkuar shumë mund dhe kohë por ne jemi munduar të bëjmë më të mirën e mundshme. Ne u munduam që këto gabime të zvogëlojmë sa të jetë e mundur më shumë por nuk mund ta themi me gojën plot se me këtë botim nuk ka më asnjë gabim ose mospërputhje. Ka disa emra të pajisjeve kishtare, të monedhave, njësisive matëse të peshës dhe sipërfaqeve të cilat sot nuk janë më dhe nuk i kanë fjalët korresponduese në gjuhën shqipe. Për këtë shkak, jemi të detyruar që këto fjalë të lemë në tekst ashtu siç janë dhe të vendosim në fund të librit një fjalor me shpjegimet përkatëse për secilën fjalë.

Përveç dokumentit të Gasprit të vitit 1671, po vendosim në këtë botim edhe katër dokumente të tjerë të cilët ne i konsiderojmë me rëndësi, sidomos për historikun e dioqezave dhe të fiseve në zonën verilindore të Shqipërisë. Kemi sjellë për botim një relacion të vitit 1675 të Shtjefën Gasprit të shkruar me dorën e tij në pesë faqe format i vogël. Kemi sjellë edhe një relacion të vitit 1697 të shkruar nga Fra Egidio nga Armanto. Dorëshkrimi përmban 17 faqe dhe sjell të dhëna me shumë rëndësi për ndryshimet në sjelljen e pushtuesit turk ndaj popullsisë së fiseve të besimit katolik në veri të Shqipërisë mbas luftës Austro-Turke të vitit 1689 dhe për qëndresën e këtyre të fundit. Relacioni tjetër që kemi vendosur në këtë botim është ai i Fra Filipit nga Shkodra, vetëm dy faqe por me rëndësi shumë të madhe për informacionin që përcjell. Po botojmë edhe pjesën prej 11 faqe të relacionit të vitit 1703 të Vinçens Zmajeviqit, pjesën ku flet për Dioqezën e Pultit ku përfshihet edhe Tropoja e sotme. Këto dokumente kanë rëndësi të veçantë për historikun e fiseve Nikaj, Mërtur, Gash, Krasniqe por edhe për fise të tjera. Ne kemi mendimet tona për zhvillimet politike dhe shoqërore të ndodhura në atë kohë në fiset dhe krahinat për të cilat flitet në relacione por e pamë me arsye që të mos bënim shumë komente por tua lëmë në dorë studjuesve të tjerë nga këto zona për të bërë komente dhe për të nxjerrë konkluzione për atë se çfarë ka ndodhur në fund të shek. XVII dhe në fillim të shek. XVIII në ato zona. Mund të vendosim në fund të prezantimit të relacioneve ndonjë mendim fare shkurtazi vetëm për fiset Nikaj, Mërtur, Krasniqe dhe Gash. Ndoshta më vonë, mbasi të marrim në studim edhe disa relacione dhe dokumente autentike të tjera, mund ta themi mendimin për historikun e asaj periudhe në një tjetër publikim tonin me një këndvështrim më të gjerë.

**SKEDË BIOGRAFIKE DHE AUTORIALE  
E MARIN BARLETIT**

Një ndër karakteristikat e epokës moderne është gjetja e elementeve të rinj e interpretimi i atyre ekzistues. Asht mendimi i te tanve se vepra Barletit edhe sot, “..edhe pas aq kërkimeve, asht ende e mjegullt”<sup>17</sup>, për ma teper Barleti me veprat e tija, mban prap sekrete, që duhen zbulue. Dh. Shuteriqi vite ma parë evidentonte disa fakte të sigurta të jetës së Barletit të fiksueme e për të cilat, siç shprehej, nuk jemi të detyruar të merremi shpesh me supozime”<sup>18</sup>.

Por, e reja janë idetë e Plasarit, që argumenton se krahas tradicionales, lypjes së rishikimit të historisë kohë më kohë<sup>19</sup> kultura ndryshon, konceptet ndryshojnë, pikpamje të reja shfaqen e “bashkëkohësit e një epoke në zhvillim progresiv mbërrijnë pikën e pamjes nga e cila mund të rishikohet e të rivlerësohet në një modalitet të ri : edhe atëhere historia rishkruhet”<sup>20</sup>.

Kësisoj edhe faktet e sigurta të Shuteriqit, tashma mbrenda një kohe relativisht jo të gjatë kanë ndryshu. Në dritën e fakteve të reja, të botueme nga Plasari, Nadin, Karanxha, Biçoku, Frashëri, Pollovina, Thëngjilli, Previzi<sup>21</sup> etj. mbeten për me u rivlerësue fakti i pjesmarrjes së Barletit në mbrojtjen e qytetit më 1478, por edhe pozicioni në këtë luftë, mënyra e shpërnguljes në Venedik; koha dhe vendi i shugurimit prift; vitet e botimeve të dy veprave kryesore e deri te përkatësia e veprës së tretë<sup>22</sup>.

E vetmja gjâ që ka mbetë âsht pohimi, se Barleti, vijon me bâ pjesë në radhët e humanistëve shqiptare, e kësisoj veprat e tij vijojejnë me këne “dëshmi e një tradite të pasur

---

<sup>17</sup> Idrizi: 1990, f.49.

<sup>18</sup> Shuteriqi. *Mbi Barletin e shkrime të tjera*, 1979, f.44.

<sup>19</sup> Plasari: *Skenderbeu. Nji histori politike*, 2010, f. 9

<sup>20</sup> *Po ai: Po aty.*

<sup>21</sup>. Thëngjilli: *Skenderbeu. Arritje, Mangësi. Pikpamje të ndryshme*, 2012, shenjon veprat e autoreve, të huaj dhe shqiptarë që janë marrë me studimet për Skënderbeun. Veçanarisht me veprën e Barletit.

<sup>22</sup> Shuteriqi: *Mbi Barletin e shkrime të tjera*, f. 44, shënjon: *Nga jeta e Marin Barletit, disa nga faktet më të sigurta janë- se ai kaloi fëmëninë në kohën e luftave të Skënderbeut, se më 1478 mori pjesë në mbrojtjen e qytetit të tij, Shkodrës, të rrethuar nga turqit, se, i shpërngulur nga atdheu, jetoi në Itali, kun ë Venedik, botoi veprën e tij të parë “Rrethimi i Shkodrës” (1504) dhe disa vjete më pas në Romë, veprën e tij të madhe , “Hsitorinë e Skënderbeut” rreth vitit 1510), se ishte prift dhe se vdiq shpejt pas botimit të kësaj vepre.*

kulturore, që sot, edhe pas kërkimeve, është ende e mjegullt”<sup>23</sup>, ndaj edhe risia e kohëve të sotme e botës akademike dhe e studiuesve asht studimi më i thelluem i veprës së Barletit<sup>24</sup>.

Siç përmenda shkarazi, Barleti është i autor i dy veprave dhe, deri tash, mjaft i dyshuem si autor i së tretës “Compendium (përmbledhja) e jetës së papëve dhe perandorëve” .. por me “Historinë e jetës e të bamave të Skënderbeut princit të Epirit”, hodhi themelet e asaj çka mund te quhet “...kult i Skënderbeut për shqiptarët brenda vendit dhe në diasporë tuj shprehë një nderim të thellë, pothuajse si shenjtor për heroin kombëtar shqiptar, si symbol dhe thelb i qëndresës ndaj sundimit të huaj”<sup>25</sup>.

Titullin e librit e mori prej shtesës turke të llogarit shqyptar, por që siç shkruente vetë Barleti, njëktshtu i pelqente ta përdore (sa e shkroi edhe librin me emnin e tij) e Noli, shkruente se ishte “aq kryelartë për këte llogap turk, sa e shtonte vetë gjithnjë pas emrit te familjes”<sup>26</sup>.

Duhet ti jepet të drejtë Shuteriqit, teksa shkruente, se nuk është aspak e lehtë me shkruer jetën Barletit e të tjerëve, pasi mungojnë kërkimet arkivale<sup>27</sup>, por nisun nga interpretimet e reja “...që në parim si dokument shërben çdo informacion prej të cilit mendja e historishkruesit di të nxjerrë diçka për njohjen e kulturës njerëzore...”<sup>28</sup>, përmes librave le të mundohuna ta rishikojmë, ta rikujtojmë, të thona disa gjana dhe ta rivleresojmë nëse mundena, jetën dhe veprën e Barletit, përmes diskutimit rreth fakteve biografike, përkatësisë etnike, veprave dhe vlerësimit të tyre.. Thanë ndryshe le t’i bajmë një skede personale, që në ditët tona asht risjellë edhe një here e kaluemja, përmes “curriculum vitae”.

### **Skeda personale biografike**

Jetën e Barletit e njohim shumë pak, “....gati vetëm nga ndonjë pohim i vet në veprat e tij”.

**Emri dhe mbiemri.** Marin (e vetmja gja që bien dakord të tanë), mbiemni Barleti. Ka larmi trajtesash mes shqiptarëve dhe të huejve, duke mos mungu as preferencat personale në trajtesë. Dy përkthyesit e veprave të Barletit, Henrik Lacaj (1962) dhe Stefan Prifti (1967), përdorin format e llogarit Barleci e Barleti për t’i lanë vend formës të normës letrare Barleti, më

<sup>23</sup> Idrizi: 1990, f.49.

<sup>24</sup> Thengjilli: 2012, f. 453.

<sup>25</sup> Elsie: *Histori e Letersisë Shqipe*, 1997, f.20

<sup>26</sup> Noli: *Historia e Skenderbeut*, 1967, f.

<sup>27</sup> Shuteriqi: *Tekstet shqipe*, f. 91.

<sup>28</sup> Plasari: *Skenderbeu. Nji histori politike*, 2010, f. 23.

1982; Çabej e lidh me emnin Bardheci, duke theksuar se shndërrimi i dh në ll është i moçëm në gjuhën shqipe<sup>29</sup>. Buda, kritikon formën latine Barletius<sup>30</sup>, (që lë shteg për interpretime rreth nacionalitetit të Barletit) dhe tuj u nisë nga zakonet e humanistëve që u japin emrave të tyre trajta latine ose greke<sup>31</sup>, arrin në përfundimin se atë mund ta kenë quajtur Bardheci ose aty afër<sup>32</sup>. I. Zamputi, tuj analizu dy format e llagapit arrin në përfundimin e përdorimit të formës Barleti, dhe se ky llagap “është i lidhur me prejardhjen e tij jo latine”<sup>33</sup>. Nuk mungojnë as trajta të tjera, kryesisht të të huajve, si Barlettano nga Paolo Xhiovio (1483-1552), Barleta; nga F.Pal<sup>34</sup>; Barlëce më 1576, nga Lavardini etj.

Vetë Barlec - Barleti, “... njohës i mirë i latinishes, iu shmag formës latine Barletus-Barlecius<sup>35</sup> tuj përdorë formën Barletii<sup>36</sup> dhe për më tepër me përcaktorin Shkodrani.

-E reja mendoj se asht edhe dhana e Thëngjillit, që i referohet K. Biçokut, sipas të cilit ‘..tendenca e kohëve të fundit është përhapja e trajtës Barleti në kurriz të formës Barleci dhe e ilustron me materialet e vendosura në Muzeun e Krujës’<sup>37</sup>; konstatimi asht thuejse i njajtë më atë çka shkruente vite ma parë Shuteriqi “... posa jemi mësuar të themi Barleti. Barleci shpjegohet me trajtën dialektore, këtu shkodrane, Barlleci, për Bardheci”<sup>38</sup>.

**Atesia, Amësia.** Sipas I. Karanxhës, Barleti paraqitet fillikat. Nuk ka nënë, babë, motra, vëllezër, bile as kushërinj të afërt e të largët<sup>39</sup>. Tuj mos përmend askënd nga familja dihet “..fare pak mbi jetën e këtij personaliteti, nga më shquarit e kulturës shqiptare”<sup>40</sup>.

Të rejat, për problemin i sjell Nadin, në librin “Shqipëria e Rigjetun”, (2012) ku citon, pa emën se babai i tij, u vra në luftimet e Shkodrës<sup>41</sup>, dhe se rridhte nga një familje që si zanat kishte profesionin e tregtisë së kafshëve të ardhuna nga hapësira adriatikase dhe tregtimin e

---

<sup>29</sup> Thëngjilli: Skenderbeu. Arritje, Mangësi. Pikpamje të ndryshme, 2012, f.444.

<sup>30</sup> Po ai:Po aty, f.444.

<sup>31</sup> Po ai:Po aty, f.445.

<sup>32</sup> Po ai:Po aty, f.445.

<sup>33</sup> Po ai:Po aty, f.445.

<sup>34</sup> Po ai:Po aty, f.446.

<sup>35</sup> Po ai:Po aty, f.446

<sup>36</sup> Po ai:Po aty.

<sup>37</sup> Po ai:Po aty.

<sup>38</sup> Shuteriqi: Shuteriqi. Mbi Barletin e shkrime të tjera, 1979, f.67

<sup>39</sup> Karanxha: Barleti apo Biçikemi, 2010, f.37.

<sup>40</sup> Shuteriqi: Shuteriqi. Mbi Barletin e shkrime të tjera, 1979, f. 55.

<sup>41</sup> Nadin: Shqipëria e rigjetun: Albania ritrovata, f. 110

shitjen e lëkurës, gja të cilën ma vonë kishte me e provu edhe vetë i riu Barleti që pati të njajtin zanat fillestar në Venedik<sup>42</sup>.

**Datëlindja dhe ditëvdekja.** Nuk dihen saktësisht dhe ka mjaft debate, përdoret metoda e deduksionit historik, kryesisht analiza e tekstit “Rrethimi i Shkodrës” (1504) për datën e lindjes dhe të “Historia e Skanderbeut” (1508-10-12) për datën e vdekjes<sup>43</sup>.

Datëlindjen e Barletit, Shuteriqi, por edhe Buda e nxjerrin përmes vetë dëshmime të Barletit. Në rrethimin e parë të Shkodrës nga turqit në vitin 1474, ai ndodhej në qytet si dëshmitar i ngjarjeve, kurse në rrethimin e dytë 1478, vetë Barleti shkruan: ..”fati i zi e solli të mbaja armët e pafat për të mbrojtur atdhenë”<sup>44</sup>.

Nisun prej moshës së përdorimit të armës nga ana e fëmijve, Shuteriqi, mendon se viti i lindjes asht fillimi i viteve 1460, dhe jo më vonë se viti 1464<sup>45</sup>, ndërsa Elsie,<sup>46</sup> dhe F. Pal<sup>47</sup> e shtyejnë në periudhën e viteve mes 1450 -1454-s

Të rejtat. Karanxha, bazue në fakte jetësore konkretisht në dokumentin e 4 qershorit të vitit 1484, zbulue nga L. Nadin në të cilin shënjohej që Barleti asht në kërkim të punës, nisun nga mosha e adoloshencës për punë 20 vjeç, i jep të drejtë Shuteriqit për vitin e lindjes, por hjedh dyshimin se mund të mos ketë marrë pjesë në luftë, pasi në Rrethimin e Dytë të Shkodrës , më 1478-1479 na del 14-15 vjeç<sup>48</sup>.

Edhe zbulimi i dorëshkrimit nga Nadin dhe Plasari në Bibliotekën Kombëtare të Francës, të “Rrethimit të Shkodrës”, që daton në vitet 1501-1502, mundet me sjellë edhe problematikat e datëlindjes.

**Ditë vdekja.** Bihet në konsensus për fundin e vitit 1512, maksimumi përpara mbarimit të shkurtit 1513. Asht një pranim i objeksionit të Francisk Palit në veprën e tij “Marin Barleti, historianë humanistët”(1938), që e lidh datën e vdekjes me datën e botimit të veprës tjetër së Barletit “Historia e Skënderbeut”, pasi thuhet se Barleti vdiq rreth dy vjet pas botimit të librit, por si bazë mund të merret edhe libri i tretë, “Compendium..... , (përmbledhja) e jetëve të papëve

---

<sup>42</sup> Po aty, f. 104.

<sup>43</sup> Noli e përcakton vitin 1510, si botim të “Historisë së Skënderbeut” dhe e lidh edhe me botime të tjera si testamenti i Gjon Muzakës 1510, si të influencuar nga Barleti dhe të Dh. Frangu (1443-1525), për rrjedhojë vepra duhej të ishte botuar para 1510 ose maksimumi në 1510.

<sup>44</sup> Shuteriqi: Mbi Barletin e shkrime të tjera, 1979, f.46.

<sup>45</sup> Po ai: Poaty

<sup>46</sup> Elsie: Histori e Letersisë Shqipe, 1997, f.20.

<sup>47</sup> Karanxha: Barleti apo Biçikemi, 2010, f.39.

<sup>48</sup> Po aty, f.37

dhe perandorëve”(te Shuteriqi 1553, Nadin1555). Për Budën dhe Shuteriqin “fakti që pjesa e veprës i atribuohet Barletit e që vete gjer në vdekjen e Papës Juli II-21shkurt-1513- tregon se Engjëllorët dinin se këtë kohë se shkodrani nuk jetonte më. Ai ka vdekur përpara shkurtit 1513”<sup>49</sup> “...thujse në të njëjtën kohë që..... mbylli sytë edhe Pjetër Ëngjëlli (1512) i cili, sigurisht ka qenë midis të njohurve të tij”<sup>50</sup>.

Fakte të tjera të lidhuna me botimin e veprës përforcojnë, por edhe hjedhin poshtë datën e vdekjes së Barletit. Kështu diskutimi ma i vjetër i botimi i “Historisë së Skënderbeut” sillet rreth viteve 1508-1510, por F. Pal sjell fakte se libri, nuk mund të jetë botuar para 1510, pasi Barleti ngjarjet e Himarës të janar –shkurtit 1508, (të lidhuna me njohjen edhe te spanjollëve të Skanderbeut si prijës) shënohen në kapitullin e dytë<sup>51</sup> të veprës, në një kohë kur vepra kishte edhe 11 kapituj, dhe sipas F. Pal puna e shkrimit të historisë ka zgjatë.

Edhe për Nadin vepra asht botue në 1510, ndër të tjera për të “...festuar çlirimin e Venedikut nga çkishërimi papnor në 24 shkurt 1510 e kursin e ri të politikës mes Venedikut dhe Papatit që synonte ta shtrinte aleancën edhe me Spanjën e me Perandorinë”<sup>52</sup>.

Por ky fakt bahet ma interesant nëse një pjesë e studiuesve e shtyjnë datën e botimit të veprës, që tanimë “...mbas Nortonit mund të lëvizë nga 1515 më 1522”<sup>53</sup>.

Kështu nëse llogarisim vdekjen e Barletit dy vjet pas botimit të “Historisë së Skënderbeut”, pohimi i Nortonit shkakton pështjellim në përcaktimi i datës së saktë të vdekjes.

E reja, hipotetike vjen edhe nga I. Karanxha i cili e sponon botimin e veprës së dytë të Barletit bazue në monogramet dhe filigramet mbi tekstin e “Historisë së Skënderbeut” që u përkasin prodhuesve të letrës dhe që shfaqen për herë të parë në dokumentat e kohës pas vitit 1520.

Edhe problem i ksilografëve, dy anësoret janë porositë dhe janë të reja. Dy balloret vertikale janë përdorë në vepra të ndryshme, nga botuesit Sessa dhe Ravani së pari në veprën e Tit Livit më 1520, dhe pak muaj pas daljes së “Historisë së Skënderbeut” të De Vitalit, maj 1522, e njajta ksilografi në pjesët anësore dhe me kombinim shkrimi brënda kornizave asht përdorë edhe te vepra Erazmi i Roterdamit, botue më 26 gusht 1522 etj. <sup>54</sup>

---

<sup>49</sup> Shuteriqi: *Shuteriqi. Mbi Barletin e shkrime të tjera, 1979, f. 71*

<sup>50</sup> *Po ai: Po aty.*

<sup>51</sup> *Karanxha: Barleti apo Biçikemi, 2010, f.40.*

<sup>52</sup> *Nadin: Shqipëria e rigjetun: Albania ritrovata, 104.*

<sup>53</sup> *Plasari: Skenderbeu. Nji histori politike, 2010, f.28.*

<sup>54</sup> *Karanxha: Barleti apo Biçikemi, 2010, f.110*

Të gjithë këto favorizojnë mendimin e dytë atë të Nortonit.

**Gjendja civile.** Marin Barleti e emërton vedin “Sacerdotis Scodrensis”. Por përsëri Shuteriqin e mbyl dyshimi. Për atë edhe cilësimi “..prift shkodran “ nuk do të thotë domosdo se ai ishte prift që në Shkodër, domethënë e pakta që në 1478<sup>55</sup>.

A duhet t’i japim të drejtë Shuteriqit sipas të cilit Barleti u largue nga Shqipëria pa një kulturë të formueme<sup>56</sup>, në një kohë kur në Shkodër ishte prania e rendeve kishtare, kjo duhet pa. Mund të hamendësohet që sa i takon edukimit fetar- humanist, fillimet munden me kenë në Shkodër, dhe ma tej në Itali, Barleti u edukue nën frymën e humanizmit italian, njëkohësisht me të tjerë shqiptarë mes të cilëve edhe me Biçikemin (në mos i njajti person me dy identitete). Në zonën e Venetos u përgatit si historian, humanist, historian i Shkodrës, i Skënderbeut i Shqipërisë së shekullit të tij, por ma shumë i atyne që kanë me ardhë.

Pikat e pakjarta natyrisht shtohen, por skjarohen nga burimet arkivore, të kalueme. L. Nadin na zbulon një dokument të 3 qershorit 1484, që përmend “discreto giovane”, pra djaloshin e mirë Marin Barleti në kërkim të ndonjë pune, në Venedik<sup>57</sup>, gja që e sposton tezen e derisotme të priftit shkodran Barleti, luftëtar me armë në dorë në rrethimin e dytë të Shkodrës<sup>58</sup>.

Dokumentit saktëson që Barleti as në 1484, nuk ishte shugurue prift, mbasi ai vijonte me punue në një tezgë mishin në zonën e Rialtos (Venedik)<sup>59</sup>.

Meritat e Marin Barletit, filluan të duken pak vite më vonë. Nën mbrojtjen e Kurisë, ai duhet të ketë filluar edukimin në shkollat teologjike në Venedik, për të vijue formimin e matejshëm në Padova<sup>60</sup>, mendohet pranë kishave benediktine të qyteteve përkatëse.

Në dokumentat e mavonshme të vjetëve 1489, 1495, na bahet me dije se tashma statusi civil i Barletit kishte ndryshue. Në këto vite ai shfaqet si dëshmitar për doktoraturat e universitetit të Padovës që festoheshin në Duomo, në rolin e një personi të lidhur me mjedisin kishtar të Duomos<sup>61</sup>. Në dëshminë e parë që i përket datës 4 dhjetor 1489 emri e tij paraqitet në

---

<sup>55</sup> Shuteriqi: *Mbi Barletin e shkrime të tjera*, 1979, f.47.

<sup>56</sup> Shuteriqi: *Mbi Barletin e shkrime të tjera*, 1979, f.56.

<sup>57</sup> Nadin: *Shqipëria e rigjetun: Albania ritrovata*, 104.

<sup>58</sup> Shuteriqi: *Mbi Barletin e shkrime të tjera*, 1979, f.47.

<sup>59</sup> Nadin: *Shqipëria e rigjetun: Albania ritrovata*, 2012, f. 104.

<sup>60</sup> Nadin: *Shqipëria e rigjetun: Albania ritrovata*, 2012, f.106.

<sup>61</sup> Nadin: *Shqipëria e rigjetun: Albania ritrovata*, f.106.

formën d. (domine, zotni) Marinus Barleta, ndërsa në dëshminë e dytë që i takon datës 23 nëntor 1495, emni i tij paraqitet në formën d. presbiter (prif) Marinus Scutarensis<sup>62</sup>.

Nga një dokument i Arkivit të Venedikut, publikue nga Nadin “mësohet se pikërisht në vitin 1494 (12 qershor) ishte ba prift dhe pritte një detyrë kishtarë<sup>63</sup>.

Selia e shërbesës që ju caktua Barletit ishte Piovonne, një territor viçentin, por që përfshihej në dioqezën e Padovës<sup>64</sup>. Nga arkivat noteriale të vitit 1495, M. Barleti, na del si famullitar i kishës së Shën Stefanit në çështjet që kanë të bëjnë me prona dhe përcaktim kufijsh të famullisë<sup>65</sup>.

Ky fakt shënjohej edhe në “Historinë e Shqipërisë”, botim i Akademisë së Shkencave të R. Shqiptare, që e përmend Marin Barletin në janar të vjetit 1497, si rektor të kishës parokiale të Shën Stefanit, në fshatin Plovenar të dioqezës së Padovës dhe si abat në kishën e Shën Justinës në Padova<sup>66</sup>.

### **Kombësia**

E keqja asht se Barleti e cilëson vedin Scutarensiss, (shkodran) por “...asnjëherë nuk thotë se ka lindur në Shkodër”, aq sa K. Biçoku hipotezon “...se mund të ketë vend-lindjen në Shkodër apo në Medun meqenëse në burimet historike është gjetur një banor i tij me mbiemni Barleti”<sup>67</sup>

Në përcaktimin e kombësisë kanë ndikue disa gjana mes të cilave rreshtojmë: Ilagapin, përçmimi ndaj kombeve të vogla, tendencat nacionaliste, mosbesimi i prejardhjes nga Shqipëria, të një humanisti europian, etj.

Mbiemni i marrun si patronomi mjaft thjesht mundet me sjellë ngatërresa, por jo, në asnjë mënyre nuk mundet me një të rame t’lapsit e vetëm me një përgjasim të tjetërsohet kombësia.

Paolo Xhovio (1483-1522) ishte i pari që në veprën “Di Marino Becichemo da Scutari” ia ndryshon kombesinë Barletit, tuj e cilesue dalmatin. Me të drejtë Shuteriqi argumentonte dalmatin asht një term gjeografik i përgjithshëm që mund të thotë raguzian, po mund të thotë

---

<sup>62</sup> Karanxha: *Karanxha: Barleti apo Biçikemi*, 2010, f.28

<sup>63</sup> Nadin: *Shqipëria e rigjetun: Albania ritrovata*, 2012, f.108.

<sup>64</sup> Nadin: *Shqipëria e rigjetun: Albania ritrovata*, 2012, f.112.

<sup>65</sup> Nadin: *Shqipëria e rigjetun: Albania ritrovata*, 2012, f.114.

<sup>66</sup> “*Historia e shqipërisë*, 2002, vol. I, f.485.

<sup>67</sup> Thëngjilli: *Skenderbeu. Arritje, Mangësi. Pikpamje të ndryshme*, 2012



edhe italian, "...ose, të paktën "latin" i bregut lindor të Adriatikut"<sup>68</sup>, mund të thotë gjithshka, por veç shqyptar, jo.

Tuj mbetë te i njati autor, Barletin si shqiptar nuk e njohu as francezi Du Cange (Dy Kanzh) në botimet enciklopedike franceze të shekullit XVIII etj.

Kjo tezë u përkrah nga një varg autorësh jo vetëm italianë, por edhe ballkanas, si: F.Pal, Nikollë Jorga. Te parët nuk e arrijshin me e konceptue që Barleti të mos ishte italian. Ata i ngatërronte edhe forma Barleti i llagapit, që e lidhnin me Barleten e Puglias, ndërsa të dytët, krahas lidhjes me Barletën, shpesh edhe nga tendenca nacionaliste tipike ballkanase u përpoqën të mohonin kulturën e kaluar shqiptare "... me mosekzistencën gjoja, midis shqipatrëve të kohës së humanizmit, të një kulture që meriton gjithë vëmendjen"<sup>69</sup>, me faktin se Barleti jetoi pjesën më të madhe të kohës në Itali.

Po çka thotë vetë Barleci! Me krenari provohet se ai e njehte vedin shkodran, e për ma tepër tuj e njuh vedin shkodran, ai kishte parasysh një koncept ma të gjanë, atë shqiptar gja që e shprehte në të tanë veprat e tija. Në veprat e tija duken qartazi dallimet etnike mes luftëtarëve, në bashkëatdhetarë, në italianë<sup>70</sup> e të tjerë. Kjo gja sidomos evidentohet mjaft në panagjericët e ndryshëm vënë në gojë të luftëtareve, por edhe të turqve.

Në përcaktimin e kombësisë nuk duhet të ngatërrojmë asnjëherë qëndrimet filovenedikase apo filo-italiane mbi prejardhjen.

### **Vepra autoriale**

E reja e veprave të Barletit asht zbulimi njëkohshëm i bamë së fundi nga Plasari dhe Nadin në Biblioteken Kombëtare të Francës, fondi Mazarini, të dorëshkrimit të librit "Rrethimi i Shkodrës" qe tashma i takon viteve 1502-1503. Dorëshkrimi sipas tyne ka ndryshime, me atë të librit, por për sa kohë nuk kemi të sakta gjykimet, në një gjë ia vlen për t'u thelluar, sidomos sa i takon raporteve te pangjerickeve Biçikemi-Barleti, në Barleti-Biçikemi.

Deri më sot tek autorët tanë asht shënuar se Barleti përdori në veprën e tij mbi rrethimin e Shkodrës, Pangjericun e Biçikemit, kushtu dogjës Loenardo Loredan, që simbas Palit e mbajti në Venedik përpara 29 gushtit 1503, "po mendohet se shtypin e pa vitin tjetër"<sup>71</sup>. Barleti, e përdori

<sup>68</sup> Shuteriqi: *Mbi Barletin e shkrime të tjera*, 1979, f. 65.

<sup>69</sup> Shuteriqi: *Mbi Barletin e shkrime të tjera*, 1979, f. 66.

<sup>70</sup> *Po ai: Po aty*, f. 69

<sup>71</sup> Shuteriqi: *Mbi Bicikemin dhe shkrime të tjera*, 1987, f. 53.

në janar 1504, në veprën e tij, pa citu emnin e autorit dhe titullin, gja që solli hamendësime për datën e botimit të tij<sup>72</sup>.

Pas këtij zbulimi dhe dorëshkrimit, secili ka të drejtë me ngrit hipoteza që shkojnë në favorin e rrëzimit të raporteve Biçikemi-Barleti. Janë një sërë pyetjesh që duhen shkjaru e duhen ripá, siç janë data e botimit të Panegjericut, përdorimi tij nga Barleti, (siç cilësohej deri tash hakmarrje ndaj lavdisë personale dhe antarëve të familjes Biçikemi<sup>73</sup>) etj., e deri në rishikimin e konstatimit të Shuteriqit, vite ma parë që pohonte se Panegjericu i Biçikemit “.. ka cilësitë stilistike të Barletit, si ka edhe dobësitë, po më të tepruara”<sup>74</sup>.

Sa i takon “Historisë së Skënderbeut”, asht një libër që, siç thotë Gay Thuillier: “ S’ka histori pa botime, por edhe historian pa kritike botimesh”.

Shumë vepra janë shkruar për Skënderbeun, nga autorë shqiptarë dhe të huaj, por pikë referimi gjithnjë merret vepra e Barletit. Lavdërohet, kontestohet, mohohet, rimerret, harrohet etj., por dy gjana nuk i mohohen: e para asht vepër origjinale humaniste (letërsi dhe histori) dhe e dyta e shkrueme nën frymën e shkrimtareve të vjetër historianë romakë, si Tit Livi, siç analizon Pal. Edhe pse ka shumë plagjiatura, të evidentueme që në vitin 1928, nga F. Pal, ajo mbetet gjithnjë tërheqëse, dikush e ka quejtë bestseller të kohës së tij.

Të rehat rreth kohës dhe mënyrës së botimit të veprës sillen nga L.Nadin, në qëndër të së cilës qëndron miqësia dhe përkrahja që Barletit i dhanë Girilamo Dona dhe De Vitali. (Albanesoti)<sup>75</sup>.

Nadin përpiket të argumentojë që Barleti dhe De Vitali, por edhe Biçikemi që në prill 1505, ishin pjesë e trupës diplomatike veneciane të përfaqësuar nga Dona pranë papës Juli II<sup>76</sup>.

Pa mbetë te historia e matejshme e botimit të veprës, asht me interes të theksohet, konstatimi i Nadin që vepra u botue në rrethanat e kontekstit gjeopolitik të marrëdhanieve të vështira të Venedikut më Romën, por edhe në kushtet e përpjekjeve për organizimin e një kryqëzate kundër turqve<sup>77</sup>. Nadin argumenton që këtij qëllimi mund t’i shërbente jeta dhe vepra

---

<sup>72</sup> *Po ai:Poaty, f. 53*

<sup>73</sup> *Po ai:Poaty, 69.*

<sup>74</sup> *Po ai:Poaty, 64.*

<sup>75</sup> *Nadin: Shqipëria e rigjetun: Albania ritrovata, 2012, f.52.*

<sup>76</sup> *Po ajo:Po aty, 2012, f. 52.*

<sup>77</sup> *Po ajo:Po aty, 2012, f.75*

e Skenderbeut, për të cilën Marin Barleti, i njohur dhe i pranuar nga De Vitali përmes veprës “Rrethimi i Shkodrës”, kishte kohë që punonte për të shkruar historinë e tij”<sup>78</sup>.

Lidhur me faktorin gjeopolitik, Nadin sjell edhe dedikimet, (10 distiket-vjershat) që gjenden në frontespicin e librit, pas titullit të librit nga Pietro Regolos, ish kancelar i ipeshkvijve Zeno dhe Dandolo, kancelar i këshillit ipeshkvnor të Padovës dhe Domenico di Arzignano<sup>79</sup>, humanist nga Vinçenca<sup>80</sup>. Në përkthimin e këtyre vargjeve<sup>81</sup>, sipas Nadin, Regolo përmenden qartë dy aleatët e momentit Papatin dhe Venedikun, që kishin qene dikur aleatë të Skënderbeut (Këtu do të mësohet, se si ai burrë i theu armiqtë e besimit të shenjtë me armët ngadhënjuese të Selisë Shejte), kurse Di Arzignano i vendos të bëmat e Skenderbeut në një radhë me trimëritë e Kamilit, triumfues mbi Galët Senonë e të Jul Cezarit, nënshtruesit të Galisë<sup>82</sup>. Nën prizmin gjeopolitik Nadin shikon edhe kushtimin e veprës Ferrante Kastriotit, si kujtim i ndihmës që Skenderbeu i kishte dhënë dikur mbretit të Napolit.<sup>83</sup> Nadin, vijon të supozojë se edhe botimi i veprës “Historia e Skenderbeut” në fillim të vitit 1510 shënon çlirimin e Venedikut nga çkishërimi papnor në 24 shkurt 1510.<sup>84</sup>

Edhe sa i takon ksilografisë<sup>85</sup> që rrethon ballinën e veprës, vijojejnë të ketë mjaft debate, rreth origjinalitetit, përcaktimit të kohës së botimit(1522), por përmbajtjes. Për Nadin përgjithësisht ksilografia asht pasqyrimi i mendimit të humanistit Dona në shkrimin e tij “Apologeticus”, që mbronte Romën si seli e papës , ... si qyteti i përcaktuar të ishte kreu i botës pagane, si dhe shkrimet e Tit Livit dhe Petrarkës, si pasqyrim i veprimtarisë së burrave të shquar të Romës<sup>86</sup> ; për të tjerët në ksilografi janë pasqyruar traditat e lashta të popullit tonë, përfaqësuar nga figurat legjendare të Aleksandrit dhe Pirros se Epirit. Në gjykimin e Zeqos, ksilografia shpreh një sërë grafikash që përmbajnë kompozime dhe subjekte të çuditshme historike dhe mitologjike të lidhuna me traditën shqiptare. Kështu Zeqo evidenton në grafikë 10

---

<sup>78</sup> Po ajo: Po, aty, f. 76

<sup>79</sup> Për Shuteriqin Petro Regulus Vicentinus dhe Domenico Alzignano Patavius hyjnë mes miqve të Barletit ; për Karanxhën nuk paraqesin emrat e tyre të vërtetë.

<sup>80</sup> Po ajo:Po aty, f. 76.

<sup>81</sup> Deri me tani njohim tre përkthime të vargjeve nga Aferdita Sharraxhi, Moikom Zeqo, Lucia Nadin.

<sup>82</sup> Po ajo:Po aty, f. 78.

<sup>83</sup> Po ajo:Po aty, 80.

<sup>84</sup> Po ajo: Po aty, f. 88.

<sup>85</sup> Blloku i sipërm Horacion, Kolkide gjate dyluftimit kundër etruskëve për mbrojtjen e urës Sublicio, dhe dy vetë të tjerë prapa që duhej të prishnin urën. Simbologjia lidhja me Skenderbeun që ju vu turqëve Blloku i poshtëm, dy episode me prejardhje nga Tit Livi të ndarë nga pozicioni mbrojtës të Kimera, djathas dhe majtas kemi dy figura që lidhen me këto lufta.

<sup>86</sup> Po ajo: Po aty, f. 78.

kompozime nga historia e shqiptarëve, Gjergj Kastrioti, martirët e kishës në shekullin XVI, ose fundin e shekullit XV, Shën Luçinë etj.

Si origjinale, Karanxha, “përcakton dy ksilografite anësore ku takohen episode nga historitë e Aleksandrit të Madh, por edhe një shqiponjë”<sup>87</sup>.

Sipas Zeqos, “është një shqiponjë dykrenare e cila paraqet një interes shumë të madh shkencor, pasi për herë të parë kemi dëshminë e simbolit të flamurit të Gjergj Kastriot Skënderbeut, pra të shqiponjës dykrenore, të pranuar dhe të aprovuar nga vetë Marin Barleti, ndërsa për Nadin “kemi të bëjmë me një iluzion të tërthortë për shqiponjën (Aquila) që duhej të triumfoje mbi gjelin (gallus) pra, me metaforën e gjetur që Girolamo Dona përdor në letrën e tij për sekretarin e Maksilianit, Bannision”<sup>88</sup>.

Gjithsesi botimi i librit pa një datë të evidentueshme në frontespice ka ngjallur mjaft diskutime rreth kohës së botimit të tij, duke nxjerrë në pah disa data.

“Historia e Skënderbeut”, siç dihet ka kalu mes shumë gjykimeve, “si vepër panegjrike, e mbushun me zmadhime, me ngjyime mitike, madje me fikcione letrare e anakronizma dhe, sidomos me pasaktësi jo të pakta”<sup>89</sup>. Mirëpo fundi i shek. XIX, i shoqënuem me botimin e përmbledhjeve të para të arkivave europiane “krahas skajimit të një pjese të paqme të të dhënave të Historisë së tij, të dhëna të tjera të saj u vertetuan ndonjëherë deri në kufijtë e së pabesueshmes”<sup>90</sup>.

Libri i Barletit për Skënderbeun, vijon të jetë burim parësor për studiuesit e fushës, por krahas kësaj duhen parë edhe autorët minorë, mes të cilëve shënjohej Martin Segoni, famullitar i kishës së Shën Marisë në Novobërdë, peshkop i Ulqinit më 1482, autor i panjohun për ambientin shqiptar, deri më 1987, kur gjansisht për të shkroi Dh. Shuteriqim që solli edhe të përkthyer veprën e tij: “Tregim mbi Gjergj Kastriotin, nga turqit në gjuhën e tyre i quajtur Skanderbeg, domethanë Aleksandër i Madh” (1485)<sup>91</sup>.

Për veprën e tretë të Barletit “Compendium.... ndonëse dyshimet mbi autorësinë ngelin përsëri, ka shkëndija, që mundohet të risjellin edhe një herë diskutimin. Një prej tyre është edhe Nadin. Kështu sipas Nadin, vepra nuk mban autorësinë e Barletit, por në arsyetimin e saj as të Pal Pjetër Ëngjëllit, por është një ekstrakt nga veprat e Giovanni Stella-s të cilat ishin botuar nga

---

<sup>87</sup> Karanxha, f.107.

<sup>88</sup> Po ajo: Po aty, f.78

<sup>89</sup> Plasari: Skënderbeu. Një histori politike, f.24

<sup>90</sup> Po ai” Po aty, f.26.

<sup>91</sup> Po ai: Po aty.

Benardino de Vitali në fillim të shek XVI<sup>92</sup>. Vitin e botimit të veprës së atribuar Barletit më 1555, Nadin e cilëson si një vit të plotë domethënieje për Shqipërinë, ku ripopullohet figura e humanistit Marin Barleti dhe përfundon hartimi i një “Meshari” të Buzukut.

Me 1555 për herë të parë, Barleti botohet në italisht nga Pietro Rocca.

### **Marrëdhëniet Barleti-Biçikemi apo humbja e identiteve.**

Marrëdhëniet Barleti- Biçikemi, apo humbja e identiteve, në ditët e sotme nga një studimin në fakt i arritun i Ilia Karanxhës, Barleti apo Biçikemi, të duket si një plagjaturë e ardhun nga shek. XVI, kur Paolo Xhovio në veprën “Elozhet”, vinte ne diskutim Barletin si shkrimtar dhe nën termin Marin Shkodrani, nënkuptonte Biçikemin tuj e zhveshë Barletin nga vepra e tij. Të njajtën gja bani edhe F. Sansavino autor i dy veprave historike mes te cilave edhe “Dell’Historia Universale dell’ Origine et impero de Turchi...”. Një shekull ma vonë Apostolo Zeno, poet e historian venedikas në polemike me Vosio-s, mbylli përfundimisht debatin në favor të tezës së dy Marinëve, por tuj lanë dyshimet mbas. I tillë asht edhe dyshimi i Karaxhes, që sa vjen e forcohet.

Karanxha përpiket të argumentojë se babai i Biçikemit dhe jo Barleti asht faktues i ngjarjeve në rrethimin e Shkodres; se Barleti asht emën që fsheh babain e Biçikemit; Barleti mund të ketë kenë një mbiemër i hershëm i Biçikemeve; babai i Biçikemit deri kur mund të jetë vra mund të ketë përdorur mbiemnin Barleti; një pseudonym që mund ta mbronte veprën nga kafshimet e faqezinjve; që Biçikemi nuk donte të kompromentohej me Venedikun, mbasi ishte kundërshtar etj. Bahen fajtorë Engjëjloret që shkruen gjenealogjin e tyre tuj u mbështetë te Barleti dhe Frengu etj.<sup>93</sup>.

Pa e diskutu në hollësi çështjen mendoj se ka ardhë koha që autori t’i përgjigjej disa pyetjeve, si: Biçikemi ka të caktuar datëlindje dhe ditë vdekjeje, kurse Barleti, jo. Në ç’bazë asht bâ përcaktimi i datave; Barleti gjithnjë ka pretenduar se historia e Skënderbeut duhej të trajtohej nga një pendë më me fat, që ai nuk kishte besim tek vetja, nëse do të ishte Biçikemi si do të kishte mundësi të shkruante kështu një person i ngritun akademik? Meqenëse ka botuar te De Vitali, a thue dhe ai e ka ngatërru me Biçikemin që edhe ai ka botuar në të njëjtin vend? Martin

<sup>92</sup> Nadin: *Shqipëria e rigjetun*, 2010, 216.

<sup>93</sup> Karanxha: *Barleti apo Biçikemi ?*, 2010, ff. 17-36.

Segoni që i vuri kurorë më 1485, a thua nuk dinte ke po kunorëzonte? Te panegjiriku Barleti konteston randë Biçikemin. A thu kishte nevojë t'i drejtohej vetes? Biçikemi, gjithkund profesor-Barleti prift, a nuk asht paradoks?

Të gjitha çka shkruem ma sipër, i shkruem për një nga figurat ma të ndrituna të kombit tonë, vepra e të cilit zen vend të rëndësishëm në historiografinë humaniste europiane dhe vijon të lexohet akoma me andje.

## ▪Histori▪

Bajram XHAFI

### **Hamza Kuçi-një luftëtar i madh i kombit dhe shtetit shqiptar**



Hamza Kuçi i takon plejadës së atyre burrave të Shqipërisë të cilët qëndruan në pararojë të procesit të shtet-ndërtimit dhe komb-formimit shqiptar. Vendimi i dhjetorit 2018-të, i Këshillit të Qarkut Shkodër për ta shpallur atë “Nderi i Qarkut Shkodër”, nderon institucionin, por në gjykimin tim ky personalitet me veprimtarinë e zhvilluar në vitet e para të konsolidimit e institucioneve shtetërore në periudhën e viteve 1912 – 1939, meriton të ketë edhe një vlerësim të lartë në shkallë kombëtare<sup>94</sup>.

Ndonjë hezitim, që mendoj se duhet të ketë patur për H. Kuçin, vjen për shkak të perceptimit të ndryshëm të ngjarjeve historike kombëtare dhe të vendit që zënë protagonistët e tyre në to. Kur është fjala për periudhën e Mbretërisë Shqiptare, çdo vlerësim ende vazhdon të shihet si herezî. Në fillim të shekullit XXI, “shqiptarët ndodhen në udhëkryqin e historisë së tyre dhe nuk arrijnë dot të bien në një mendje (veç të tjerash edhe) se çfarë duan e çfarë u duhet; çfarë

---

\* *Mbajtur në veprimtarinë organizuar me rastin e dhënies së titullit ‘Nderi i Qarkut Shkodër’ nga Këshilli i Qarkut Shkodër Hamza Kuçi, në bibliotekën e qytetit ‘Marin Barleti’ të qytetit më 07.03.2019.*

duhet të kërkojnë e çfarë duhet të pranojnë nga ato që u ofrohen, çfarë duhet të mbrojnë dhe çfarë duhet të rishikojnë nga historia e trashëgimia e tyre; çfarë duhet të ripërtërijnë e çfarë duhet të flakin nga kujtimet, doket e huqet e tyre, nga mënyra e tyre e të jetuarit e të ëndërruarit; çfarë stereotipash duhet të braktisin e çfarë tabush duhet të krijojnë e të rrënojnë në mendimin e sjelljen e tyre politike kombëtare lidhur me miqtë e armiqtë; çfarë përfytyrimi duhet të kenë mbi individualitetin, personalitetin dhe dinjitetin kombëtar shqiptar etj. Shqiptarët ende nuk e dinë mirë se ku janë, ku po shkojnë, çfarë po lënë pas si të panevojshme dhe se çfarë i pret përpara si e panjohur. Me një fjalë, shqiptarët janë në një krizë të përgjithshme e të gjithanshme, që degëzohen në një mori krizash specifike në të gjitha fushat”. Por të kthehemi tek objekti ynë!

### **Kush ishte Hamza Kuçi ?**

*Hamza Kuçi*, (kështu shkruhet emri i tij në dekretet me rastin e gradimeve ushtarake gjatë jetës së tij apo të emërimeve si anëtar ushtarak i gjykatave ushtarake të jashtëzakonshme), lindi në qytetin e Shkodrës me 01.04.1891, në lagjen Dudas. Ishte njëri ndër katër djemtë e Selim Kuçit. Mësimet e para i mori në shkollën fillore të Kolegjit Françeskan në Shkodër, që atëherë drejtohej nga At Gjergj Fishta. Në fëmijërinë dhe rininë e tij u ushqye fort me dashurinë për Atdheun, Shqipërinë e tij të dashur. Ishte koha kur vinte i freskët dhe tregohej me pathos akti i qëndresës vërtet legjendare të Oso Kukës me shokët e tij shkodranë në kalanë e Vraninës.

Metaforat “qëndresë legjendare” apo “ikonë” po zhvlerësohen tek s’mban duke u keqpërdorur edhe për akte normale në vlerësime figurash e raste dekorimesh, por ajo e Oso Kukës që me të vërtetë një legjendë, siç që i tillë edhe Rrethimi i Shkodrës më 1912–1913. Ishte koha kur vinte e freskët jehona e përballjeve të shqiptarëve me sulmet e fqinjëve agresorë mbi tokat e tyre. Ende ishte e pashuar jehona e Lidhjes së Prizrenit me luftat e saj fitimtare për mbrojtjen e gjithanshme të trojeve shqiptare. Shkodra dhe gjithë Shqipëria ishin vënë në fokusin e sulmeve të pandërprera për pushtimin nga fqinjët ortodoksë serbë e malazezë, grekë e bullgarë. Në këtë atmosferë u rrit e hodhi shtat Hamz Kuçi!

Në luftën e Parë Ballkanike (1912 – 1913) mbrojtja e Shkodrës përbën epopenë më heroike e më madhështore në historinë e luftimeve të shqiptarëve, e pashoqe madje në gjithë historinë evropiane. Pas 5 muaj rrethimi, në fillim të marsit 1913, Shkodra ende vazhdonte qëndresën ndaj sulmeve serbo–malazeze, Janina ndaj ushtrisë greke dhe Edërneja ndaj atyre bullgare. Shqipëria po shkelej anembanë prej ushtrive greke e serbo–malazeze, shkruan Mihal Grameno, duke gjetur pengesa “vetëm në kryeqytetet e Shqipërisë, Shkodër dhe Janinë, ku



luftonin trimat shqiptarë në komandë të dy luftëtarëve të mëdhej, Esat Pashë Toptanit dhe Esat Pashë Janinës, të cilët habitën botën me burrërinë e tyre. Më 6 mars 1913, Janina ra në duart e grekëve. Më 26 mars edhe Edërneja ra në duart e bullgarëve. Shkodra vazhdonte qendresën mbinjerëzore në një luftë për jetë o vdekje.”

Konferenca e Ambasadorëve në Londër rrinte e gatshme me hanxharin dhe gërshërën ngritur në dorën kriminale mbi hartën e Shqipërisë, në pritje sa të bjerë Shkodra. Ndërsa makina e vdekjes grinte mizorisht jetë shqiptarësh, në radhë të parë shkodranësh prej ferri të topave, bajonetave dhe, më të tmerrshmes, urisë, në sy të Evropës “gjakftohtë” dhe “të qytetëruar”. Hamz Kuçi ishte një nga trimat shkodranë që morën pjesë në luftën për Shkodrën dhe luftuan me vendosmëri. Kjo luftë e zuri në moshën më të bukur, kur sapo kapërceu të njëzetat. Përveç kontributit ushtarak, që dëshmohet edhe nga fotografitë e Marubit, ai shërbeu edhe si përkthyes personal i Kryekomandantit ushtarak dhe Valiut të Shkodrës, Hasan Riza Pasha. Ishte djalë i besës.

Hamz Kuçi mori pjesë edhe në luftërat e mëvonshme, për mbrojtjen e Atdheut, luftra që historia ia rezervoi Shqipërisë martire si pjesë e pandarë e fatit të saj tragjik. Me ardhjen e Princ Vidit, më 1914, ai dërgohet për studime ushtarake në Vjenë. Në përfundim pajiset me diplomën e Kurseve 3-vjeçare për Oficer (1914–1917). Pas kthimit në Atdhe, me gradën nën/toger, inkuadrohet në repartet e vullnetarëve shqiptarë në kuadër të ushtrisë austro-hungareze.

Pas Kongresit të Lushnjës, Hamz Kuçi, tashmë me përvojë e kualifikim të lartë ushtarak, do të vihet në dispozicion të qeverisë së Tiranës dhe nevojave të shtetit kombëtar shqiptar. Me gradën e togerit, bashkë me figura të tjera, si: Hamit Gjylbegu, Dodë Nikolla, Rexhep Shala etj., ai mori pjesë e dha kontribut të çmuar në Luftën e Koplikut të korrikut 1920, kundër ndërhyrjes ushtarake jugosllave në drejtim të Shkodrës dhe Dibrës. Ortakëria politiko-ushtarake e Italisë me Jugosllavinë më 1920, i hapi shtetit të ri shqiptar tre fronte lufte njëherësh: luftën e Vlorës kundër ushtrisë italiane, të Shkodrës (Koplikut) dhe të Dibrës kundër ndërhyrjes ushtarake jugosllave.

Në vitin 1921 (korrik) Hamz Kuçi mori pjesë edhe në operacionet qeveritare për shtypjen e Kryengritjes separatiste të Mirditës, të shkaktur nga Kapidani i saj Marka Gjoni. Në vitin 1922 Hamz Kuçi do të ishte toger i forcave të sigurisë të Komisionit Ndërkombëtar për caktimin në vend të Kufijve. Më pas ai emërohet komandant i kufirit në prefekturën e Dibrës.

Me rastin e aksionit për rivendosjen e legalitetit kushtetues, në dhjetor 1924, qëndrimi i tij si komandant kufiri ka shkaktuar debat në historiografinë shqiptare. Sejfi Vllamasi, një ndër nxitësit e të ashtuquajturit revolucion i Qershorit, në kujtimet e tij shkruan, *se Zogu marshoi me fuqitë dibrane, të cilat ishin grumbulluar në Dibër të Madhe, ndërsa Aqif Lleshi, ish kundërshtar i Zogut, u muar vesh me Zogun dhe ky mundi të bëjë për vete edhe komandantin e kufirit, toger Hamz Kuçin dhe disa oficerë të tjerë, të cilët e lanë vendin pa asnjë mbrojtje, e liruan kufirin dhe u bashkuan me Zogun*".

Nuk dua të bëj apologjinë e Hamz Kuçit, por jeta dhe vepra e tij shpreh respekt për institucionet, respekt për shtetin dhe Atdheun me të cilët sot elita "nacionaliste" po tallet në mënyrë cinike dhe prej të cilit po e pësojnë aq shumë shqiptarët.

Vllamasi shkoi edhe tek ministri anglez në Durrës dhe i kërkoi ndërhyrjen e Anglisë duke i thënë se Jugosllavia me ushtarë dhe artileri ndihmon Zogun për të invaduar Shqipërinë, por ministri anglez Aires i tha: "... nuk besoj për ekzistencën e ushtarëve dhe të topave serbë, prandaj ju a dispononi fakte?".

"U largova miqësisht prej tij, - shkruan Vllamasi, - duke mallkuar shkaktarët e kësaj tragjedie dhe veten time bashkë me shokët e mi, që përkrahën një element që na nxu faqen neve dhe gjithë popullit të pafajshëm". Vllamasi pas 15-vjetëve u kthye në Shqipërinë tashmë të "çliruar" nga tirania e Zogut për t'u bërë ministra, anëtarë të Këshillit të Shtetit e hjerarkë të lartë të Fashizmit.

\* \* \*

Në gjithë këtë konfrontim forcash me armët mbushur, asgjëkundi nuk u shkrep një pushkë, vetëm një nëntoger u vra në Gur të Bardhë, (një Sinan), më shumë për faj të një komandati inatçor. Qe me të vërtetë një marshim triumfal drejt Tiranës.

Atëherë pse duhet akuzuar për tradhti Hamz Kuçi? Përse duhej të vriste ca shqiptarë "kundërshtarë" dhe pastaj të flijohej me gjithë të tijt? Për t'i ruajtur nderin Fan Nolit që tallej me shtetin dhe rrinte duke i rënë fyellit? Për Llazar (Zai) Fundon e "Bashkimi" të Avniut (një organizatë terroriste me organizim fashist, klasifikime të Mustafa Krujës, Bernd Fisherit etj.), të atij Llazari që më pas u bë komunist, më vonë trockist, pastaj, më 1944 Enveri e vrau në Tropojë si tradhtar, jo i Shqipërisë, por i B.S.; një figure që shtypi pluralist na e ka shitur si liberal-demokrat, duke e qarë si viktimë të Enverit? Shqiptarët duhet t'i kursejnë pak lotët e të mos i harxhojnë për çdo aventurier politik.

Për Stavro Vinjaun të luftonte Hamz Kuçi? Një tjetër aventurier që, kur Vllamasi bashkë me Kolë Tromarën, Rexhep Mitrovicën dhe Beqir Valterin (ai skizofreni 17 vjeçar që i bëri atentat Kryeministrit, më 1924) ktheheshin nga Parisi për në Shqipëri, në maj 1939, në Bari ku kishte dalë ta takonte, i thotë: *I dashur Sejfi, tetëdhjetë përqind ne e kemi marrë më qafë shtetin. Për këtë Stavër të vriteshe me vllaznit t'uaj ? Apo për shokët e Riza Danit, që autori e kishte baxhanak e në kulmin e dëshpërimit i thoshte: 'Ah ç'a kemi bam na, po ta them copë se s'kemi lanë gja pa ba dhe midis shokëve të mi unë kam qenë ma ekstremist'.*

Për qeverinë e Nolit, për të cilën Elez Isufi, para se të bëhej viktimë, thoshte: “Zogu s'mund të ndalet me këtë qeveri që kemi në Tiranë, por atëherë unë do të fus një bombë në tirq dhe do të hidhem në skëterrë”. Për të mbajtur nderin e Nolit të griheshin sallatë shqiptarët mes vedit? Për atë Fan Nol, që kur varka e Noes së revolucionarëve të qershorit mbërrini në Brindisi i tha Gurakuqit: *“Gurakuq, ne kemi bërë shumë gabime”* dhe në shenjë pendimi, shkruan Vllamasi, Noli *“rrojti mustaqet dhe mjekrën e zezë e madhështore, (oh çfarë sakrifice!) duke thënë “Këtë borç që i pata Shqipërisë po ia laj dhe nuk e vlen barra qiranë për përpjekjet për një popull një milionësh malarikë, por duhet të përpiqemi për popullin kinez 400 milionësh”*. Një tallje prej pizevengu, jo për gabime, por, për krime ndaj shtetit, popullit dhe kombit (pastaj na bën vjersha atdhetare me motive biblike). Spiro Koleka e bëri levere për këto fjalë, por Noli, aq inatçor që të shkatërronte me sarkazmën e tij, e qepi gojën e nuk i ktheu përgjigje.

Po edhe më sarkastik Noli u tregua në prill të vitit 1939, kur vendi u pushtua nga Italia. Me ardhjen e Zogut dhe zgjedhjen e tij në fillim si President, pastaj si “Mbret i Shqiptarëve”, Hamz Kuçi u bë për Shqipërinë njeriu i duhur, burrë i besës dhe i ndershëm. Ai punoi me ndërgjegje të lartë e përkushtim. Përgjegjshmëria dhe vullneti u pasuan me gradimet ushtarake, të merituar për veprat e kryera. Në shkurt 1925, u gradua Kapiten i klasit II; në janar 1928-Kapiten i klasit I; në 1933 major, ndërsa më 1938, nën/Kolonel.

Hamz Kuçi u emërua anëtar i Gjyqit Ushtarak në Shkodër, më 15 mars 1925, anëtar i Gjyqit Politik për konspiracionin e Vlorës më 1932, anëtar ushtarak i Gjykatës së Posaçme për faje politike më 17 gusht 1935 dhe më 1938 anëtar i Gjykatës së Lartë Ushtarake.

Më 1932, kryetar i Gjyqit Politik për Konspiracionin e Vlorës ishte major Bilal Nivica, anëtar kapiten Hamz Kuçi dhe kapiten Luigj Mikeli për ushtarakët dhe dy gjyqtarë të tjerë që gjykoheshin për komplot kundër shtetit dhe terrorizëm politik: Bilal Golemi, Kostë Çekrezi, Hasan Dosti, Myqerem Hamzaraj, Qazim Kokoshi, Skender Muço, Seit Qemali, Beqir Sula,

Qamil Ismail Vora. Anëtar ushtarak i Gjykatës së Posaçme për Faje Politike më 17 gusht 1935 (Kryengritja e Fierit) me kryetar Ali Riza Toptani-Kosova, Major Hamz Kuçi, kapiten Zef Prendushi. Për ngjarjen e fundit vijnë më shumë në apostrofë stigmat e forta nga historiografia komuniste e krahiniste e Shqipërisë, por këto më tepër vijnë nga urrejtja për Mbretërinë dhe Mbretin dhe s'kanë shumë lidhje me vetë gjykimin profesional dhe personin e Hamz Kuçit. Unë nuk kam arsye të zgjatëm në motivet e gjykimit dhe vendimet e marruna, profesionale apo subjektiviste për pjestarët e kryengritjes së Fierit më 1935, një përpjekje për grusht shteti e një shëmti politike kryekëput antikombëtare, me karakter fashist e komunist së bashku, që aq shumë e qajnë komunistët e historiografisë sonë.

Dihet se, në çdo vend të botës dhe kurdoherë, ushtarakët që ngrenë krye kundër shtetit e kanë vendin në konop. Këtë gjë bëri, më 1935, Musa Kranja-zv /rreth /komandanti xhandarmërisë së Fierit (që në kohën e demokracisë i përkujtuam edhe 100 vjetorin e lindjes), i cili urdhëroi xhandarët e “tij” të rrëzonin qeverinë, ashtu siç bënë dy nën / kolonelët e ushtrisë shqiptare në qershor 1924, Rexhep Shala dhe Kasem Qafëzezi, të cilët urdhëruan regjimentet e “tyre”, njëri në Shkodër e tjetri në Përmet të marshonin drejt Tiranës për të përmbysur qeverinë e ligjshme, dalë nga zgjedhjet, të pranuar si të rregullta.

Pse duhet ta shkelte ligjin Hamz Kuçi në gjyqet politike e t'i falte kriminelët? Për hatër të Ali Shefqetit, ushtarak i lartë, komplotist e terrorist që mendonte të përmbyste shtetin dhe të sillte qysh më 1935 Italinë? Apo për Riza Cerovën që e nisën enkas nga B. S. për të shpërthyer revolucionin komunist në Shqipëri? Për Hekuran Manekun, i cili të vetmin “akt të lartë” moral që bëri ishte se qëlloi mbi kufomën e gjeneral Gjilardit, gjë për të cilën Mbreti nuk i akordoi falje këtij, që ishte i vetmi civil dhe 11 xhandarëve, si ushtarakë. Institucionin e faljes e ka Mbreti, jo gjykata, dhe ai e bëri atë siç duhet. Edhe në aspektin moral, historia tregoi se kush ishin këta farë burrash. Të gjithë ata që morën dënime në këto gjyqe, kur Italia pushtoi Shqipërinë në prill të 1939-s, u bënë ministra, anëtarë të Këshillit të Shtetit, hjerarkë të lartë dhe morën edhe pensione prej saj.

Me ardhjen e Italisë, Hamz Kuçi lihet në dispozicion të komandës së Mbrojtjes Territoriale Shqiptare duke u përfshirë në funksionin e oficerëve të këmbësorisë në Shërbimin Permanent Efektiv të Ushtrisë, me gradën major, sipas ligjit datë 13 korrik 1939, mbi shkrirjen e forcave të armatosura shqiptare me forcat koresponduese italiane. Internohet pak kohë në

Mantova – Çitadela të Libisë për pikëpamjet e tij antifashiste, gjë që iu theksua edhe gjyqit komunist më 1950, kur u arrestua.

Me vendosjen e regjimit komunist filloi persekutimi. Mbetet pa punë. Në vitin 1950 arrestohet dhe dënohet me 15 vjet burg për agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit. Në fund të vitit 1960, lirohet nga burgu i Burrelit dhe jeton në varfëri, pa punë, deri sa vdiq në Shkodër më 19 mars 1978.

Hamz Kuçi është figurë e pastër shkodrani nacionalist, personalitet me integritet moral dhe politik, koherent e me përgjegjësi të lartë, politike e morale. Në jetën e tij nuk shihet asnjë luhajtje e vogël, inkonsguencë apo zigzage politike në fatin aq të ngatërruar të Shqipërisë sonë; ai e pret fatin e tij me gjakftohtësi e stoicizëm, ashtu siç i ka rënë për pjesë edhe vendit të tij, Shqipërisë.

Hamz Kuçi la pas dy djem: Melekun, që jetoi dhe u largua nga kjo dynja si melek. S'mund të ishte ndryshe nën diktaturën komuniste me atë hije të rëndë në biografi si nacionalist dhe si mbretëror. I dyti, Selimi, i njohur si Jahuzi, që aty nga viti 1962, theu kufirin, shkoi e u bë ushtar i Mbretit Leka I dhe kreu misione të denja për një Jahuz.

**Gëzim H. JUKA**

### **14 Maji i vitit 1913**

14 Maji, mendoj se duhet të jetë një datë përkujtimore për pushtetin lokal në Prefekturë dhe Bashki të Shkodrës, pasi pas 28 Nëntorit 1912 ka vlerë historike, politike e sociale të pakrahasueshme me datat e tjera.!

Perkujtimi i kësaj date është nderim e kujtesë për rezistencën 7 mujore si dhe për dëshmorët e atyre ditëve heroike.

Shkodra në vitet 1912 – 1913:

*“U bëj thirrje malazezëve që të ndihmojnë vëllezërit e tyre në Serbinë e vjetër, ku burrat, gratë e fëmijët serbë janë masakruar.*

*Sado që Madhëria e Tij nuk dëshiron prishjen e paqes në Europë, nuk mbetet tjetër veç të rrëmbejë shpatën, pasi shpresat për të çliruar serbët nga Turqia pa gjakderdhje janë të kota.”*

*”Mali i Zi shpall luftën e shenjtë, i frymëzuar nga qëllime fisnike për të ndaluar shfarosjen përfundimtare të vëllezërve të vet”.*

Me këtë thirrje të Krajlit, Nikolla, Mali i Zi filloi luftën dhe pas tij hynë në luftë kundër Turqisë edhe Serbia, Bullgaria dhe Greqia.

Sipas thirrjes ishte një luftë më së paku pan-ortodokse.

Në atë moment historik, Serbia, Greqia, Mali i Zi ishin shtete të pavarura dhe me kufinj të përcaktuar. Me arsyen se po luftojnë kundër Turqisë, këto shtete synuan që të aneksonin sa më shumë territore që ishin brenda Perandorisë Osmane, siç quhej zyrtarisht, por në realitet ishin toka shqiptare.

Mali i Zi siç dihet historikisht synonte Shkodrën dhe në drejtim të saj u nisën forcat ushtarake.

Shkodra u rrethua plotësisht nga forcat e Malit të Zi, në tetor të 1912. Forcat mbrojtëse të fundit që hynë në qytet, ishin ato të “redifëve”, siç quheshin të gjithë nga zona e Tiranës, Shijakut dhe Kavajës, të komanduar nga Esad Pashë Toptani.

Qëndresën në Shkodër e drejtonte Valiu, Hasan Riza Pasha, i cili ishte kryeadministratori civil dhe ushtarak në atë moment. Qytetarët e Shkodrës ishin mobilizuar në formacione vullnetare krahas ushtrisë së rregullt. Hasan Riza Pasha dhe ushtarakët turq vazhduan të luftonin

me një përkushtim të pashoq, megjithëse kishin dijeni që Perandoria Osmane e kishte përfunduar qëndrimin në Ballkan. Ata e tejkaluan atë që mund të quhet detyrë ushtarake.

Me 6 dhjetor 1912 ishte arritur armëpushimi mes Turqisë me Serbinë e Malin e Zi, por në Shkodër qëndresa vazhdonte.

Ky është një nga momentet ku vargjet e poetit Gjergj Fishta ishin tepër aktuale:

*Por, pse na të vegjël jemi,  
pse kend fis as vlla nuk kemi,  
na sot Shkjaut s'mund t'i bajmë ballë,  
qi po do't'na përpijë gjallë;  
prandej, thom, se e lypë e mbara,  
qi dhe sot na, si përpara,  
të rrimë ngjitë me Mbret t'Stambollit,  
për me i bamun ballë Nikollit.*



*Kisha e Madhe e Shkodrës e dëmtuar nga bombardimet malazeze.*

Në këtë situatë të vështirë për shqiptarët, kur forcat serbe, greke, bullgare e malazeze ishin përfshirë në luftime me forcat turko-shqiptare, patriotët shqiptarë arritën të shpallin me 28 Nëntor 1912 në Vlorë, Pavarësinë e Shqipërisë.

Në këtë ditë të shënuar përfaqësues i vetëm i Shkodrës, por tepër i rëndësishëm ishte Luigj Gurakuqi.

Në 31 Janar 1913 u vra Hasan Riza Pasha, vrasësi nuk arriti të zbulohet asnjëherë. Qarkullon varianti se u vra nga Esat Pashë Toptani me qëllim që ky të dorëzonte Shkodrën. Në

realitet kjo nuk qëndron pasi Esat Pasha vazhdoi qëndresën me sukses edhe më pas, në muajt shkurt, mars, gjer më 24 prill 1913.

Dorëzimi më 24 prill nuk kishte me vlerë; kjo sepse më 22 mars Fuqitë e Mëdha e kishin caktuar kufirin verior të Shqipërisë dhe Shkodra ishte pjesë e Shqipërisë.

Ky dorëzim kishte vlerë vetëm për Krajl Nikollën dhe udhëheqësit e Malit të Zi. Gjatë 7 muajve të rrethimit ishin vrarë shumë malazez. Thuhej që nuk kishte shtëpi në Mal të Zi që nuk kishte vendosur mbi harkun e portës cohen e zezë. Kështu, së pakut për propogandë u brohorit: “E morëm Shkodren!”

Esad Pasha, së bashku me ushtarakët turq, redifët e tij dhe banorët e Shkodrës me rrethina kishte vazhduar një qëndresë, shembull ushtarak se si mund të mbrohet një qytet i rrethuar.

Është folur shumë se si ishte arsyeja që Shkodra pas atë qëndrese u dorëzua. Si ishte ky dorëzim? Kapitullim, pushtim ushtarak apo marrëveshje klasike mes kundërshtarësh. Po i referohemi:

Marrëveshja e Esat Pashës me Princin Danilo: (Si këndohet zyrtarisht ndër dokumenta)

***Shkodër, më 10-23 të Prillit 1329-1913***

Shtat muej rresht kalaja e Shkodrës, pa i ardhë një me kërkah, u bani ballë fuqive t’anmikut e sot me pikllim të fort po shef se nozullat (ushqime-vettovalie) qi kaa mrendë, s’po mastojnë veç sa për një ditë me e majtë ushtriin në kamë. Tujë pasë vojton puna në ketkrajjate (hall) e tujë paa se as për Qeveri as për ket vend s’po m’del me xjerrë kurnji prodhe (dobi), i pështetun themeniive (qyshkeve–patti) rreshtue ktu poshtë unë po ja lëshoj pritrat (istikamet–trinnee) ushtriis të Malit Zi e po nisem për Tiranë.

Po baj me dit, se nesër mrama qyteti kaa për të dalë nën administracjon të Sundusit të Malit të Zii.

Me nder, etr, etr,

Nëkamsi i Valiut e Urdhentari i armatës të Shkodërs:

Xheneralii urdiis. Esadi.

I – Ushtria ka me dalun lirisht preje qytetit me armë të veta, me nozulla e me rraqe luftet.

II – Ashtu edhe kushdo të ktii popullit qi t’dishrojnë me dalë me ushtriit tujë marrë me vedi armet e veta e gjaan e vet.

III – Të shtruemt ottoman qi gjinden mrenda rrethit të kalaas s’kan me psue kurrfar placket, e target vehtjetore (diritti personali) s’kan per tu prekun kurrsesi. As fare ndeshkimit



s'kaa per t'udhanun atyne qi patne pjesë në luftë, tuje kene se tjetër s'kanë ba por me i dalë zot atmes mas detyret të kanunit. Popullit si mysliman si të krishtenë i nepet siguria e plotë, se s'ka per t'utrazue kerkund as kah besimi as kah zakonet e komit të vet.

IV - Tubat ushtarake në të nisun të vet kan për t'marrun me vedi, posë petkave të shtatit, edhe njato rraqe, shatorre, shtroje, kusija etr. Qi u viin rrugës, aq sa t'munden me bartë. Prandej kanë me marrë qerre e kual, qi u duhet per ket të bajtun.

V - Zyrtarët ushtarakë e qytetnore si me thane: xhendarmë e polica qi t'dishrojnë me ju percjelle ushtriis, s'kan për tu pritë.

VI – Ushtriya, në të dalun të vet, kaa për t'u percjelle preje nji Xheneralit e preje do Zytarve Malazez.

VII – Robt, qi i perkasin ushtriis të Serbis, kan për t'u leshuemun në dorë të Kryeurdhentarit t'ushtriis të Malit të Zii. Si ktyne robve, si ushtarve, si të gjithëve të vendit, qi jane të smuete të plaguem u nepet securiya, se kan per t'u shikjuemun me gjithë at ndime e kujdes saa mund t'u bahet. Kaa pert'u dhane leja disaa mjeksave ottoman, aq saa duhen m'undalë në Shkodër nji farë kohet per ndimë të plaguemve e të smuetve. Si kta si ata kan per t'u çuemun në tokë otomane me spenxime (harxhe) të ktii Sundit vetë.

VIII – Kan me mujtë me hjekë e me marrë me vedi të gjith dokumentat ushtarake zyrtare e dossier, kan me marrë edhe njata dokumenta qytetnore e dossier, qi Kryeurdhentari ka përt'i zgjedhë e me i gjikue per të nevojshem.

IX – Të gjitha pushket automatike (mitraloza) ashtu edhe lumardhet vrulla qitje (topa me të qitun te shpejtë) e fushatore, si dhe rraqet qi u perkasin kan per t'dalë me ushtri otomane.

X – Ashtu edhe të gjith artikujt e marredhanies.

XI – U nepet të falun njatyne qi saa ngiati lufta u vit ne Sundit ottoman.

XII – Falen edhe të gjithë ata të shtruem të huej, edhe Malazez qi ikne preje vendit të vet e ranë në Shkodër e muerne armete luftuene per brii t'ushtriis otomane.

XIII – N'i rafs nevoja ushtriis per rade udhet, Mali i Zii, ne kjoftë semundet, kaa per t'ju baa ndime aq saa duhet.

XIV – Kryeurdhentari i ushtriis të Shkodrës kaa per t'ja leshue Kryeurdhentarit t'ushtriis te Malit te Zi i kalaan njashtu siasht, por nuk lidhet mos me i çarte njato mjete perpjekjet, qi përdorj në kohë të qindrimit.

XV – Me 23 të Prillit 1913 (10 të Prillit 1329) me 8 sahatin nade fillohen m'u leshue pritat e Taraboshit e të Bardhanjorve.

Ceta e Malit të Zii kaa për t'a xanë Tepen neser me 11 sahatin para mjesditet, Bardhanjoret me 1 sahatin mas mjesditet, Shtojt me 3 sahatin mas mjesditet.

Me 9 – 10 të Prillit 1329 (22 – 23 të Prillit 1913.)

*Kryeurdhentari i ushtriis të Malit të Zi.:*

*Kunorëprinci Danili*

*Nëkamci i Valiut e Urdhentari i Ushtriis të Shkodrës:*

*Xhenerali i urdiis, Esadi.*



*Ushtria turko – shqiptare në largim nga Shkodra me 24 prill 1913.*

..... kanë për të marrë me vete ...aq sa munden me bajtë.

Shkodra ishte i vetmi qytet në hapësirën mbarë shqiptare që më 1912 rezistoi me luftë. Historia ishte përsëritur; rreth 500 vjet më parë shkodranët dhe venecianët kishin luftuar së bashku kundër ushtrisë turke dhe u suall dita që tani shkodranët dhe turqit të rezistonin kundër serbo-malazezëve.

Ushtria turke që nga momenti i shpalljes së Pavarësisë e më pas luftoi si një ushtri e një shteti aleat kundër Serbisë, Malit të Zi e Greqisë.

Gjatë rrethimit dhe luftimeve do ishte frymëzim marshi i ushtrisë mbrojtëse të Shkodrës, i cili është shkruar nga Patër Gjergj Fishta, me kërkesë të Valiut, Hasan Riza Pasha.

*Prej kah lenë e merr hana.*

*M'u çu shekulli kundra nesh*

*Djelm kreshnikë na bani nana*

*Vetem na iu dalim ndesh*

*Të parët tonë burra çelikut*

*Bota mbarë sot i nderon  
Ata i binin ndesh anmikut  
Si rrufeja kur veton  
Në ballë të ushtrisë u ngreh bajraku  
Luftë burija që po thërret  
Bini djelm ku derdhet gjaku  
Për liri edhe për Mbret  
Kush të jetë djalë në ushtri të Sulltanit  
Kush të jetë djalë që deken ban  
Të dalin sot ai në fushë të mejdanit  
Me dhanë jetën për vatan  
Asht ollsun ushtriya Osmane  
Nenë Sanxhak rreshtu tabor  
Marre të parve kurr s'iu çon  
Se përpara bijnë gjallë në vorr.*

Forcat e Malit të Zi hynë në Shkodër me mburrje e brohoritje për Krajlën Nikollën. Guvernatori i Shkodrës u emnua Petar Plamenac, por siç dihet nuk qëndruan më shumë se tre javë dhe Europa i kerkoi që të lirohej Shkodra, pasi quhej pushtim i një shteti tjetër. Malazezët u larguan duke mallkuar Europën, që u çoi dëm gjakun e derdhun për Shkodrën.

Kishin sulmuar në tetor të 1912 me besim se do e pushtonin shpejt. Kishin bërë plane që të gjithë popullsinë ta vrisnin ose dëbonin, pasi ata donin qytetin. Megjithatë arritën që gjatë largimit të digjnin një pjesë të pazarit.

Krimet që bënë forcat serbe e malazeze janë të pakrahasueshme, siç thotë Mis Durham: Nuk ka patur turk të jetë sjellë aq keq me armenët, sa u sollën dy popujt serb me shqiptarët.

Gazeta “Përlindja e Shqipërisë” 1913, nr. 35, jep barbarizmat që tregon Miss Durham. Kurse Miss Durham që u dekorua nga Krajl Nikolla i Malit të Zi, e ktheu mbrapsht këtë dekoratë.

Me 14 maj u larguan forcat malazeze; me 15 maj erdhën në Shkodër përfaqësuesit ndërkombëtarë me në krye Sesil Berney. Ky moment historik u quajt “koha e internacionalit”.

Sesil Berney ( Cecil Burney), Nën Admiral i forcave angleze, ishte guvernator i Shkodrës dhe i një zone rreth 10 km qark. Ky ndejti në Shkoder gjer në 19 tetor 1913 dhe u largua me detyrë tjetër.

Megjithate në kujtesen tonë ngelet 14 maj 1913

## SHKODRA NË KONGRES TË LUSHNJËS, MË 1920

Lufta e parë botërore përfundoi me 11 nëntor 1918. Ushtria Austro – Hungareze u largua nga Shkodra që me 30 tetor 1918. Atë ditë hynë në Shkodër ushtria e Malit të Zi, me 31 tetor ushtria italiane dhe të nesërmen me 1 nëntor erdhi Gjeneral Ferrero i cili një ditë më vonë përshëndeti në një tubim popullin e shkodrës dhe përgjigje përshëndetjes i dha Ndoc Coba. Me 5 nëntor erdhen francezët. Nga kjo datë administrator i Shkodrës me rrethina sa një rreze 10 km u emërua nga Antanta, Bardi Dë Fuortou.

Gjatë periudhës së Luftës së Madhe (kështu quhej atëkohë) Austro – Hungarezët në territorin shqiptar që arriten të kenë nën kontroll krijuan një zonë të përbashkët administrative e cila u shoqërua me ndertimin e një administrate shqiptare me qendër në Shkodër. Administrata qendrore përbehej nga tre Drejtori, ku respektivisht drejtorë ishin: Fejzi Alizoti, financë; Avni Dabulla, drejtësi; Luigj Gurakuqi, arsim. Kjo administratë kishte tagrin e një qeverie.

Pushteti lokal në Shkodër në atë periudhë të 1916 – 1918 ishte i perfaqësuar nga :

Musa Juka - Kryetar Bashkije

Ndrek Naraçi - Zv/kryetar Bashkije

Loro Ashiku - Drejtor i administratës

Luigj Kodheli - Sekretar i parë

Aleks Saraçi - Sekretar i dytë

Jonuz Buliqi - Arkivist- regjistruer

Pashko Gurakuqi - Kryefinancier

Luigj Baba - Llogaritar

Zef Shiroka - Arkëtar

Kolë Krajni - Mbledhës taksash

Adem Troshani - Mbledhës taksash

Maliq Bushati - Drejtues seksionit sanitar

Sejfi Vllamasi - Veterinjer

Serafin Mitroviç - Drejtues seksionit të lejeve

Beqir Hysi - Magazinjer

Daniel Gjorgji - Shkrues

Smalj Axhemi - Shkrues

Tahir Dizdari - Shkrues

Lazer Gurakuqi - Vrojtues i pazarit

Hajdar Qyrku - Vrojtues i pazarit

Jusuf Dibra - Shef i policisë bashkiake

Qamil Kadija - Sherbimi zyrtar i brendshëm

Zef Haxhija - Sherbimi zyrtar i brendshëm

Brahim Reshiti - Sherbimi zyrtar i brendshëm

Gjithashtu ishin doktorët e bashkisë Basri Asimi dhe Syreja Korça. Farmacisti Sait Pipa.

Avokati që përfaqësonte bashkinë ishte Hoxha Kadri Prishtina.

Një nga organizimet e para që në këtë nëntor 1918 ishte policia.

Në 1913 Koloneli Filips kishte organizuar rreth 70 djelmosha për t'u përgaditur si xhandarë kalorës. Drejtues ishin Toger Malo Bushati dhe Nentoger Lekë Mirash Luca. Edhe në 1918 vashdoi po ky organizim me rikthim të përfaqësuesve të fuqive të mëdha.

Xhandarmëria vazhdoi me Kapiten Malo Bushati dhe oficerët Zef Serreqi, Brahim Mandiqi, Oso Kopluku. Ndërsa policia qytetëse Shkodër kishte drejtues Omer Lutfi me sekretar Zef Mirdita dhe pyetës Musa Celepia.

Gjithashtu sipas gazetës "Populli" nr. 3, janar 1919, Riza beg Kopluku, Kryetar i Gjykatës së Apelit njofton se ligjet e Austries bien nga fuqia e hyjnë edhe një herë në fuqi ligjet Osmane. Ky është njoftim i 23 janarit 1919.

Periudha nga mbarimi i luftës në nëntor 1918 e gjer në bashkimin e Shkodrës me qeverinë kombëtare e shtetin shqiptar, më 13 mars 1920, do ishte një periudhë e ngarkuar politike. Rezultati i përfundimit të luftës për Shkodren nxori se ato të cilët ishin historikisht në krah të Austro-Hungarisë e Turqisë konsideroheshin humbës ndërsa fitues ishte Antanta me Anglo – Francezët e në realitet ishin pro italianët që në Shkodër ishin çdo herë prezent dhe si rrjedhim sëbashku quheshin në anen e fituesve edhe Serbo – malazezët. Sëbashku me to ishin fitues edhe perkrahësit e Esat Pashë Toptanit.

Duhet të cilësojmë veçorinë e luftes së parë ku Esat Pashë Toptani me cilësinë e kryeministrit të Shqipërisë i kishte hapur rrugën e kalimit të ushtrisë serbe si dhe familjes mbretërore serbe në territorin shqiptar nga ku kishin perfunduar në Korfuz. Gjithashtu i kishte shpallur luftë Austro- Hungarezve e Bullgarëve duke u larguar me një forcë ushtarake rreth 600 vetë. Esat Pasha me forcat e tij dhe pjestarë të qeverisë shqiptare arrinte në portin e Selanikut ku ishte qendra e Antantës. Gjenerali francez i forcave luftuese e priti me ceremoni Esat Pashen si

një aleat. Nga kjo Esat Pasha sa jetoi në Itali e Francë i jepte vetes të drejten si një aleat i Antantës si dhe fitimtar i luftës që të perfaqësonte Shqipërinë.

Megjithate sapo mbaroi lufta filluan kontradiktat mes fituesve. Interesat Italiane kërkuan që “ aleatët serbë “ të mos ishin prezent në Shkodër. Gjithashtu italianët mënjantuan aleatin Esat Pasha pasi kishin përkrahje më të madhe nga një grupim tjetër politik.

Me 25 gjer 27 dhjetor 1918 u zhvilluan punimet e atij që në histori njihet “Kongresi Durrësit” Delegat të Shkodrës në këtë kongres ishin Riza Dani, Ndoc Coba, Preng Bib Doda i cili në pamundësi u zëvendësua nga Luigj Gurakuqi. Në terësinë e tij ky kongres u dominua nga rryma proitaliane. Aty u rikonfirmua qeveria e Turhan Pashës e cila ishte vazhdim i shtetit të paraluftës. Kjo qeveri drejtoj gjer me 29 janar 1920.

Në këtë situatë Britania e Madhe që në popull njihet Anglia duke mos patur historikisht ndikim e pasues në Shqipëri zgjodhi të afronte atë element politik që përpara luftës ishin pro Austriakë. Kjo edhe pse më tepër dallohej që ky grupim ishte më i madh në numër dhe më solid. Kjo dallohej gjatë shumë veprimtarive por njera ishte edhe zgjedhjet për pushtet lokal në Shkodër.

Cfarë i dalloi në Shkodër zgjedhjet për Bashkinë. Këto u zhvilluan në mars 1920. Sipas gazetës “ Populli” jepet se : Zgjedhjet e zakonshme të Perilimtares që paten filluar me 1 të këtij muaji mbaruan me këtë perfundim.

Musa Juka - Kryetar

Ndrek Vogli - Nenkryetar

Elez Sokoli - anëtar

Xhemal Begu - anëtar

Man Hoti- anëtar

Daniel Perikli - anëtar

Vasil Kushi - anëtar

Jonuz Repishti - anëtar

Patuk Saraçi - anëtar

Cuk Bufli - anëtar

Qazim Dani - anëtar

Kol Ujka - anëtar

Pra u dallua që përsëri dominuan ish pro austriakët.

Nga kjo dhe nga mos sukseset e qeverisë së Turhan Pashës u arrit që të krijohej një Komision Organizator që të realizonte një Kongres Kombëtar në Lushnje. Qëllimi ishte: Sigurimi i vetëqeverisjes së plotë të Shqipërisë, forcimi i bashkimit kombëtar, të diskutohej për gjendjen e brendëshme dhe të jashtme për të siguruar besimin e fuqive të mëdha, largimin e mosmarrveshtjeve dhe sigurimin e bashkëpunimit për forcimin e jetës së Atdheut.

Delegatët e Kongresit të Lushnjës ishin në shumicë ish perkrahës të Austrisë dhe perkrahësit e Esat Pashë Toptanit që arriten një aleancë politike kundër interesave italiane në Shqipëri ku kryesorja ishte çështja e Vlorës që ishte nën pushtim italian.

Delegatë të Shkodrës në Kongres të Lushnjës u zgjodhen nga Bashkija Shkodër: Ndoc Çoba, Rexhep Shala, Ejup Sabri ( Hafiz Sabri Bushati), Hoxha Kadri Prishtina, Mati Logoreci, Xhemal Naipi.

Kongresi ripohoi formën e rregjimit Monarki Kushtetuese ku gjer në zgjidhje të problemit të Mbretit vendi do drejtohej nga një Këshill prej 4 vetësh i quajtur Këshilli i Naltë. Këto do përfaqësonin edhe besimet fetare në shqiperi ku do ishin; musliman suni, musliman bektashi, ortodoks, katolik. Në Kongres u zgjodhen perkatësisht Zotërinjtë : Abdi Toptani, Aqif Pashë Biçaku, Mihal Turtulli dhe Imzot Luigj Bumçi.

Kongresi i Lushnjës emëroi edhe qeverinë me Kryeminister Sulejman Delvina në kabitet të të cilit Ministër Finance u emërua Ndoc Coba.

Në Kongres të Lushnjës u shpall një numër prej 37 përfaqësuesish që do të organizonin jetën Parlamentare. Me ardhje nga Lushnja në Tiranë dhe pasi u mbledhën shumica e përfaqësuesve që atë kohë u quajten senatore me 27 mars 1920 në orë 9 “ paradreke në mes të një entuziazmi me pjesëmarrje të autoriteteve dhe popullit u bë çelja e parë e Këshillës Kombëtare.

Hapja u bë me fjalën përshëndetëse të Fronit ( Këshillit të Naltë):

Të ndershmit Këshilltarë të Kombit.

Zotnij !

Në Kongres të Lushnjës që u çel me 21 kallnuer 1920 ishte vendosë që Këshilli Kombëtar të mbledhej me 15 të këtij muaji. Jemi shumë fatbardhë që ndodhemi në çeljen e të parit Parlamentit Kombëtar.

Kurë u çpallë Vetqeverimi i Shqipërisë me 28 Nanduer 1912 në Vlonë ishte vendosë mbledhja e një Senatit por nuk u mbledh, me 25 dhetuer 1918 përsëri në mbledhjen e Durrësit



ishte vendosë mbledhja e një Senati fort të caktuem por edhe ky nuk u mbledh. Prandaj jeta Parlamentare e Shqipniës fillon me zotniën t'uej.....

Dhantë Zoti qi në kohë të këtij parlamenti daltë atdheu i ynë sambas dëshireve të përgjithshme të Kombit Shqiptar i pa varmë dhe me tanësiën e sajë toksore.....

Mbledhja e dytë u zhvillua me 29 mars 1920. U vendos zgjedhja e kryesisë dhe kontrollor i votimit u emëruan zotnitë Beqir Rusi dhe Hil Mosi.

Kryesia doli:

Z. Xhemal Naipi, Kryetar

Z. Spiro Koleka, N/kryetar

Z. Hil Mosi, Sekretar.

Nga ky rast doli që Xhemal Naipi është Kryetari i parë i parlamentit të parë shqiptar dhe veçoria që është nga Shkodra.

Në këtë parlament të parë ( që u quajt senat) Shkodra u perfaqësua nga Zotërinjtë: Imzot Gjergj Koleci, Xhemal Naipi, Hafiz Sabri Bushati, Hil Mosi, Xhemal Shkodra, Kol Thaçi.

Ky parlament u mbyll në nëntor 1920 për të vazhduar me zgjedhje të parlamentit të vitit 1921.

## ▪ Tradita arsimore ▪

**Prof. dr. Njazi KAZAZI**

**Vështrim historik për kualifikimin e mësuesve dhe puna e kabinetit pedagogjik.**

### **1. Pak nga historia e këtij Kabineti:**

Kabineti Pedagogjik, ishte Institucioni i vetëm arsimor që kishte objektin e vet të pavarur të punës, por që ishte pjesë e Seksionit të Arsimit e të Kulturës së Rrethit.

Në Shkodër u themelua në vitin 1959 dhe funksionoi deri me 1992. Fillimisht u vendos në katin e parë të shkollës “Ndre Mjeda” (Fushë Çelë).

Objekti i punës së Kabinetit Pedagogjik, ishte: kualifikimi i vazhdueshëm periodik profesional i mësuesve mbi arsimin e kryer; njohja reale dhe përgjithësimi i përvojës më të mirë e rezultateve në fushën e mësimin e të edukimit; të mbulonte gjithashtu edhe punën krijuese e shkencore në fusha të ndryshme të mësuesve, kryesisht në fushën metodike e të mësimdhënies.

Standarti i punës së Kabinetit Pedagogjik varej drejtpërdrejt nga zhvillimi i arsimit në vend dhe më konkretisht, nga përgatitja e mësuesve në shkollat e mesme pedagogjike fillimisht, e më vonë në degët e mësuesisë në Institucionet e Larta Arsimore të vendit.

Organika e Kabinetit Pedagogjik ka qenë gjithnjë e kufizuar, me drejtorin e vet edhe tre metodistë. Por është interesant fakti që në çdo kohë, që nga krijimi e në vazhdim, aty emëroheshin mësues të zgjedhur, me shumë përgjegjësi për aftësinë dhe nivelin e lartë profesional të tyre. Në Kabinetin pedagogjik kanë punuar njerëz të të gjitha shtresave të shoqërisë së mëparshme, por pa përjashtim njerëz që impononin domosdo respekt absolut profesional.

Metodistët Faik Luli (Doktor Honoris Causa dhe “Mësues i Popullit“), Islam Dizdari “Mësues i merituar“), Tahsim Mlloja, Vitore Daija, Vehbi Hoti (Prof. dr.), Nikolin Preka (“Mësues i merituar“), Hiqmet Bekteshi, Sila Mësonjësi, Nuri Gokaj (Prof.as.dr.), Dhurata Bushati, Shpresa Rama (Kapisyzi), Njazi Kazazi (Prof. dr. dhe “Mësues i merituar“), Bahri Kurti, në periudha të ndryshme në jetëgjatësinë 33- vjeçare të Kabinetit Pedagogjik, mbulonin ngushtësisht profilet e tyre vetiake.

Kanë punuar dhe drejtuar me profesionalizëm për shumë vite për zbatimin e eksperimentimit të metodave të reja të mësimdhënies në tekstet e matematikës e të tjera si këto Fehmi (Ali) Quku, Xhevat Kraja dhe më pas Gani Quku, Ymer Vila, Afërdita Hafizi. Po kështu

kanë punuar pranë Kabinetit Pedagogjik edhe metodistet përkatës, si: Alfred Fishta, Spartak Lekaj, Ahmet O. Osja, Hysen Karagjozi, Hasan Sykja që kanë mbuluar profilet përkatëse nga gjuha shqipe e deri tek fizika.

Emëtime me afate të gjata të mësuesve pranë Kabinetit Pedagogjik për studimin a aksione të rëndësishme shkencore si për shembull –Mbledhja e fjalës së rrallë shqipe në rrethin e Shkodrës e drejtuar me profesionalizëm e përkushtim nga Agim Çausholli, i cili grumbulloi rreth 11.000 fjalë të rralla, me përdorim lokal, fond ky i dorëzuar herë pas here në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë.

Atestimi i gjithë mësuesve me stazh 5, 10 e 15 vjet në një sistem të ri referimi e programimi drejtuar me aftësi administrative nga Eljaz Kraja e Lumi Asllani me ndihmën e përhershme të I.L.P. (sot USH “Luigj Gurakuqi”).

Pjesa më e madhe e tyre kanë vazhduar punën në I.L.P. (sot USH “Luigj Gurakuqi”).

Duke qenë se K.P kishte organikë të kufizuar, volumi i madh i punës së institucionit që shtrihej nga qyteti në tërë rrethin duke përfshirë edhe tri zona malore shumë serioze për arsimim siç ishte Dukagjini (Shalë, Shosh dhe Pult), Shllaku dhe Këlmendi, puna e Kabinetit Pedagogjik mbështetej në grupe pune të natyrave të ndryshme:

-një kategori e këtyre grupeve ishin Komisionet e Lëndëve që ngriheshin në çdo zonë dhe në çdo grup shkollash ose edhe brenda përbrenda shkollave të mëdha. Këto komisione ngriheshin bazuar në ligje administrative të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës dhe po bazuar në këto ligje në mënyrë që të bëhej e mundur dhe konkrete dhe e realizueshme puna e tyre kualifikuese, kryetarëve të komisioneve u ulej norma arsimore me 6 orë mësimi javore.

Një kategori tjetër ishte krijimi i grupeve periodike si:

- Me afat të gjatë një a dy vjeçar si p.sh. për studimin e Historisë së Arsimit (të përkushtuar historianët Xhevat Repishti dhe Dr. Mikel Prenndushi; studimin e revolucionarizimit e shkollës ku përfshihej natyrisht masa e madhe mësuesve dhe që pavarësisht nga ideologjizimi, substancialisht shkencat mbeteshin shkenca dhe dijet dije dhe tendencat ishin të mëdha që nxënësit t'i përvetësonin ato sa më mirë të ishte e mundur; të eksperimentimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe në tekstet e matematikës e të tjera si këto dhe e drejtuar me profesionalizëm.

- Krijime grupesh pune me afate të shkurtëra për testime të ndryshme të ecurive arsimore në lëndë të veçanta e që kjo punë perballohej vullnetarisht nga mësuesit të cilet ishin në të shumtën e rasteve kryetarë komisionesh ose mësues të veçuar në aftësitë e tyre profesionale.

Në drejtimin e Kabinetit Pedagogjik, kanë punuar fillimisht **Themoidha Rakaj** që mund të themi ishte drejtuesja e parë, **Faik Luli** (“Doktor Honoris Causa” dhe “Mësues i Popullit”), **Islam Dizdari** (“Mësues i merituar”) dhe kjo deri më 1971; nga viti 1971 dhe deri më 1990 **Sytki Spahija** ish-inspektor arsimit, (“Mësues i merituar”) dhe më 1991-1992 **Njazi Kazazi** (“Mësues i merituar”), duke shpërndarë gjithë bazën materiale dhe bibliotekën shkencore dhe didaktike të pasur të Kabinetit pedagogjik. Këtë vit mbyllet Institucioni i Kabinetit Pedagogjik dhe funksionet e tij kalojnë brenda Drejtorisë Arsimore të rrethit që zëvendëson Seksionin e Arsimit dhe të Kulturës.

Bashkëpunimi i Kabinetit Pedagogjik të Shkodrës me Institutin e Studimeve Pedagogjike, me Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, me Institutin e Historisë dhe me Universitetin “Luigj Gurakuqi” ka qënë një rrugëtim i natyrshëm.

Puna e Kabineteve Pedagogjike në Shqipëri është një faqe e bukur e arsimit tonë. Ajo punë mund të përkufizohet si përkushtim ndaj shkollës që do të ishte themel arsimit e kulture për të ardhmen e gjatë.<sup>95</sup>



## 2. Përvojë nga kualifikimi i mësuesve në fillimet e shek. XX:

Gjatë gjithë zhvillimit historik të shkollës shqiptare, në përgjithësi dhe arsimit në veçanti, përpara shoqërisë, shtetit shqiptar, organeve arsimore, në prefektura e deri në shkolla të veçanta problemi i përgatitjes së vazhdueshme dhe i kualifikimit të mësuesve ka qënë një çështje që ka dalë gjithnjë në evidencë. Kjo shprehte në një farë mënyrë dëshirat dhe aspiratat e popullit, të forcave përparimtare, të grupeve të ndryshme shoqërore, të shoqërive kulturore arsimore për arsimin kombëtar në gjuhën shqipe. Ajo që më ka rënë në sy dhe që e kemi prekur edhe në ndonjë vend gjatë punimit është se në kuadrin arsimor vërehet një farë polarizimi: - nga njëra anë, drejtuesit e arsimit, drejtorët e shkollave, profesorët kishin nivel shumë të lartë, ishin përgjithësisht me universitete apo normale të plota perëndimore ose të orientit. Për më tepër ata nuk ishin vetëm mësues, por edhe autorë



<sup>95</sup> Marrë nga “Fjalori enciklopedik i hapësirës shkodrane” i Dr. Zenepe Dibra, EBP “Gjergj Fishta” Lezhë, 2016. Zëri: Kabineti Pedagogjik i Shkodres. Vëllimi I, fq. 144. Për Faik Lulin. Islam Dizdarin, Sytki Spahinë, Nikolin Prekën, Vehbi Hoti, Sila Mësonjësi, Agim Çauholli, Nuri Gokaj, Njazi Kazazi ka zëra të veçantë në këtë fjalor.


programesh, tekstesh, revistash arsimore etj., në mes të të cilëve mund të përmendim: Daut Boriçin, Luigj Gurakuqin, Mati Logorecin, Gaspër Beltojën, Karl Gurakuqin, Ismail Anamalin, Gaspër Mikelin, Kol Margjinin etj., etj., dhe, nga ana tjetër, padyshim shumica, ishin mësuesit e shkollave përgjithësisht fillore, niveli i të cilëve ishte relativisht i ulët. Nga ky fakt lind nevoja që drejtuesit në të gjitha nivelet të përdorin forma të ndryshme pune, për të cilat mendojmë se është me interes të flasim në këtë pjesë. Për të konkretizuar mendimin e mësipërm po sjellim disa shënime të gjetura për gjendjen dhe nivelin e kualifikimit të mësuesve në vitet '20.

Në revistën “Agimi”, që citon revistën “L’Europa orientale”, në numrin e 4-t të saj, më 1921, në intervistën e ish-ministrit të arsimit Kristo Floqi mbi gjendjen e shkollave lexojmë “shkolla gjithsej 528 me 878 mësues nga të cilët vetëm 4% (pra rreth 34 mësues) me kulturë perëndimore dhe kulturë orientale. Le të mendojë lexuesi se çfarë fryti mund të japin këto shkolla!”, përfundon artikullshkruesi.<sup>96</sup>

Në një ekspozitë të Ministrit të Arsimit të atëhershëm, mbajtur në parlament në vitin 1921, botuar në “Shkolla e re”, flet për 581 shkolla dhe 1092 mësues. Për shkallën e arsimit dhe të kualifikimit të tyre jep këtë pasqyrë: I- Mësues vetëm me shkolla fillore të vjetra në gjithfarë gjuhësh 392; II- Me qytetëse (dy-tre vjet mbi filloren) 92 ;III- Me gjysmë gjimnazi turqisht ose greqisht 95;IV-Me gjimnaz të plotë të shteteve të Ballkanit 69; V- Ata pak të tjerë që teprojnë e që meritojnë me u thirrë mësues të vërtetë (nuk jep shifër)<sup>97</sup>

Gjergj Fishta, në fjalën e përgatitur për t’u mbajtur në Parlament, në vitin 1922, jep këto shifra: Nga 1120 mësues gjithsej janë pa diplomë 465, me diplomë 67 dhe pjesa tjetër 698 janë mësues besimi. Ai e përfundon këtë paraqitje me fjalët “Merret vesht prej vedit se në ç’hall gjendet arsimit në Shqipëri”.<sup>98</sup>

Në një informacion tjetër të Ministrisë së Arsimit, dt. 6.4.1923, në pikën b, lexojmë: “Sot për sot në shtetin tonë kemi vetëm 25 profesorë të cilët janë specializuar në këto degë: I -



<sup>96</sup> Një mësues, “Shkollat tona”, “Agimi”, Viti III, nr. 8, V. 1921, fq. 147.

<sup>97</sup> Shih “Shkolla e re”, Viti 1921, nr 12, fq. 286.

<sup>98</sup> Gj. Fishta: “Reforma arsimimorë në Shqipëri”, Hylli i Dritës”, Nr.5-8, 1924, fq.232.

*Filozofi, 1 - filozofi e teologji, 3 - letërsi, 3 - matematikë, 2 - histori-gjeografi, 1 - muzikë, 3 - filologji, 1 - bujqësore, 10 - pedagogji.”<sup>99</sup>*

Për rrjedhojë, gjendja dhe niveli i mësuesve ka qenë vazhdimisht shqetësim i drejtuesve të arsimit nga qendra në bazë. Në një relacion që Luigj Gurakuqi, Drejtor i Përgjithshëm i Arsimit, bën parashtrimin e nevojave, por thekson edhe rrugëzgjdhjet e menduara: “...kam nderin të heq vërejtjen e kryekomandës mbi një çështje shumë me rëndësi e cila duhet gjithnjë parasysh kur flitet për themelimin e organizimit shkollash e që është mungesë e mësuesave.”<sup>100</sup>

Aq më tepër shtrohej ky problem i mprehtë, kur “...të mos gjinden më tepër se 50 mësues në të tanë Shqipërinë e gjithë tjerët jo vetëm që nuk dinë mjeshtrinë e mësimit, por edhe gjuhën shqipe e përdorin me vështirësi, në vend që gjuha është vegla më e parë që i duhet një mësuesi të mirë”<sup>101</sup> në një kohë kur “...kjo do të ishte gjuhë mësimi.”<sup>102</sup>

Në shkresat që cituam dhe në materialet e tjera që kemi gjetur, ndjehet qartë shqetësimi për gjendjen dhe nivelin e mësuesve, madje ky problem shtrohet që herët nga drejtuesit e arsimit, të cilët e shihnin kualifikimin e vazhdueshëm të tyre si një ndër rrugët kryesore dhe efektive për arritjen e rezultateve në arsimimin e fëmijëve.

Mendoj se është me interes për të trajtuar se cilat ishin rrugët që mendonin dhe që realizuan në të vërtetë intelektualët e kohës për të zgjidhur këtë problem të rëndësishëm. Ndër rrugët kryesore:

-Krijimi i rrethave të shpejta për përgatitjen e mësuesve në Shkodër e në Elbasan ku “...t’i jepet më tepër rëndësi mësimit të metodikës, të psikologjisë, të logjikës, të gjuhës shqipe e gjermanishtes e kështu për vjetin që vjen të na shtohet numri i mësuesave për shkollat fillore të katundeve.”<sup>103</sup>

Këto masa u realizuan me hapjen e rrethave të shpejta në këto qyteteve gjatë viteve 1917-1918, për të cilat kemi folur në pjesën e shkollave Normale.

- a) Zhvillimi i kurseve të kualifikimit në pushimet e verës, në kohë të ndryshme, në qytete të ndryshme, që siç shprehshin edhe vetë drejtuesit të tyre kanë qenë të dobishme. Dërgimi i studentëve jashtë shtetit me investime nga fondi shtetëror ishte një masë tepër

<sup>99</sup> AQSH, F. 295, V. 1923, D.1110, Fl. 2.

<sup>100</sup> AQSH, F.295, V. 1917, D. 4, Fl. 1-2.

<sup>101</sup> Po aty, fl. 1.

<sup>102</sup> AQSH, F.295, V.1916, D. 23, Fl. 1-4.

<sup>103</sup> Po aty, fq. 2.

rëndësishme që u mor. Ndonëse nuk mund të krijojmë një pamje të plotë, po sjellim etëm disa pasqyra të nxjerra nga arkivat e konsultuara.

Kështu Luigj Gurakuqi flet për 60 nxënës që do të shkojnë jashtë sipas kësaj ndarjeje: 30 do të shkojnë në shkolla normale, 10 do të bënin gjimnaz klasik që do të përgatiteshin për fakultete universitare dhe 20 do të bënin shkolla të mesme të llojeve të ndryshme nga të cilat punonjës financash për nënprefektuarash, bashkitë si dhe sekretarë gjykatoresh<sup>104</sup>. Në ekspozenë që përmendëm më lart thuhej se në vitin 1921 Ministria e Arsimit mbante në shkolla të jashtme 151 studentë të ndarë sipas shteteve: Francë- 7, Austri- 92, Itali- 52. Sipas shkollave ndiqnin: në universitete 44, në shkolla të mesme të epra (të larta) 25 në shkolla të ulëta 82.

Në një shkresë, që mban datën 28 shtator 1925, flitet edhe për 129 bursistë në universitete e shkolla të tjera të larta të profile të ndryshme, si dhe për 150 vetë që do të studiojnë me shpenzimet e veta<sup>105</sup>.

a) Botimi i organeve pedagogjike dhe i artikujve të shumtë të kësaj fushe në shtypin e kohës ishte një ndihesë konkrete për mësuesit, veçanërisht për mësuesit e fillores ku punonte pjesa më e madhe e tyre. Në mes të këtyre duhet të përmendim: “*Shkolla e re*”, “*Kumtari Arsimor*”, “*Revista pedagogjike*”, “*Arsimtari*”, “*Agimi*” “*Afrimi*”, “*Hylli i Dritës*”, “*Lajmet e Komissë letrare shqipe*”, “*Mësuesi*”, “*Edukata e re*” e dhjetra organe të tjera. Veç artikujve teorikë, përkthimeve nga pedagogë të huaj, histori pedagogjike, vendin kryesor e zinin orët e mësimit të zbërthyer metodikisht. Kujtojmë se vetëm Gaspër Mikeli, Drejtor i të përkohëshmes “*Shkolla e re*”, botoi në këtë organ rreth 18 modele të tilla mësimi që zënë rreth 75 faqe, pra 1/4, e gjithë botimin prej 12 numrave të kësaj reviste. Por vend të rëndësishëm në ngritjen e nivelit të mësuesve zënë padyshim edhe botime në fushën e pedagogjisë, disa prej të cilave u realizuan nga shtyshkronjat e Shkodrës.

Përpjekjet për një gjë të tillë i gjejmë që para fillimit të shekullit XX, ndoshta ndër të parët e këtij lloji. Ky botim, që kishte vlera didaktike dhe edukative, i drejtohej një rrethi të gjërë lexuesish intelektualë, madje edhe prindërve, të çdo niveli, gjë që e konkludojmë nga niveli, mënyra e ndërtimit, thjeshtësia e trajtimit të problemeve të shtruara. Është fjala për librin e Gaspër Benussit “*Shqiptari i mësuem në gjuhë të vet*”, botuar në Shkodër më 1897, e botimi i dytë, libër i nevojshëm për shkolla e për popull. (Botimi i parë ishte bërë më 1890 po në

<sup>104</sup> AQSH, F. 295, Viti 1917, D. 4, Fl. 2.

<sup>105</sup> AQSH, F. 251, V. 1925, D. 231, Fl. 3.

Shkodër). Ne analizuam botimin e dytë. Autori Gaspër Benussi, (i biri i Gjergjit, që më 1836 pat hapur një shkollë në rrugën e jezuitëve) dhe për veprimtarinë e të cilit kemi folur në hyrje të punimit, duhet të ketë lindur po në Shkodër më 1856. Gasperi e vazhdoi zejen e të jatit dhe për 12 vjet rresht në këtë qytet mbajti një shkollë private në shtëpinë e vet, ku u mësonte nxënësve gjuhën shqipe. Prej tij, siç dihet, është hartuar edhe një abetare, e shtypur në Bukuresht më 1886.

106

Rëndësi të veçantë në vështrimin pedagogjik ka libri në fjalë. Ai përbëhet nga katër pjesë, si më poshtë:

*Pjesa e parë: faqet 5-25. Është një përmbledhje me rregulla të ndryshme morale, si:- mënyra se si duhet të sillemi para shkollës, në shkollë, në tavolinën e bukës, në kishë e në shtëpi; rruga e njerëzisë, pastërtia, të ndenjurit dhe të ecurit, të folurit; detyrimet (borxhet) e njeriut nga ana e Zotit, nga ana e vetes, nga ana e shokut, nga ana e prindërve, nga ana e mjeshtrit, nga ana e pleqve, nga ana e atdheut.*

*Pjesa e dytë: Kallzime të Nasihatshme (fq. 25-48). (e këshillueshme, sipas Tahir Dizdarit, Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe. Tiranë, 2005, fq. 704).*

*Pjesa e tretë: Dheshkronjë (fq. 49-68).*

*Pjesa e katërt: fjalë, biseda e fraza për të mësuar gjuhën italiane, (fq. 69-129).*

Vend të veçantë në këtë fushë zënë botimet “Pedagogji teoritike” për mësues të shkollave fillore dhe nxënës të shkollave normale, me autor Gaspër Beltojën, Drejtor i Arsimit të Shkodrës, botuar më 1920 dhe “Edukata a se mirërritja e fëmijëve”, punuar për mësues e mësuese të shkollave shqiptare nga një françeskan shqiptar, botuar më 1915. Ndonëse të dy librat janë përkthime nga autorë të huaj, në ta ndjehet qartë dhe bie lehtë në sy puna krijuese e autorëve për t’u dhënë vlera aktuale lidhur ngushtë me kushtet konkrete dhe psikologjinë e popullit tonë, me ndjenjat e dëshirat e shqiptarëve për të përgatitur një brez të kulturuar dhe të qytetëruar në të gjitha pikëpamjet.<sup>107</sup>

Që në parathënien (parafjalën siç e quan autori) e “Pedagogjisë teoritike” duken qartë qëllimet e autorit për t’u ardhur në ndihmë mësuesve të kësaj shkence, mbasi “të lanunit anash të parimeve të saja në mësim, asht një punë shumë e damshme.”<sup>108</sup>

<sup>106</sup> Shefik Osmani- Njazi Kazazi: “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike”, Botim i MASH dhe shtëpisë botuese “Idromeno”, Tiranë, 2000, fq. 376, shih faqet 129-134

<sup>107</sup> “Pedagogji teoritike...”, Shkodër 1920, fq. 10.

<sup>108</sup> Po aty, fq. 5.



Autori vlerëson dhe i jep rëndësi të dorës së parë zhvillimit dhe përparimit të arsimit të shkollës shqiptare sepse vetëm kështu, thekson ai, do *“t’i vemë themele të shëndosha atdheut ...që ky ... të gëzojë, të përparojë e të lulëzojë.”*<sup>109</sup>

Autori thekson me të drejtë rëndësinë e dobisë që i sjell tërë njerëzimit mësuesi i mirë e për rrjedhojë u drejtohet kolegëve që të punojnë pa u lodhur në dobi të atdheut. Për këtë autori i kushton një syth të veçantë rolit të mësuesit në progresin e mësimit. *“Përparimi i fëmijve në shkollë, sqaron autori, nuk rrjedh vetëm prej zellit, aftësisë dhe forcës morale të mësuesit.”*<sup>110</sup>

Këtë të fundit autori e lidh me disa kushte, si: *kur është i kuptueshëm në mësime, i kandshëm në të punuëm, kur zotëron profesionin, kur ka energji vullneti të lidhura me ndërgjegjen, por duke mos harruar edhe një paraqitje korrekte dhe estetike në veshje.*

Virtytet morale të mësuesit, si: *“qetësia, ëmbëlsia në fjalë, burrëria, drejtësia, bujaria, kreshnikëria dhe të prumit e mirë si në jetën shpiake, por edhe në shoqëri, jo vetëm mund t’u vlejë nxënësve si shembuj, por...edhe të lulëzojnë personalitetin e tij.”*<sup>111</sup>

Teksti ka 26 krerë, të ndarë secili në çështje me numra. Aty trajtohen të gjithë komponentët e edukimit, që nga edukata fizike, edukimi moral, edukimi mendor (mësimi) e deri tek edukimi estetik (dashuria për sendet e bukura). Njohuritë e pedagogjisë janë ndërthurur dhe me njohuri nga psikologjia e përgjithshme, ndërmjet të cilave: kujtesa, parafytyrimi, gjykimi, arsyetimi etj.

Është me interes të theksojmë se në njërin nga kapitujt e librit *“Prirjet për sendet e larta”* trajtohet si çështje dashurie për sendet e bukura. Qëllimi i saj është që ta drejtojë nxënësin në vëzhgimin e bukurive të natyrës, *“me harmoni të mrekullueshme”*<sup>112</sup> dhe, si rrjedhojë e punës së prindit dhe të mësuesit, të edukohen dhe të formohen tek ai shije estetike, si dhe të bëhen përpjekje *“që edhe në jetesë e në vepra të tija të sundojë bukuria dhe harmonia”*, duke e familjarizuar vazhdimisht fëmijën me to.

Në fund të kësaj pjese, mendojmë se është me interes për studiuesit, por jo vetëm për atë ,të tregojmë se si është trajtuar mësuesi materialisht, ç’pagë kishte, mbasi gjatë dekadave të fundit është folur shumë para vitit vitit 1938 dhe në përgjithësi kjo periudhë është para me syze të errëta, aq sa në çdo punim shkencor gjithmonë shifrat janë krahasuar me këtë vit.

---

<sup>109</sup> Po aty, fq. 5.

<sup>110</sup> Po aty, fq. 93.

<sup>111</sup> Po aty, fq. 97.

<sup>112</sup> Po aty, fq. 73.

Në një “*Rregullore për kategorizimin e e arsimtarëve*”, botim i Ministrisë së Arsimit, për mësuesit e shkollave të mesme jepen tri shkallë atestimi si më poshtë:

**Kategoria I-** ata që kanë diplomë të akademisë pedagogjike ose prej degës së pedagogjisë së univesitetit - kanë rrogë themelore: franga ari- 250.

**Kategoria II-**ata që kanë mbaruar universitetet dhe kanë marrë liçencë, por të kenë dhënë të pakten 2/3 e provimeve të lëndëve kryesore, kanë rrogë themelore: fr. ari- 280.

**Kategoria III-a)** ata që kanë mbaruar univesitete dhe kanë marrë liçencën kanë rrogë thmelore: fr. ari-300. **b)** ata që kanë mbaruar universitet dhe që kanë marrë liçencën dhe doktoraturën kanë rrogë themelore: fr. ari- 320. <sup>113</sup>

**Përfundime:**

Menduam të trajtojmë disa drejtime të punës pedagogjike për kualifikimin e mësuesve të viteve '20 të shekullit të kaluar dhe të theksojmë korrektesën dhe saktësinë e punës për përgatitjen e mësuesve, materialet që kanë përdorur dhe në kushtet tona mund t'i shërbejnë dikujt në drejtime të ndryshme.

---

<sup>113</sup> *Republika Shqiptare: “Ligje dhe rregullore mbi kategorizimin e arsimtarëve”. Tiranë, 1928, fq 6-8. (ligji është i vitit 1926, 12. 04.)*

## ▪Letërsi-Art-Kulturë▪

### POEZI

#### Rozafa SHPUZA

#### DYER PA ÇILCA



*Rozafa Shpuza asht lindë në qytetin e Shkodrës, ku më 1956 Pjetër Marubi hapi studion e parë fotografike shqiptare dhe ballkanike, ndaj ajo beson me shpirt se asht e bekueme qysh në ngjizje me artin e bukur të fotografisë dhe me balsamin e apostujve të poezisë geqe. Mbasi përfundon me rezultate të shkëlqyeme studimet e nalta për Gjuhë- Letërsi, shkon në Tiranë, ku aktualisht punon si redaktore në sektorin e botimeve të parlamentit shqiptar. Pasionet ma të dashtuna të Rozafës janë poezia dhe fotografia. Lidhjet e saj me poezinë dhe fotografinë janë të hershme dhe mundena me pohue pa droje se kanë ardhë vjetë mbas vjetit tue u ba ma të ndijshme dhe intensive. Rozafa boton fillimisht “Kohë ikonash” me proza poetike, që pasohet me “Anipse” dhe “Grizhlat” me poezi në gegnisht. Ndërkohë, ka gati për botim një vëllim të ri poetik. E veçanta e krijimtarisë së Rozafës asht se poezitë kanë një lidhje të pashmangshme me fotografitë që ajo shkrepë. Së fundmi, ajo ka hapë në Shkodër një galeri arti, që ka me kenë një Odë mikpritëse për artistët kudo në botë. E.A.*

#### Dyer pa çilca

Në shpinë tonë dyert ishin pa çilca  
e përdita kalamendej nga njena odë në tjetrën  
e pandryshueshme  
si lutjet që gjyshja këndonte nën za  
teksa njehte nyjet e një filispaje të sajueme si tespije...

Shtrojet e pecave iu përngjitnin rrugicave qorre  
me destinacion të paracaktuem  
e tanë rrugtimi jem ishte një lojë shahu  
pa fitimtarë.

Tash që shpija e vjetër u zhba  
si në epilogët e përrallave me gogolë  
e ndjej përditën të shfaqet prej birave të çilsave  
që kurrë s'u përdorën  
krejt si në fokusin e një aparati që s'rresht' së fotografuemi...

### **Mesditë maji**

Im atë luen shah n'oborr.  
Me sy t'picrruem rreshton ushtarë drunit  
mbi kuadratet e njeshun solemnisht si paradë maji.  
Aty ku pikon truma  
lugu asht birue n'qasje t'synit t'ciklopit,  
e gjyshja s'pranë tue m'porositë  
se trumës duhet me i qitë pak ujë sipër  
sa me shpërla ndryshkun.  
Im atë luen shah n'oborr  
në pamundësi me gjetë arsye pse antena e radios  
e lidhun për tandën me hardhi të krasituna  
s'asht e zoja me kapë një tjetër stacion,  
përpos marshit solemn të paradës.  
Jam veç 13  
e sandalet e reja m'i shtërngojnë gishtat  
teksa marshoj mbi kuadratet bardhezi...  
Im atë luen shah n'oborr  
me shpresë se radioja ka me këndue një tjetër himn

e unë kam me nga' z bathët n' nji fushë pa kuadrate...

### **Dalldi gushti**

U dejen gjinkallat...

e i rrëfyen inxhe për pe sekretet e tje glave  
tue i zprazë ngutshëm si shkuma në gotën e birrës.

U dejen gjinkallat...

e jaret e stërgjyshave i kënduen zaçjerrë  
tue i zëvendësu emnat e dashnorëve  
me inicialet e gdhenduna fatalisht mbi krahë.

U dejen gjinkallat...

e plasën saora prej zhegut zhuritës.

Shpija e braktisun u kot

e pa n' andërr se njerëzit e fotografive bardhezi  
buzqeshën...

## Kritikë letrare

Xhahid **BUSHATI**

### **PËRJETIMI LIRIK NË NJË PROZË POETIKE**

-Vështrime dhe përftesa për librin “Monolog me veten” (kur nuk kam një partnere për të biseduar...) të autorit Meritan Spahia

1.

I prirur në udhëtimin e tij, drejt një arti të vërtetë e me kërkesa artistike, e ke të pamundur të mos të të bjerë në sy ky tipar edhe në librin më të ri të titulluar: “Monolog me veten” (kur nuk kam një partnere për të biseduar...) të shkrimtarit Meritan Spahija.

Mozaiku i tekstit me proza poetike (por më shumë se kaq) na shpie sa në bregun e mallit, aq edhe në atë të kujtimeve, sa në të ritë e autorit aq, edhe në ngjarje fatmira e fathumbura, sa në perceptime filozofike, po aq edhe në zbulesa të trishta sociale, sa referues i një bote të largët, po aq përkuese me realitetin e përditshëm, sa në lëvrimin dhe objeksionin e legjendave e të miteve aq edhe në diagramën progresive të kulturologjisë së autorit, e kështu, pa harruar se besimplotë e pret një mëngjes i ri i së nesërme për një udhëtim të ri artistik, sigurisht me një hapësirë të re, ku siç thotë studiuesi Sali Bashota: “Kur fillon e kur mbaron shkrimi? Kjo është temë-dilema e secilit krijues kur ballafaqohet me kuptimin dhe domethënien e fjalës poetike, përbrenda aktit të frymëzimit. Pastaj, në procesin e krijimit: projektohen, ringjallen, lëvizin ndjenjat, mendimet, figurat; aty ku strukturohet rrethi i imagjinatës: kujtimi, ligjërimi, shkrimi.”<sup>114</sup>

I prirur për t’i shtuar edhe një faqe poliedrit të figurës së tij në lëmin e krijimtarisë letrare, shkrimtari Meritan Spahija vjen me një libër, ku shpërfaq dinjitetshëm prozat në poetikat e tij, proza me fabul ose jo, por, ama, me imazhe dritëhijshme, të cilat në tekst i përgjigjen një organizimi korrekt e të admirueshëm strukturor ku detajet ndjehen të përzgjedhura, kanë një gdhendje prej dalte artistike, joshëse e plot sensibilitet artistik.

Libri është i ndërtuar mbi bazë ciklesh, dhe titullohen sipas prezantimit të autorit: “Përsiatje”, “Përkushtime”, “Nostalgji verore”, “Rrëfime”. Synopset, janë një tjetër vështrim i autorit, ku në vetvete mbartin ngarkesa filozofike e shtresime liriko-epike, si dhe tekstet që përmbyllin librin, si: “Çështje nderi” (një meditim i shkurtër në muajt e nxehtë të diellit 616,

<sup>114</sup> Bashota, Sali: *Enigma e shkrimit, Prishtinë, Artini 2018, shkrimi “Meditimi lirik”, f. 33.*

mbas Trojës) e “Jazoni” (djaloshi i heshtur, që nuk dinte se ishte i ditur), konfigurojnë estetikisht librin, i falin frymëmarrje më të gjerë dhe një ndërtim kompozicional më të konsoliduar.

2.

Në lëndën e librit, në disa cikle, të bien në sy emërtesa *Përkushtime*, që ngajnë si medaljone vlerash, ku tipizohen personazhet në raporte të caktuara me realitetet. Siç mund ta gjejmë në prozën “Dimër i butë”, kushtuar G. B.

“Që kur ike ti, asgjë nuk ka ndryshuar në qytet. Përsëri kafenetë të shtunave në mëngjes janë plot, ashtu si të hënave, dhe kalimtarët në rrugë janë të shumtë.

Edhe ky dimër po duket i butë, siç kanë qenë zakonisht këta të fundit. Me gjasë, nuk do të bjerë borë as sivjet. Na kalbi shiu!

I vetmi ndryshim qysh se ke ikur ti, është se, diku, në një lagje të qytetit, një plakë fisnike për herë të parë në jetën e saj ka vënë në krye një shami të zezë. Ndryshmi tjetër është se ne jemi një më pak.” (Dimër i butë, për GB, f. 11)

Tek ciklet pasuese, si udhërrëfyese motivesh shndrisin e rrezatojnë përcjellje mesazhesh pavarësisht vendit dhe kohës që bëhet fjalë, dituria e kultura e autorit, thellësia e njohjes, personazhe me dukuritë dhe ngarkesat emocionale, afirmimi i një bote femërore me shumë problematika, filozofi, arsyetime, vizione e bashkëkohësi... një botë sa tokësore e po aq qiellore, sa mitike, aq legjendare, që jo vetëm e dashuron autori Spahija, por edhe e sjell me mjeshtëri dhe dallueshëm në letërsinë shqipe, duke iu përmbajtur prozës poetike, ndoshta edhe më shumë se kaq si zhanër. Një prozë poetike që rrezaton nga *Saktësia*, - siç thotë Italo Kalvino. E, duke iu referuar Kalvinos, proza poetike e Meritani në ligjërimin e rrëfimin e tij shquhet nga tre gjëra: “1.Projektimi i përcaktuar dhe i llogaritur mirë i një vepre (tekstit në rastin konkret.); 2.Evokim imazhesh vizuale të kthjellëta, energjike, të paharrueshme; 3.Një gjuhë më e sakta për nga leksiku, ngjyrimet e mendimit dhe të imagjinatës.”<sup>115</sup> Duke u nisur edhe nga këto tri gjëra që përmenda më sipër, mendoj se ky libër është një arritje e re në krijimtarinë e autorit, e pse jo, edhe në zhanrin e prozës poetike shqiptare.

3.

Në fakt, Meritani e ka një ndjesi, e një marrëdhënie komunikimi me tekstin që shkruan. Shpërfaqja është në shumë pika vështrimi. Po rendis disa prej tyre, si: \*e ndërtuar mbi filozofinë e Migjenit (“Portreti i përsosur”), \*e konceptuar si thirrje drejt dritës dhe dashurisë së

---

<sup>115</sup> *Calvino, Italo: Saktësia, f. 5 – 6; ALEPH 9, Tiranë, vjeshtë 2000.*

diturisë (“Për një Eco të papërsëritshme...”), \*e ndërtuar në një rrafsh në raportet me qytetin (“Dimër i butë”), \*e ndërtuar mbi bazën e përshkrimeve me prirje filozofike (“Valët në breg”), \*i ndërtuar mbi bazën e ngjashmërive (“Zgënjimi i imazhit”), \*i ndërtuar mbi bazën e vokacionit të evolucionit dhe vazhdimësisë së jetës (“Gjethet e vjeshtës së shkruar”), \*i ndërtuar si gërshetim planesh, mes koherencës dhe vlerave të traditës (“Të vjetrit”), etj., etj. I përmenda disa, ashtu siç mund të përmendja të tjera, për të arritur në karakteristika të prozës së Meritani, siç janë qasja dhe procedimi. Shpesh bashkangjitur, herë pranë e pranë duke ruajtur edhe veçanësitë e tyre, ligjërimi i autorit fsheh të dukshmen dhe nxjerr në dritë të padukshmen, herë nëpër një përhumbe, e herë në perspektivë vizionesh, herë meditimi a ngjarje bëhet e afërt ashtu siç bëhet e largët, herë duke besuar, e herë duke udhëtuar në arritjen e një qëllimi, një ëndrre a dëshire, herë e herë... Ndaj dhe jo më kot e ndërton mendimin në një rrafsh filozofik ku merr përparësi meditimi, shpesh përmes një loje e kontrastesh të përfutuara, e shpesh ngjyresat poetike kanë praninë dhe mospraninë e tyre (është fjala për nënkuptimet), herë-herë fjalët a fjalitë krahasuese apo pyetësore, nga mënyrat e formulimit i gjegjen qëllimshëm strukturës dhe organizimit të lëndës.

#### 4.

Në poetikën e tij, Meritani shquhet për zgjedhjen e detajuar të tipareve të personazhit, të shprehjeve të thëna në funksion të përkatësisë së ideve. Dialogun e shoqëron një tension emocional dhe meditim si vlerë për t’i dhënë dimension e përjetim problemit që trajton. Këtë dukuri e gjejmë në çdo cikël, por më e dendur mbart cikli “Nostalgji verore”. Veçanërisht këto tekste mbartin ngjyra të theksuara lirike. Këtu, metafora dhe simbolika mbartin një peshë të veçantë, ngaqë përjetimi i dashurisë në shumëformësinë e saj mbart një pajë të lakmueshme të botës emocionale.

Në poetikën e tij, Meritani i jep vend përditshmërisë, legjendës, mitit, kanunit etj. Edhe kur teksti nuk ka fabul, edhe kur teksti ka fabul, mbeten të palëvizshme: tabloja meditative dhe pamja ekspresive. Këto vlera e ornamente i ndeshim te “Nostalgji verore”, te synopset, te “Çështje nderi” e te “Jazoni”.

Meritani preferon një lloj fjalori, sigurisht të vetin, autentik, ku paraqet një dukuri të brendshme, konkrete, abstrakte, antike, mitologjike, etj., si: dituri, kafene, dimër, botë, Zeus, Apolon, valë, kokrrizë rëre, kokërr misri, malësor, rapsod, gur, lot, vjeshtë, gjethe, syth, sy, Narciz, Perseu, Ariana, Tezeu, Jazon, Parid, jetë, etj., për të shprehur copëza kujtese, copëza



realitetesh, imazhe të afërta e pse jo edhe të largëta. Të gjitha këto ne “i prekim” përmes ligjërit të tij që na i rrëfen në vetën e parë, ku dhe ai kërkon të jetë i pranishëm në komunikim me subjektin.

5.

Duke kqyrur më vëmendje lëndën poetike të ofruar nga libri “Monolog me veten” gjen brenda çdo teksti “oaze” poetike, që të falin ndjesinë e poezisë, aq sa për një çast kujton se, je duke lexuar vargje, që të lënë mbresë, por shpejt kujtohesh se po komunikon me një krijim të shkruar në prozë... Më kujton Borges-in, i cili thotë: “Poezia lirike shkruhet në mënyrë të tillë, që lexuesi të vendoset personalisht në qendër të saj. Janë shkallëzime shpirti. ... Poezia është arti që shkakton ndjeshmëri, duke përdorur lojën e fjalëve.”<sup>116</sup>

Për t’i shërbyer argumentit tim të mësipërm, zgjedha prozën me titull: “Valët në breg”:

“Në bregun e detit, te rrypina që rrahet nga uji papushim, qëllon të shohësh ndonjë gur jo shumë të madh, por pashmangshëm e vëren, sepse vëllimi i tij është disa mijëra herë më i madh se kokrrizat e rërës. Mendon: ai është i palëvizshëm aty, kush e di qysh kur... Dallimi nga kokrrizat e rërës nuk qëndron në faktin se ato i zhvendos vala periodikisht, por në faktin se ajo nuk e përfshin të tërin siç bën me kokrrizat, por vetëm pjesërisht, sipërfaqe që prapë i bie të jetë mijëra herë më e madhe se sipërfaqja e një kokrrize. Vala ndjehet e pafuqishme. Ndërsa kokrrizat i zhvendos papërfillshëm dhe me përbuzje, ndaj gurit duket se përkëdhel stoicizmin e tij.”

Si përfundim: prozat e Meritanit të shkruara me mjeshtri, paraqesin në thelb gjendje, ndërsa subjekti i këtyre krijimeve fsheh dhe shpërfaq mëkatën, intimitetin, kujtesën fëmijërore e rinore, kujtesën e vlerave, etj, aq sa shkrimtarin Meritan Spahija e bëjnë nostalgjik, përjetues, romantik e ëndërrimtar...

---

<sup>116</sup> *Borges, Jorges Luis: Specifikimi i shpejtë për artin poetik, f. 101; Illz – revistë letrare e Tiranës, nr. 8 – 2017.*

**Arben PRENDI**

## **POETIZIMI I GJENDJEVE METAFIZIKE KOMPLEKSE**

*Autori Pal Ndrecaj vjen me vëllimin më të ri poetik: “Nëpër galaktikën që e ke krijuar vetë, botoi Armagedon, Prishtinë 2019. Pal Ndrecaj është shkrimtar dhe gazetar nga Kosova. Ai lindi më 1960 në Moglicë (Gjakovë). Studioi letërsi shqiptare në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqiptare dhe gazetar në të përditshmet kosovare “Koha ditore” dhe “Zëri”. Prej vitit 2004 jeton dhe punon në Nju York. Merret me poezi dhe prozë. Librat e tij poetikë janë: “Lule mbi plagë” (1993), “Akti i krijimit” (1998) dhe “Gdhendja e përmasave” (2015). Ka botuar edhe romanin me titull “Lista e zezë”.*



Vëllimi *Nëpër galaktikën që e ke krijuar vetë* përbëhet nga katër cikle: *Art poetik*, *Tablo me atdhe*, *Nëpër galaktikën që e ke krijuar vetë* dhe *Imazhe*. Përkatësisht këto cikle janë shprehje e gjendjeve reale dhe metafizike të poetit në kohën në të cilën jeton. Por le ti analizojmë ato me radhë.

### **Manifesti poetik**

Në ciklin e parë *Art poetik* artikullohet kredoja poetike e krijesit në aventurën e tij të përhershme për të kërkuar dhe realizuar mjeshtërinë artistike, poetike. Në këtë aventurë është poeti, lexuesi, kritika por edhe bota tjetër që është përgjithësisht indiferente ndaj artit. Këto poezi janë në thelb poezi për poezinë, dhe na paraqesin konceptin poetik të autorit: çfarë është për të poezia, vargu, forma, domethëniet kuptimore, qëllimi i saj etj. Është e njohur tashmë se artisti

krijon botë, duke imituar Zotin, përkatësisht ky është universi ku jeton poeti: galaktika që ka krijuar është arti i tij, atdheu që e mbart me vete dhe imazhet ku përthehen të gjitha këto.

Secila poezi ndërtohet mbi artikulimin e një esence kuptimore, ku poezia është: *torturë* (“Torturë”); *zog që shpërthen lëvozhgën e emocionit dhe mësyn botën* (“Poezia”); *mision pa shpërblim monetar* (“Brenda kohës”); *mënyrë për të luftuar frikën* (“Gjatë fluturimit Nju Jork-Zyrih”); *kërkim enigmatik në shpirtin njerëzor* (“Vargje që mbetën pa titull”); *armë për të luftuar të keqen* (“Më thotë se i do poezitë e mia...”); *vetëflijim* (“Poezi për një flutur dhe për një ide...”), *por edhe dështim para historisë* (“Sprovë”); *dëshmi e të vërtetës* (“Ora e trishtimit”), *por edhe art që nuk i shkon gjithkujt* (“Tjetërsimi”), *dhe mbetet një kërkim që herë është i realizuar e herë i pakryer deri në fund* (“Një kritiku tendencioz”).

Poezia diku na del si mundim, torturë, kërkim dhe mision vetësakrifikues i krijesit:

*“Nesër do të ngushëllohem  
se ishin fluturime të rastësishme  
që provokojnë para kohe,  
dhe se është e zakonshme me u sjellë  
edhe nëse ke me u djegë në fund.”* (“Poezi për një flutur dhe për një ide...”).

Ndërsa në poezinë “Ora e trishtimit” poeti është shpallësi i të vërtetës dhe si i tillë nuk mund të fajësohet: *“po nëse lumi e solli këtu tanë këtë llum,/ ç’faj kam unë që e thash’...”*. Po ashtu në poezinë “Një kritiku tendencioz” poeti është i vetëdijshëm për kufizimet e veta “hapësirat boshe” të tekstit ku kritiku letrar i zë pritë me tendenciozitetin e tij prej gjuetari gabimesh. Edhe në poezinë “Sprovë” poezia/arti është një betejë e përzishme me kohën dhe historinë, ku lavdia me mallkimin qëndrojnë pranë e pranë:

*“Kundërmojnë pjesë të tana të rame:  
vargje pa jetë,  
forma pa ide,  
qajnë poetë të premë nga kosa e historisë,  
dekorata, çmime, bien përdhe.”*

## Gjeografia metafizike e atdheut

Në ciklin e dytë “Tablo me atdhe” autori ndjek një motiv të njohur në poezinë shqipe dhe veçmas në poezinë shqipe në Kosovë, duke konfiguruar poetikisht tablotë që përbëjnë gjeografinë metafizike të atdheut. Përmes një toni narrativ që përshkon pothuaj të gjitha poezitë e këtij vëllimi, atdheu mitizohet dhe antropomorfizohet poetikisht, por përmes një përjetimi dhe ndjeshmërie moderne që lind nga reflektimi i njeriut bashkëkohor të shkëputur nga vendi i tij dhe jo nga patetizmi e retorizmi romantik i tejkaluar.

Në këtë cikël artikuloohen trajtat e mbartjes së atdheut me vete si dhimbje e kryqëzimit të tij (“Tablo me atdheun në javën e madhe”), si kujtim i vendlindjes (“Në shtëpinë e lindjes në Moglicë”, “Nata në Moglicë”), kujtim i të afërmëve dhe i njerëzve të dashur (“Kangë Krishtlindjesh”, “Gjyshja”) kujtim e aktualizim i figurave kulturore si: Ali Podrimja, Xajë Nura, Latif Berisha; nderim dhe ndërtim i historisë që nga ilirët (“Teuta”), Skënderbeu (“Duke pritur Gjergjin me u kthye”), arbëreshët (“Bisedë me një arbëreshe), deri tek të rënët në luftën e fundit në Kosovë (“Kuptimi i kufinit”, “Poezi rapsodike për mikun tim dëshmor Gaspër Karaqi”).

Kredoja e këtij cikli artikulohet në poezinë “Tablo me atdheun në javën e madhe” ku poeti njëson dramën e kryqëzimit të Krishtit me atë të atdheut të tij duke shpresuar njëkohësisht për ringjalljen e tij, sikurse në legjendën biblike të ringjalljes së Krishtit. Atdheu kalon mundimet e kryqëzimit gjatë gjithë javës, vdes të shtunën dhe ringjallet të Dielën e Pashkëve. Në këto imazhe përfshihet silueta e një figure femërore e cila sikurse në legjendën biblike ngjason me siluetën e Maria Madalenës, e cila në rrëfenjën biblike ia lan trupin Krishtit me erna të mira. Madje në fund të kësaj poezie atdheu identifikohet edhe me vetë këtë siluetë femërore, e cila ngjan me dashurën e poetit. Pra atdheu identifikohet me njeriun, atdheu është njeriu, janë njerëzit tanë të dashur.

*“Të dielën, më shumë se kurrë  
atdheu të përngjan Ty.  
Ai është trupi dhe shpirti Yt,  
që më mban në jetë.”*

Ky antropomorfizim i atdheut plotësohet me poezitë e tjera për prindërit, gjyshen, vendlindjen, djalin, miqtë, poetët, simbolet e historisë sonë kombëtare etj. Dramën e poetit në marrëdhënien me atdheun, por edhe mitizimin e ri të tij, e përmban edhe poezia “Martini niset

për Atdhe”. Shqetësimi i poetit dhe prindit se brezi më i ri, i cili u largua në moshë të mitur nga atdheu drejt vendeve të tjera, do ta ketë të vështirë ta ripërtrijë lidhjen me atdheun edhe në një realitet kompleks ku koncepti për atdheun është duke ndryshuar me shpejtësi në botën kozmopolite:

*“...Ka dalë prej Kosove kur s’e dinte ç’do me thanë atdhe,  
në Fordham University ka hasë në teorinë e Atdheut Planetar,  
të cilën e ka përqaftue si idenë më të mirë për një botë humane.*

*Në shtëpi i kena thanë se tharmi më i mirë për të është dheu*

*ku të ka shkelë kamba më së pari.”* Pra, atdheu sipas teorisë moderne është si me thënë planeti Tokë, gjithçka tjetër do të bëhet e parëndësishme. Ajo çka është e shenjtë dhe mitike për atin, rrezikon të mos jetë më për të birin, por megjithatë ai po e bën një përpjekje për ta kuptuar atdheun e prindit, po shkon në Kosovë... Ndërsa në poezinë tjetër “Martini më shkruen mbasi mbërrin në Atdhe” shihet se lidhja me atdheun do të vazhdojë përmes birit, i cili, sikurse i ati, është i tronditur që kufijtë e atdheut janë lëvizur, janë ndryshuar. Mitizimi i atdheut na kthen në kohën e stërgjyshërve apo më tej në kohët kozmike të krijimit të botës, kohë në të cilën krijohet atdheu i poetit: “Atdheu që i kishte kufijt m’at’ anë,

*një gur në diell,*

*një tjetër në hanë.”*

Nënkuptohet pra se ky atdhe kaq i lashtë nuk duhet harruar, prandaj edhe këtu atdheu është ridimensionuar në tri kohë, në të tashmen, në të kaluarën dhe në të ardhmen.

Në të tashmen reflektohet marrëdhënia e poetit me vendlindjen, me njerëzit e familjes, prindërit, gjyshen, djalin, miqtë, por edhe me disa figura kulturore dhe politikën. Në të kaluarën ndërtohen raportet me prejardhjen kozmike, të tipit “ një gur në diell/një tjetër në hanë”, me historinë ilire dhe atë mesjetare, përkatësisht në poezinë për mbretëreshën ilire Teutën, për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun dhe arbëreshët; deri tek lufta e fundit në Kosovë dhe heronjtë e saj. Nga e tashmja në të ardhmen është projektuar atdheu përmes të birit, Martinit, i cili nisat dhe mbërrin në atdhe.

### **Nën peshën e absurdit dhe të mëkatit të rrjedhshëm**

Në ciklin “Nëpër galaktikën që e ke krijuar vetë” përmes këndvështrimit poetik të botës poeti e krijon vetë *galaksinë e tij*. Kjo është galaksia e botës njerëzore, ka planetet dhe yjet e saj, që janë njeriu dhe njerëzimi, në fate të përbashkëta por edhe individuale. Në mjaft prej poezive

përsiatet mbi fatin e njerëzimit në shekullin modern dhe atë të individit si vetje më vete, por edhe si pjesë e shoqërisë ku jeton. Vuajtjet e individit dhe njerëzimit vijnë nga veprimet apo mosveprimet e tij si dhe nga një përcaktim i fatit të tyre absurd, të ngjashëm me atë të Sizifit në esenë e njohur të shkrimtarit të njohur francez A. Kamysë, heroit të ndëshkuar nga hyjnitë për të bërë një punë në thelb absurde, por që për Kamynë mund të vishet me kuptim, madje mund edhe ta bëjë të lumtur heroin dhe njerëzimin. Madje këtë cikël, ndjehet afria e poetit me filozofinë e absurdit, si një mënyrë për t'i dhënë kuptim ekzistencës dhe veprimit të njeriut në jetë. Gjendje e cila shprehet më qartë në poezinë “Çka na thotë Sizifi kur rikthehet tek guri”:

*Edhe gjanat që nuk mund t'i ngremë në majë vlejné,  
qoftë vetëm për hir të përpjekjes,  
kështu pastaj ato marrin peshë  
dhe nuk iu nënshtrohen ligjeve të gravitetit,  
tërheqin përpjetë.  
Me rënie të lirë bien vetë gjërat e lehta.*

Këtu poeti e shfaq qëndrimin e tij të angazhimit në çështjet e botës, qëndrim i cili është i pakompromis duke ikur nga neutraliteti intelektualist dhe duke kërkuar rrugën e tij përmes mundimit të Sizifit i cili e bën betejën e tij pavarësisht fundit absurd.

*“...prandaj nuk e kam zgjedhë mesin,  
kam zgjedhë me u rrëzue në ndonji skaj,  
por që është skaji im,  
që është maja ime deri ku jam ngritë tue shtue peshë  
dhe tue mos ndigjue me shkue mbas tjetërkujt,  
as me u tërheqë me litar tre deri në pesë metra,  
si makinat e prishuna të mbetuna në rrugë.”*

Edhe poezia “Binarët” duket se përshkohet nga gjendje të frymëzuara nga absurdi kamyzian: rruga e ekzistencës së njeriut kalon përmes gjendjesh absurde: fitore dhe humbje, ato i japin kuptim asaj, sikurse veprimet në dukje pa kuptim të Sizifit:

*Kështu mes fitoresh e humbjesh,  
udha jote mbërrin në fund.  
Në mbarim të betejës së pasosur,  
të dy flamujt njiilloj i tund.*

Ndërkaq paralel me temën e absurdit të ekzistencës është e pranishme atmosfera e zymtë e një bote që vuan pasojat e mëkatit të rrjedhshëm, sipas frymës së krishterë. Një botë e këtyllë është e mjegullt, e palumtur dhe e paorientuar mirë në hapësirë dhe në kohë. Vizioni se kjo palumturi dhe papërsosmëri buron nga shpirti i ndotur prej mëkatit të rrjedhshëm, të papastruar në kohën e duhur. Madje kjo gjendje e spërkat poezinë me një pikëllimë të rëndë dhe në pamje të parë të pakuptueshme, por të përjetueshme. Qenia është e palumtur në një botë të kërcënuar nga arritjet teknologjike të cilat kanë nxjerrë në rend të dytë arritjet shpirtërore, të cilat domosdo e mbingarkojnë poetin edhe me një vizion apokaliptik të saj dhe pastaj në vënien në dyshim si në poezinë “Kundra mëkatit të rrjedhshëm” apo në poezi të tjera të kësaj gjendjeje:

*... Në jetë kështu nuk udhëtohet,  
thonë ata që të gjitha caqet  
i kanë gjetë të gatshme si mëkatin e rrjedhshëm.  
...Më beso mâ i mirë âsht një dyshim që tmerrësisht të trazon  
se besimi i dhuruem që të fal qetësinë  
që nuk ia shplon rrajët asnjë fije bari!*

Ndërsa në poezinë “Sprovë” ngjan se “mëkati i rrjedhshëm” qëndron si *diçka e trishtë* mbi gjithë galaksinë shpirtërore të poetit, madje rrezikon edhe ta shkatërrojë atë tërësisht:

*Diçka e trishtë  
bredh nëpër galaksinë  
që e ke krijue vetë.  
Herë si dritë,  
herë si kometë.  
...Veç druej se ka me e goditë  
e ka me ta bâ copë-copë  
atë planet.*

Por në këtë botë absurde, të trishtë e të errësuar nga mëkati i rrjedhshëm shkëlqen njeriu i cili është si yjet, i rrethuar nga terri i tij, që zhvillon idenë e galaksisë së krijuar nga poeti:

*“Në pështjellakun e madh të territ,  
yjet janë dëshmia se terri mundet me u shpërthye,  
janë rasti me të provokue mu tashti  
e me të bâ me mendue se edhe ti je si ata:*

*i mbeshtjellë me terrin tand”.*

Kurse në poezinë “Tufa e Zotit”, autori ironizon parabolën biblike të krijimit të njerëzimit, derisa ai u shkëput nga bariu i tij:

*“Pastaj dikush doli prej saj,  
e braktisi,  
tha se quhej Unë.  
... Sot e atë ditë,  
bariu e Uni nuk kanë mâ paqe,  
sherri i tufës së Zotit”.*

Poezitë e këtij cikli vijnë duke krijuar një vështrim filozofik mbi botën ku jetojmë dhe problemet që ka shoqëria moderne. Këtu zgjerohet vizioni prej demiurgu i poetit i cili merret me probleme e tema mbarënjëzore, duke nisur nga ato biblike me historinë e Adamit dhe Evës, (“Biseda e fundit mes Adamit dhe Evës”) deri tek përditshmëria e njeriut bashkëkohor përmes puthjes së Judës. Madje poeti ndërton edhe vizionin e fillimit dhe fundit të botës: *Adami dhe Eva në fillim dhe fundi* në poezinë “Për fundin”. Fundi një herë është fundi i rrugëtimit të njeriut të vdekshëm, herë është fundi i qytetërimit: *me foshnjën që nuk din të qeshë dhe me vajzën që ia mbyll sytë kukullës së saj* që të mos shohë tmerret që prodhon qytetërimi modern apo me frikën nga bomba atomike.

Një pjesë e poezive, me sa duket, mbështeten në përjetimet përgjatë fluturimeve me avion dhe vetvetiu krijojnë imazhin e vështrimit në distancë dhe nga lart të botës dhe problemeve të saj (“Luaj me glob...”, “E shkruar gjatë fluturimit...”, “Gjatë fluturimit”, “Duke fluturuar”). Si të thuash poeti qëndron lart dhe bota poshtë, si një hartë e vizatuar prej tij, që përputhet me imazhin e “galaktikës që e ka krijuar vetë”. Poeti luan me globin në fantazinë e tij, por i këshillon udhëheqësit e njerëzimit të mos sillen si poetë, sepse tragjeditë që shkaktojnë veprimet e tyre nuk kanë fund. Shqetësimi për fatin e botës njëzore dhe të njeriut e dominon poezinë e këtij cikli deri në atë masë sa mund ta quajmë autorin si *poet të angazhuar*, që reflekton për katastrofat që njerëzimi ia ka thurur vetes gjatë shekullit modern, si në poezinë “Rekuiem për Murin e Berlinit”:

*“Çmendunia e një gjysmëshekulli  
u copëtue në miliarda thërmia,  
u shkul nga ekzistenca,*



*siç e heqim nga vjersha  
nji varg që nuk shkon.*

*...kisha dashtë me coptue  
çdo mur si ai i Berlinit...”.*

Ndërsa në poezinë “Muret” pas shembjes së *mureve* shfaqen horizontet:

*“Bien njeni mbi tjetrin muret  
dhe shfaqen njeni mbas tjetrit horizontet”.*

Ndaj në këtë cikël përveç meditimit për gjendjet e natyrës njerëzore dallohet qartë shqetësimi për fatin e njeriut, por edhe të popujve, fat i cili varet prej politikave globale apo lokale. Shqetësim të këtillë e shfaq autori në poezinë “Luaj me glob...” ku enden gjurmët e ankthit atomik të Luftës së Ftohtë ndërmjet superfuqive të botës:

*“...Nesër ka me lindë foshnja që nuk di me qeshë  
e ka me i pa mërrolët popuj e kultura.*

*Tash merre me mend,*

*një njerëzim i tanë*

*fle me kokë në bombën atomike*

*dhe mban një shpresë të lidhur lak në fyt.* (“E shkruar gjatë fluturimit nga Nju Jorku në Prishtinë”).

### **Me gjuhën e imazheve poetike**

Në ciklin e katërt “Imazhe” poeti parapëlqen të flasë me gjuhën e imazheve që shpesh u ngjasojnë imazheve piktorike duke tentuar një retrospektivë në kohë parake: të kapjes së momentit të para ndodhjes së ngjarjes, që të sjell ndërmend reflektimin e një ylli, drita e të cilit vijon të udhëtojë deri tek ne por në fakt ai është shpërbërë prej kohësh. Imazhet lindin nga një proces psikik ku vetëdija dhe pavetëdija ndërhyjnë tek njëra-tjetra, pa e sqaruar mirë kufirin me realitetin. Disa prej poezive kanë pikërisht të njëjtin titull (“Imazh I”, “Imazh II”, “Imazh i kthjelluar”, “Çaste”). Në këtë proces poeti, si një shaman i urtë rreket të rikthejë çastin e ikur, të kthejë kohën pas si mundësi për të ndrequr gjërat ndryshe si në poezinë: “Imazh II”

*Kjo qershia e kalbun n’degë*

*âsht rasti yt i harruem me buzëqeshë.  
...Unë edhe pse sajoj imazhe për qejfin tim,  
nuk gjej dot mundësi me e kapërcye këtë ligj,  
pos nëse e vendos ngjarjen,  
në çastin para kalbjes.*

Ndërsa në poezinë *Çaste* tentohet ikja nga lëndorja, fizikja, duke u zhdukur pas metafizikes në një botë dhe në një kohë që është boshe:

*Nuk jam këtu, kot vini, nuk jam,  
âsht orë e trajtës së kotë,  
i fshehun diku siç fshehet vetja mbas pavetëdijes  
bâj çastin e mungesës në botë...*

Me gjuhën e imazheve flitet edhe në poezinë “Riprodhim” ku çmitizohet përsëri bota përmes vështrimit ironik të ekzistencës, e cila nuk ka më asgjë origjinale, të papërsëritshme, por përkundrazi, duket si e kopjuar për të kushedisesatën herë. Bota ngjason me një pikturë që përsëritet përjetësisht, ndërrohen ngjyrat, ndërrohen njerëzit, por piktura mbetet, jeta dhe ekzistenca vijon pavarësisht se kjo ngjan me një pikturë të riprodhuar:

*Kjo pikturë âsht e kopjueme,  
ai lumi që shihet aty rrjedh i pasigurtë,  
ajo vajza që rri në breg,  
duket qartë se nuk e pëlqen këtë motiv,  
do një tjetër mâ optimist.  
... Pema afër saj tashmë i ka shkundë gjethet,  
një brushë dhe ca ngjyra tjera  
ndodhen aty për me ndërrue efektet.  
Grueja ndjen se âsht koha të çohet  
një tjetër vajzë vjen e ulet në vendin e saj,  
brusha e ngjyrat janë prapë aty,  
efektet megjithatë s`ndërrojnë.*

## Disa vërejtje

Vëllimi poetik *Nëpër galaktikën që e ke krijuar vetë* ka në bazë poetizimin e gjendjeve metafizike komplekse ku ndërthuren përjetimet e thella subjektive me filozofinë e njeriut bashkëkohor, pjesë e së cilës janë kërkesa për artin poetik, lidhja me atdheun në kohët moderne, pesha e rëndë e situatave absurde dhe e palumturisë së një bote në udhëkryqe. Ligjërimi i kësaj poezie manifeston veçori të ligjëritit narrativ, gjithsesi një narrativë poetike ku çlirohet reflektimi i gjithanshëm i poetit që jeton në botë. Lirshmëria dhe natyrshmëria e kësaj narrative shpesh janë cilësi të vyera në të cilat mbështetet gjuha poetike. Në rastet kur iket prej këtij ligjërimi që imponon poezinë me varg të lirë dhe shkohet drejt poezisë me varg më të matur apo me rimë, ndonjëherë vargu vuan nga kërkimi i rimës së qëllimshme e cila vërtet realizohet, por duke zbehur vlerën artistike të poezisë në tërësi. Në disa raste autori, për shkak të densitetit emocional dhe ideor sikur e humb betejën me mjegullën e asaj çka ka në mendje dhe asaj se si duhet ta shprehë, duke mos arritur t'i harmonizojë plotësisht ligjërimin poetik me domethëniet kuptimore. Në këto raste poezitë dalin të pakryera plotësisht nga rrafshi kuptimor dhe estetik.

Arben PRENDI

## NJË SPROVË LEXIMI E VËLLIMIT POETIK *CARPE DIEM* TË ARJOLA ZADRIMËS



*CARPE DIEM* - *Kape ditën*, asht vargu i famshëm i poetit romak Horaci, që shpreh pak a shumë idenë se jeta duhet gëzue intensivisht, çdo moment i saj asht i rëndësishëm, dhe nuk duhet lanë me ikë kot. Kjo sentencë përshkon figurativisht dhe konkretisht edhe vëllimin poetik të Arjola Zadrimes. Prandaj edhe poezitë janë një përpjekje poetike për me kapë atë që nuk kapet: momentet flurore të ekzistencës së qenies njerëzore, në një rrafsh krejtësisht ideal, që ndan përmes realen me irealen, andrrën me zhgjandrrën.

Autorja asht gjuetare e momenteve të ekzistencës së qenies së saj dhe këto momente i bashkëndan me dikënd imagjinar që shpesh del se do të jetë lexuesi apo dikush tjetër i nënkuptuem, që asht gjithmonë i pranishëm... me mungesën e tij. Shpesh poezitë ndërtohen në formën e bashkëbisedimit gojor me atë që nënkuptohet se asht i pranishëm, siç thashë në ndonjë rast lexuesi, në ndonjë rast dikush tjetër: Këtu bahen pyetje, që s'marrin përgjigjen, rrëfihen përvoja të çasteve të posaçme të ekzistencës, bahen deklarata dashurie, jepen këshilla, por edhe lutje e ndonjë rast edhe mallkime të pranueshme etj. **Prej fillimit:** ... *Ti nuk e din si ndihesh/ me humbë në errësinë/ tuj kërkue ma s'parit dritën.* **Vetmi:** *Kur të vish ki kujdes;* **Testament:** *Ti vetëm lexo atë që s'them;* **Më duej:** *Më duej deri në shpërbamje;* **Ty:** *Kur kam fytyrën tande ndër duer.* **Rrokje:** *kam me mësuë;* etj. Ky ton intim i ligjërimit ruhet deri në fund dhe shkurton distancën ndërmjet autores dhe lexuesit.

Gjuha poetike e poezisë luan me antitezën, paradoksin dhe oksimoronin tue krijue efekte dhe imazhe origjinale por edhe tue rrezikue në lojën e ligjërimit dhe kuptimit.

Tematikisht në qendër të vëllimit gjejmë temën e erosit dhe të meditimit për fatin e qenies njerëzore. Të dyja këto tema shkrihen tek njena-tjetra organikisht për me na dhanë përpjekjen e qenies që përballet me përkohësinë për të fituar përhershmerinë, përballet me vdekjen dhe vetminë për me vijue jetën dhe me realizue qëllimin e saj ... Pikënisja e gjithçkaje asht vetja, prandaj natyra e poezisë përcaktohet si thellësisht introspektive, e distancueme pothuaj nga çdo trajtë e realitetit të jashtëm: *Unë dhe unë mjaftojmë/ për mot të pikëlluem...* ndaj në çdo poezi artikullohet bota e unit të saj poetik e cila asht e identifikue me “një grue të veshun me ujë” që “vjen me vërtik”, tue nënkuptue hovin e pasionit por edhe një qenie efemere që ndryshon trajta vazhdimisht e si e tillë e paparashikueshme, e si e tillë edhe duhet pasë frikë, sepse mund të sjellë rrënim... Në raste të tjera hiqet dorë edhe prej identitetit të grues si grue, qenie sociale, apo si qenie shpirtnore, për t’u shëndrrue në dashni: *Më shuej/ tash që ma ndeze zemrën, më shuej mendjen/ se nuk jam ma grue/ as shpirt/ veç dashni...* Megjithëse situata poetike asht paradoksale artikullohet dëshira me u shkëputë prej çdo pengese reale dhe me u shëndrrue në diçka krejt ideale të çlirueme prej çdo konvencioni social apo tradicional: Jo rastësisht këtë e varg e gjejmë edhe në ndonjë poezi tjetër: **Magdalena:** *Unë s’jam grue sot,* dëshira me e braktisë konvencionin e zakonshëm të grues si qenie sociale: sepse ky konvencion i lidhun fort me mjedisin social shqiptar e pengon atë për me u realizue si qenie metafizike por edhe fizike. Mund të tingllojë si një farë herezie, heqja dorë me rebelim prej identitetit social, i cili në fakt e pengon qenien njerëzore shpesh, dhe e ban të ndihet e frustueme në realitet, por ky asht haraçi që kërkon të jetuemit në mjedisin social. Kena parasysh si çfarë konotacionesh ka shpesh të qenit grua sidomos në mjedisin shqiptar. Tek poezia **Ding -dong** në këtë mjedis social, natën vonë, siç shprehet poetja: “nudoja e një grueje shfaqet dyerve të qiellit, / me u pa andërr, tue mbetë kohë”, sinonim i të dëbuemes, të ndaluemes dhe të mallkuemes, si një shfaqje fantazme e cila nuk i përket realitetit, ndoshta fantazma e ndonjë grueje të sapovrame nga burri, i dashuni, apo ndonjë maniak seksual apo e vetëvrame nga paragjykimet, thashethemet, apo pamundësia për me realizue veten e saj në një mjedis që ta mohon me egërsi këtë gja, tue t’i mbyllë të gjitha shtigjet.

Në temën e erosit buron nga libidoja e qenies që e ka braktisë identitetin social, kjo libido dhe kërkesa e saj për realizim kamuflohet poetikisht ndërmjet imazheve dhe shprehjes poetike tue shpëtue nga deklarata por edhe duke u përfutue si një dimension bazik i ekzistencës në të cilin qenia plotësohet dhe motivon këtë ekzistencë. Në botën që poetesha percepton, dashunia dhe

erosi ndërkaq vihen në pikëpyetje, jo rrallë i përkasin një kohe të kalueme e cila ka lanë pas një botë të hirtë e të ftohtë: Në poezinë: **Dimnor**, thuhet shprehimisht: *në anën ma të ftohtë të universit/ishte një herë/ dashnia...* Tek poezia **Natë**: pyetet: *A ka mbetë ma dikush që don/ me gjithë shpirt?* Imazhi që krijohet prej këtyre pyetjeve asht sigurisht ftohtësia, shkretia, nata, errësina, sepse edhe kuptimisht bota pa dashuni asht botë e vdekur, pa jetë, sepse jeta buron nga dashunia, formë e së cilës asht edhe ajo mes mashkullit e femnës. Imazhi i këtillë i botës asht fundi i botës, pra imazh apokaliptik. Ndërsa në poezitë tjera përpjekja për me kapë dashninë i jep kuptim ekzistencës dhe botës: Kur ka ndër duar fytyrën e njeriut që don, sigurisht bota bahet ma e bukur, ka dritë, ngrohtësi dhe ngjyra ndërsa gjuha poetike kamuflon vrullin e libidos seksuale e cila asht vrulli dhe gjallëria e jetës së qenies njerëzore. “A po m’len?” “Më duej”, “Flakë bore” etj. Si në poezinë *Venus*, shenja e yllit Venus, perendia e dashunisë te romakët, mundet me e ndriçue botën. Nën ndriçimin e Venusit bota merr kuptim dhe ekzistenca mund të përballohet si në poezinë **Mikut**: *Për me u shky tue qeshë/ më duhet një hanë e plotë/ një trup i ri/ e një mik i hershëm*. Mbas kësaj “asht e lehtë me vdekë”. Në ndonjë rast tjetër si tek poezia **Më duej**: dashunia realizohet edhe si sfidë: *Më duej/ deri në shpërbamje/ më duej deri në koc./ si sfidë./ si një miratim i heshtun palësh,/ ligj i aprovuem,/ që të lejon gjithçka”*

Ndonjëherë gjuha e paradoksit dhe oksimoronit por edhe kërkesa për ta shpalosë libidon femnore si pushtet apo ndëshkim ndaj mashkullit e tejkalon *detyrën* e poezisë erotike tue ra ndonjë herë në patetizëm siç më duket se ka ndodhë në poezinë *Magdalena*, në të cilën përballja me mashkullin shëndërrohet në një akt fizik, ku del në pah instikti, dhe ndjenjat e kundërta që i kundërvihen njëra-tjerës: Shenjtëria e Magdalenës në vargjet e para shëndërrohet paradoksalisht në të kundërt në ndonjë varg ma poshtë, kur i drejtohet mashkullit, (ose ndoshta organit të tij seksual): *Krejt forca jote asht ai çast që më ke zgjue bishën/ Drueje,/ jam përbindëshi që ti s’e njeh*. Loja me paradoksin apo gjuha e oksimoronit këtu krijon një gjendje kontradiktore etikisht por edhe estetikisht: *shenjtëri/ përbindësh*. Qenia që i shfaqë njëkohësisht edhe shenjtërinë edhe përbindshin na përfton një imazh të cënuem estetikisht dhe poetikisht. Mungon dashunia në këtë përplasje, ajo asht zëvendësue nga përplasia fizike dhe shqisore ku artikullohet egoizmi femnor i sundimit deri dhe i poshtnimit të seksit tjetër. Emni i heroinës ndoshta mund të krijonte në rastin ma fatlum edhe ndonjë analogji me emrin e personazhit biblik të Mari Magdalenës, por kjo nuk asht arritë me gjasë sepse Madgalena e poezisë sonë asht sinonimi i egos femnore dhe i dëshirës

për sundim. Pra, nuk ka ndodhë plotësisht ajo që duhet me ndodhë në poezitë me këtë temë sublimimi i libidos seksuale në art poetik.

Sigurisht kjo asht vetëm një sprovë leximi e këtij vëllimi poetik dhe siç dihet në art nuk mund të jepen receta, dhe në një lexim të dytë kjo sprovë mund të pozicionohet ma qartë mbi veçoritë artistike dhe kuptimore të këtij vëllimi poetik.

## In memoriam



### Fatmir JUKA

Ndoc **GURASHI** (1925-shkurt 2018)

Më pak se para një viti u nda këso jete një ndër të romantikët e palëkundur të pikturës realiste, piktori Ndoc Gurashi.

U lind dhe u rrit në familjen e njohur artëdashëse të Gurashëve. Shkodranët “e vjetër” sigurisht që kujtojnë të atin Kolë Gurashi si njohës i mirë i muzikës qytetare dhe si piktor me një talent të spikatur dhe me një kontribut të gjërë në jetën kulturore dhe civile të qytetit.

Duke i njohur këto dy fusha të arti dhe kulturës, ai ishte edhe etnograf. Të gjitha këtotribute të çmueshme e shtynë Kolën, që natyrshëm, të linte si trashëgim përveç të tjerave edhe librin e tij të pritur nga lexuesit, titullar: “Shkodra e baballarëve”.

Që në fëmijëri Ndoci shfaq prirjet e tij për vizatim dhe pikturë ku ndikim të madh pati edhe motra e tij Xhuzepina (Gurashi) Zadrime, e cila ishte në atë kohë nxënëse e Idromenos, si dhe një ndër të parat piktore femër në historinë e artit shkodran dhe shqiptar në tërësi. Shtëpia e Gurashëve sot, vijon të jetë dëshmi e Shkodrës se kahershme, e odës me oxhak prej së cilës morën frymëzim shumë artistë të hershëm e të rinj.

Në vitin 1937 fillon gjimnazin françeskan “Illyricum”. Në këtë institucion vizatimi bëhej nga Patër Leon Kabashi i sapo diplomuar në Akademinë e Arteve në Firence. Që prej këtu fillon seriozisht rritja e tij artistike duke i përforcuar mësimet nën vëmendjen e piktorit italian Prof. Lorenzo Kotura e mikut të tij, piktorit Vladimir Jani. Nga fundi i viteve '60 të shekullit të kaluar studioja e piktorit Ferdinand Paci që ishte kunati i tij, u bë shkollë e dytë për Ndocin.

Më 1959 paraqitet para publikut për herë të parë me dy piktura në gjininë e peisazhit, Nga ai miment u përfaqësua vazhdimisht në ekspozitat lokale e kombëtare. Jeta artistike e Ndocit pasurohet vazhdimisht. Ai kërkon bukurinë kudo.

Më 1974 hap tjetër ekspozitë me 20 punime të realizuara në qendër të Alpeve të Shqipërisë që u paraqitën para popullit dhe pushuesve të pikës turistike në Theth të Dukagjinit, për të vijuar edhe me dy të tjera në shkollat e mesme të qytetit.



Gjatë viteve '90 (shek. XX) kontakti i tij me publikun kapërcen kufijtë e Shqipërisë duke ekspozuar jashtë saj si në Bari (Itali) në “Santa Chiara” të Bischieles (1993) etj.

Që nga viti 1999 e këtej ishte pjesëmarrës në të gjitha aktivitetet që organizonte shoqata “Illyricum”. Moshë nuk e ndalonte, ndihej i ri.

Më 2002 mori pjesë në ekspozitën e organizuar në Galerinë “Shkodra”.

Më 2004 u paraqit para publikut në Ferizaj të Kosovës, dhe më 2005 promovoi CD-në e jetës së tij artistike.

Më 2004, Këshilli Bashkiak i Qytetit i dha titullin: “Mirënjohja e qytetit”.

Ndoci si piktor mund të përkufizohet si ndër romantikët e palëkundshëm të pikturës realiste, besnik i natyrës që nuk shpërndahet, por stoik i qëndron frymës së traditës. Piktura e tij ka qëndër dhe drita e ndjek atë, i shtruar, me një penelatë të qetë, i sigurtë në atë çka kërkon të japë në telajo prej modelit natyral, nuk mund t'i rrëshqasë dot natyrës së klasikëve si Idromeno, Rrota, Jani etj. Besnik i teknikës së vajit, endet mes peisazheve romantike plot dritë të fushave dhe alpeve e ndalet përmbi kurora lulesh të freskëta të natyrave të qeta.

Përmes gjinive të pikturës ai ka lëvruar dhe pllakatin ku u shqua për konceptimin e qartë të figurës e mesazhit në mënyrë globale.

Pikturimi akademik që respekton më besnikëri karakteret e modeleve e ndihmoi në ruajtjen e një trajtshmërisë të stilit adaxhio, që e dallonte atë nga piktorët e tjerë.

Adoxhio ashtu siç shëtiste çdo natë më Landin, zojën e vet. Do t'i takonin aty në Piacë, përherë thuajse në të njëjtin orar, mbështetur tek njëri-tjetri. Dhe më pas, me një buzëqeshje që i shkonte për shtat një dame shoqëruar nga kavaleri fisnik, do ndaheshe nga çifti me kapelen republika të ngritur. Buzëqeshja e gruas do të shoqërohej me fjalët e përhershme të shkodranëve të shkuar: “Nji mijë të mira i dashtun”.

E tani që të dy kaluan në amshim urimi ynë do të ishte: “Pushoni në Paqë nën hijen e Krijuesit”, miqtë tanë.

▪ **Personazhe** ▪

**Palokë Zef KURTI**

**PALOKË KOL KURTI**

*Muzikant, drejtues muzike dhe poet i spikatun*



Palokë Kurti, (1860-1920) i biri i Kolës dhe i Drandes u lind në Shkodër më 3 korrik 1880. Rrjedhte prej një familjeje të vorfën qytetare. Shpia ku lindi (lagja Ballabane) ishte përdhese<sup>117</sup>.

I ati u vra prej serbëve në Shtoj të Ulqinit kur ai ishte vetëm dy vjeç, tuj lanë të re gruen, nanën e Palokës, që e rriti mes vështirësive djalit e saj.

Në moshën 14-vjeçare, Paloka hyni si shegert në Pazar. Gëzimi ishte tepër i madh për familjen kur ai solli në shpi një simit të blemë me fitimin e parë. Puna e randë e kësaj moshe nuk ja theu vullnetin, por e forcoi atë. Mëson gjatë kësaj kohe të gjitha veglat frymore, tuj fillue nga bariton, tenor dhe nisi të shkruaj poezitë e para me përmbajtje patriotike.

Në moshën 18- vjeçare, më 1878 u bâ drejtues i bandës së parë shqiptare prej 40 vetësh, të cilët me entuziasëm dhe vullnet u banë jo vetëm instrumentistë të zotë, por edhe pionierë të çashtjes kombëtare.

Ketu zúni fill punimi i tij ma i vjetër “Bashkimi i Shqipnisë” marsh ký i mbushun plot me frýmëzim prej ideve kombëtare të Lidhjes së Prizrenit:

*Çova sytë në Rozafa*

*Përshendeta ato mure të vjetra*

*Të gjegjun mu ba se më dha*

*Orlesha ushtini në këthetra*

---

<sup>117</sup> Doreshkrim i lanë nga nipi i Palokë Kurtit, Palokë Zef Kurti. I shkruem në diktaturë, natyrshëm që mban tone të kohës.

Më 1901 zuni fill formacioni i bandës së Shkollës së Artizanatit nën drejtimin e tij që mes vështirësive të shumta, tuj kenë shpesh herë edhe i sulmuem me të padrejtë e mbajti këtë formacion deri më 1911.

Pikërisht në këtë vit merr pjesë me armë në dorë në luftën e Malcisë së Madhe, së bashku me të birin Zefin, që mori dy plagë tuj luftue.

Gjatë kësaj kohe formon korin prej 23 vetësh të Kishës Ortodokse (kjo e pasqyrueme në një dokument fotografik , ruajtë deri më sot).

Koncertet publike ishin për kohën momente të mirëprituna të jetës qytetare. Shpesh tingllimi kushtrues i bandës qe sinjali i grumbullimit dhe i përcjelljes së vullnetarevë për frontet e luftimit në mbrojtje të tokave shqiptare nga rreziku i huej. Nota dhe fjala lojshin të njëjtin rol:

*E s'kam zori për Shqipni*

*Që të gjithë juve ju dha i gj*

*Veni vesh pra e çilni sytë*

*E vraponju gjakut t'ndytë.*

Gjithmonë muzika e tij kishte për qëllim të ndizte shpirtin e bukur të bashkëqytetarit, të ndizte ndiesitë intime të masës së ndame simbas besimit, prandaj koncertet baheshin në Dërgut-pikë kufiri mes popullsisë katolike dhe muslimane - kjo për qëllime patriotike me ndezë dashuninë për një çështje të shenjtë, atë të bashkimit.

Krijimi dhe karakteri popullor e kombëtar i bandës, por edhe pjesëmarrja me armë në dorë në luftë kundër të huejit e detyrojnë atë me u strehu te miqtë e tij qytetarë e fshatarë.

Me ndihmën e shokëve fiton “faljen”; kthehet në qytet dhe hap një pijetore të vogël që u bâ qendër takimi dhe e lidhjeve ndërmjet patriotëve dhe luftëtarëve të malit kundër pushtuesit turk.

Nuk e ndërpreu veprimtarinë muzikore e poetike. Nisi të shkruiej marshe plot dashuni, mbështetë në karakterin popullor, që shpejt u bënë marshe të masës, si: “Bashkimi i Shqipnisë”, “Turqit në Maqedoni” etj. Turqit nuk e harruan e kapën dhe e dërguan në Diariheqir. Me këtë pësoi internimin e parë si shumë atdhetarë, me të cilët kishte bashkëpunuar në veprimtarinë e Degës së Lidhjes së Prizrenit.

Atje këndoi me vargje tingujt e mallit për Atdhe dhe familje. Pas shpalljes së Pavarësisë nën ndikimin e ideve të mëdha të kohës e të patriotëve të shquem, Hilë Mosi, Sali Nivica e më vonë Avni Rustemi, pranë shoqërive të ndryshme u ngritën dhe banda të tjera muzikore si ajo e

shoqërisë “Vllaznia”, më 1917. Drejtuesi i parë ishte prap Paloka, që gjithnji në veprim atdhetar mori anën e popullit, prandaj jo vetëm turqit, por edhe shkelësit e tjerë e ndoqën dhe e internuan.

Ashtë këtu internimi që i banë më 11 mars 1916, austriakët në Grosao të Austrisë. Me ftesën e Bajram Currit më 1918, shkoi në Gjakovë për me formu bandën e parë të këtij qyteti. Në kujtime shkruan:

*Lamtumirë mori Gjakovë*

*Lamtumirë nxansat e mi*

*Ket shej ju la provë*

*T'ma të madhen dashtuni.*

Francezët, me ta marrë pushtetin në Shkodër, e internuan në Korfuz. I dënuem për mos me qëndru në Shqipni, dhe aq më tepër në qytetin e lindjes mërgon në Itali.

60 vjeçar, i goditun nga të gjithë këto vuajtje, pa përkrahje.... vdes i shtymë në moshë, më 31.12.1920, natën e Vitit të Ri.

Qytetarët ndaluan kangët si në ditë zije. Të nesermen në funeral mori pjesë thuajse e gjithë Shkodra. Në mes të kurorave të shumta pati dhe nga ata të anës muslimane dhe ortodokse.

Ai nuk ishte vetëm muzikant, drejtues muzike, por edhe poet plot frymëzim për njeriun, për Atdheun. Vepra e tij poetike ka më tepër se 1500 vargje me përmbajtje të thjeshtë patriotike, luftarake dhe laike.

“Jeta e pasur dhe e pastër, ajo e Palokë Kurtit” (V. Bala “Drita , viti I, Nr.1.)

Vetëm pas Çlirimit të Atdheut, duke njohun veprimtarinë e tij muzikore të gjanë, karakterin e saj popullor, plot nota optimizmi për të ardhmen, karakterin e fortë dhe të qendrueshëm të një atdhetari, u njoh dhe ngrit vepra e tij që sot asht ba tashma e njohun për popullin tonë.

Muzika dhe kangët e Palokës ekzekutohen dhe këndohen nga kangëtarë profesionistë dhe amatorë, gjithshu edhe nga kangëtarë kosovarë , si: “Marshallah bukurisë sate”, “Në zaman të asaj furie”, “Për mu paska ken kismet”, “Nje këllef me ar ta çova”, “Shota e Shkodrës etj.

Për të gjitha çka trajtuem ma nalt janë të dokumentueme në dorëshkrime, kompozime e fotografi.

Shkroi nipi i tij Palokë Zef Kurti

**Fritz RADOVANI**

**TRIMI I MALEVE MARTIN SHELDIJA...**

*Një ndër legjendat e Maleve tona të Veriut ishte edhe ish-oficeri Martin Sheldija*

Di shumë pak për prejardhjen e tij, familjen dhe jetën e këtij Heroi të Shqipnisë. Koha po punon në drejtim të harresës së këtyne figurave të lavdishme, për mos me thanë atë që po ngjan në të vërtetë në Historinë e Popullit Shqiptar: “Shlymje e lavdisë së Tyne të perjetshme!”... Një ndihmesë të madhe në këtë drejtim po jep pa u kursye përditë shteti “monodemokratik”, i cili nuk u përzihet në “shkarravinat” e tyne “askujtë”, madje as “prof.dr. dhe akademikëve” falsifikatorë të historisë.

Kisha dëgjue vetëm se doktor Sheldija, mjek i nderuem në Shkodër, dhe i njoftun si i tillë, ka paë një vëlla aq trim ndër male, sa vetëm At Fishta do të kishte mujtë me tregue të vërtetën e jetës dhe të veprave të tij heroike.

Koha më solli një mundësi në vitin 1998. Kisha në dorë dosjen 1417 në arkivin e Ministrisë Mbrendshme në Tiranë: “Oficeri Martin Sheldija”, me origjinë familjare nga Sheldija e Shkodrës. Në vitin 1915 ka krye tre vjet në gjimnazin e Jezuitëve, mandej në 1917 ka krye një vit kurs ushtarak në Austri. Në vitin 1942 ka kenë në Çorovodë oficer me gradën toger në polici. Deri atëherë ishte mësues. Në prill e deri në korrik të vitit 1944 ishte Komandant i kazermave të Tiranës. Në muejin korrik vjen në Shkodër. Me 20 nandor 1944, bashkë me policin Gjon Ganjolla, shkojnë në Sheldi mbasi “*nuk do të vonojnë dhe do të zbarkojnë anglezët*”. Në Sheldi takohet me Kol Ashikun dhe bashkë me Shuk Gjokën dalin në mal me vazhdue rezistencën kundër komunistëve. Disa ditë kalojnë në shtëpinë e Shuk Nushit e Simon Kolës. Prej aty bashkohën me oficer Gjergj Vatën, Zef Mirashin, Don Alfons Trackin, Ndoc Jakovën, Zef Agostinin, Kol Mark Tomën etj.

Janë gati 20 vetë që jetojnë në një shpellë në Stenë, nën Kishën e Shllakut.

Ndër të pakët njerëz që kanë mbijetue nga ky grup heronjësh asht kenë edhe Loro Vata, i cili ka vdekë në vitin 1999. Fliste me respekt për burrneshen Palina, që u kishte çue bukë e duhan në shpellë, dhe po me aq nderim kujtonte sakrificën e Lena Prendushit, nusja e nipit të Palinës. Kjo, tregonte Loro Vata, na ka shpëtue jetën, se kishte vërejtë se jemi të rrethuem, e kishte thirrë me gjithë forcën e zanit të saj: “Dilni burra, se ju kapën!”.

Duhet theksue se në Malet e Shllakut, nuk kujtohet asnjë tradhëti nga vendasit.

Martini, bashkë me Gjergj Vatën (me pseudonimin “Cukali”), përpilojnë një letër të cilën e përsërisin prap më 4 janar 1946, por me ton ma të fortë. Këtë herë në drejtim të Don Shtjefën Kurtit, po në Tiranë, për misionet e hueja atje, ku ndër të tjera shkruajnë:

*“... tue mos dashtë me iu shtrve terrorit të Enver Hoxhës, kemi marrë malet.*

*Na do të vazhdojmë përpjekjet për liri.*

*... t'arratisunit e Veriut, të organizuem në çeta për t'i dhanë grushtat e fundit qeverisë terroriste, që si këte nuk njofti historia.”* Martini vazhdon rezistencën ndër male deri në vitin 1949. Me datën 12 mars 1949, mbas shpalljes së amnistisë “Për faljen e jetës së atyne personave që dorëzohen”, ai dorëzohet dhe i shtrohet hetimeve. Ai deklaron: “Mbas vrasjes së Gjergj Vatës nga Prelë Nika, edhe ky i arratisun dhe i ardhun diversant nga Jugosllavia për këtë qëllim, humba çdo shpresë për me vazhdue me qëndrue ndër male. Trathtia e vrasjes së Ludovik Saraçit më 11 janar 1948, tek Përroji i Gjadrit, *më dha me kuptue se asnjë ndërhyrje nga jashtë nuk ka ndër mend me u ba në Shqipni.*

*Të gjithë ata që na premtuen, vetëm na rrejtën, mbasi në një mënyrë apo në një tjetër, ata e lanë me u forcue rregjimin e Enver Hoxhës, tue vra e zhdukë të gjithë kundërshtarët që ishim ndër male. Kështu që e pashë se ishte kot me vazhdue ...”*

“... Shaban Abdullahi e Zyber Hysejni nga Rragami, na kanë njoftue për Lëvizjen e Postribës. Ata ishin në Rragam e Kryethi, Tish Pashuku në Sheldi, Shuk Gjoka në Ganjollë, Spathar e Juban. Jemi mbledhë në Juban, kemi ra nga livadhet e Shaban Matit dhe jemi nisë me i ra Shkodrës bashkë me Pjetër Dedën, që ishte në mal bashkë me gruen e tij. Tek Ura e Kirit kemi shkrepë pushkët, e pamë se nuk asht gjâ dhe kemi ikë edhe njëherë andej...Unë lajmin për me sulmue Shkodrën e kam marrë më 8 shtator 1946”.

“Luftën e Postribës e ka fillue Seit Duli te fusha e aeroplanave...”

“Nuk mbaj mend ku jemi përpjekë me forcat e Ndjekjes, mbasi janë kenë të shumta, as nuk di ke kemi vra, mbasi shpesh përpjekjet baheshin natën. Mbasi prante pushka, nuk rrinim me pa të vramit, por çanim rrethimin dhe ndrronim vend, mbasi Ndjekja shtonte forcat kundër nesh.

*“Na kemi luftue kundër jush, mbasi për mue ju jeni shtet terrorist.”*

Kështu, deklaroi Martin trimi në hetuesi.

Më 4 tetor 1949, Gjykata e Naltë Ushtarake e Tiranës me kryetar nën/kol. Bilbil Klosin, aprovon vendimin për Martin Sheldinë “me dënim të përjetshëm në burg”.

Ministri i Mbrendshëm atëherë Mehmet Shehu shënon:

“... t’i jepët dënimi i përjetëshëm edhe pse nuk e parashikon neni 28.

*Të aplikohet tek 32, mbasi duhej me vdekje.*

*Martin Sheldija ka rrezikshmëri shoqërore shumë të theksuar.”*

Tiranë, 29 qershor 1949.           Ministri i Mbrendshëm (Mehmet Shehu) d.v.

Ky motivacion i kriminelit Mehmet Shehu, që nuk zbaton ligjin e amnistisë, tue e dijtë mirë se neni 28 nuk e parashikonte këtë dënim, kërkon aplikimin e nenit 32, *mbasi duhej me vdekje*, vendim i cili e ndjekë fatkeqin Martin Sheldija gjithë jetën.

Martin Sheldija dërgohet në burgun famëq të Burrelit. Atje ai kaloi gjithë dënimin mbasi dosja ka edhe datën e lirimit nga ai burg: *Burrel, 14 shkurt 1966*.

Dosja e Martinit, e këtij martiri që mbijetoi për aq shumë vite në një ndër burgjet ma të mnershme të diktaturës komuniste, asht shembull i qëndresës së patundun të këtij atdhetari, që për aq kohë të gjatë nuk bani asnjë lutje për lirim të parakohshëm.

\*\*\*

Asht e vërtetë se ka pasë shumë burra si Martin Sheldija, por ka pak e aspak nga ata që duhet të kërkojnë me kujtue me nderim shokët e Trimit të Maleve, Martin Sheldija.

Fatkeqësisht po harrohen *Burrat e Herojtë!* Ua kanë zanë vendin tradhëtarët që kerkojnë me njollosë historinë e shqiptarëve.

Anglezi *A.Glen*, shkruen: “*Ato që i përcaktuan ngjarjet kanë qenë armët që iu dhanë E. Hoxhës, e partizanëve... Ne bëmë shumë pak me ua shpërblye besnikërinë miqëve tanë (nacionalistëve e Abaz Kupit). Në vend të kësaj, pa qenë nevoja na lejuam që ata të mundeshin e disa, të tradhëtoheshin.*” (“*Albania’s National Liberation Struggle*” fq. 363).

## SKËNDER TEMALI

### VEHBI BALA – NJE ZË I VEÇANTË NË KULTURËN SHQIPTARE

Nuk qenka dhe aq e lehtë të shkruash për një njeri me të cilin ke ndejtë e bisedue kushedi sa herë ndër vite dhe, kur ai është larguar nga kjo botë, e ke kuptuar se nuk paske arritë ta njohësh. E kam fjalën për Vehbi Balën, njeriun, profesorin, poetin, studiuesin, mbi të gjitha, Njeriun.

Jam njohur me profesor Vehbiun kur unë isha një letrar i ri gjimnazist dhe ai kryetar i degës së lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shkodrës. Që në takimin e parë e kuptova se mbi të gjitha ai ishte njeri në kuptimin e vërtetë të fjalës. Ia pata dhënë me ndrojtjen e fillestarit disa poezi që të m'i lexonte dhe të më jepte mendim nëse ia vlenin apo jo për t'i dërguar në ndonjë organ letrar. E takova rastësisht në rrugë, shikoi orën, tha "po" me vete dhe më mori për krahu e më futi diku në një klub të piacës së Shkodrës. Ndofta tek "Bar imperio". Impresioni im që po rrija në një kafe me të ishte i madh dhe ai u rrit edhe më shumë kur nisi të flasë për poezitë e mia. Qenë fjalë zemre. Të thjeshta, të qarta, të kuptueshme, inkurajuese. Kisha nevojë për to. I nxorri nga çanta dhe m'i ktheu. Aty-këtu kishte bërë ndonjë shënim, ndonjë redaktim.

Thellësinë e thjeshtësinë e një njeriu të mirë nuk e sheh vetëm në një rast. Rast pas rasti jo vetëm unë, por edhe plot vërsnikë të mi krijues, e ndjenin përkujdesjen e tij. Madje ajo i kalonte edhe kufinj të detyrimit që ai kishte ndaj nesh, si kryetar dege shkrimtarësh që ishte për të mbajtur afër e nxitur talentet e rinj. E ku ta dija unë asokohe se Vehbi Bala, kur kishte punuar në gjimnazin "Asim Zeneli" të Gjirokastrës, si mësues letërsie i sapo diplomuar në Rumani, në rrethin letrar të asaj shkolle kishte afruar nxënësit e tij më të talentuar si Dritëro Agollin, Ismail Kadarenë e të tjerë, që shpejt do të bëheshin zëra të përveçëm të letërsisë shqipe.

Qershor 1964. Takohem me profesorin në shkallët e Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës. "Oh, sa mirë që të pashë, – më thotë. – Urime për hartimin! E lexova tek "Mësuesi". Të lumtë!".

Sapo kisha dhënë provimin me shkrim të letërsisë në maturë. Hartimi im që vlerësuar dhe pas dy ditësh gazeta "Mësuesi" kishte botuar një pjesë të tij.

Por hartimi mund të botohej në gazetën "Mësuesi", organ i ministrisë së arsimit të kohës dhe të ndodhte absurdi, që të drejtën e studimit për në universitet po kjo ministri të ma nxirrte jo



për letërsi, madje as në fakultetin filologjik të Tiranës, por në Ekonomik, edhe pse në shkencat e natyrës si nxënës nuk kisha pasë kurrfarë shkëlqimi, madje isha nxënës nënmesatar.

U trondita sa s'ka! Ngaqë s'kisha miq që të ma ndrronin degën, mora nga shtëpia e profesor Vehbiut. "Si dreqin, – tha me atë ngurrimin që kishte hera-herës në të folur, ndofta më të theksuar kur diçka nuk shkonte. "Si dreqin e kanë bërë këtë?!", përsëriti. Më vuri dorën në sup dhe më tha: "Mos u mërzit, do ta rregullojmë, ti do të shkosh të studiosh për letërsi. Nesër nisim në Tiranë. Unë po të jap një letër për zëvendësministrin e arsimit, Bedri Dedjen e do t'ia çosh. Sonte, e shumta deri nesër në mëngjes, pa mbriritë ti në Tiranë, unë do të lidhem në telefon me të...Ai është shkrimtar dhe do të na kuptojë. Ka për të na ndihmuar".

Ngjarjet ndodhën ashtu siç profesor Vehbiu kishte menduar, shpirti i tij njerëzor e poetik gjeti të njëjtin akord me atë të Bedri Dedjes, një tjetër njeri i mirë i kulturës shqiptare.

Më pas, kontaktet e mia me profesor Vehbiun kanë qenë më të shpeshta, por gjithnjë përmes një respekti të ndërsjelltë, aq sa më dukej pak që në 50-vjetorin e ditëlindjes së tij, që ne shkrimtarët e artistët shkodranë ia patëm festuar në shtëpinë e kulturës e të krijimtarisë popullore, unë nuk diskutova për vlerat e Vehbi Balës si krijues, por recitova një poezi që ia kushtova atij, me titullin "Monologu i Vehbi Balës në 50-vjetorin e lindjes", të cilën, natyrisht e kam të plotë dhe e kam ruajtur, ashtu siç e kishte ruajtur në kujtesë edhe poeti Visar Zhiti, asokohe student në Shkodër, që ma përmendi kur u takuam pas gati tri dekadash. Po sjell për lexuesit strofën e fundit:

*"Eh, çdo desha unë kësaj nate,*

*Kur dritë e shpirtit zë e flet:*

*Në çdo hap që të hedh në jetë*

*Të jem ky që jam: njeri dhe poet!"*

Shkodra, në veçanti dhe kultura shqiptare, në përgjithësi, e kanë të fiksuar në memorien e tyre historike figurën komplekse të Vehbi Balës: atë të antifashistit, të poetit me shpirt të ndjeshëm, më shumë lirik se sa epik, të autorit të disa monografive për figurat më të spikatura të kulturës shqiptare të Rilindjes e të Pavarësisë, të historianit e të studiuesit të letërsisë shqipe, si autor e bashkëautor në shumë tekste mësimore të arsimit të mesëm e të lartë, si një nga themeluesit e arsimit të lartë në Shqipëri, të Institutit të Lartë 2-vjeçar në Tiranë e më pas, më 1957 të Institutit Pedagogjik në Shkodër, duke drejtuar për disa vite katedrën e gjuhës shqipe e të

letërsisë tok me emra të tjerë të ndritur të arsimit e të shkencës shqiptare si Jup Kastrati, Kolë Kamsi, Kolë Ashta, Fadil Podgorica, Neki Lezha etj.

Unë, si krijues, e çmoj Vehbi Balën për thjeshtësinë e brishtësinë e ndjenjës poetike që nga vëllimi i parë i tij "Shtigje drite", botuar në vitin 1946 e deri tek "Përsiatje" e "Vallja e luleve", e botuar katër dekada pas vëllimit të parë. T'i rezistosh poezisë deri në moshën e tretë, madje poezisë lirike, është shprehje e një shpirti të ndjeshëm, të një bote që ka hapsira rudine me lule gjithfaqsh poetike, të një poeti melankolik e vizionar, herë përfaqësues besnik i traditës poetike e herë modern në figuracion.

Kam ndejtë kushedi sa herë me profesor Balën, sidomos kur isha redaktor në Radio Shkodra e në gazetën "Jeta e re", por asnjëherë nuk ishte mburrur për kontributin që kishte dhënë në shtypin ilegal e sidomos në atë letrar gjatë luftës kundër nazifashistëve, edhe pse mua për profesionin që ushtroja e emisionet e rubrikat që përgatisja tema e episode nga ajo periudhe më interesonin e më kërkoheshin për pasqyrim, ndaj edhe me të drejtë studiuesi i huaj Robert Elsie, në veprën e tij "Historia e letërsisë shqiptare" (fq.327) "ndër shumë poetë para ardhjes në pushtet të komunistëve, krahas Kristaq Cepës, Vedat Kokonës, Petro Markos, etj., rendit edhe Vehbi Balën".

Tani atë e gjejmë në enciklopeditë e vlerave të mirëfillta, siç është "Fjalori enciklopedik" i vitit 2002 (*Shtëpia Botuese "Baechus", Tiranë, fq.65*) e po kështu me foto e tekst edhe tek "Fjalori enciklopedik" i gazetarëve e publicistëve shqiptarë (*Botim i Entit Botues "Gjergj Fishta", 2005*).

Mes gjithë botimeve për të vjen e konfigurohet portreti i profesor Balës: që në Gjimnazin e Shtetit në Shkodër ai fillon të shkruajë e të botojë. Nisi studimet e larta në Universitetin e Barit (1943), por i ndërpreu dhe mori pjesë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në vendlindje. Pas luftës, studioi në degën e filozofisë në Universitetin e Zagrebit (1946-48) dhe vijoi e përfundoi studimet në degën e gjuhëve dhe letërsive neolatine në Universitetin e Bukureshtit në vitet 1948-1952.

U shfaq si poet me 8 vëllime. Veçanërisht pati jehonë poezia e tij "*Doli nana në çardak*", e përfshirë në mjaft antologji dhe e muzikuar nga Çesk Zadeja. Fëmijët e kohës domosdo nuk kanë se si ta harrojnë për krijimet që u adresoi atyre. Monografitë për Elena Gjickën, Pashko Vasën, Nolin, Migjenin e Viktor Eftimiun. Vehbi Balës nuk i duhet anashkuar edhe një meritë gjatë periudhës së sistemit të kaluar : mbase ndër të parët e të vetmit krijues hulumtoi që në vitin

1961 mbi vlerat e poetit tonë të madh, por të anatemuar e të ndaluar, Gjergj Fishta, shtroi « trasenë » e një monografie me shpresën se do ta botonte si vepër, e cila u arrit të shihte dritën e botimit vetëm pas vdekjes së Vehbi Balës, në vitin 1998. Kontributi i tij spikat edhe në studimin e marrëdhënieve shqiptaro-rumune e në përkthimet nga letërsia rumune, ku i solli si pakush lexuesit të kohës portretin poetik të Emineskut.

Qe me titull profesor, i lauruar me çmimin e Republikës së shkallës së parë, por mbi të gjitha qe njeri i klasit të "zotnive" të Shkodrës. Vënia tani e një rruge të qytetit me emrin "Vehbi Bala" duhet çmuar, edhe pse të një rrugëze, por them se është ende pak për gjurmën e pashlyeshme që ai ka lënë në kulturën shqiptare.

## •Bibliofili•

Fatmira LEKIQI

### NJË VËSHTRIM BIBLIOGRAFIK MBI VEPRËN E FRANG BARDHIT

Në çdo kulturë flitet dendur për “ngjarje” në rastin e botimit të librave, pa qenë të sigurtë se sa jetëgjatë do të jenë ata nga njëra anë, si dhe sa të mirëpritur mund të kenë qenë ata, nga tjetra, shkruan studiuesi A. Plasari<sup>118</sup>.

Në rastin konkret, meqë librat janë të njërit nga pesë autorët më të vjetër të gjuhës por edhe letërsisë shqipe; meqënëse ata lindën në rrethana të vështira të shekullit XVII, por edhe me një ambient të brendshëm, të pakulturuar, (*përkundrazi që përpiqeshin ta kulturonin, edhe shtresën më të ditur të kohës, shërbëtorët e grigjës, priftërinjtë*), për librat duhet thënë se jetëgjatësia e tyre, por edhe mirëpritja janë të lidhura me bibliotekat, vendet e ruajtjes të trashigimisë së vyer kulturore të kombeve të ndryshme përgjatë shekujve.

Para se librat të përdoren dhe/ose të studiohen, duhet të dihet që ata ekzistojnë: ky është parimi lëvizës që shërben si shtysë në vlerësimin e çdo biblioteke<sup>119</sup>.

*“Librat për libra – vijon A. Plasari- janë të kushtueshëm nga pikpamja e investimit intelektual, shkencor dhe kohor, përkatësisht financiar, duke qenë njëherësh ky investim që i bën ata bartës vlerash të pamohueshme”*<sup>120</sup>.

I tillë ishte edhe kalvari i botimit të librave të F. Bardhit, i pasqyruar saktë nga njohësit e jetës së tij, si M. Roques, S. Riza, J. Rrota, I. Zamputi, E. Çabej, F. Fishta, Ë. Kamsi, B. Demiraj etj., kalvar që ndahej mes jetës meshtarake dhe njeriut diturak, që duhej të kapërcente pengesa të panumërtat të të tijve, pushtuesit turk, por edhe të hierarkisë kishtare. Të mos harrojmë se *“Fjalori.....” para se të botohej mori aprovimin e Mark Skurës, “Episcopos Stephanensis”*<sup>121</sup> (*Ipushkëv i Arbërit*) dhe më vonë atë të Kardinalëve të Kongregacionit Propaganda Fide<sup>122</sup>.

Librat e Frang Bardhit:

*Shqipërimet e dorëshkruar të kredos dhe të ritualit.*

*Relacionet italisht (1637, 1638, 1641), të përkthyer nga I.Zamputi.*

<sup>118</sup> Plasari, Aurel. *Parathanie e botimit, Libri shqip 1555-1912*. Tiranë, Biblioteka Kombetare, 2010, f. 11.

<sup>119</sup> *Po ai, po aty.*

<sup>120</sup> *Po ai, po aty.*

<sup>121</sup> Roques, Mario. *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera*. Shkodër: Botime Françeskane, 2011. f.91

<sup>122</sup> *Po aty, f.92.*

*Apologjia latinisht mbi origjinën e Skënderbeut, kunder tezës së Jan Tomkut, mbi orgjinën boshnjake te Skënderbeut. Rome 1632. Margnaviceve (slave ) me titullin e saktë:*

*Gjergj Kastrioti Epirotasi, popullorçe Skënderbeu, trimi me fletë dhe i pathyeshëm, prind i epirotasve-ridhënë të vetvet dhe atdheut”.*

*“Dictionarium Latino-Epiroticum una cum nonnullis usitatoribus loquendi formulis”(Fjalor latinisht-shqip bashkë me disa mënyra shprehjesh që përdoren shpesh, hartuar nga Frang Bardhi epirot, ... Romë 1635) <sup>123</sup>(30 maj 1635)*

*“Fjalori latinisht-shqip”, cilësohet si vepra më e rëndësishme e Frang Bardhi, pasi është leksiku i parë i gjuhës shqipe, i hartuar nga një shqiptar, që sipas. K. Ashtës nga 2544 fjalë shqipe të fjalorit , afro 1300 janë të brumit vëndas<sup>124</sup>.*

Mario Roques, zbuluesi dhe njohësi më i mirë të veprës së F. Bardhi na sqaron se ajo lindi “... në trysninë e e italishtes dhe të turqishtes, ndoshta për njerëzit e dijtun, dhe nën ndikimin e latinishtes, pasi leksiku i shqipes (së Veriut) po humbte pastërtinë e vet... , dhe do të shërbente me shkrue shqip, vepra të dobishme për përhapjen e fesë. Po duhet sidomos të mënjanojë gabimet dhe shpërdorimet ndaj të cilat, madje, asht shumë rrezik kleri shqiptar, për arsye të padijes së gjuhës latine<sup>125</sup> . 113 fjalë të urta, të mbledhuara nga Frang Bardhi dhe të vendosuara në fund të librit, e bëjnë atë edhe nismëtar të folkloristikës sonë<sup>126</sup>.

Për kah rëndësia në krijimtarinë e F. Bardhit nuk mund të lihen pas dore edhe trajtesat e tjera, historike, fetare dhe folklorike të pasqyruara në relacionet, e tri vizitave baritore<sup>127</sup> të krahinave të Pukës, të përfshira në Dioqezat e Sapë-Zadrimës dhe të Pultit.

Nese thellohemi në studimet e bëra mbi veprat e F. Bardhit nga autorë të fushës, mund të arrihet në këtë konkluzion, se këto vepra janë pjesë e trashigimisë më të vyer të dokumentave shqipe, por fatkeqësisht, bazuar në kohën kur lindën shek. XVI-XVII, nuk na rezultojnë se do të kenë patur ndonjë ndikim të madh kulturor në vend. Kjo lidhet me injorancën kulturore të

---

<sup>123</sup> Pepa, Simon. Kontributi i klerik katolik në leksikografine shqiptare. Në: Krishtërimi ndër shekuj, Tirane, 2000, f. 447.

<sup>124</sup> Po ai. Po aty.

<sup>125</sup> Roques, Mario. Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera. Shkodër, Botime Françeskane, 2011. f. 92

<sup>126</sup> Pepa, Simon. Kontributi i klerik katolik në leksikografine shqiptare. Në: Krishtërimi ndër shekuj: Tiranë, 2000, f. 448.

<sup>127</sup> Shënim. Relacioni i parë 1637, “Puka dhe pukjanët, Relacioni i dytë (1638) “Pulti dhe malësorët”, Relacioni i tretë (1641) “Zadrima dhe zadrimorët”.

popullsisë vendase, që rridhte edhe nga pamundësia zhvillimit të kulturës (sidomos e gjuhës) gjatë regjimit turk, e aq më tepër që autorët e këtyre veprave ishin prelatë katolikë të Veriut.

Këtë e vërteton edhe fakti se në rrjedhë të shekujve as që dihej ekzistenca e tyre. Ndër vite hulumtues të ndryshëm, por edhe bibliografë kanë ndjekur, siç shkruante A. Plasari, odisenë e botimeve<sup>128</sup>, humbjes, gjetjes, rihumbjes, rigjetjes e kështu me radhë.

Fatmirësisht, siç ndodh rëndom edhe në ditët e sotme në Shqipëri, do të ishin të huaj që do të iniconin një proces kërkimi të dokumentave të shqipes, të shpërndarë në biblioteka të ndryshme, nisur më tepër nga kërkëria për këtë vend, dhe nga interesat shkencore në kuadër të popujve ballkanikë, në përpjekje për të zbuluar identitetin kombëtar të popullit tonë.

Natyrisht që në kohët moderne pati një interes të shtuar edhe nga studiuesit shqiptarë ku mund të veçojmë F. Konicën, Mehdi Frashërin etj., por pa mohuar kontributin e veçantë të studiuesit frëng, Mario Roques, i përkrahur edhe J. Rrota, që “... bante një përpjekje organike<sup>129</sup> për të paraqitë kjahtë e sa ma të plotë si në pikpamje kronologjike dhe bibliografike, krejt një plejadë autorësh të vjetër”<sup>130</sup>.

Mario Roques zbuloi dhe ribotoi “*Fjalorin.... Shqip*” të F.Bardhit, në shtesat introductive pranë fjalorthit të Arnold Von Harff dhe e pajisi me një hyrje prej 48 faqesh<sup>131</sup>. Krahas Fjalorit, M. Roques u fali studimeve shqiptare edhe vëllimin tjetër “*Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe*”<sup>132</sup> që Filip Fishta, e cilësonte si fillesë të një “*Corpusi*” të dokumentave të hershëm të shqipes, të zbuluara në biblioteka dhe arkiva të Italisë, pas konsultimeve të bëra me specialistë të fushave, bibliotekare por edhe paleografë. M.Roques i njihet merita e zbulimit të dokumentave gjuhësorë, si bie fjala: “*Dokumenti i Ambrosiana-s*” së Milanit në kërkim të të dhënave të reja historike dhe letrare mbi L. Matrangën (1592); në bibliotekën Vatikanit zbuloi veprën e P. Budit dhe lajmëroi i pari tri veprat, botim i parë i “*Doktrina e Kishterë*” (1618), “*Rituali romak*” (Rituale Romanum), (1621) dhe *Shpjegimin e Meshës Shejte*, të po atij viti. I njëjti autor zbuloi në arkivat e Propagandës dhe të Vatikanit edhe “*Fjalorthin italisht- shqip*” të vitit 1633 të Pjetër Mazrrekut<sup>133</sup>.

---

<sup>128</sup> Plasari, Aurel. *Parathanie e botimit “Libri shqip 1555-1912”*. Tiranë, Biblioteka Kombetare, 2010, f. 11.

<sup>129</sup> *Recherches sur les anciens texts albanais, dhe Le dictionnaire albanais de 1635 edite avec introduction et index complete par Mario Roques.*

<sup>130</sup> Roques, Mario. *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera*. Shkodër: Botime Françeskane, 2011. f.5

<sup>131</sup> Fishta, Filip në: *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera*. Shkodër: Botime Françeskane, 2011. f.12.

<sup>132</sup> *Po aty*, f.11.

<sup>133</sup> *Po aty*, f.12

Diku më lart u përmend odiseja e librave, ndërsa në fillimet shekullit XX, ata do të publikoheshin pjesë-pjesë apo edhe do të studioheshin në tërësi, apo edhe në pjesë të veçanta në fletoret “Albania”, “Përparimi”, “Hylli i Dritës”, “Leka” nga personalitete të shkencave filologjike të kohës mes të cilëve Ndre Mjeda dhe Justin Rrota. Këto libra nga mesi i shekulli të kaluar, fatkeqësisht për një periudhë të gjatë 50–vjeçare, “hupën si kripa në ujë”, për publikun e gjerë të studiuesve duke u bërë vetëm prona të instituteve shkencore. Për studiuesit e interesuar ata ishin përsëri të humbura. Më të drejtë A. Plasari këtë moment e cilëson si histori më vete, vështirësi të pakuptueshme të kohës, të regjimeve tanimë të lëna mbrapa, të kushteve në përgjithësi, përfshirë pengime, shtërngime etj.<sup>134</sup>

Kultura shqiptare duhet t’i dedikojë mirënjohjen më të thellë bibliotekave dhe veçanërisht bibliotekave të Shkodrës, së pari atyre të enteve fetare, muslimane dhe katolike (françeskanë dhe jezuitë), por edhe pasionit të sa e sa individëve të kulturuar, që arritën të hulumtonin, grumbullonin, por edhe ruanin këto vlera të rralla dhe të pazëvendësueshme të kulturës sonë kombëtare.

Njihej pasioni i Atë Gjergj Fishtës, në blerjen e librave të rallë për Shqipërinë, që mund t’i ndeshte në vizitat që bënte jashtë vendit .

“... sa herë ju paraqitte mundësia ekonomike shetite libraritë e antikuariatit, kudo që gjëndeje nëpër botë, për me ble libra të rallë e të çmueshëm, nga përmbajtja po ashtu edhe nga vjetërsia, si dhe në pikpamje artistike e të gjitha për pasunimin e krijesës së vet , Bibliotekës Francëskane. Blete libra, riprodursione arkitekturet e piktoret auktorësh të vjetër me famë se dikuj kanë me vjeftë ndinji here si aspiracion”<sup>135</sup>.

Frymëzimi i shtyu edhe klerikë të tjerë të formonin rrjetin e bibliotekave të tyre të famshme, i shtyu drejt hulumtimeve të reja të dokumentave të shqipes. Mjafton të kujtojmë Atë Justin Rrotën që solli së pari të fotografuar më 1929, në Shqipëri “Mesharin”, apo edhe jezuitët Fulvio Kordinjanon e Atë Zef Valentinin. Ky personalitet shkencor gjurmoi shumë vite në arkiva dhe biblioteka duke na lënë pas vepra madhore, thuajse në çdo fushë të shkencave filologjike, përfshirë kryeveprën 30 vëllimshe “Akte shqiptaro – venete të shekullit XIV-XV”<sup>136</sup> etj., vepra historike, të së drejtës zakonore etj.

<sup>134</sup> Plasari, Aurel. Parathanie e botimit Libri shqip 1555-1912. Tiranë, Biblioteka Kombetare, 2010, ff 11-12..

<sup>135</sup> Kamsi, Willy. Atë Gjergj Fishta për kulturën shqiptare. “Hylli i Dritës”. Numer i posaçëm.

<sup>136</sup> Vepra I. 2005, f.13.

Rrugë e gjatë dhe vështirë u desh për mbrojtjen e trashigimisë kulturore të vendosuna në bibliotekat e famshme të Shkodrës. Shumë dëshmi janë dhënë për valën shkatërrimtare që përfshiu të gjitha bibliotekat, veçanërisht ata të enteve fetare. Duhet të lexosh Atë Zef Pllumin, për të kuptuar kalvarin që pësuan bibliotekat. Në fillim të viteve 1945, nga një ekip njerëzish të ardhur nga Tirana u muar një listë librash të autorëve të vjetër të traditës, ndërsa me *fillimin e viteve 1946 u thyen dyer dhe u plaçkitën pa farë kriteri*<sup>137</sup>.

Por gjithsesi shikimi me vëmendje i asaj që ka ngjarë, të lë të kuptosh që edhe në radhët e çlirimtarëve ka patur njerëz, të mençur që ditën të ruanin pjesën më të madhe të trashigimisë. Ndryshe nuk kish si të ndodhte që në ditët e sotme në bibliotekën e Shkodrës, por edhe në atë Kombëtare ndodhen këto libra, që qartazi mbajnë vulën e institucioneve fetare nga kanë ardhur. Në bibliotekën e Shkodrës kemi shqyrtuar dhe kemi ndarë një sërë librash që janë libra përdorimi, pjesë të bibliotekave të Fishtës dhe Gjeçovit, por edhe të klerikëve të tjerë. Po kështu mund të kenë qenë edhe libra të institucioneve islame, por tanimë ata i janë kthyer Myftinisë dhe nuk mund të kemi ide të sakta.

Sa i takon veprave të Frang Bardhit, duhet theksuar se origjinalet nuk ndodhen në Shkodër. E vetmja kopje e “*Fjalorit* ..... “ gjendet në Tiranë, në B.K. Ajo ka shënime të shkruara me dorë pothuajse në të gjitha faqet dhe mban vulën e “Collegium S. Francisci Xavri Scodra”. Besoj se nuk ka nevojë për koment, pasi vjen nga Shkodra, dhe i takon bibliotekës së jezuitëve, përdoruesve të parë të një alfabeti me shkonja shqipe<sup>138</sup>.

Siç del nga hulumtuesit dhe bibliografët, ndonëse me këtë vepër nis botimi i 35 titujve të librave të shtypura dhe botuara nga shtypshkonja e Propaganda Fides, numri i kopjeve të këtij libri është shumë i kufizuar, pasi për shkaqe të ndryshme ai asnjëherë nuk pau më dritën e ribotimeve, ashtu si librat e tjerë të autorëve të vjetër shqiptarë shqiptarë që u ribotuan disa herë nga kjo shtypshkronjë. Sot libri gjindet në biblioteka të ndryshme, në Bibliotekën Nacionale të Parisit, në biblioteka të Gjeneves dhe në Londër.

Të fotokopjuara librat e Frang Bardhit, “*Apologjia e Skënderbeut*” dhe “*Fjalori*... “ sot në Shkodër ndodhen në Bibliotekën e Françeskanëve. Në ditët tona “*Fjalori*...” është ribotuar nga Ë. Kamsi i përfshirë në tekstin: “*Gjurmime mbi tekstet e vjetra* “dhe nga Bardhyl Demiraj me titullin: “*Fjalori*...” .

<sup>137</sup> Pllumi, Zef. *Histori kurr e tregueme*. Tiranë, 2006. f.43.

<sup>138</sup> Vozga, Ramaza. *Libri shqip 1555-1912*. Tiranë, Biblioteka Kombetare, 2010, f. 76.



**Stela KARAFILI**

**BIBLIOGRAFI E PUNIMEVE TË LLUKA KARAFILIT.**

( Vizion nga numri 9, f. 20)

*(Mâ poshtë po rendisim ashtu siç i kâ lanë vetë autori bibliografinë e shkrimeve të botueme dhe atyne të pabotueme me renditjen qâ ka bân vetë autori dhe të afërmit e tij mbas vdekjes)*

1. Dëshirë e dashurisë- libër me vjersha e të tjera faqe. Shtypshkronja “Korçë”, 1912. Faqe 48.
2. Shënime Kombëtare- Historija e Toskërisë. Haonija e moçme në Istori të Epirit.  
“Kalendari Korça”, 1913. Faqe 9.
3. Giuseppe Le Jacene - Le prime parole e i primi pensieri nella ligue Italiana e Albanese – Të parët fjalë dhe të parët mendime në gjuhët Italishte dhe Shqipe, G.B. Paravia & C,1919, në Italië. Gjithë ushtrimet u përkthyen prej meje në gjuhën shqipe dhe këte e ka shënuar edhe autori vetë, në parathënine të tij në libër.
4. Histor’i e Shqipërisë-Pjes’e dytë (Hepiri), Shtypshkronja “Vlora”, 1921. Faqe77
- 5.Lulishtja Djelmërorë Pjes’e Parë Abetare Radh’e Parë, Shtypshkronja “Albania” të Kontancës (Rumani), “pa. vt.”. Faqe 48.
6. Vlora në pikpamje Historike – Një shkurtim i historisë së moçme të Vlorës e shtypur në Fletoren “Populli” në Vlorë, 1913. (Nuk kam, kopjen e Dorëshkrimit dhe fletoren që të shënoj faqet dhe masën e saj, vetëm se sa do të jetë nja 10 faqe dorëshkrim- shën i S.Karafili)
7. Dissa shënime historike mbi gjuhën shqipe e shtypur në fletoren “Mbrojtja Kombëtare” të Vlorës.
8. Shëmbëlla Patriotizmi – Timoklea Thivjania dhe Shpirtë madhësija e Lekës së Math,  
Gazeta Shqiptare të Barit. Faqe 4.
9. Martesa e Timerlahut ,”Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 6
10. Profesor Arturo Galanti ,”Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 3
11. Bernardino Arciprete Bilotta, “Gazeta Shqiptare” e Barit. Faqe 4
12. Ankimet e nje të vdekuri, Gazeta Shqiptare, e Barit. Faqe 5.
13. Fundi i Vjershëtarit të Hainit, “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 2
14. Vjershëtori Lamertin dhe Turqit, “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 2
15. Studime-Kategorizimi i mësuesvet, “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 4
16. Çështja femërore në Shqipëri, “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 6
17. Randësija e rinisë, “Gazeta Shqiptare”, e Barit.
18. Studime historike- Aromënët e Shqipërisë dhe të Hepirit, “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 3
19. Ciaganët në Shqipëri , “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 5
20. Sllavët në Shqipërië , Gazeta Shqiptare, e Barit. Faqe 2.
21. Historija e Gazetës dhe historija e Gazetavet në Shqipërië. “Gazeta Shqiptare”, e Barit.  
Faqe 17
22. Dora D’Istria, “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 10
23. Fituesi i Perseut pas triumfit “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 5
24. Mbreti Arhillosoji i Maqedonisë, “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 3

25. Alianca Romane – Apolloniane.”Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 2
26. Ismahil Pasnebeu- Jeta dhe Veprat e tija në Janinë, “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 37
27. Porroja e Math mbret i Hepirotvet dhe Luftar i rrepet kundra Romanve. Prëmbledhur me kujdes nga shkrimtarët e moçmë dhe të rinjë, “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 37
28. Vollkanet inaktive të Shqipërisë. “Gazeta Shqiptare”, e Barit. Faqe 37
29. Urakulli i Dodonës. “Shekulli i Ri”, Durrës. Faqe 2
30. Gjon Kastrioti dhe Kisudio Korkodili. “Shekulli i Ri”, Durrës. Faqe 3
31. Maqedonija. “Shekulli i Ri”, Durrës., Faqe 5.
32. Hepiri. “Shekulli i Ri”, Durrës. Faqe 5
33. Dashurija e njerezimit. “Shekulli i Ri”, Durrës. Faqe 3
34. Hronikat e disa Nënëprefekturavet - Nënëprefektura e sarandës, e Delvinës – Çamërisë.  
Të botuara në Revistën Leka të Shkodrës. – Faqe., 60. – Të tri nënprefekturat në pikpamje Arheologjike. Kjo u botua përgjysmë- mbetën pa u të Tri nënprefektura në pikpamje Eklisiatike. – Njerzit u shquarë të Krahinës- Njerzit e Mësuarë. Shkrimtarët. Industria e Mjeshtëria- Këngët popullore dhe të Tri Nënëprefekturat në Pikpamje Hrencisterike. Fatkeqsisht mua më mka mbetur vetëm Këngët Popullore dhe të Tri Nënëprefekturat në pikpamje histerike. Prej këti libri nxora vetëm botonte dhe pjesët e tjera pa u mbyllë. Gjithë Dorëshkrimi i Dhaktillografëve behesh si ne nja 300 faqe.
35. Universitet e Para të Sinisë Ilirike . Revista “Leka”. Faqe 17
36. Të drejtat e Shqipëtarëve Revista “Leka”. Faqe 3
37. Shënime mbi Lidhjen e Prizrenit. Revista “Leka”. Faqe 3
38. Nga Humanistët t’anë- Jesu Kedumi Maqedacussi. Revista “Leka”. Faqe 3
39. Historija e Bibliotekavet në Shqipërië. Revista “Hylli i Dritës”. Faqe 72  
Si dhe shtojcë e parë faqe 18 u botuan në revistën “Hylli i Dritës” në Shkodër, Shtojcën e dytë në Revistën Njeriu i Tiranës faqe 3 shtojcën e tretë faqe 6 është e pabotuar.
40. Suli- Luftrat Kreshnike të Suliotevet. Revista “Hylli i Dritës” në Shkodër. Faqe 12
41. Marko Boçari. Revista “Hylli i Dritës” në Shkodër. Faqe 11
42. Kujtime për Lirin dhe Vetqeverimin e Shqipërisë. Revista “Hylli i Dritës” në Shkodër.  
Faqe 8
43. Misioni Katella Oriental. Revista “Hylli i Dritës” në Shkodër. Faqe 4.
44. Qyteti i Rëngut. Revista “Hylli i Dritës” në Shkodër. Faqe 13.
45. Hronikat e Nënëprefekturavet së Lushnjes Filloje botimin në Revistën “Hylli i Dritës” në Shkodër. Faqe 146 . Fillojë botimin në Revistën “Hylli i Dritës” dhe u botua gjer në faqen 34- pastaj u ndalua për të rifilluar më pas, po Revista u mbyllë dhe kështu mbeti i pa botuarë.
45. Ungarija – Prëshkrim u botua te fletorja ... Faqe 14.

#### Mungon faqja

65. Formimi ethnologjik i popujvet tre Ballkanit Kalendary Engjykllopedik Shqipëtar të V. C. , ačkës në Tirane. Faqe 5

66. Qyteti i Dhedkonës dhe Urakulli i famëshëm i saj. Vetëm një pjesë u botua në Kalendary Engjyklopedik Shqipëtar të V. C., açkës në Tiranë. Faqe 9.
67. Karavastaja Kalendary Encyklopedik Shqipëtar të V. C. , açkës në Tiranë. Faqe 5
68. Historija e maqinës Qepse . Revista “Donika”, Tiranë. Faqe 6
69. Kënga e Sprasme e Ballës. Fletorja “ Fashizmi”, Tirane. Faqe 6
70. La Missione Cattolica Orientale a Lushnja, Kalendari françeskan i Padavës. Faqe 4.
71. Arsimi dhe Edukimi i Gravet Ramane ne kohrat e Moçme. Revista “Tomori i Vogël”. Faqe 11.
72. Prej Aleksandit të Math në Mesjetë. Revista “Tomori i Vogël”. Faqe 5
73. Hyrja e parë e duhanit dhe dhe kafes në turqi dhe në Shqipërie. Revista “Njeriu”, Tiranë, Faqe 4
75. Skënderbeu. Revista “Tomori”, Tiranë, Faqe 5.
76. Mejtime mbi Vet- vrasjen. Revista “Tomori”, Tiranë, Faqe 5.
77. E drejta. Revista “Tomori”, Tiranë. Faqe 4.
78. Ali Pashë Janina . U botua gjysma në fletoren Tomori të Tiranës, po mbassi fliste keq për bejlerët u pezullua botimi sa ish Kryeministër Eqerem Bej Libohova që familja e tij ka të .....
79. Historija e Flamurit Shqipëtar. Revista “Drita e Tiranës”. Faqe 10.
- 80 ) Urakulli I Dodonës , Revista “Drita e Tiranës”. Faqe 10.
- 81 Studime shoqërore – Qimtime. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 2.
82. Studime shoqërtore. Emblema dhe Simbole. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 2.
83. Studime fetare- Feja ose Mbesimi. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër . Faqe 5
84. Prë të njohur Shqipërinë. Dyzet Shenjët ose Saranda. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 2.
85. Prë të njohur Shqipërinë – Finiqi, Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 3.
86. Prë të njohur Shqipërinë- Himara. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 5.
87. Prë të njohur Shqipërinë- Boboshtica. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 3.
88. Prë të njohur Shqipërinë- Mbroja. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 3
89. Prë të njohur Shqipërinë- Manastiri i Shën Naumit. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 5.
90. Prë të njohur Shqipërinë- Filati. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 2.
91. Prë të njohur Shqipërinë- Nën të huaj Paramythia. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 2.
92. Prë të njohur Shqipërinë - Nën të huaj - Parga. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 2.
93. Për të njohur Shqipërinë- Nën të huaj- Aherendi. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 2.
95. Shkëndit e para të qytetërimit Helenik. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 2
96. Për të njohur Shqipërinë- Nën të huaj- Peristeri. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 2.

97. Prë të njohur Shqipërinë- Nën të huaj- Hrupishta. Revista“Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 2
98. Për të njohur Shqipërinë- Nën të huaj- Siatishta ose Saçista. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 8.
99. Për të njohur Shqipërinë- Nën të huaj- Zhupani. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 5 f.
100. Për të njohur Shqipërinë- Nën të huaj Pella e Moçme. Revista “Kumbona e se Diellës”, Shkodër. Faqe 2.
101. Karavastaja dhe Divjaka. Revista“Drini”, Tiranë. Faqe 4.
102. Keneta e Tërbufit Revista “Njeriu” në Tiranë. Faqe 4.
103. Jeta e Mirvetjake dhe Qyettare të shqypetarvet të Moçmë, Revista“Agimi”, Shkodër. Faqe 3.
104. Lord Byron në Toskëni (Prej letravet të tija Anektodike. Revista “Agimi”, Shkodër. Faqe 3.
- Edhe disa përshkrime të tjera që nuk i mbaj mentë në për revista të ndryshme shqipëtare. Këto janë veprat e botuara që trashëgimtarët e mië për kujtim duhet me qoftë se në një herë do të kenë mjetet t’i ,bledhin në një ose dy vëllime dhe t’i ribotojnë që të gjitha se sot nuk gjenden më këto shkrime. Këto janë shkruarë si pas rastit dhe kohës që ka qenë, po kurdoherë janë shkruajtur për të mirën e Shqipërisë dhe të shqipëtarëvet dhe për një shqipëri autonome e indipedente dhe ethnike.
- Le të shpresojmë se një ditë do të dalin ndonji dhe do t’i botojë sërisht këto përshkrime.

### **Shtojcë mbi botimet të Llukë Karafilit**

Veç veprave që shënuarë më sipër, z. Llukë Karafili ka botuarë edhe këto që dihen dhe janë kopjet e tyre në Bibliotekën Karafili.

105. Nga studimet fetare –Farisenjë. Revista “Jeta Kristiane”, Tiranë. Faqe 8.
106. Kisha të moçme që ekzistojnë më në rajonë të ndryshme –Në Rajonin e Lushnjës-revista “Jeta Kristiane”. Faqe 4.
- Janë botuar edhe disa vjersha në për fletore të ndryshme shqipëtare.

### **Vepra te pabotuara të z. Luke H. Karafilit**

Nga veprat e pabotuara tëz. Llukë Karafilit që gjënden në Bibliothek të familjes Karafili janë këto që shënojmë më poshtë (ne total 75 vepra te pabotuara)

#### *Historike:*

- 1.Historija e Shqiperisë- Pjesë e parë-Origjina, fiset- Dhe shenimet e shkrimtarvet - Faqe 190.
- 2.Historija e Shqiperise –Pjesa e dyte, Gjuha shqipe dhe shenimet e shkrimatarvet mbi te. Faqe 400
- 3.Historija e Shqiperise – Pjesa e trete Mythollogjija (janë dhaktillogruarë vetëm 670 faqe, gjithë libri do te kete 1500 faqe )

*( kjo pjesë mungon në biblioteken e familjes. Bazue në letrat që shkembente me z. Eqerem Çabej, Androkli Kostallari, Stefanaq Pollo, hipotizoi se mund te kene mbetun në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, ku ishte bashkepunëtor në vitet 1956 – 1964. shën i mbesës . S. Karafili)*

4. Vjim i veprës më sipër - Paragjykimet e Popullit në Toskëri dhe shpjegim i tyre- Faqe 77
5. Historija e librit dhe e shtypshkronjavet në Shqipëri- Gjithsejt 268 e më tepër faqe
6. Hronikat e disa Nënprefekturave në pikepamje Hrono historike (që bëjnë fjalë mbi Delvinën, Sarandën e Konispolin) Faqe 100
7. Këngët Popullore të Labërisë – Permbledhur prej gojës së popullit në Vlorë, Himarë, e Delvinë, faqe 31
8. Shqipëria - Artikull për tezë kuëshikohet Shqipëria në çdo pikpamje- Faqe 38
9. Për të njohur Shqipërinë – Manastiri i Shën Ardenicës – pjesërisht ne revistën “Drini” të Tiranës – Faqe.5 vijon.
10. Për të njohur Shqipërinë- Manastiri i Shën Todhrit në Kadi Pashën të Muzeqes . Faqe 4
11. Për të njohur Shqipërinë nën të huaj - Milovica. Faqe 4
12. Për të njohur Shqipërinë nën të huaj- Hugareva. Faqe 5
13. Për të njohur Shqipërinë nën të huaj- Resmja. Faqe 5
14. Muzika arabe Faqe 7.
15. Ali Pasha i Janinës. Faqe 14. Nji pjesë e këti artikulli u shtypë në Revistën: Tomori” të Tiranës.
16. Thanas Vaja. Faqe 14
17. Kostë Gramatikoje Vurbijaniti i Kolonjës. Faqe 7.
18. Studime shoqërore . Qëmtime nga historija e Shqipërisë. Faqe 9
19. Ghillotina. Faqe 4
20. Patatja. Faqe 4
21. Të ndryshme Faqe 5 . Kopjen e ka P. Giuseppe Valentini
22. Nji shqipëtar i Shquar –Kontantin Memopotariti. Faqe 4. Kopjen e ka P. Giuseppe Valentini
23. Banorët e Toskërisë në kohë të Lidhjes së Prizrenit. Faqe 12. Kopjen e ka P. Giuseppe Valentini
24. Emigrimi i Suliotvet në Maqedhoni dhe në Thrak . Faqe 5
25. Artikuj të ndryshëm të Engjykllopediq shqipe. Faqe 23. botue pjesërisht në Revistën Leka të shkodrës në pjesën Nomeklatura shqipëtare.
26. Çamërija. Faqe 7. Kopjne e saj e ka Revista “Hylli i Dritës” në Shkodër e asht dhanë për botim , por edhe nuk u botue.
27. Haraçi. Faqe 4.
28. Shtypshkronja At Gjergj Fishta. Faqe 4. Kopjen e ka revista “Hylli i Dritës” në Shkodër për botim.
29. Nji Ças i Math – Panagjiet Stamat Aravandini. Faqe.11. Kopja i ëshët dërguar Institutit të studimeve Shqiptare në Tiranë.
30. Gjergj Kastrioti Skëndebeu . Faqe 3. Kopja i ëshët dërguar Institutit të studimeve Shqiptare në Tiranë.
31. Nikolla Nikokleu – Filolog-Allbanolog . Faqe 5. Kopja i ëshët dërguar Institutit të studimeve Shqiptare në Tiranë.
32. Prefektura e Dibrës (Peshkopisë) Përshkrimi historike- Gjeografikë dhe Kështjellat e moçme të saj . Faqe 20. Kopja i ëshët dërguar Institutit të studimeve Shqiptare në Tiranë.

33. Biblioteka e Myftis së Tabakvet ( Përgjegjës Prof. Filip Fishtës) . Faqe 1. Ju dërgua Revistës Shkëndija për botim po nuk e botojë.

Arsimore

34. Kontributi në Historinë e kulturës së Shqipërië – Nga Dorëshkrimet e moçme gë Beratit- “Përmbledhje Llogjike . Faqe 16. Kopja i është dorëzuar Revistës “Hylli i Dritës” në Shkodër botim, por nuk u botua.

35. Arësimi shoqëror dhe Familja. Faqe3

36. Mjeshtëria të shumica ase Arti në Rusie. Faqe 4.

37. Arësimmi në Russi. Faqe 20

Studime Historiko- Arheologjike – Fetare

38. Kujtimet Byzantine në Shqipërië . Faqe 142.

39. Kisha Jonë ose Historija e Kishës lindore të Shqipërisë dhe dy shtojca gjithësej. Faqe 407.

40. Kisha të Krishtera që nuk ekzistojnë në Rajone të ndryshme Shqipëtar. Faqe 112.

41. Shenjtorët e Vendit T’onë. Faqe 146

Vijon

- 1) Historia e Kishes Lindore të Shqipërisë 1936 Lushnje – 1941 Shkoder
- 2) Historija e Bibliotekave në Shqipërië “Paralipomena” 1941 Lushnje
- 3) Shenime Historikë mbi Komunitetin Ortodoks të Shkodrës 1960 Shkoder
- 4) Shenime të ndryshme historikë mbi Berat dhe Kodet e tij

*Studime Albanologjike:*

- 1) Studime Albanologjike – Disa shënime mbi gramatiken e gjuhës shqipe 1968 Shkoder
- 2) Studime Albanologjike Familja Albani ( Familja e moçme Albani – Degat e saj në Italië – Dega e Korfuzit – Margarita Matildi Albani Memisti – Friderik Albani - Leonidha Albani – Korfusi qender e studimeve të albanologjike - Bibliografie ) 1971
- 3) Studime Albanologjike – Angjelina Pali të Hepirit, 1975
- 4) Studime Albanologjike – Albanoit dhe Ahenjet e Kaukasit të Asisë, 1971
- 5) Studime Albanologjike – Skicë mbi zhvillimin e shkollës shqipe në Shqipërië, 1974
- 6) Studime Albanologjike – Shenime Hronohistorikë mbi Familjen bujare Koka të Delvinës, 1971
- 7) Studime Albanologjike – Hoxhi Mihal Dajlan dhe Ergjeli Mustafa Pasha Gjirokastra, 1975
- 8) Metrika ose Rithmika e Gjuhës Shqipe, Vlorë 1928
- 9) Janni i Stobit dhe Qyteti i Stobit, 1973
- 10) Njerezit e mesuarë të kohërave të kaluara, 1973
- 11) Gojedhena Popullore mbi disa Kisha të Elbasanit 1963 Shkoder

*Studime Shoqërore*

- 1) “Lamartin dhe Turqit”, 1972

*Perkthime të lira, 1973 prej revistës “La Lettura” 1916- 1917 :*

- 1) Grate luftetare në Kohra të Moçme
- 2) Makedhonija

- 3) Kostantini i math
- 4) Etrusket
- 5) Vepra e Italinvet ne Shqiperieprej Umberto Fracchio, 1917
- 6) Venecja e Shqiperija
- 7) Shqipetaret, njepopullpoet e ushtareprej Achille Torelli, 1913
- 8) PrejKosove ne Pakt te Romes, Pietro Silva 1918
- 9) Velleht e Pindit, 1917
- 10) Grate luftarake ne kohrat e reja, 1917
- 11) Grate e carcafitedhe te fshehura te Shqiperise, Rodolf Stevani, 1918
- 12) Arbereshet e Sicilise 1974 ( Revista "Il Secolo XX", 1913)
- 13) Etj

**Bibliografi, “GEGNIA”. Nr.1-9<sup>139</sup>**

1. “Gegënia” në kërkim rrajëve të identitetit.  
*f.5-7, nr.1(2016)*
2. Ekspertizë mbi disa krijime letrare të P. Arbnorit.  
*f.40-52, nr.1 (2016)*
3. In memoriam / At Gjergj Fishta  
*f.117-122, nr.1 (2016)*
4. Të mbajmë gjallë kujtesën tonë kulturore.  
*f.5-7, nr.2 (2016)*
5. Pak fjalë për lexuesit.  
*f.5-6, nr.3 (2017)*
6. Letërkëmbim i D. Nikollë Gazullit me Nobert Joklin.  
*f.134-140, nr.3 (2017)*
7. Nekrologji/ Willy Gjon Kamsi (1926-2017)  
*f.170-171, nr.3 (2017)*
8. Vdekja e dr. Elsie humbje e madhe për kulturën shqiptare.  
*f.5-6, nr.4 (2017)*
9. Ortografija e gjuhës shqipe.  
*f.141-169, nr.4 (2017)*
10. Tranzicion, tranzicion!  
*f.5-9, nr.5 (2018)*
11. Personalitete / Ali Llukaçi (1932 – 2018)  
*f.103-116, nr.5 (2018)*
12. Ortografija e gjuhës shqipe.  
*f.203-207, nr.5 (2018)*
13. Ortografija e gjuhës shqipe.  
*f.236-243, nr.6 (2018)*
14. Nekrologji/ Kolec Topalli (1938 – 2018)  
*f.244-245, nr.6 (2018)*
15. Libri baraz me qytetnim ose nëpër travajet e librit në gjuhën shqipe.  
*f.5-10, nr.7 (2018)*
16. Problemet tona.  
*f.7-10, nr.8 (2019)*
17. Krijime letrare të konkursit : “Njeriu dhe koha”, “Unë jam poet”  
*f.110, nr.8 (2019)*

---

<sup>139</sup> Bibliografia është hartuar bazuar në rënditjen alfabetike të autorëve .Artikujt redaksional dhe ata jo autorial nuk janë shënuar në rënditjen alfabetike.



## A

**18. Ademi, Muhamet [Hesperus]**

Pa titull

*f.72, nr.1 (2016)*

**19. Agamben, Giorgio**

Mbi vështirësitë e leximit.

*f.160-163, nr.2 (2016)*

**20. Alia, Albana**

L'isotopia mitica e folclorica nell' opera Karpa di Martin Camaj.

*f.26-34, nr.3 (2017)*

**21. Alija, Ermira**

Personazhet fëmijë te Migjeni në funksion të beletristikës a utopisë sociale?

*f.28-38, nr.6 (2018)*

**22. Alija, Ermira**

Xhevahiri (Portreti një gruaje të panjohur)

*f.120-122, nr.8 (2019)*

**23. Ashta, Kole**

Frang Bardhi shkroi të parën Apologji për Skënderbeun më 1636.

*f.11-19, nr.7 (2018)*

## B

**24. Bala, Smajl**

Bibliotekat fetare muslimane në Shkodër.

*f.94-103, nr.4 (2017)*

**25. Bardeli, Klevisa**

Unë jam poet...

*f.111-112, nr.8 (2019)*

**26. Bebeziqi, Izet**

Gjendja artistike dhe sociale e Vlorës.

*f.176-181, nr.8 (2019)*

**27. Benni, Stefano**

Tabela "Bar Sport".

*f.83-85, nr.9 (2019)*

**28. Bërdica, Merita**

Puhizë/ Kthim maji/ Shemshirët.

*f.76-78, nr.3 (2017)*

- 29. Biemmi, Giammaria**  
Mbledhja e Kuvendit të Lezhës (2 mars 1444)  
*f.20-26, nr.7 (2018)*
- 30. Brahaj, Manjola**  
Melankolia – Cikël poetik-  
*f.183-190, nr.6 (2018)*
- 31. Buharaja, Edmond**  
Gjergj Kastrioti – Skënderbeu në muzikën operistike dhe reagimi i kritikës zyrtare.  
*f.130-161, nr.8 (2019)*
- 32. Bushati, Nexhmi**  
Një bashkëpunim modest përmes një letërkëmbimi miqësor.  
*f.28-39, nr.1 (2016)*
- 33. Bushati, Nexhmi**  
Prej letërkëmbimit të Hamdi Bushatit me Kristo Frashërin.  
*f.149-152, nr.2 (2016)*
- 34. Bushati, Nexhmi**  
Mësuesi im martir që sfidoi tri diktatura.  
*f.60-62, nr.3 (2017)*
- 35. Bushati, Nexhmi**  
Izet Bebeziqi, personalitet i përmasave të rralla.  
*f.164-169, nr.3 (2017)*
- 36. Bushati, Nexhmi**  
Dr. Robert Elsie – Dijetari me zemër të madhe.  
*f.117-119, nr.5 (2018)*
- 37. Bushati, Nexhmi**  
Të thëna e të pathëna mbi Bibliotekën dhe Bushatllinjtë.  
*f.179-190, nr.7 (2018)*
- 38. Bushati, Nexhmi**  
100 – vjetori i Kuvendit të Bushatit.  
*f.42-45, nr.9 (2019)*
- 39. Bushati, Xhahid**  
Refleksione rreth krijimtarisë së shkrimtarit Teufik Gjyli në gjininë e përrallës.  
*f.61-91, nr.2 (2016)*
- 40. Bushati, Xhahid**  
Mendimtari i lirë, poeti dhe politikani Hamid Gjylbegaj.  
*f.155-163, nr.3 (2017)*
- 41. Bushati, Xhahid**  
... dhe iku “I vizatuar nga hëna”... - Në kujtim të poetit Frederik Rreshpja-  
*f.109-124, nr.4 (2017)*
- 42. Bushati, Xhahid**  
Jetë nga jeta e shkrimtarit Skënder Drini. –triptik kujtimesh-  
*f.127-138, nr.5 (2018)*

**43. Bushati, Xhahid**

Poet i drithërimës e i zemrës së drithëruar... Ndue Pal Shllaku përmes një arkive...  
*f.128-140, nr.7 (2018)*

**44. Bushati, Xhahid**

Shqyrtime kritike mbi vjershat për fëmijë e më gjerë të Ndre Mjedës.  
*f.87-95, nr.8 (2019)*

**45. Bushati, Xhahid**

Arif Gjyli, përshtatësi i parë i Eposit të Kreshnikëve...  
*f.57-64, nr.9 (2019)*

**C**

**46. Camaj, Martin**

Mërgimi gjuhës.  
*f.24-27, nr.1(2016)*

**47. Camaj, Martin**

Poezi (Nji ditë ka edhe korbi/ Grueja e malit/ Kishte ardhë për mik)  
*f.112-113, nr.2 (2016)*

**48. Campanile, Achille**

Pantonimë  
*f.77-79, nr.9 (2019)*

**C**

**49. Çelepija, Isa**

Gjuha standard dhe gegërishtja.  
*f.25-30, nr.8 (2019)*

**50. Çoba, Zef**

“Opera” dhe “Kendemi” në librat e studiuesit Ferit Bala.  
*f.91-93, nr.4 (2017)*

**51. Çoba, Zef**

Opera” dhe “Kendemi” në librat e studiuesit Ferit Bala.  
*f.198-202, nr.8 (2019)*

**52. Çobani, Tonin**

Një tekst poetik i vjetër sa vetë melodia që e ka përcjellë si këngë.  
*f.73-77, nr.6 (2018)*

**53. Çobani, Tonin**

Gjakmarrja nuk është hakmarrje: Cozzi te Fishta.  
*f.175-178, nr.7 (2018)*

**54. Çuni, Gjovalin**

Intervistë me studiuesin Willy Kamsi.  
*f.8-13, nr.1(2016)*

**55. Çuni, Gjovalin**

Kontribut për datën e saktë të themelimit të bibliotekës kombëtare.  
*f.136-141, nr.2 (2016)*

**56. Çuni, Gjovalin**

Në gjurmët e një letërkëmbimi.  
*f.104-108, nr.4 (2017)*

**57. Çuni, Gjovalin**

Kultura Islame në kontekstin e periodikëve shqiptarë.  
*f.81-86, nr.6 (2018)*

**58. Çuni, Gjovalin**

Willy Kamsi – Një jetë kushtue librit  
*f.200-202, nr.7 (2018)*

**D**

**59. Dibra, Ridvan**

Poezi (Plagët e Moisiut)  
*f.118-120, nr.2 (2016)*

**60. Dibra, Zenepe**

Kontributi i disa autorëve shkodranë në përkthimet në gjuhën shqipe.  
*f.203-209, nr.8 (2019)*

**61. Dizdari, Hysen S.**

Dom Ndre Mjeda në Filatelinë Shqiptare.  
*f.78-80, nr.6 (2018)*

**62. Dizdari, Hysen S.**

Kontributi i Kurbinit në fitoren e Pavarësisë.  
*f.56-60, nr.8 (2019)*

**63. Doda, Vitjola**

Unë jam poet.  
*f.118-119, nr.8 (2019)*

**64. Draçini, Enver**

Qemal Draçini (1922 – 1947)  
*f.59, nr.3 (2017)*

**65. Draçini, Qemal**

Bjen shi  
*f.68, nr.1 (2016)*

**66. Draçini, Qemal**

Fragmente nga krijimtaria letrare. (Andrrat/ Ninullë/ Kopështije të Shkodrës s'ime/ Bora e bardhë/ Vallja natore e rrezeve)

*f.63-66, nr.3 (2017)*

**67. Draçini, Rezarta**

Fishta mes dy bibliotekave.

*f.191-199, nr.7 (2018)*

**68. Draga, Nail Dr.**

Roli i Austro-Hungarisë në shkollimin shqip në Mal të Zi (1916-1918).

*f.69-77, nr.7 (2018)*

**69. Drini, Genc**

“Malësorja e bjeshkëve tona”, një roman autentik i shkrimtarit Lulash N. Palushaj.

*f.132-138, nr.4 (2017)*

**70. Drini, Skënder**

Testamenti

*f.139-143, nr.5 (2018)*

**71. Drini, Skënder**

Rekujem për Karlo Ljarjen.

*f.199-201, nr.6 (2018)*

**72. Dushi, Andreas**

Shtatë poezi të Pushkinit të përkthyer në shqip.

*f.50-53, nr.4 (2017)*

**73. Dushi, Ledia**

Poezi

*f.134-135, nr.2 (2016)*

**74. Dushi, Luljeta**

Trajtat Arb, Alb në gjuhën shqipe.

*f.16-24, nr.8 (2019)*

**F**

**75. Fishta, Besnik**

Dëshmi autentike mbi historinë e klubeve filatelike në Shqipëri. – Me rastin e 70-vjetorit të krijimit të klubit të parë filatelik në Shqipëri.

*f.116-125, nr.3 (2017)*

**76. Fishta, Gjergj**

Lahuta e Malësisë.

*f.144-171, nr.5 (2018)*

**77. Fishta, Gjergj**

Lahuta e Malësisë.

*f.87-140, nr.6 (2018)*

## G

**78. Gaspri, Ervis**

Një varg i lirë. – cikël poetik  
*f.96-109, nr.8 (2019)*

**79. Gernstner, Otto von**

“Albania”, përktheu Gjergj J. Kola  
*f.62-68, nr.7 (2018)*

**80. Gernstner, Otto von**

“Albania”, përktheu Gjergj J. Kola  
*f.45-50, nr.8 (2019)*

**81. Grishaj, Eduard**

“Humanistët Italo-Arbërorë” i prof. Pipës si kapitull integral i studimeve të tij historiografike mbi letërsinë dhe kulturën tonë ndër shekuj.  
*f.20-29, nr.4 (2017)*

**82. Gurakuqi, Karl**

Populli shqiptar dhe gjuha e tij.  
*f.10-19, nr.9 (2019)*

**83. Gurakuqi, Nush**

Mbi krijimin e Bibliotekës Shtetnore.  
*f.142-144, nr.2 (2016)*

## Gi

**84. Gjeçi, Pashko [Pa-Gjë]**

Ecco Homo  
*f.69, nr.1 (2016)*

**85. Gjinaj, Maksim**

Një shekull i shtypit shqiptar në bibliografinë e periodikut.  
*f.14-20, nr.5 (2018)*

**86. Gjini, Pjetër**

Nji shikim!  
*f.66, nr.1 (2016)*

**87. Gjylbegaj, Hamit**

Poezia e bukuris  
*f.65, nr.1 (2016)*

**88. Gjyrezi, Qamil**

Epistemologjia dhe semiontika e artit të Tonin Harapit.  
*f.99-113, nr.7 (2018)*

## H

**89. Halluni, Sidita**

Dixhitimi një qasje e re në Bibliotekën Publike “Marin Barleti”.  
*f.120-122, nr.5 (2018)*

**90. Harapi, Anton**

Idealista pa ideal.  
*f.5-7, nr.6 (2018)*

## I

**91. Ivanaj, Mirash**

Nata e fundit  
*f.70, nr.1 (2016)*

## J

**92. Juka, Gëzim**

Një kujtesë historike nga Shkodra e periudhës së Princ Wiedit.  
*f.51-55, nr.8 (2019)*

## K

**93. Kaçulini, Lorenc**

Historia e filatelistë në Shkodër.  
*f.96-102, nr.5 (2018)*

**94. Kakarriqi, Olimpia**

Puna kërkimore e albanologut Filip Fishta në bibliotekat evropiane.  
*f.30-43, nr.4 (2017)*

**95. Kamsi, Gjon**

Banka dhe monedha shqiptare 1913 – 1944.  
*f.210-235, nr.6 (2018)*

**96. Kamsi, Willy**

Giammaria Biemmi e la critica.  
*f. 14-19, nr.4 (2017)*

- 97. Kamsi, Willy**  
Bibliografi  
*f.203-224, nr.7 (2018)*
- 98. Kapedani, Markelian**  
Teoria xhaz.  
*f.70-90, nr.4 (2017)*
- 99. Karafili, Stela**  
Lluke H. Karafili (Bardhyli), personalitet i kulturës kombëtare.  
*f.20-25, nr.9 (2019)*
- 100. Karakaçi, Ridvan**  
Karakteristikat e ahengut shkodran.  
*f.64-68, nr.6 (2018)*
- 101. Kazazi, Lindita; Kazazi, Njazi**  
“Abetaret shqipe dhe Pavarësia Kombëtare”.  
*f.37-41, nr.9 (2019)*
- 102. Kazazi, Njazi**  
95-vjetori i gjimnazit të shtetit.  
*f.59-69, nr.4 (2017)*
- 103. Kazazi, Njazi**  
“Perashi – Krenaria e Kujtesës”, foto - album nga Brahim Miloti.  
*f.207-209, nr.6 (2018)*
- 104. Kazazi, Njazi**  
Pjetër Gjini, artisti shumëdimensional.  
*f.125-127, nr.7 (2018)*
- 105. Kazazi, Njazi**  
Një historik i shkurtër i shkollës normale të Motrave Stigmatine.  
*f.182-190, nr.8 (2019)*
- 106. Kelmendi, Shefqet**  
Tanagra – historia e genit dhe e gjuhës.  
*f.93-96, nr.9 (2019)*
- 107. Koka (Mencacci), Italia**  
Ju rrëfej Gasper Palin.  
*f.103-106, nr.2 (2016)*
- 108. Kola, Ariste**  
Korpusi i soneteve të Arshi Pipës  
*f.36-45, nr.2(2016)*
- 109. Kola, Elsa**  
Impresione...  
*f.123-129, nr.8 (2019)*
- 110. Kola, Gjergj Jozef**  
Mrekullia e heshtun e Nanë Terezës.  
*f.172-195, nr.5 (2018)*



- 111. Kola, Gjergj Jozef**  
Mrekullia e heshtun e Nanë Terezës.  
*f.141-182, nr.6 (2018)*
- 112. Kola, Lisandri**  
Nji motiv i përbashkët mes “*Mehmet Ali Pasha*” dhe “*Të shtatë kralat rrehin telin*”.  
*f.86-100, nr.1 (2016)*
- 113. Kola, Lisandri**  
Gaspër Pali, antipodi i vëllazënve.  
*f.92-100, nr.2 (2016)*
- 114. Koliqi, Ernest**  
Atdhe pa adjektiva.  
*f.7-9, nr.9 (2019)*
- 115. Koliqi, Pjerin**  
Avokatura në Shkodër.  
*f.164-171, nr.7 (2018)*
- 116. Komi, Evina**  
Njeriu dhe koha  
*f.113, nr.8 (2019)*
- 117. Komi, Suhejla**  
Njeriu dhe koha.  
*f.115, nr.8 (2019)*
- 118. Koperaj, Erzen**  
“Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, i prof. Kolec Topallit arritje madhore në gjuhësinë shqiptare.  
*f.23-27, nr.6 (2018)*
- 119. Koperaj, Erzen**  
Shqipja dhe shqiptarët në artikujt e etërve françeskanë.  
*f.115-121, nr.9 (2019)*
- 120. Koperaj, Sereta**  
Revoltat qytetare në Shkodrën e viteve ’30 të shek XIX.  
*f.37-44, nr.8 (2019)*
- 121. Koperaj, Sereta**  
Ditët e fundit të mbretërisë shqiptare, para pushtimit italian (1939), në dokumentet britanike.  
*f.46-56, nr.9 (2019)*
- 122. Kopliku, Arbri**  
Njeriu dhe koha.  
*f.114-115, nr.8 (2019)*
- 123. Kraja, Bardhyl; Vajushi, Zyhdi; Qosja, Ymer**  
Tradita e gjuetisë në Shkodër.  
*f.126-133, nr.3 (2017)*

- 124. Krasniqi, Gazmend**  
Poezi (Shkodra/ Kështjella/ Litani/ Rimurimi)  
*f.121-123, nr.2 (2016)*

## L

- 125. Lanksch, Hans-Joachim**  
Gjuha dhe poetika e Martin Camajt.  
*f.34-35, nr.2 (2016)*
- 126. Leka, Gazmend**  
“Kryevepra e panjohur” – për artistin nga Shqipëria e Epërme, Asim Lohja.  
*f.148-150, nr.3 (2017)*
- 127. Lekiqi, Fatmira**  
Gjurmë të At’ Shtjefën Gjeçovit në Bibliotekën Publike “Marin Barleti”.  
*f.123-127, nr.1 (2016)*
- 128. Lekiqi, Fatmira**  
Pasuri hartografike në bibliotekën “Marin Barleti”./ Bibliografi  
*f.100-114, nr.9 (2019)*
- 129. Luka, Agron**  
Si e shfrytëzuan dhe e çensuruan Andrea Stefin me statusin: “miku e komentuesi më intim dhe i plotfuqishmi” për botimin Migjeni, “Vargjet e Lira”, 1936”!  
*f.42-58, nr.3 (2017)*
- 130. Luka, Agron**  
“Afrodita e Skodrinonit” – Statujëza më e re ndër hyjneshat e bukurisë.  
*f.39-63, nr.5 (2018)*

## Ll

- 131. Lleshanaku, Luljeta**  
Poezi (Autoportret në tekstil/ Shkallët/ Ndoshta)  
*f.124-128, nr.2 (2016)*

## M

- 132. Maçaj, Edison**  
Afër mesnatës/ E uritura/ Kartmonedhat.  
*f.67-72, nr.3 (2017)*
- 133. Marku, Kastriot**  
Injac Zamputti – themeluesi i diplomatikës dhe i shkollës historiografike shqiptare.  
*f.5-7, nr.2 (2016)*

- 134. Marku, Vinçens**  
Nicolas Boileau “L’Art Poetic”, 1674  
*f.101-111, nr.1 (2016)*
- 135. Marku, Vinçens; Puka Gëzim; Prendi, Arben**  
In Memoriam/ Hasan Lekaj, pedagog, bibliofil dhe botues i shquar i letërsisë shqiptare.  
*f.210-212, nr.8 (2019)*
- 136. Marteta, Rafaela**  
Shkrime për burgun, At Zef Pllumi, Maks Velo, Visar Zhiti. Stina e re e letrave në postkomunizëm.  
*f.7-25, nr.3 (2017)*
- 137. Marticanaj, Klodjana**  
Dom Alfons Tracki misionari martir i përkushtuar ndaj përparimit të Shqipërisë.  
*f.141-154, nr.7 (2018)*
- 138. Matishi, Enia**  
“Emira”, e shkrimtarit arbëresh Françesk Anton Santori, në skenë nga studentët “Luigj Gurakuqi”.  
*f.86-92, nr.9 (2019)*
- 139. Martini, Luigj**  
Dr. Mirash Ivanaj, kalorësi i mendimit të lirë.  
*f.26-36, nr.9 (2019)*
- 140. Mhilli, Ndoj**  
Thurja e narracionit të dramat *Loja e mbasdrekës* dhe *Kandili i argjandit* të Martin Camajt.  
*f.35-41, nr.3 (2017)*
- 141. Mirdita, Pjerin**  
“Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës”, muze për të përkujtuar viktimat e regjimit komunist.  
*f.111-115, nr.3 (2017)*
- 142. Montale, Eugenio**  
Armiqtë e Zotëri Fuksit.  
*f.80-82, nr.9 (2019)*
- 143. Muka, Adnan; Dizdari, Burhan**  
Shkodra dhe lulet.  
*f.172-175, nr.8 (2019)*

## N

- 144. Ndrukaj, Beqir**  
Arkeologjia në pullat shqiptare 1913 – 2018.  
*f.97-99, nr.9 (2019)*

- 145. Nikolla, Albert P.**  
Musine Kokalari: Kryeneçe për të vërtetën!  
*f.141-147, nr.3 (2017)*

**Q**

- 146. Osja, Vjollca**  
“Prendimi i andrimeve”, Gasper Pali.  
*f.101-102, nr.2 (2016)*
- 147. Osmani, Shefik**  
Komisia Letrare Shqipe. Komisia Letrare e Shkodrës në 100 vjetorin e saj.  
*f.112-116, nr.1 (2016)*

**P**

- 148. Pali, Gaspër**  
Prendimi i andrimeve  
*f.67, nr.1 (2016)*
- 149. Pali, Gaspër**  
Poezi  
*f.107-111, nr.2 (2016)*
- 150. Palnikaj, Mark**  
Relacioni i Stefano Gasparit i vitit 1672 dhe rëndësia e tij për historinë e Shqipërisë.  
*f.31-36, nr.8 (2019)*
- 151. Pipa, Arshi**  
Vjeshtë e dytë.  
*f.71, nr.1 (2016)*
- 152. Pipa, Arshi**  
Si vdiq Vinçenc Prendushi.  
*f.153-159, nr.2 (2016)*
- 153. Pipa, Arshi**  
Mitologjia e Shqipërisë. (Përktheu nga frëngjishtja: Ndriçim Mlika)  
*f.10-13, nr.5 (2018)*
- 154. Pipa, Myzafer**  
Frenezi botimesh.  
*f.73-77, nr.1 (2016)*

- 155. Pipa, Myzafer**  
Vetëdije apor Krim?  
*f.11-15, nr.8 (1019)*
- 156. Prendi, Arben**  
Mbi sprovën etnomuzikologjike “Pse qanë kuajt e Akilit? “E qara me bote” dhe prejardhja e iso-polifonisë popullore shqiptare”.  
*f.128-133, nr.1 (2016)*
- 157. Prendi, Arben**  
Poezi (Mes shiut të natës toksore/ A po rrin afër meje përgjithmonë?)  
*f.128-131, nr.2 (2016)*
- 158. Prendi, Arben**  
“Premtimi i përmbushun” me autor Gjon Sinishtën, pasqyrë e kalvarit të popullit shqiptar nën diktaturën komuniste.  
*f.167-169, nr.2 (2016)*
- 159. Prendi, Arben**  
Kanga popullore shkodrane me motivin e dashunisë.  
*f.69-72, nr.6 (2018)*
- 160. Prendi, Arben**  
Rivjen në shqip kryevepra e letërsisë franceze - Arti Poetik e N. Bualo.  
*f.90-93, nr.7 (2018)*
- 161. Prendi, Arben**  
Poezia e D. Agollit ndërmjet dy kohëve.  
*f.61-86, nr.8 (2019)*
- 162. Puka, Gëzim**  
“Valë mbi valë” e Atë A. Harapit – kur arti i fjalës është më i vërtetë se ngjarjet referenciale.  
*f.26, nr.2 (2016)*
- 163. Puka, Gëzim**  
“Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore”.  
*f.202-206, nr.6 (2018)*
- 164. Puka, Gëzim**  
Ymer Bala në kohën e rrëfimitarisë.  
*f.172-174, nr.7 (2018)*

## R

- 165. Raka, Luigj**  
Kapiten Mark Raka, patriot dhe demokrat i vërtetë.  
*f.125-131, nr.4 (2017)*

- 166.       Ramadani, Farida**  
Dialekti gegë si pasurues i strukturës leksikore të gjuhës shqipe.  
*f.78-89, nr.7 (2018)*
- 167.       Rea, Domenico**  
Koshi I letrave. (përkthyer nga Amila Gjyrezi)  
*f.75-76, nr.9 (2019)*
- 168.       Repishti, Sami**  
100 vjetori i Revolucionit Bolshevik – Meditime të një viktime.  
*f.191-198, nr.6 (2018)*
- 169.       Reshpja, Frederik**  
Poezi  
*f.115-116, nr.2 (2016)*

## **Rr**

- 170.       Rrota, Justin (At)**  
Lavruesët e shqipes.  
*f.14-23, nr.1(2016)*

## **S**

- 171.       Seci, Ilir**  
Aksidenti që shkaktoi vdekjen e Albert Kamysë mund të ketë qenë vepër e KGB-së.  
*f.151-154, nr.3 (2017)*
- 172.       Sokoli, Helidon**  
Mozaiku i shek. III-IV, zbuluar në Shkodër dhe ekspozimi i tij.  
*f.145-148, nr.2 (2016)*
- 173.       Sokoli, Helidon**  
Gjurmime arkeologjike në rajonin e Shkodrës.  
*f.79-86, nr.3 (2017)*
- 174.       Sokoli, Helidon**  
Gjurmime arkeologjike në rajonin e Shkodrës.  
*f.54-58, nr.4 (2017)*
- 175.       Sokoli, Helidon**  
Fortifikimet mesjetare në rajonin e Shkodrës.  
*f.39-48, nr.6 (2018)*

- 176. Spahija, Anelmo**  
Evolucioni i mendimit dhe i veprimtarisë politike të Lidhjes së Prizrenit.  
*f.21-38, nr.5 (2018)*
- 177. Stani, Lazër**  
Letërsia moderne shqiptare.  
*f.7-13, nr.4(2017)*

### Sh

- 178. Sheldija, Gjush**  
Shpijat tipike të Shkodrës.  
*f.162-171, nr.8 (2019)*
- 179. Sheme, Selman**  
Vepër me vlera teorike-shkencore dhe aplikative.  
*f.191-197, nr.8 (2019)*
- 180. Shllaku, Primo**  
Poezi (Vdekja si dashnore/ Pa titull/ Fleta e bardhë)  
*f.116-118, nr.2 (2016)*
- 181. Shllaku, Primo**  
Diaspora shqiptare – Kjo jetime me prindë gjallë.  
*f.196-202, nr.5 (2018)*
- 182. Shyti, Luigj**  
Xhubleta, veshja autoktone që kërcënohet nga zhdukja.  
*f.155-163, nr.7 (2018)*

### T

- 183. Tabaku (Sörman), Entela**  
Poezi (Poezitë e ftohta)  
*f.131-134, nr.2 (2016)*
- 184. Tabaku (Sörman), Entela**  
Persiatjet e një poeteje mbi konstruktin e munguar në shqipen standard.  
*f.164-166, nr.2 (2016)*
- 185. Tafilica, Zamir**  
Harta Arkeologjike e Pellgut të Shkodrës.  
*f.87-110, nr.3 (2017)*

- 186. Tafilica, Zamir**  
Tradita muzeore në Shkodër.  
*f.64-86, nr.5 (2018)*
- 187. Tafilica, Zamir**  
Tradita muzeore në Shkodër.  
*f.49-63, nr.5 (2018)*
- 188. Tarnaku, Tonin**  
Scanderbeg nell'arte musicale Albanese ed Europea.  
*f.27-40, nr.7 (2018)*
- 189. Temali, Skënder**  
“Shtjellë letrare” e Z. Vukajt – Shtjellë vlerash të mendimit kritik dhe estetik.  
*f.139-140, nr.4 (2017)*
- 190. Temali, Skënder**  
Shoqata e shkrimtarëve të Shkodrës – zë i veçantë në kulturën tonë.  
*f.123-126, nr.5 (2018)*
- 191. Temali, Skënder**  
Shkodrës sime. – Cikël poetik  
*f.114-124, nr.7 (2018)*
- 192. Toma, Çezarin**  
Giuseppe Schirò e Luigi Pirandello: un' amicizia fraterna.  
*f.46-60, nr.2(2016)*
- 193. Traboini, Kolec**  
Poetika e fëminisë  
*f.78-85, nr.1 (2016)*

## V

- 194. Vukaj, Zija**  
Poezi e motiveve dhe gjetjeve të larmishme poetike.  
*f.94-98, nr.7 (2018)*

## Xh

- 195. Xhoxhi, Ledio**  
Shqiptarët dhe trashëgimia kulturore shpirtërore e tyre.  
*f.87-95, nr.5 (2018)*



## Z

- 196. Zadeja, Tonin**  
Shoqëria “Vllaznia” (1919)  
*f.53-64, nr.1 (2016)*
- 197. Zadrimea, Arjola**  
Poezi (Në shtëpinë time/ Zgjedhohem NANË/ Pa fjalë/ Nanë e tim biri/ Unë jam/  
Melankonia/ Ditët/ T’zotit t’shpisë/ Dikujt/ N’heshtje)  
*f.44-49, nr.4 (1017)*
- 198. Zefi, Edona**  
Njeriu dhe koha.  
*f.116-117, nr.8 (2019)*
- 199. Zogaj, Skënder**  
Vdekja e Sabahut.  
*f.73-75, nr.3 (2017)*
- 200. Zojzi, Rrok**  
Ndamja krahinore e popullit shqiptar.  
*f.8-22, nr.6 (2018)*
- 201. Zojzi, Rrok**  
Mdamja krahinore e popullit shqiptar.  
*f.41-61, nr.7 (2018)*
- 202. Zorba, Zef**  
Poezi (Sonte festë/ Një gozhdë/ Hënë të reja/ Përtej.../ Alegro Furioso)  
*f.113-115, nr.2 (2016)*
- 203. Zorba, Zef**  
Mbi tragjedinë e papërfunduar “Hajrija” të At Gjergj Fishtës.  
*f.65-68, nr.9 (2019)*
- 204. Zorba, Zef**  
Demokrati At Gjon Shllaku.  
*f.69-74, nr.9 (2019)*

## Tregues alfabetik autorëve

### A

Ademi, Muhamet [Hesperus] .....	18
Agamben, Giorgio .....	19
Alia, Albana .....	20
Alija, Ermira .....	21-22
Ashta, Kole .....	23

### B

Bala, Smajl .....	24
Bardeli, Klevisa .....	25
Bebeziqi, Izet .....	26
Benni, Stefano .....	27
Bërdica, Merita .....	28
Biemmi, Giammaria .....	29
Brahaj, Manjola .....	30
Buharaja, Edmond .....	31
Bushati, Nexhmi .....	32-38
Bushati, Xhahid .....	39- 45

### C

Camaj, Martin.....	46-47
Campanile, Achille .....	48

### Ç

Çelepija, Isa .....	49
Çoba, Zef .....	50-51
Çobani, Tonin .....	52-53
Çuni, Gjovalin .....	54-58

### D

Dibra, Ridvan .....	59
Dibra, Zenepe .....	60
Dizdari, Burhan .....	143
Dizdari, Hysen S. ....	61-62
Doda, Vitjola .....	63

<b>Draçini, Enver .....</b>	<b>64</b>
<b>Draçini, Qemal .....</b>	<b>65-66</b>
<b>Draçini, Rezarta.....</b>	<b>67</b>
<b>Draga, Nail Dr. ....</b>	<b>68</b>
<b>Drini, Genc .....</b>	<b>69</b>
<b>Drini, Skënder .....</b>	<b>70-71</b>
<b>Dushi, Andreas.....</b>	<b>72</b>
<b>Dushi, Ledia .....</b>	<b>73</b>
<b>Dushi, Luljeta .....</b>	<b>74</b>

### **F**

<b>Fishta, Besnik .....</b>	<b>75</b>
<b>Fishta, Gjergj .....</b>	<b>76</b>

### **G**

<b>Gaspri, Ervis .....</b>	<b>78</b>
<b>Gernstner, Otto von .....</b>	<b>79-80</b>
<b>Grishaj, Eduard .....</b>	<b>81</b>
<b>Gurakuqi, Karl .....</b>	<b>82</b>
<b>Gurakuqi, Nush .....</b>	<b>83</b>

### **Gi**

<b>Gjeçi, Pashko [Pa-Gjë] .....</b>	<b>84</b>
<b>Gjinaj, Maksim .....</b>	<b>85</b>
<b>Gjini, Pjetër .....</b>	<b>86</b>
<b>Gjylbegaj, Hamit .....</b>	<b>87</b>
<b>Gjyrezi, Qamil .....</b>	<b>88</b>

### **H**

<b>Halluni, Sidita .....</b>	<b>89</b>
<b>Harapi, Anton .....</b>	<b>90</b>

**I**

**Ivanaj, Mirash ..... 91**

**J**

**Juka, Gëzim ..... 92**

**K**

**Kaçulini, Lorenc ..... 93**

**Kakarriqi, Olimpia ..... 94**

**Kamsi, Gjon ..... 95**

**Kamsi, Willy ..... 96-97**

**Kapedani, Markelian ..... 98**

**Karafili, Stela ..... 99**

**Karakaçi, Ridvan ..... 100**

**Kazazi, Lindita ..... 101**

**Kazazi, Njazi ..... 101-105**

**Kelmendi, Shefqet ..... 106**

**Koka (Mencacci), Italia..... 107**

**Kola, Ariste..... 108**

**Kola, Elsa ..... 109**

**Kola, Gjergj Jozef ..... 110-111**

**Kola, Lisandri..... 112-113**

**Koliqi, Ernest ..... 114**

**Koliqi, Pjerin ..... 115**

**Komi, Evina ..... 116**

**Komi, Suhejla ..... 117**

**Koperaj, Erzen ..... 118-119**

**Koperaj, Sereta ..... 120-121**

**Kopliku, Arbri ..... 122**

**Kraja, Bardhyl .....123**

**Krasniqi, Gazmend ..... 124**

**L**

**Lanksch, Hans-Joachim ..... 125**

**Leka, Gazmend ..... 126**

**Lekiqi, Fatmira ..... 127-128**

**Luka, Agron ..... 129-130**

## L

Lleshanaku, Luljeta ..... 131

## M

Maçaj, Edison ..... 132  
Marku, Kastriot ..... 133  
Marku, Vinçens ..... 134-135  
Marteta, Rafaela ..... 136  
Marticanaj, Klodjana ..... 137  
Matishi, Enia ..... 138  
Martini, Luigj .....139  
Mhilli, Ndoj ..... 140  
Mirdita, Pjerin ..... 141  
Montale, Eugenio..... 142  
Muka, Adnan..... 143

## N

Ndrukaj, Beqir ..... 144  
Nikolla, Albert P. .... 145

## O

Osja, Vjollca ..... 146  
Osmani, Shefik ..... 147

## P

Pali, Gaspër .....148-149  
Palnikaj, Mark..... 150  
Pipa, Arshi ..... 151-153  
Pipa, Myzafer ..... 154-155  
Prendi, Arben ..... 135, 156-161  
Puka, Gëzim ..... 135, 162-164

## Q

Qosja, Ymer ..... 123

## R

Raka, Luigj ..... 165

<b>Ramadani, Farida .....</b>	<b>166</b>
<b>Rea, Domenico .....</b>	<b>167</b>
<b>Repishti, Sami .....</b>	<b>168</b>
<b>Reshpja, Frederik .....</b>	<b>169</b>

### **Rr**

<b>Rrota, Justin (At) .....</b>	<b>170</b>
---------------------------------	------------

### **S**

<b>Seci, Ilir .....</b>	<b>171</b>
<b>Sokoli, Helidon .....</b>	<b>172-175</b>
<b>Spahija, Anelmo .....</b>	<b>176</b>
<b>Stani, Lazër .....</b>	<b>177</b>

### **Sh**

<b>Sheldija, Gjush .....</b>	<b>178</b>
<b>Sheme, Selman .....</b>	<b>179</b>
<b>Shllaku, Primo .....</b>	<b>180-181</b>
<b>Shyti, Luigj.....</b>	<b>182</b>

### **T**

<b>Tabaku (Sörman), Entela.....</b>	<b>183-184</b>
<b>Tafilica, Zamir .....</b>	<b>185-187</b>
<b>Tarnaku, Tonin .....</b>	<b>188</b>
<b>Temali, Skënder .....</b>	<b>189-191</b>
<b>Toma, Çezarin .....</b>	<b>192</b>
<b>Traboini, Kolec .....</b>	<b>193</b>

### **V**

<b>Vajushi, Zyhdi .....</b>	<b>123</b>
<b>Vukaj, Zija .....</b>	<b>194</b>

**Xh**

**Xhoxhi, Ledio ..... 195**

**Z**

**Zadeja, Tonin ..... 196**

**Zadrina, Arjola ..... 197**

**Zefi, Edona ..... 198**

**Zogaj, Skënder ..... 199**

**Zojzi, Rrok..... 200-201**

**Zorba, Zef ..... 202-204**

## ▪Recensione▪

**Erzen KOPERAJ**

### **“BANORËT E ALPEVE” TË W.OBERMUELLER SI NJË FTESË PËR TË RIMARRË ÇËSHTJEN E ORIGJINËS SË SHQIPTARËVE**

Pas përkthimeve të dy pionerëve në studimet e shqipes, Johan Tunman me “Historia dhe gjuha e shqiptarëve dhe vllhëve”; si dhe Johan Rihter fon Ksilander me “Gjuha e shqipëtarëve”, tani kemi në duar “Popujt e Alpeve” të Eilhelm Obermylerit, libër i cili na vjen në gjuhën shqipe përmes një pune skrupuloze të Albert Gjokës dhe Frida Vokopola Gjoka.

Popujt e Alpeve, titanët, gjigandët, albanët, napoletanët, katët, skotët, shvabët, zviceranët dhe tirolezët, është një libër i botuar një shekull e gjysëm më parë nga një autor shumë kompleks si në interesat kulturore ashtu dhe në veprimtarinë jetësore të tij. Eilhelm Obermyler, një hej si gazetar revolucionar nga njëra anë, por edhe antropolog, historian, etnograf, gjuhëtar, një njeri i pasionuar pas studimeve kelte nga ana tjetër. Ai filloi të botonte që në vitin 1840 me “Peshorja e Zotave”, më pas “Leksikoni gjeografiko historik gjermanisht keltisht (1866/1872)”, në dy vëllime që do të ishte dhe libri i tij më debatueshëm.

Libri “popujt e Alpeve” në punimet e Obermylerit vjen pas atyre mbi popujt e Saksonisë, mbi origjinën e hungarezëve, të baskëve, indianëve etj. I dhënë pas gjurmimit të origjinës së popujve, Obermyler përpiqet të krijojë historinë e gjenezës së tyre. Duke iu referuar autorëve antikë, të cilët i njeh mirë, sidomos Strabonin, Ptolemeun, Diodorin e Tit Livin, por edhe të dhënave antropologjike, ai radhit argumentet duke ndërtuar idenë se që pas periudhës së akullnajave në viset e Mesdheut, kryesisht Ballkani, pjesa jugore e gadishullit apenin, ishujt e Egjeut, ka qenë e përhapur një popullsi ilire, që prej të tjerëve njiheshin si gjigandët, ndërsa tek albanët sot e kësaj dite quhen gegë. Që në fillim të librit të tij Obermyler fton lexuesin e tij duke thënë:

*“Cilido që dëshiron të shohë një gjigand për së gjalli, le të shkojë në Shqipëri, ku do të gjejnë tek gegët pasardhësit e tyre pothuaj të papërzier, njerëz të bukur, të gjatë të fuqishëm, ... me flokë të zinj, shpesh me sy të zinj e të mprehtë dhe me hundë të drejtë, ..pra një njeri me temperament dhe vigan, si ai nuk gjendet në gjithë Europën, ...shpeshherë të konsideruar si ekzemplarët më të bukur të racës ariane.”(f.2-3).* Në kapitujt e parë ai merret me elementet që



na vijnë nga antikiteti dhe mitologjia në lidhje me gjigandët, përplasja e tyre me titanët, si dhe afritë e njerëzve të shkëmbinjve e maleve, si i quan ai kretët, katët dhe skotët.

Ai që paraqet interesin më të madh është padyshim kapitulli i katërt i librit, kapitulli me titullin, “Gegët”. Në këtë kapitull, Obermyler merret me shqiptarët e Veriut, me ata që sot, nga Shkodra e deri në zonën qendrore të vendit quhen gegë, e që sipas autorit, s’janë gjë tjetër veçse gjigandët e dikurshëm. Sipas Obermylerit, vetë fjala gegë ka kuptimin “i egër”, “njeri i egër”, ose dhe banor i maleve, ndërkohë që në lidhje me gjuhën e gegëve ai jep mendimin se në themel të saj nuk është një gjuhë ariane nga njëra anë (një përfundim i gabuar, pasi sot gjuhësia e pranon mirëfilli shqipen si një gjuhë indoevropiane), por pranon disa ngjashmëri midis shqipes, keltishtes dhe sanskritishtes. Materialit gjuhësor të shqipes ai i referohet vetëm asaj çfarë ka gjetur te Ksilanderi dhe tek Hahni. Ndërsa toskët, sipas tij, janë maqedonët, etolët e akarnanët, që përbënin albanët e jugut.

Ndërsa në kapitujt e tjerë ai ia kushton kalabrezëve, tirolezëve, emigrimeve të fiseve gjermanike dhe sllave, ai del në përfundimin se banorët autoktonë të alpeve në hapësirën gjeografike europiane janë në zanafillën e tyre gegë, ilirët gjigandë, tek pjesa më e madhe e tyre ndryshoi gjuha, e cila vetëm tek shqiptarët është ruajtur. Sipas Obermylerit (f.92) - *gjuha është ruajtur vetëm tek shqiptarët dhe nëpërmjet saj këta bij të Skënderbeut kanë ditur ta ruajnë njëkohësisht lirinë dhe pavarësinë e tyre- ata kanë mbetur gjigandët e vjetër.*

Libri vjen në shqip mjaft qartë, për çka dëshmon punën cilësore të dy përkthyesve. Një përgëzim vjen për tërë punën e kontributin e tyre duke na risjell vepra të cilat në albanologji deri tani vinin të pjesshme, kryesisht, të përcjellura si citime nga autori në autor.

Pasi ka lexuar librin me të drejtë shumë kush mund të thotë sot se kemi një vepër të 1874, një punim të tejkaluar në kohë e në fakte. Padyshim shkenca ka përparuar mjaft, antropologjia dhe gjuhësia kanë ecur shumë në këtë drejtim. Duke u nisur dhe nga kufizimi i njohjes me tekstet e shqipes, përfundimet e tij janë të diskutueshme. Por për lexuesin e sotëm, e sidomos për studiuesin e sotëm, ky libër ka vlerë jo vetëm kuriozitetin. Ai është, do të thoja, një ftesë për të rimarrë çështje të cilat lidhen origjinën tonë, një çështje ende shumë e hapur në studimet albanologjike. Arbëreshët, shekuj më përpara, që me vendosjen e tyre në Italinë e jugut, vendasit i quanin xhexhi, madje deri vonë. Sipas studiuesve në dorëshkrime kjo ndeshje herë e shkruar gegi e herë jeji, sepse në të dy rastet në italishte lexohet njëlloj. Sipas tyre kjo fjalë kishte kuptimin i egër. Gjetja e të njëjtit shpjegim edhe te Obermajer më befasoi.

Apo dhe përkimi me veprën e Pashko Vasës “E vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët” botuar në frëngjisht një vit pas librit të Obermajerit, Sa për Gegërinë dhe gegët, domethënien ua gjejmë në veprën e Homerit. Përtej maleve Akrokeraune banojnë gigantët (γίγαντες), thotë babai i poezisë. Fjala gigas do të thotë gjigant. Meqenëse banorët e malësive të Shqipërisë së Sipërme janë pothuajse të gjithë me shtat përtej mesatares, të vjetrit i merrnin për gjigantë dhe ashtu i quanin. Gigas dhe Gega është i njëjti emër dhe në të dyja gjuhët ka të njëjtën domethënie”.

Një temë e tillë nuk mund të quhet e mbyllur vetëm me atë çfarë përkufizohet në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (1985 dhe 2008), ku thuhet se fillimisht Gegëria ose “Nëntë Malet e Gegëve” përfshinin vetëm principatën e Kastriotëve dhe “shtrirja e termit Gegëri për gjithë Veriun e Shqipërisë i takon kohës së re. Apo në studime të tjera ku si zgjidhje jepet vetëm shprehja, *fjalë me burim të errët*. Një libër i tillë është një ftesë dhe për studimet në fushën e antropologjisë, që në këndvështrimin albanologjik nuk arriti asnjëherë të ngrihej në nivelin institucional të kërkimit shkencor.

Në mbyllje mund t’i kthehemi një fraze të Obermylerit në një prej artikujve të tij të vitit 1876, pas debateve mbi idenë e tij mbi keltishten, që thotë:

*-Me librat e mi dua të tregoj se e vërteta nuk është gjithmonë ajo që mësohet dhe përpiqet të ngulitet në shkolla-*

**“SAGA SHQIPTARE E DHEMBJES” E FATBARDHA SARAÇIT -LIBËR  
KUNDËR HARRESËS DHE FANTAZMAVE  
TË SË KALUEMES KOMUNISTE**

Paraqitja e librit asht një moment që shenjon jo thjesht prezantimin e një libri, por edhe një moment takimi dhe kujtimi për ata njerëz, tashma jo të shumtë që ishin apo edhe nuk ishin indirekt, pjesë të Sagës shqipe të dhembjes, hidhënimit, gëzimit, ndjenjës, trupit dhe zemrës, lindjes dhe perëndimit të jetëve.

Nisun prej botimeve të tjera, dikush edhe mund të pyesë: Po prap kjo? Si nuk mbaroi së shkruemi? Janë pyetje, por edhe gjegje që i kanë pasë bâ, por edhe dhanë përgjegje thuejse në çdo kohë.

Ilo Mitkë Qafëzezi, i njoftun për studimet e tija medievale, i përgjigjej njikshtu kësaj pyetjeje: “Njeriu sa ka shpirt ndër dhëmbë duhet edhe diç të punoje”. Krijimtaria e pashterrun e Bardha Saraçit, të kujton sentencën e Mopasanit: *“Prandvera shkund gjithë natyrën e pemeve të mia dhe më shtyn të prodhoj këto fryte letrare, (ne rastin tand memuaristike) që as vete s’di si më dalin”*. Ndoshta nuk asht kështu, por si metaforë qëndron.

Tuj mbetë te krahasimi e veprave të Bardhës me gjykimet e njerëzve të mëdhej, trajtesat e ngjashme At Anton Harapi, i cilësonte jo thjesht një e drejtë, por edhe një detyrë edhe një nevojë.

*“Asht e drejtë dhe detyrë kujtoj sa dhe të nderomi njerëzit që i kanë shërbye fesë e atdheut, jasht siç asht nevojë përmes kujtesës me ndezë zemra tona e sidomos të rinisë në dëshirë që me i marrë “mbrapa gjurmët e fatosave, me punue si kanë punue ata; me i mbajtë me i shumue veprat e bamirësís, qi prej tyne kan xan fill”*.

Libri e Bardhës nuk asht as i pari, as i vetmi i trajtesës. Në këto kohë ka shumë prej tyne, falë edhe punës që ban që ban Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit por ashtu sikurse edhe librat e maparshëm të saj, dhe të tjerëve, gjithnji ata mbesin visare që duhet me e plotësue historinë tonë, që fatkeqsisht nuk po e plotësojnë, ndonse në këto libra, sillen figura dhe njerëz të thjeshtë dhe të rëndësishëm, që i kanë bâ dhe i bâjnë nder kombit.

Përmes dokumentave në libër forca magjike e historisë pasunohet me fakte të shënjueme direkt, në kohën kur kanë ndodhë, përmes edhe ditarit personal, pjesë e ketij libri, por edhe përmes takimeve të realizueme me persona të ndryshëm, dëshmitarë të vuajtjeve të thella, thellësisht jo-humane e për mâ tepër edhe paradoksale. Një ndër paradokset që vërehet, asht

mohimi i antifashizmit te personave që cilësoheshin antikomunista. E megjithatë, forca e fakteve të përshkrueme në libër e libra, të shpërndame në fletët e ditarit, takimet direkte, dokumenta dhe faksimileve të ruejtuna të protagonistëve të kohës, ka me shërbye dikur si pasunim për historinë bashkëkohore shqiptare.

Koha që rrjedh, kuptimin e vet e ka në lidhni me të kaluemen, e kjo e kalueme asht edhe një premtim për të ardhmen. E këtë duhet me e kuptue të tanë njato që kanë për me dëshmue diçka, mbasi siç thotë shprehja e urtë popullore e sjellun prej Atë Anton Harapit: “Si të shtrohet sofa e vëhet pilafi, me lugë në brez del kushdo ndër të parët”.

Lexon ndër faqet e librit dëshmi nga jeta e njerëzve të fisit, Mulletëve e Mukajve, që në vend që të ishin ndera e Shqipnisë në periudhën e përpjekjeve për konsolidimin e shtetit shqiptar, u banë kinse “gazi i Shqipnis” prej regjimit komunist. Shqiptarët kanë shumë thanie, por mes tyre kane edhe një thanie të thekshme: “Nuk ta ban i hueji, çka ta ban i joti”. Të tanë tashma e dimë se pak nderë, e ma tepër përbuzje, shpifje, trillime nga ma të ultat, e vonë edhe vrasje ju rezervuen njëktyne “fatosave”.

Ka shumë për me thanë për këtë libër, por më duhet të theksoj se në ditët tona, mjerisht jena të gjithë dëshmitarë se janë kthye, ase ma mirë me thanë, ringjallë e kthye, fantazmat e së kaluemes komuniste, që për një moment i harruem, e na del detyrë ne shtresave të përndjekuna dhe të përsekutueme, pa mllef dhe ndjenjën e hakmarrjes, por bazue në drejtësi, të shkruejmë për ata njerëz që kryen detyrat dhe vuajtën padrejtësisht. “*Popujt, shkruan Emil Cioran, e bëjnë rrugën e tyre mes gabimesh sublime dhe e sosin mes të vërtetash të thata*”.

red.

**VLERA E SHUMANSHME E LIBRIT “SHEUQET MUKA, SHKODRANI” TË AUTORIT  
ADNAN MUKA**

Njerëzimin kah herë e ka shqetësue pyetja: Ku qëndron kuptimi dhe vlerat e jetës? Simbas Viktor F. Frank, “*çdo njeri synon ti japë jetës së vet kuptimin e plotë për të arritun cakun e qëllimin e saj. Orvajtja e njerëzve rreth vehtes për të realizue kuptimin e jetës nuk asht asgja tjetër përveçse kryerjes së detyrës.*” Guximin i çdonjenit për me u ballafaque me jetën dhe me luftën për me realizue qëllimin e vumë, Frank e konsideron si realizimin e kuptimit të jetës, që shoqënohet me harmoninë dhe qetësinë e shpirtit “*edhe në skutat dhe në situatat ma të vështira që të sjell jeta*“. E pame në këtë këndvështrim, Sheuqet Muka thjesht nuk jetoj, ai mbijetoj, mbasi e dinte pse jetonte.

“*Për atë që nisë të numërojë në vend e s’asht i zoti t’ecë ma përtej,- shkruen Muka- s’ka pikë dyshimi se asht fillesa e teposhtës, të cilës i mendshmi, këqyrë me i qëndrue larg e ma larg*“.

Të njajtin problem (pra kuptimin e jetës) Italo Kalvino, shkrimtar italian e konsideron se “*është diçka që mund ta kapim vetëm në jetën e të tjerëve, e cila kur bëhet objekt rrëfimi (e diskutimi) na paraqitet si e përfundueme, e vulosun nga vdekja. Tregimi ... flet për jetën dhe ushqen dëshirën tonë për jetë, por pikërisht për faktin se kjo jetë përmban në vetvedi praninë e vdekjes, pra ka si sfond përjetësinë*”.

Në rasë të letrave të Sheuqet Mukës, (Shkodranit), çuditnisht të dyja përkufizimet qëndrojnë. Franklin, kuptimin e jetës e përqaste tuj u nisë prej psikikës, studimeve që i bëni jetës së burgosurve, mbasi edhe vetë ishte i tillë; kurse Kalvini, nisë nga studime letrare, realizimin e jetës e lidhë me vdekjen, me përjetësinë, që Sheuqet Mukës, Shkodranit, po i realizohet falë përkujdesjes së njanit prej fëmijëve, Adnanit apo “*orrlit Adnan*“, siç e quante, që atij “*...i jepte shpresë se ka me u ba shkrimtar i mirë, pse rruga qi ka zgjedhë me vazhdue, ka me ia pregatitë terrenin ma së miri. Për këtë jam i bindun, prandaj edhe po i uroj*”.

E tesh kur edhe vetë Adnani është në moshë të tretë, e megjithëse nuk u bë shkrimtar, po ja realizon të jatit, “*pengun e dëshirit*”.

Në ditët e sodit, një tubë njerëzish, qi po përpiqena me përcjellë vlerat e jetës, bazue së pari në një frymëzim fetar dhe njerëzor, nuk mundena me ndejë indeferenta përballë kësaj skene të madhe, në të cilën mbi vlerat e jetës ka triumfue pragmatizmi njerëzor, i shoqënuem me humbjen e dinjitetit, me braktisjen e Atdheut, prindërve e të afërmve.

E në mënyrë që të mos rrijmë tuj thanë përheri: “*Na ishte një here*”, shprehje që përcjell kujtime, por edhe harresë, është një gjâ shumë e mirë botimi i këtyne librave, nxjerrja në dritë e njatýne sendeve që i japin kuptim vújtjes, por qi shikojnë edhe një të nesërme mâ të mirë, një të nesërme të ndërtueme s’bashku.

Disa pjesë të letrave të Sheuqetit, ndonëse janë kumte të s’kaluemes, mbesin prapë në çdo kohë t’vlerata e t’vërteta. Përfytyroni për një ças kënaqësinë që kishit me ndigju tekxa një lexues i mirë ju kumton rrjeshtat e mâposhtëm shkruie prej Mukës:

*“Përveç erës së lirisë, s’ka erë ma t’ambël e ma të shijshme se ajo e rrethit familjes, së cilës s’i përngjet asnji kënaqësi e shije tjetër në këtë botë, sado e vlefshme e e çmueshme që ajo të jetë. Sikur t’ishe para kësaj dileme: a don të jeshë i pari i dheut a të jetosh pranë familjes , un pa një pa dy do të hiqshe dorë prej së parës e do të zgjedhshe qindrimim tem në prehnin e familjes , ku njeriu lindë e rritet, zinë e fërgohet”.*

Pjesa e dytë e librit “103 Letrat nga Burgjet Komuniste (1951-1965)”, apo siç shprehen studiues të ndryshëm edhe *si letra nga qelia, letra nga vetmia, letra nga errësira apo edhe letra nga vete ferri*, të ruejtuna me aq kujdes prej Adnanit, falë Provanisë Hyjnore edhe t’shpëtueme prej flakëve, qi përfshinë shtëpinë e tij, krahas shprehjeve të personalitetit të shkruesit, nevojës së parë që kanë tanë të burgosunit, “*dëshirës së pakufishme*” me u lidhë me anëtarët e familjes me të afërmit e miqtë e humbun, janë një pasuni e fondit epistolar shqiptar që sheh dritën e botimit, pas vdekjes, si zakonisht.

Letrat ruejnë në vetvedi jo vetëm tipologjinë e epistolarit, por edhe stilistikën e tij. Secila prej tyne (letrat) është e veçantë prej njena- tjetrës, asnji nuk ka të njâtin format, bile në çdonjenën prej tyne ndryshon edhe paraqitja grafike, e realizueme me një kaligrafi bukurshkrimi. Letrat dikund fillonin me një fjalë ose me fjali të shkurta drejtue marrësit, me metafora si fillesë, diku me një poezi , diku me një këshillë etj.

I tanë epistolari i Mukës, si tanë epistolarët, tuj pasë përgjithësisht shumë marrës përcjellin mesazhe të ndryshme, që me të drejtë studiuesit i fushës i grumbullojnë në mesazhin e parë intim për familjen e gruen, hallen dhe fëmijët; mesazhin e dytë diskriptiv, për familjen e gjanë, të afërmit, kojshitë, njerëzit që i njihte dhe e njihnin. Në mënyrën mâ brutale dhe të pabesueshme nuk mungon as mesazhi “*politik*”, mbasi tana letrat e viteve të para të nisuna nga burgjet fillonin me anagramat *V. F. - L.P.*

Në të tana letrat e botueme, zbulohet kadalë –kadalë shpirti, e mbrendshmja e copëtuese e autorit të tyne. Në âta ndihet shqetësimi kryesor, zbërthimi i misterit të dhimbjes, vetmisë dhe i pakuptimit të çasit; situatat e vështira të kushteve *çnjerëzore* të burgjeve, apo edhe të padrejtësive ligjore të bâmë në kurriz të tij. Shpirtnisht autori e vuen, edhe vuajtjen e “burgosunve” të tjerë të familjes së tij në liri, vuen edhe pse asht parazit, por gjithnji nuk harron edhe pse në burg me i përcjellë fëmijëve mesazhe atdhedashnie.

*“Nji e gjashta e mâ e jetës s’eme më kaloj n’arrati, burgje e internime e nëper sebeb t’emnit u takoi edhe juvet me vuejt e me hjekë keq e kjo gja asht qi më ka lodhë ma tepër se vetja. Më ka lodhë pse i kam të gjalla ende shiset e s’jam bâ gurë qi mos me ndie e mos me dijtë, por qofshin të kalueme për ju, e ky asht urimi i jem..... E në të njajtën letër, krenohet per Uranin djalin e dytë që po i afrohet koha m’e krye me plot lavd e nder shërbimin ushtarak ( letra 5 ). E teksa lexoj keto shprehje më shkon mendja te Mitrush Kuteli (një tjetër i burgour) që porosiste fëmijët:”Atdheu âsht atdhe edhe kur të vret”*

Ndonëse e nisun prej dëshirës me i dhanë vlerë jetës të një njeriu, cilësuem prej regjimit të “pa vlerë”, epistolari i Mukës, ndoshta edhe me padashjen e tij, por bazue në formimin intelektual, mundet me u cilësue, prozë e shkurtë poetike, komunikim edhe letrar, element i “burgologjisë”, siç e quan Visar Zhiti, letërsinë e krijueme në burg. Leximi i tyne të jep kënaqësi estetike.

*“Tubëza e bukur e urimeve të tua radhitë në varg inxhije e rrethue me flete të bardhenta drandofileje, mbushi me erë të mirë gëzimi zemrën t’eme të ndezun flakë dashtunije për ju të gjithvet, e cila hova hova rreket sikuer fluturon.....*

*“..... Por era kandshme e tubzës s’ate, qindisë e thurë me maje të pupëls ia del me u ulë s’nalti e me prue në vedi, kështu që tash i kapluem prej bukurís saj qi shkëlzen si vjollë behari strukë në kaçubë bari, merrem për dore e siellem pranë teje, për me sjellë edhe un urimet e mija e me t’urue fitore mbas fitoresh” .*

Letrat e Sheuqetit kanë vlerë dokumentare. Në ata lexuesi ka me gjetë trajtesa të ndryshme të karakterit informativ, edukues, arsimor, kulturor, fetar etj., e kjo rrjedh mbasi ata në radhë të parë janë shkruar prej prindit, dhe një figure të shqueme atdhetare, arsimore dhe kulturore.

Jeta dhe vdekja janë aq pranë njëna-tjetrës sa në kuptimin e një besimtari në fund të fundit janë e njëjta gjë e transformueme në gjendje. Njerëzit që lanë shenja, siç thuhet: “ata që u

*dallun për me kenë të ndamë në shenj*”, vijojnë me jetu, vijojnë me na ngjall nderim dhe emocione të përleshme.

“*Kujtimet -thoshte Bodler- janë edhe palimpsest*, e tashma Sheuqeti ka vite që është nda këso bote, por siç thoshte Padër Frano Kiri, ai ka lanë të pasun fëmijëet e tij. E kjo pasuni sapo ka fillu me u zbulue...

red.



## ▪Kronika kulturore▪

### “Dante continua....”

Në pafundësinë e telasheve të një jete të përditshme, njeriu duhet me kenë i vemendshëm e me kapë, rujtë e transmetue në çdo mënyrë, njata gjana që janë, e kishin me kenë, (sidomos kur janë edhe të çasje botnore) krenaria e vijueme kulturore, tashma në stade të reja, të një qyteti që në vite ka “plluskue” kulturë.

I tillë është libri: “DANTE. KOMEDIA HYJNORE. FERRI. KANTIKU I PARE“, nën përkthimin dhe komentimin e Meritan SPAHISË, redaktimin e Dr. Lisandër KOLËS, e redaktorit të trajtesave teologjike, Pastor Meriton CUNGU.

Meritan Spahija i shtohet vargut të autorëve shkodranë që ndër vite morën guximin me u përballë me përkthimin e Dantes, dhe me sjellë në shqip, simbas mënyrës e ndjesive personale krijuese. Kujtojmë se ishin persona të një “kalibri të naltë kulturor” e njohës të mirë të kulturës e gjuhëve klasike, të tre veriorë, që e pasuen veprën në variante të gegnishtes.

Meritan Spahija me përkthimin më të ri të veprës së Dantës, në vitin 2019, qëndron me vlerat dhe risitë personale, krahas Pashko Gjeçit që e solli Danten në vitin 1962, Mark Ndojës në vitin 2008, Çezar Kurtit në vitin 2000, 2013, por edhe autorëve të tjerë shqiptarë mes të cilëve, Ernest Koliqi, At Vincenc Prendushi, Kristo Floqi e Nikollë Daka që e përkthyen pjesërisht.

Në gjykimin e redaktorit të librit Dr. L. Kola, “Ferri “ i Meritan Spahisë , “ ...ka hapë mundësinë e gjykimit të historisë dhe atributit të primatit të përkthimit në gjuhën shqipe” (Dante Continua...., f. 8), tuj u ba “... me u radhitë me shumë edicione cilësore që sot qarkullojnë në gjuhët e hueja” (po aty, f. 21), e një produkt i kulturës shqiptare “... që mund të kalojnë vite dhe nuk i vjen” (po ai”po aty).

Vepra në fjalë , nën redaktimin gjuhësor të Prof. dr. Tefë Topallit, recensentit letrar Prof. as. Dr. Vincenc Markut dhe përkujdesjen e e veçantë të Profesorit Gjergj Preluca, është botim i shtëpisë botuese “Fiorentina”. Libri ka 904 faqe dhe kushton 2000 lekë.

Ai u botua edhe falë ndihmës bujare të Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv Shkodër-Pult.

Në përfundim “Dante continua....”

Red.

## 70- vjetori i Teatrit “Migjeni”

Ditë ma parë u festue 70 vjetori i teatrit “Migjeni” të Shkodrës. Ngjarje e randësishme për artin shqiptar e atë të qytetit tonë. Sikurse e dimë tashma lëvizje teatrore kishte në Shkodër që nga fundi i shek XIX me shoqnitë kulturore fetare e ma vonë edhe me ato laike, madje që në këtë kohë ato kishin edhe sallonet e tyre për shfaqjen para publikut. Ndërsa teatri “Migjeni” si institucion shtetnor u krijue në vjetin 1949. Nëpër skenën e këtij teatri kaluen dhjetëra aktorë të dimensioneve të ndryshme, regjisorë, autorë dramash, u shfaqën me dhjetëra drama e pjesë

teatrale, spektakle e estrada etj. Sigurisht teatri “*Migjeni*” u dëshmue nëpër kohë si një nga të parët teatro cilësorë nëpër rrethet e Shqipnisë së kohës.

Në kushtet e izolimit kulturor të Shqipnisë dhe veçanërisht të Veriut të Shqipnisë, teatri “*Migjeni*” vërtet u ba një qendër e randësishme e artit dhe e komunikimit kulturor. Pa dashtë me mohue punën e talentin e sa e sa artistëve që dhanë kontribut në këtë skenë kena për detyrë para shoqnisë me kujtue edhe anën tjetër të medaljes e cila sigurisht lidhet me politikën dhe propagandën. Në kuadër të shëndrrimit të artit dhe kulturës në një megafon ideologjik edhe teatri i Shkodrës si të gjitha institucionet e kulturës në Shqipninë socialiste nuk i shpëtoi kësaj dukurije.

Presidenti i Republikës, Ilir Meta i akordoi këtij teatri, çmimin “*Nderi i Kombit*” me motivacionin: *“Si tempulli më i rëndësishëm i dramaturgjisë, qytetërimit, artit e kulturës në veriun e Shqipërisë; vlerë e pakrahasueshme e trashëgimisë së traditave shkodrane dhe mbarëshqiptare, duke u dhënë kënaqësi artistike, emocione dhe cilësi estetike ardashësve të saj të shumtë”*.

Meriton këtu me u përgëzue mbështetja që Bashkia e Shkodrës i ka ba këto vite teatrit “*Migjeni*”, por edhe botimit të ri të shkrimtarit Xhahid Bushati: “*Kujtesa e një qyteti*”, që i kushtohet figurave ma të spikatuna të këtij teatri, por mendojmë se ka pasë vend edhe për ma shumë bashkëpunim mes institucioneve shtetnore. Bie fjala ky përvjetor mund të ishte përcjellë edhe me një konferencë shkencore për teatrin dhe dramën kombëtare, vlerat dhe antivlerat, tue bashkëpunue me Akademinë e Arteve në Tiranë, me Universitetin “*Luigj Gurakuqi*” të Shkodrës, me Bibliotekën “*Marin Barleti*” etj.

Red.

### **At’Fishta e ka vendin në komunikim jo në muzeum**

Mbas shumë debatesh e premtimesh me rastin e 148 të lindjes së shkrimtarit At’ Gjergj Fishta kryeministri Edi Rama ka prenzantue projektin “*Nëpër gjurmët fishtiane*”.

Simbas njoftimit të Agjensisë Telegrafike Shqiptare: *“Ky projekt do të shtrihet nga kulla ku lindi, tek shkollat ku mësoi, në kishat ku shërbeu, në kuvendin ku dha frymë. Të gjitha këto ndërtesa apo vende që lidhen me jetën e Fishtës do të restaurohen, do të pajisen me simbolika, sinjalistikë, etj, që të mund të jenë të vizitueshme dhe të kthehet në një rrugë pelegrinësh, për tu njohur dhe për të reflektuar.*

*Konkretisht projekti do të përfshijë ndërtimin e një memoriali ku lindi At Gjergj Fishta, sinjalistika dhe rikualifikimi i sheshit, restaurimi i banesës, monument kulture, ku ai ka lindur dhe vendosja e tabelave informuese. Po ashtu pjesë e projektit është edhe shpallja monument kulture i kategorisë së dytë kompleksi i Kishës Françeskane, Kuvendit dhe Shkollës, restaurimi dhe pasurimi i bibliotekës së Kuvendit, krijimi i një këndi të dedikuar për Fishtën brenda Kuvendit në Troshan, Lezhë, vendosja e sinjalistikë informuese bashkëkohore dhe një pllakë jashtë dritares në kishën e Zojës Nunciatë, etj.”*

Ndonëse projekti është prezantuar akoma nuk është e qartë me cilët institucione do të bashkëpunojë Ministria e Kulturës për realizimin e tij.

Mendojmë që një hallkë e rëndësishme e bashkëpunimit është edhe Universiteti “Luigj Gurakuqi” si qendër shkencore e studimore e lidhun edhe me veprën letrare të At’Gjergj Fishtës, qendër e cila ndër ma të parat ka mbajtur konferenca shkencore e programe landësh universitare, studimesh shkencore që kanë në qendër veprën letrare të këtij krijuesi të madh të letërsisë sonë kombëtare.

Vepra letrare e Atë Gjergj Fishtës përveç infrastrukturës muzeale ka nevojë edhe për botimin studimin dhe interpretimin gjuhësor, letrar e kritik për ta ngritur në vendin që meriton dhe jo thjeshtë autorin, si objekt muzeal për turista ose për kalimtarë të rastit.

Red.

### **Dibranët e Shkodrës**

Kolanës së librave mbi qytetin e Shkodrës dhe banorët e saj i shtohet edhe libri më i fundit i autores Zenepe Dibra: “Dibranët e Shkodrës” , (“Botimet Shkodra”, 2019.).

Libri asht një trajtesë tejet e veçantë. Janë të përmbledhuna në atë histori të njohuna dhe pak të njohuna të lidhjeve dhe të bashkëpunimit mes dibranëve dhe shkodranëve në luftë për mbrojtjen e Shkodrës nga malazezët, por edhe sakrificat e dibranëve në shumë vepra ndërtimore monumentale që gjinden në qytet.

“Libri- siç shkruan autorja- i kushtohet posaçë komunitetit të madh dibranësh që kanë dhënë contribute shumë të rëndësishme për Shkodrën dhe popullin e saj .... që së bashku me shkodranët ... punuan dhe sakrifkuan, vuajtën por edhe gëzuan së bashku për të mirën e këtij qyteti”

Zenepe Dibra ashtu si në librat e tjerë, përmes një pune dhe hulumtimi tejet rigoroz, i ka bërë dhe vijon me i bërë nder vedit, kulturës dhe personazheve të rëndësishëm të jetës qytetare të Shkodrës, tuj i krijuar qytetit një pasuni tejet të rëndësishme bibliografiko-kulturore, që në terminologjinë e bibliotekave janë “dyert” e hymjes në botën e madhe të kërkimit.

Red.

▪Veprimtari kulturore në bibliotekën “Marin Barleti”▪

- 23 gusht 2019. Prezantimi i librit përmbledhës konferencës “Shkodra në vitet e vendosjes së diktaturës” 1945-53”.
  - 26 shtator 2019. Bisedë letrare me poetin Kolec Traboini. Prezantim i librit “Ode për Shkodrën”
  - 03 tetor 2019. Jozef Radi, Bisedë letrare me nxënësit e shkollës “Oso Kuka”.
  - 05 tetor 2019. Prezantimi i librit “Shefqet Muka, Shkodrani” me autor Adnan Muka.
  - 19 tetor 2019. Prezantimi i librit “Pazari i Gjytetit” me autor Gani Karamanaga
  - 25 tetor 2019. Prezantohet libri “Saga e dhimbjes” me autore Fatbardha Mulleti
  - 07 nëntor 2019. Prezantohet “Lahuta e Malesise” me autor At Gjergj Fishta, e përkthyer në frengjisht nga Abidin Krasniqi. "Lahuta pa kohë e pa kufinj"
  - 08 nëntor 2019. Prezantimi i librit “Epopëja e Ilomit kombëtar”, me autor Gjosho Vasia
  - 09 nëntor 2019. Prezantohet libri i autorit Wilhelm Obermüller, “Banorët e Alpeve”, përkthyer nga Albert Gjoka dhe Frida, Vokopola. Organizuar në bashkëpunim me qendrën Albanologjike të Universitetit Luigi Gurakuqi.
  - 22 nëntor 2019. Bisedë me autorin Ahmet Prenci. Prezantim i librave “Udhë në pasqyre”, “Vice Versa”.
  - 23 nëntor 2019. Prezantimi i librit “Dibranët e Shkodrës”, me autore Zenepe Dibra.
- M.C.